



With funding from

 Austrian
Development
Cooperation

Nga Ligjet në Vepra

Monitorimi i reagimit institucional ndaj
dhunës me bazë gjinore në Kosovë

Nga Ligjet në Vepra

Monitorimi i përgjigjes institucionale
ndaj dhunës me bazë gjinore në Kosovë

© Rrjeti i Grave të Kosovës, 2021

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara.

Autorë: Endrita Banjska, Besarta Breznica, David JJ Ryan dhe Nicole Farnsworth

Redaktore: Lauren Hanna

Botuar online, në Prishtinë, Kosovë.

Dizajnuar nga Jeta Dobranja.

Ky publikim është prodhuar me mbështetje financiare nga Agjencia Austriake për Zhvillim. Përmbajtja e tij është përgjegjësi vetëm e autorëve dhe nuk pasqyron domosdoshmërisht pikëpamjet e Agjencisë Austriake për Zhvillim.

PËRMBAJTJA

Mirënjohje	3
Akronime dhe shkurtesa	6
Përmbledgje ekzekutive	7
Hyrje	9
Pse ky hulumtim?	12
Metodologjia	13
Rreth këtij raporti	16
Analiza Ligjore	17
Korniza ligjore ndërkombëtare	17
Çështjet tematike sipas KS dhe zbatueshmëria e tyre në ligjin e Kosovës	19
E drejta materiale	26
Hetimi, ndjekja penale, ligji procedural dhe masat mbrojtëse	40
Masat për parandalimin e dhunës	53
Mbledhja e të dhënave	56
Konkluzion	56
Përgjigja institucionale ndaj dhunës me bazë gjinore në Kosovë	58
Ndërgjegjësimi i përgjithshëm dhe zbatimi i kornizës ligjore	58
Grupi Koordinues Ndërministror kundër Dhunës në Familje	67
Policia e Kosovës	77
Instituti i Mjekësisë Ligjore	83
Prokuroria	85
Mbrojtësit e Viktimave	88
Zyrat për ndihmë juridike falas	91
Gjykatat	93
Shërbimi Korrektues i Kosovës	106
Shërbimi Sprovues	107
Shërbimet Sociale	108
Institucionet Shëndetsore	123
Institucionet dhe Shërbimet Arsimore	126
Institucioni i Avokatit të Popullit	130
Organizata e Shoqërisë Civile	130
Aktorët Ndërkobëtar	133
Rekomandime	146
Punime të Cituara	154
Shtojcat	161
Shtojca 1. Lista e të intervistuarve	161
Shtojca 2. Të dhënat për dhunën me bazë gjinore nga institucionet	169
Shtojca 3. Zbatimi i SKMDHF	176

MIRËNJOHJE

Rrjeti i Grave të Kosovës (RrGK) falënderon të gjithë përfaqësuesit e institucioneve dhe organizatave që kontribuan kohën e tyre për realizimin e këtij monitorimi. RrGK vlerëson thellësisht bashkëpunimin e saj të vazhdueshëm me Agjencinë për Barazi Gjinore në Zyrën e Kryeministrit. Ekipi hulumtues i RrGK-së i përbërë nga Nerina Guri, Endrita Banjska, Besarta Breznica, Dardan Hoti dhe Majlinda Behrami punuan pa u lodhur për të zhvilluar, transkriptuar dhe analizuar intervistat. Biljana Jaredić i zhvilloi intervistat në gjuhën serbe. David JJ Ryan është autor i analizës ligjore. Nicole Farnsworth dhe Adelina Berisha mbështetën hartimin e raportit përfundimtar. Lauren Hanna mbështeti redaktimin e raportit. Ekipi i monitorimit të gjykatës së RrGK-së kontribuoi në lidhje me rastet specifike, përfshirë Anita Mazrekaj, Blerina Sylejmani, Viona Krasniqi, Genc Kadriu, Senad Telaku dhe Tringe Arifi. Erza Kurti mbështeti integrimin e gjetjeve nga monitorimi i gjykatave në raport dhe ndihmoi në procesin e hulumtimit. Driton Zeqiri, Mirjeta Dibrani dhe Ernera Dushica ndihmuan në procesin e hulumtimit. Alba Loxha dhe Loreta Suka mbështetën përkthimin dhe transkriptimin. Anëtarët e stafit të RrGK-së ofruan mbështetje të vazhdueshme gjatë gjithë procesit të hulumtimit dhe finalizimit, duke përfshirë: Drejtoreshën Ekzekutive të RrGK-së Igballe Rogova, Drejtoreshën e Programit dhe Hulumtuesen Kryesore Nicole Farnsworth, Menaxheren e Programit Adelina Berisha, Menaxheren e Programit Zana Rudi dhe Menaxheren e Financave Besa Shehu. Kolegët redaktues dhanë komente të dobishme për draft raportin.

Rishikimi kolegjial ofroi komente të dobishme për draftin e raportit, nga Ariana Qosaj Mustafa, Kryetare e Bordit të RrGK-së dhe Ligjëruese në Riinvest International; Chiara Tagliani, Këshilltare Gjinore për Misionin e Bashkimit Evropian për Sundimin e Ligjit në Kosovë (EULEX); Edi Gusia, Kryeshefe Ekzekutive, Agjencia për Barazi Gjinore; UN Women; Basri Kastrati, Menaxher i Zyrës për Mbrojtje dhe Ndihmë Viktimave; dhe Arsim Shala, Shef i Njësisë së Dhunës në Familje në Policinë e Kosovës.

Realizimi i këtij monitorimi dhe raporti është mbështetur nga Agjencia Austriake për Zhvillim.

AKRONIME DHE SHKURTESA

ABGJ	Agjencia për Barazi Gjinore
BE	Bashkimi Evropian
BIRN	Rrjeti Ballkanik i Gazetarisë Hulumtuese
CEDAW	Konventa për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave
CMIS	Sistemi i Menaxhimit të Informacionit të Rasteve
DHF	Dhuna në Familje
EIGE	Instituti Evropian për Barazi Gjinore
EULEX	Misioni i Bashkimit Evropian për Sundimin e Ligjit në Kosovë
GREVIO	Grupi i Ekspertëve për Veprim Kundër Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje
GJEDNJ	Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut
GjPNJ	Gjykata Penale Ndërkombëtare për ish-Jugosllavinë
IAPK	Instituti i Avokatit të Popullit të Kosovës
IKAP	Instituti i Kosovës për Administratë Publike
IML	Instituti i Mjekësisë Ligjore
KB	Kombet e Bashkuara
KGJK	Këshilli Gjyqësor i Kosovës
KIPRED	Instituti Kosovar për Kërkime dhe Zhvillim të Politikave
KNDHF	Koordinatori Nacional kundër Dhunës në Familje
KPK	Kodi Penal i Kosovës
KPPK	Kodi i Procedurës Penale i Kosovës
KS	Konventa e Këshillit të Evropës për parandalimin dhe luftimin e dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje (“Konventa e Stambollit”)
LGBTQIA+	Lezbike, Gej, Biseksual-e, Transgjinnor-e, Queer, Interseks, Aseksual-e dhe identifikime tjera
LMDHF	Ligji për Mbrojtje nga Dhuna në Familje
M&V	Monitorimi dhe Vlerësimi
MAPL	Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
MASHT	Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë
MD	Ministria e Drejtësisë
MF	Ministria e Financave
MK	Mekanizmi i Koordinimit
MPB	Ministria e Punëve të Brendshme
MPMS	Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale
MSH	Ministria e Shëndetësisë
MTI	Ministria e Tregtisë dhe Industrisë
MV	Mbrojtës i Viktimave
MZHE	Ministria e Zhvillimit Ekonomik
Nr.	Numri

NJHDHF	Njësia për Hetimin e Dhunës në Familje
OJQ	Organizatë Jo Qeveritare
ON	Organizatë Ndërkombëtare
OSBE	Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë
OShC	Organizatë e Shoqërisë Civile
PK	Policia e Kosovës
PSV-të	Procedurat Standarde të Veprimit për Mbrojtje nga Dhuna në Familje në Kosovë
QAP	Qendra e Aftësimit Profesional
QPS	Qendra për Punë Sociale
QRP	Qendra Rajonale e Punësimit
RAE	Rom, Ashkali dhe Egjiptian
RrGK	Rrjeti i Grave të Kosovës
RROGRAEK	Rrjeti i Organizatave të Grave Rome, Ashkali dhe Egjiptase në Kosovë
SIT	Qendra për Këshillim, Shërbime Sodiale dhe Hulumtime
SKMDHF	Strategjia Kombëtare e Republikës së Kosovës për Mbrojtje nga Dhuna në Familje dhe Plani i Veprimit
TIK	Teknologjia e Informacionit dhe Komunikimit
SHKK	Shërbimet Korrektuese të Kosovës
UMPE-të	Urdhra për Mbrojtje të Përkohshme Emergjente
UNDP	Programi i Zhvillimit i Kombeve të Bashkuara
UNFPA	Fondi i Kombeve të Bashkuara për Popullsinë
UNICEF	Fondi për Fëmijë i Kombeve të Bashkuara
UNMIK	Misioni i Kombeve të Bashkuara në Kosovë
UM	Urdhër i Mbrojtjes
UME	Urdhri i Mbrojtjes Emergjente
UNODC	Zyra e Kombeve të Bashkuara për Drogat dhe Krimin
UNW	UN Women
ZMNV	Zyra për Mbrojtje dhe Ndihmë Viktimave
ZBGJ	Zyrtar për Barazi Gjinore
ZKBGJ	Zyra Komunale për Barazi Gjinore
ZNJ	Zyrtarët e Ndihmës Juridike
ZP	Zyra e Punësimit

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Në lidhje me kornizën ligjore për adresimin e dhunës me bazë gjinore në Kosovë që nga viti 2015 kanë ndodhur disa ndryshime: ndryshimi i Kushtetutës së Kosovës për të përfshirë Konventën e Stambollit, përfshirja e dhunës në familje dhe ngacmimit seksual në Kodin Penal të Kosovës, dhe themelimi i Strategjisë Kombëtare për Mbrojtje nga Dhuna në Familje dhe Planit të Veprimit (2016-2020) (SKMDHF). Ligjet dhe politikat e tjera relevante janë duke u shqyrtuar. Në këtë kontekst, Rrjeti i Grave të Kosovës ndërmori këtë hulumtim për të identifikuar boshllëqet e mbetura në kornizën ligjore të Kosovës drejt zbatimit të Konventës së Stambollit dhe për të informuar proceset në vazhdim me një vlerësim të njohurive, qëndrimeve dhe performancës së institucioneve përgjegjëse në zbatimin e kornizës ligjore përkatëse. Ky raport përmbledh gjetjet, bazuar në literaturën ekzistuese, intervistat me 190 aktorë përkatës, monitorimin e gjykatave dhe të dhënat ekzistuese.

Një kuptim gjinor i dhunës ndaj grave nuk është integruar plotësisht në kornizën ligjore të Kosovës. Ndërsa disa instrumente adresojnë dhunën në familje, ka pak ndërhyrje në politika për t'iu përgjigjur formave të tjera të dhunës me bazë gjinore. Miratimi i Draftit të Kodit të Procedurës Penale do ta sjellë ligjin e Kosovës më afër Konventës së Stambollit në formalitet, por ndryshime të mëtejshme ligjore dhe të politikave janë të nevojshme për të zbatuar një kornizë të integruar, efektive, gjithëpërfshirëse dhe të koordinuar për parandalimin dhe adresimin e të gjitha formave të dhunës me bazë gjinore. Progresi dhe koordinimi ndërinstitutional janë penguar nga mungesa e pozitive të nëpunësve civilë të përhershëm të mandatuar ligjërisht përgjegjëse për zbatimin, monitorimin dhe vlerësimin, përkatësisht, në nivelet kombëtare dhe komunale.

Në përgjithësi, ky hulumtim gjeti disa përmirësime në njohuritë dhe qëndrimet e institucioneve përgjegjëse për adresimin e dhunës me bazë gjinore që nga monitorimi i fundit i realizuar në vitin 2017. Megjithatë, ekzistonte kuptimi i pamjaftueshëm i dhunës me bazë gjinore, veçanërisht dhuna seksuale. Fajësimi i viktimës vazhdon. Përpjekjet për të "pajtuar" çiftin "për të ruajtur familjen" dhe shkeljet e konfidencialitetit mbeten mbizotëruese në rastet e dhunës në familje. SKMDHF u zbatua vetëm pjesërisht. Ndarjet e pamjaftueshme të buxhetit penguan përgjigjen e duhur. Lidhur me institucionet specifike, Policia e Kosovës kishte prirje të dinte shkeljet e reja në Kodin Penal dhe përgjegjësitë e tyre. Sidoqoftë, disa zyrtarë larguan viktimat nga shtëpitë e jo kryesit. Ndërsa policia dhe prokurorët duhet të ndjekin krimet e pretenduara, edhe nëse viktimat tërheqin dëshminë, kjo nuk ka ndodhur gjithmonë. Rritja e besimit në polici çoi në shtimin e raportimit, por disa grupe të cënueshme ende kanë frikë t'i drejtohen policisë. Ndërsa u caktuan prokurorë dhe gjykatës të specializuar, mungesat e burimeve njerëzore ende ngadalësojnë prioritetin e këtyre rasteve, si dhe pengojnë aftësinë e Avokatëve të Viktimave për të mbështetur viktimat. Presioni i gjyqtarëve ndaj viktimave për tu pajtuar me kryesit e krimeve vazhdoi dhe shqiptimi i dënimit nuk ka qenë gjithmonë efektiv, proporcional dhe dekurajues, siç përcaktohet në Konventën e Stambollit. Shërbimi Korrektues dhe Shërbimi Sprovues ende nuk kanë programe për riintegrimin dhe rehabilitimin e kryesve të dhunës ose përcjelljen e këtyre rasteve. Qendrat për Punë Sociale kanë pasur vështirësi për të siguruar menaxhimin e duhur të rasteve për shkak të mungesës së personelit. Kjo minon aftësinë e tyre për të përfaqësuar të drejtat e fëmijëve. Strehimore të vazhdojnë të përballen me probleme financiare, megjithëse financimi u përmirësua që nga viti 2019. Përfaqësuesit e

institucioneve arsimore dhe shëndetësore vazhdojnë të kenë mungesë të vetëdijesimit për dhunën me bazë gjinore dhe ka të ngjarë të mos i raportojnë gjithmonë rastet në polici. Programet e trajtimit janë të kufizuara. Zyrtarët e Qendrave të Aftësisit Profesional dhe të Zyrave të Punësimit zakonisht nuk kishin njohuri për përgjegjësitë e tyre ligjore dhe qasjen që duhet të kishin për të ndihmuar personat që kanë përjetuar dhunë me bazë gjinore.

Raporti jep konkluzione me rekomandime për ndryshime ligjore dhe për secilin institucion përkatës. Një shtojcë përmbledh gjetjet nga monitorimi i zbatimit të SKMDHF.

HYRJE

Dhuna me bazë gjinore është dhuna e kryer ndaj një personi për shkak të gjinisë, ose dhuna që prek personat e një gjinie të veçantë në mënyrë disproporcionale. Duke pasur parasysh marrëdhëniet e pabarabarta që ekzistojnë midis grave dhe burrave në shumicën e shoqërive, dhuna me bazë gjinore ka tendencë të prekë gratë dukshëm më shumë sesa burrat.¹ Në të vërtetë, dhuna ndaj grave dhe vajzave është ndër shkeljet më të përhapura të të drejtave të njeriut në të gjithë botën.²

Në Kosovë, një anketë e vitit 2019 nga Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE) zbuloi se 57% e grave të anketuara kishin pësuar dhunë psikologjike, fizike ose seksuale që nga mosha 15 vjeç.³ Më specifikisht, 53% e grave kishin pësuar dhunë psikologjike, 9% dhunë fizike dhe 4% dhunë seksuale nga partneri intim. Ndërsa anketa e OSBE-së nuk i intervistoi burrat, një anketë e vitit 2015 nga Rrjeti i Grave të Kosovës (RrGK) zbuloi se 56% e burrave dhe 68% e grave kishin pësuar një formë të dhunës në familje gjatë jetës së tyre.⁴ Për shkak të marrëdhënieve ekzistuese të pushtetit dhe pabarazive të ndërthurura, disa persona mund të jenë veçanërisht të prekshëm nga dhuna me bazë gjinore, të tillë si Lezbike, Gej, Biseksual-e, Transgjinnor-e, Queer, Interseks, Aseksual-e dhe persona me identifikime tjera (LGBTQIA+) dhe gra me aftësi të ndryshme fizike ose mendore.⁵ Studimi i OSBE-së zbuloi se gratë që kishin nivele më të ulëta arsimimi, ishin të varura financiarisht ose ato që jetonin në zona rurale kishin më shumë gjasa të deklaronin se kishin përjetuar dhunë në familje.

Më shumë gra kanë përjetuar dhunë me bazë gjinore sesa raportohet në këto anketa. Duke pasur parasysh që shumë gra në Kosovë (48%) ende e konsiderojnë një dhunë të tillë, veçanërisht dhunën në familje, një çështje private,⁶ dhuna me bazë gjinore shpesh vazhdon të fshihet, pa u raportuar kurrë. Kjo pengon aftësinë e institucioneve për të adresuar dhunën. Për më tepër, OSBE gjeti një korrelacion midis të anketuarve që përjetojnë dhunë dhe besojnë se dhuna në familje është çështje private, që gratë duhet të jenë të bindura (të dëgjueshme) dhe se gratë duhet të jenë të nënshtruara. Gratë që shprehën këto bindje kishin më shumë të ngjarë të tregonin se kishin përjetuar dhunë në familje.

Rekomandimi i Përgjithshëm nr. 19 i Konventës së KB për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave (CEDAW) e ka njohur dhunën ndaj grave, si në sferën private ashtu edhe në atë publike, si shkelje të të drejtave të njeriut që kërkon adresim nga shtetet.⁷ Në vitin 2014, Konventa e Këshillit të Evropës për parandalimin dhe luftimin e dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje, e njohur si “Konventa e Stambollit” (në tekstin e mëtejshëm, “KS”), prezantoi një sërë detyrimesh gjithëpërfshirëse për adresimin e dhunës me bazë gjinore brenda kornizës ligjore të së drejtës ndërkombëtare

¹ Këshilli i Europës, [Çfarë e shkakton dhunën në baza gjinore](#). ND.

² UNFPA, [Dhuna me bazë gjinore](#), 2017.

³ OSBE, [Anketë për Mirëqenien dhe Sigurinë e Grave në Kosovë](#), 2019

⁴ Farnsworth, N., Qosaj-Mustafa, A., Banjska, I., Berisha, A. dhe Morina, D., për RrGK, [Mjaft më me arsytetime – Një analizë e qëndrimeve, incidencës dhe përgjigjes institucionale ndaj dhunës në familje në Kosovë](#), 2015

⁵ Berisha, A., Farnsworth, N., dhe Hoti, D. për RrGK, [Nga Fjalët në Vepra: Monitorimi i reagimit institucional ndaj dhunës me bazë gjinore në Kosovë](#), 2017

⁶ OSBE, [Anketa e udhëhequr nga OSBE mbi dhunën ndaj grave: Mirëqenia dhe Siguria e Grave](#), 2019 Kjo i bën jehonë rezultateve të anketës së RrGK-së të vitit 2015 ku 31% e kosovarëve e konsideruan dhunën në familje çështje private pasi fqinjët nuk duhet ta raportojnë atë në polici (Farnsworth dhe të tjerët për RrGK, [Mjaft më me arsytetime](#), 2015).

⁷ Komiteti i KB për Eliminimin e Diskriminimit Kundër Grave, Rekomandimi i Përgjithshëm i CEDAW Nr. 19: Dhuna ndaj grave, 1992 Me Rekomandimin e Përgjithshëm nr. 35 është identifikuar gjithashtu që ndalimi i dhunës me bazë gjinore ndaj grave ka kaluar dhe evoluar në një parim detyrues të së drejtës ndërkombëtare zakone.

të të drejtave të njeriut, duke e bërë atë instrumentin e parë ligjërish të detyrueshëm të llojit të tij.⁸ KS pranon që dhuna ndaj grave është pjesë e një sistemi më të gjerë të shtypjes. Gratë përfshijnë dhunë strukturore të bazuar në gjini, e cila ndryshon nga dhuna incidentale e kryer ndaj burrave.⁹ Për shembull, në Kosovë, ky sistem më i gjerë i shtypjes përfshin nivele më të ulëta të punësimit, diskriminim në punësim të bazuar në gjini, nën-përfaqësim të grave në pozitat e vendimarrjes dhe pronësi minimale të pronës.¹⁰ Të gjitha këto përbëjnë shkelje të të drejtave, ndërkohë që i vendosin gratë në një pozitë të pabarabartë brenda shoqërisë dhe kështu në rrezik më të madh nga dhuna. Kosova është zotuar për zbatimin e CEDAW, dhe në vitin 2020, Kosova përfshiu KS në Kushtetutën e saj, duke e bërë të zbatueshme gjithashtu.¹¹

Përveç nevojës kryesore për të adresuar dhunën me bazë gjinore si një shkelje të rëndë të të drejtave të njeriut, parandalimi i dhunës gjithashtu mund të kontribuojë në uljen e kostove thelbësore të shtetit, në lidhje me policinë, drejtësinë, shërbimet sociale dhe papunësinë, ndër të tjera.¹² Në Kosovë, vlerësimet e mëhershme sugjerojnë se vetëm dhuna në familje i kushtoi shtetit më shumë sesa 3.1 milion euro si në vitin 2011 ashtu edhe në vitin 2012 në kosto direkte, dhe dukshëm më shumë në aspektin e ditëve të humbura në punë, ndikimet në shëndet, dhe rezultatet e punësimit arsimor ose afatgjatë për fëmijët, ndër kostot e tjera.¹³ Kështu, trajtimi dhe parandalimi i dhunës, veçanërisht i përsëritjes së veprës penale, është në interes të shtetit.

Që nga viti 2008, Kosova ka miratuar disa ligje dhe politika drejt adresimit dhe përmirësimit të reagimit të saj institucional ndaj dhunës me bazë gjinore.¹⁴ Kohët e fundit, në vitin 2019, Kodi Penal i Kosovës (KPK) u ndryshua për të përfshirë veprat penale në përputhje me KS, duke përfshirë: dhunën në familje, ngacmimet seksuale dhe gjymtimin e organeve gjenitale të grave.¹⁵ KPK tani e njeh dhunën në familje si dhunë fizike, psikologjike, seksuale ose ekonomike ose keqtrajtim brenda një marrëdhënieje familjare. Ligji për Mbrojtje nga Dhuna në Familje (LMDHF) përcakton në mënyrë të ngjashme këto lloje të dhunës.¹⁶ Ndërkohë, në vitin 2020 Kosova filloi të bëjë hapat e parë për të ndryshuar LMDHF në mesin e ligjeve tjera relevante, për të përmbushur më mirë nevojat e identifikuar dhe për t'i harmonizuar ato me KS. Strategjia Kombëtare e Republikës së Kosovës për Mbrojtjen nga Dhuna në Familje dhe Plani i Veprimit (SKMDHF) për 2016-2020 dhe Procedurat Standarde të Veprimit për Mbrojtjen nga Dhuna në Familje në Kosovë (PSV) gjithashtu ishin vendosur për rishikim

⁸ Këshilli i Evropës, *Konventa e Këshillit të Evropës për parandalimin dhe luftimin e dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje* (Konventa e Stambollit), 2011.

⁹ Berisha dhe të tjerët. për RrGK, *Nga Fjalët në Vepra*, 2017.

¹⁰ Për detaje të mëtejshme të pabarazive ekzistuese strukturore, shih Farnsworth, N., Morina, D., Ryan, D., Rrahmani, G., Robinson-Conlon, V., dhe Banjska, I. për RrGK, *Analiza Gjinore e Kosovës*, 2018

¹¹ KS tani është e zbatueshme nën nenin 22 [Zbatimi i drejtpërdrejtë i Marrëveshjeve dhe Instrumenteve Ndërkombëtare], 2008

¹² Për shembull, një studim rasti në Mbretërinë e Bashkuar nga Instituti Evropian për Barazi Gjinore vlerësoi se dhuna me bazë gjinore i kushton vendit më shumë se 32.5 miliardë euro në vit (*Vlerësimi i kostove të dhunës me bazë gjinore në Bashkimin Evropian: Raport*, 2014)

¹³ Farnsworth, N., Qosaj-Mustafa, A., Ekonomi, M., Shima, A., dhe Dauti-Kadriu, D. për RrGK, *Me çfarë çmimi? Alokimet Buxhetore për Zbatimin e Kornizës Ligjore kundër Dhunës në Familje në Kosovë*, 2012

¹⁴ Për informacione të mëtejshme, shihni kapitullin tjetër dhe publikimet e mëparshme të RrGK-së.

¹⁵ Kuvendi i Republikës së Kosovës, *Kodi Penal i Kosovës*, 2019

¹⁶ Ligji Nr. 03/L-182, Ligji për Mbrojtje nga Dhuna në Familje, 2010

nga Agjencia për Barazi Gjinore dhe Ministria e Drejtësisë përmes Zyrës së Koordinatorit Nacional kundër Dhunës në Familje.¹⁷ Në këtë kontekst, dhe duke lejuar ndryshimet ligjore të sipërpërmendura, hulumtimi i tanishëm u përpoq të monitoronte nëse institucionet dinë për këto ndryshime, si kanë filluar t'i zbatojnë ato, dhe për të mbledhur prova që mund të informojnë më tej ndryshimet e ardhshme ligjore dhe të politikave.

Përmirësimi i përgjigjes së Kosovës ndaj dhunës me bazë gjinore si shkelje e të drejtave të njeriut, përfshirë sigurimin e qasjes në drejtësi, është i rëndësishëm për pranimin e dëshiruar të Kosovës në Bashkimin Evropian (BE), pasi këto përbëjnë të drejta themelore. Komisioni Evropian ka vërejtur mangësi në performancën e institucioneve në adresimin e dhunës me bazë gjinore. Në *Raportin e Komisionit Evropian të Kosovës 2018*, Komisioni Evropian theksoi disa çështje, përfshirë: mungesën e koordinimit midis policisë, prokurorëve, institucioneve gjyqësore dhe aktorëve të tjerë kryesorë që merren me dhunën me bazë gjinore; nevojën për financim të qëndrueshëm për strehimoret; dhe nevojën për riintegrim më efektiv të viktimave.¹⁸ *Raporti i Komisionit Evropian të Kosovës 2019* ka vërejtur që strehimoret ende nuk kanë financim të qëndrueshëm dhe theksuan sfidën e dënimit minimal.¹⁹ Një studim nga Këshilli i Evropës më tej zbuloi se ekziston ende mungesë e strehimit afatgjatë dhe e mundësive ekonomike për viktimat e dhunës në familje dhe se mbështetja ligjore nga Mbrojtësit e Viktimave (MV) ende varet nga kapacitetet e individit të caktuar për rastin.²⁰ Të gjitha këto janë çështje që SKMDHF duhej të adresonte brenda afatit kohor 2016-2020.²¹ Për të lehtësuar rishikimin e zbatimit të SKMDHF, si dhe monitorimin e vazhdueshëm të progresit në lidhje me procesin e pranimin në BE, hulumtimi aktual gjithashtu kërkoi të shqyrtojë çdo ndryshim në përgjigjen institucionale ndaj dhunës me bazë gjinore në Kosovë. Në të vërtetë, Monitorimi paraprak i RrGK-së ka ndihmuar e mbështetur qeverinë e Kosovës dhe BE-në duke siguruar dëshmi të situatës aktuale.

Ndërkohë, *Raporti i Kosovës 2019* identifikoi gjithashtu përmirësime që nga viti 2018, duke vërejtur se emërimi i Koordinatorit Nacional kundër Dhunës në Familje kontribuoi në përmirësime të dukshme në përpjekjet për të zbatuar SKMDHF.²² Raporti njohu faktin që në vitin 2019 shtatë komuna krijuan mekanizma koordinues për adresimin e dhunës në familje dhe institucionet krijuan një bazë të dhënash për regjistrimin e rasteve të dhunës në familje. Sidoqoftë, vetëm afërsisht gjysma e komunave të Kosovës duket se kanë vendosur mekanizma koordinues.²³ Për më tepër, në të kaluarën, funksionimi i tyre ka qenë i përzier, varësisht nga vendndodhja.²⁴ Duke pasur parasysh rolin e rëndësishëm që mekanizmat e tillë luajnë në sigurimin e një qasjeje kohore të duhur ndërinstitucionale, të përqendruar në viktimën për mbrojtjen (shih Kutinë I), rehabilitimin dhe shërbimet e ri-integrimit,

¹⁷ Një vlerësim i zbatimit të PSV-ve u krye për të informuar këtë. ABGJ, Vlerësimi i nivelit të zbatimit të Procedurave Standarde të Operacionit për Mbrojtjen nga Dhuna në Familje në Kosovë, 2019.

¹⁸ Komisioni Evropian, *Dokumenti i Punës së Stafit të Komisionit, Raporti Kosovë** 2018, 2018.

¹⁹ Komisioni Evropian, *Dokumenti i Punës së Stafit të Komisionit, Raporti Kosovë** 2019, 2019.

²⁰ Krol, P., Kabashi, E., Ramizi Bala, A. për Këshillin e Evropës, *Krijimi i hartës së shërbimeve mbështetëse për viktimat e dhunës ndaj grave në Kosovë*, 2017

²¹ Ministria e Drejtësisë, *Strategjia Kombëtare e Republikës së Kosovës për Mbrojtjen nga Dhuna në Familje dhe Plani i Veprimit* (2016-2020), 2017

²² Komisioni Evropian, *Dokumenti i Punës së Stafit të Komisionit, Raporti Kosovë** 2019, 2019

²³ UN Women (UNW), raport i progresit i siguruar për RrGK më 18 maj 2020, i pabotuar, 2019.

²⁴ Berisha dhe të tjerët për RrGK, *Nga Fjalët në Vepra*, 2017

ky hulumtim gjithashtu ka pasur për qëllim të shqyrtojë funksionimin e tyre aktual dhe nëse ka pasur ndonjë përmirësim me kalimin e kohës.

Kutia 1. Përkufizimi i një “Qasjeje të përqendruar në viktimë”

Përdorimi i një “qasjeje të përqendruar në viktimë” do të thotë që institucionet duhet të përpiqen të vendosin gjithmonë në vend të parë prioritetet dhe nevojat e personave që kanë pësuar dhunë.²⁵ Si parim themelor, institucionet duhet të minimizojnë dëmin dhe të rrisin sigurinë e personave që kanë përjetuar dhunë. Ndjeshmëria dhe konfidencialiteti duhet të sigurohen dhe informacioni të ndahet me institucionet e tjera vetëm pas pëlqimit të personit të prekur. Personat që kanë pësuar dhunë duhet të informohen plotësisht për të drejtat e tyre njerëzore, të drejtat ligjore dhe shërbimet mbështetëse në dispozicion të tyre. Pasi të jenë të sigurt dhe të aftë, institucionet duhet t’i angazhojnë ata në zhvillimin e një plani që siguron sigurinë e tyre dhe përfundimisht i mbështet me shërbime rehabilitimi të përshtatura për nevojat e tyre. Për më tepër, ata duhet të kenë të drejtën të japin informata kthyesë mbi mënyrën se si institucionet i kanë trajtuar ata, përfshirë edhe në lidhje me referimet; dhe institucionet duhet të përdorin këto informata kthyesë për të përmirësuar shërbimet. Të gjithë ofruesit e shërbimeve duhet të marrin trajnim për një qasje të përqendruar në viktimë dhe të sigurojnë zbatimin e qasjes në praktikë. Përdorimi i një qasjeje të përqendruar në viktimë është në përputhje me KS.

PSE KY HULUMTIM?

Misioni i RrGK-së është të mbështesë, mbrojë dhe promovojë të drejtat e grave dhe vajzave. Për të arritur këtë, një nga qëllimet strategjike afatgjata të RrGK-së është që gratë dhe vajzat të jetojnë të lira nga dhuna me bazë gjinore.²⁶ Për të bërë përparim drejt këtij vizioni, RrGK rregullisht monitoron performancën e institucioneve për të vlerësuar progresin e tyre në zbatimin e kornizës ligjore. Përmes monitorimit, RrGK kërkon të sigurojë prova që mund të përdoren në komunikimin dhe avokimin me institucione, drejt një përgjigjeje të përmirësuar. RrGK në këtë mënyrë synon të sigurojë informacion të dobishëm dhe kritikë konstruktive që do të çojë në përmirësimin e jetës për personat më të prekur nga dhuna, veçanërisht gratë. Në vitin 2008,²⁷ 2009,²⁸ 2015,²⁹ dhe 2017,³⁰ RrGK zhvilloi një hulumtim në të gjithë Kosovën që shqyrtoi përgjigjen institucionale ndaj dhunës me bazë gjinore, duke u përqendruar në dhunën në familje dhe, që nga viti 2015, në ngacmimet seksuale. Të kryera në bashkëpunim të ngushtë me Agjencinë për Barazi Gjinore në Zyrën e Kryeministrit të Kosovës (ABGJ), së bashku me institucionet e tjera përkatëse, këto studime kanë dhënë një kontribut të rëndësishëm në informimin

²⁵ Ky përshkrim del nga ai i UN Women, “*Qasja e përqendruar në viktimë/të mbijetuar*”, 2019.

²⁶ RrGK, *Strategjia 2019-2022*, 2018

²⁷ Farnsworth, N. dhe Qosaj-Mustafa, A. për RrGK në bashkëpunim të ngushtë me Agjencinë për Barazi Gjinore (ABGJ), *Siguria fillon në shtëpi: Kërkime për të informuar strategjinë kombëtare dhe planin e veprimit kundër dhunës në familje në Kosovë*, ABGJ: 2008

²⁸ Qosaj-Mustafa, A. dhe Farnsworth, N. për RrGK, *Më Shumë se “Fjalë në Letër”? Përgjigja e Organeve të Drejtësisë Ndaj Dhunës në Familje në Kosovë*, UNDP, 2009

²⁹ Farnsworth dhe të tjerët për RrGK, *Mjaft më me arsyetime*, 2015

³⁰ Berisha dhe të tjerët për RrGK, *Nga Fjalët në Vepra*, 2017

e LMDHF, SKMDHF,³¹ dhe PSV-ve. Kohët e fundit, Raporti i RrGK 2017, *Nga Fjalët në Vepra*, përdori gjetjet nga monitorimi i reagimit institucional ndaj dhunës në familje për të bërë rekomandime për secilin institucion përgjegjës.³² Që nga ajo kohë, RrGK është takuar me përfaqësuesit e institucioneve për të diskutuar këto rekomandime dhe për të mbështetur zbatimin e tyre. Ky raport i tanishëm gjithashtu kërkon të vlerësojë nëse institucionet kanë zbatuar rekomandimet e mëparshme të RrGK-së dhe shkallën në të cilën performanca e tyre është përmirësuar që nga ushtrimi i monitorimit të vitit 2017. Ky hulumtim ka për qëllim të matë ndryshimet në qëndrimet e institucioneve, ndërgjegjësimin e tyre dhe trajtimin nga to të dhunës me bazë gjinore që nga viti 2017, si dhe të monitorojë zbatimin e kornizës ligjore nga institucionet përkatëse.

Meqenëse ka pasur disa ndryshime të dallueshme në kornizën ligjore që nga viti 2017, përfshirë miratimin e KS në Kushtetutën e Kosovës në vitin 2020, ky raport gjithashtu analizon shkallën në të cilën këto janë zbatuar dhe cilët hapa mbeten të pazgjidhur në mënyrë që të harmonizohet plotësisht korniza me KS. Për më tepër, pasi SKMDHF skadoi në vitin 2020, ky monitorim i kryer u përpoq të vlerësonte zbatimin e SKMDHF, për të informuar procesin e hartimit të strategjisë së re dhe planit të veprimit në vitin 2021. Në përgjithësi, ky hulumtim kërkon të propozojë rekomandime të bazuara në prova për përmirësimin e përgjigjes institucionale ndaj dhunës me bazë gjinore në Kosovë.

METODOLOGJIA

Për të arritur qëllimet e lartpërmendura, ky hulumtim u përpoq t'u përgjigjej tri pyetjeve të ndërlidhura të hulumtimit dhe nën-pyetjeve shoqëruese:

1. Deri në çfarë mase është harmonizuar korniza ligjore në lidhje me dhunën me bazë gjinore me KS; deri në çfarë mase po zbatohet korniza; cilat pjesë kanë nevojë për rishikim të mëtejshëm; dhe se si është përmirësuar kjo që nga viti 2017, nëse ka pasur përmirësim?
 - 1.1. Deri në çfarë mase është zbatuar SKMDHF (2016-2020)?
 - 1.2. Deri në çfarë mase po zbatohen dispozitat e reja të KPK-së që kanë të bëjnë me dhunën me bazë gjinore?
2. Deri në çfarë mase janë të vetëdijshëm përfaqësuesit e institucioneve përkatëse publike për detyrat e tyre në lidhje me trajtimin e rasteve të dhunës me bazë gjinore, dhe si ka ndryshuar kjo vetëdije që nga viti 2017, nëse ka ndryshuar?
 - 2.1. Sa janë të vetëdijshëm për llojet e ndryshme të dhunës me bazë gjinore?
 - 2.2. Sa janë të vetëdijshëm për detyrat e tyre në lidhje me dhunën në familje?
3. Deri në çfarë mase po i zbatojnë institucionet përkatëse përgjegjësitë e tyre?
 - 3.1. Deri në çfarë mase po funksionojnë mekanizmat e koordinimit?
 - 3.2. Cilat sfida ekzistojnë për qëndrueshmërinë dhe funksionimin e tyre të duhur?

Për këtë hulumtim, dhuna me bazë gjinore u operacionalizua, që përcaktohet, për të përfshirë dhunën në familje, dhunën fizike, dhunën psikologjike, martesën e detyruar, abortin e detyruar,

³¹ Rreth 70% e rekomandimeve të RrGK-së që rezultojnë nga raporti [Mjaft më me arsye time](#) u përfshinë në SKMDHF.


³² Berisha dhe të tjerët për RrGK, [Nga Fjalët në Vepra](#), 2017

sterilizimin e detyruar, dhunën e mundësuar nga teknologjia, ngacmimin seksual, përdhunimin, sulmin seksual, gjymtimin e organeve gjenitale të grave, ndjekjen dhe vrasjen. Ekipi hulumtues pranon që ekzistojnë forma të tjera të dhunës me bazë gjinore, sidomos duke përfshirë trafikimin e qenieve njerëzore. Format e tjera nuk janë shqyrtuar në këtë hulumtim për shkak të kufizimeve në kohë dhe burime. RrGK përdor termin “viktimë” në këtë raport sepse KS, ligji i BE-së dhe korniza ligjore e Kosovës e përdorin këtë term.³³ Megjithatë përdoret ky term, RrGK gjithashtu njeh agjencinë e mundshme dhe autonominë e personave që kanë pësuar dhunë.

Ky hulumtim ka përdorur një metodologji të ngjashme me atë të përdorur për hulumtimet paraprake të RrGK-së mbi dhunën me bazë gjinore, drejt krahasimit me kalimin e kohës. Hulumtimi ka përfshirë metoda të përziera, duke përfshirë një rishikim të kornizës përkatëse ligjore, vëzhgimin e përgjigjes institucionale ndaj dhunës me bazë gjinore, hulumtime në tryezë, intervista dhe një rishikim të të dhënave statistikore.

Së pari, rishikimi i kornizës ligjore shqyrtoi ligjin dhe politikën e Kosovës në lidhje me KS dhe aspektet përkatëse të *acquis* të barazisë gjinore të BE-së. U përpoq të identifikonte çdo ndryshim që ende nevojitet në kornizën ligjore në fuqi. Rishikimi ligjor informoi hartimin e pyetjeve të hulumtimit për intervista.

Grafiku 1. Rastet e monitoruara në gjykata për secilën komunë



Së dyti, gjashtë monitorues nëpër gjykata të trajnuar nga RrGK-së monitoruan punën e institucioneve përgjegjëse në adresimin e 297 rasteve të ndryshme të dhunës me bazë gjinore ndërmjet janarit dhe qershorit 2020 (gjashtë muaj) në gjashtë rajone ku ndodhen gjykatat: Prishtinë, Besianë, Gjiilan, Ferizaj, Prizren dhe Pejë (shih Grafikon 1) Në thelb më shumë raste janë monitoruar në Prishtinë sepse ka më shumë gjykata në Prishtinë dhe më shumë raste janë të raportuara. Monitoruesit zgjedhën rastet duke përdorur marrjen e mostrave të përshtatshme, duke u përpjekur të ndjekin të gjitha rastet e raportuara në institucionet përkatëse. Në disa raste, anëtarët e stafit të RrGK-së ose monitoruesit

³³ Përkufizimi i Viktimës, Instituti Evropian për Barazi Gjinore, 2012; [Direktiva 2012/29/BE](#), 2012

gjithashtu ndoqën rastet kur njerëzit iu drejtuan RrGK-së dhe kërkuan që RrGK-ja të monitorojë rastin e tyre. Monitoruesit përdorën një protokoll monitorimi të vendosur për të vëzhguar rastet, të cilat përfshinin vlerësimin e punës së të gjitha institucioneve të përfshira në një seancë gjyqësore të caktuar. Ata gjithashtu morën pjesë në dëgjime në Qendrat për Punë Sociale (QPS), kur ishte e nevojshme. Monitoruesit regjistruan vëzhgimet në një softuer të sigurt në internet (Kobo Tool Box), i cili përmbante një grup pyetjesh të standardizuara për secilin institucion, bazuar në përgjegjësitë e tyre ligjore.

Së treti, ekipi hulumtues shtatë anëtarësh i RrGK-së zhvilloi 190 intervista gjysmë të strukturuara me institucione dhe aktorë përgjegjës për zbatimin e kornizës ligjore që lidhet me dhunën me bazë gjinore (55.5% gra, 45.5% burra). Të anketuarit u përzgjedhën në përputhje me përgjegjësitë e tyre ligjore dhe duke përdorur marrjen e mostrave nga institucionet e mëposhtme: Policia e Kosovës, Mbrojtësit e Viktimave, QPS-të, gjykatat civile, gjykatat penale, prokuroria, Institucioni i Avokatit të Popullit, shërbimet korrektuese, shërbimet sprovuese, institucionet arsimore, institucionet shëndetësore, qendrat e punësimit, Qendrat e Aftësimit Profesional, Instituti i Mjekësisë Ligjore dhe strehimoret për personat që kanë pësuar dhunë. RrGK gjithashtu intervistoi organizata të ndryshme të shoqërisë civile (OSHC) që punojnë për të adresuar dhunën me bazë gjinore.³⁴ Kjo përfshinte mësimin nga përvojat dhe ekspertiza e organizatave anëtare të RrGK-së, kryesisht strehimoreve. Intervistat u zhvilluan në zonat rurale dhe urbane të Prizrenit, Suharekës, Rahovecit, Pejës, Klinës, Malishevës, Gjakovës, Gjilanit, Mitrovicës së Jugut, Mitrovicës së Veriut, Prishtinës, Vushtrrisë, Drenasit dhe Ferizajt. Udhëzimet e intervistave të përshtatura për secilin institucion përfshinin pyetje në lidhje me përgjegjësitë ligjore të institucionit, njohuritë për këto përgjegjësi, qëndrime dhe përvoja në trajtimin e rasteve të dhunës me bazë gjinore që nga viti 2017. Atyre gjithashtu iu kërkua të reflektojnë mbi ndryshimet që kanë ndodhur në institucionin e tyre që nga viti 2017.

Duke pasur parasysh izolimin dhe masat parandaluese të ndërmarra në Kosovë për të parandaluar përhapjen e virusit COVID-19, hulumtuesit kryen 130 intervista online (69%). Për të lehtësuar interpretimin, hulumtuesit këmbëngulën që intervistat të kryheshin duke përdorur kamera kompjuterike në mënyrë që ata të mund të vëzhgonin gjuhën e trupit dhe shprehjet e të intervistuarve. Për të arritur fokusim të hulumtuesve dhe vlefshmëri të shtuar, dy hulumtues morën pjesë në shumicën e intervistave: një intervistues dhe një mbajtës shënimesh.³⁵ Hulumtuesit gjithashtu përdorën reflektimin, duke reflektuar në shënime pas çdo interviste se si hulumtuesit mund të kenë ndikuar në përgjigjet e intervistës, duke pasur parasysh moshën, gjininë dhe pozicionin e tyre në shoqëri. Për të zvogëluar çdo efekt të mundshëm, të hipotezuar, të lidhur me gjininë që pozicionet e hulumtuesve brenda shoqërisë mund të kenë në intervista, ekipi u përpoq të siguronte që hulumtuesit burra të intervistonin burra të anketuar dhe gratë të intervistuan gra të anketuara. Sidoqoftë, kjo nuk ishte gjithmonë e realizueshme duke pasur parasysh çështjet e planifikimit. Ekziston mundësia që përgjigjet e pjesëmarrësve në hulumtim të kenë ndryshuar bazuar në gjininë e personit që i intervistoi ata.

Së katërti, RrGK paraqiti kërkesa për të dhëna dhe shqyrtoi të gjitha të dhënat e disponueshme

³⁴ Shtojca I përmban një listë të të gjithë të anketuarve në intervistë.

³⁵ Në disa raste, një mbajtës shënimesh nuk mund të merrte pjesë për shkak të sfidave të planifikimit. Për të siguruar që asnjë informacion të mos humbet, këto intervista u regjistruan dhe më vonë u transkriptuan.

statistikore në lidhje me dhunën me bazë gjinore, siç mirëmbahen nga institucionet përkatëse, duke përfshirë policinë, prokurorinë, gjykatat, strehimoret dhe Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale.³⁶ RrGK gjithashtu shqyrtoi bazën e re të centralizuar të të dhënave për rastet e dhunës në familje. Analiza e të dhënave kishte për qëllim të shqyrtonte trendët me kalimin e kohës në lidhje me raportimin e rasteve të dhunës me bazë gjinore.

Ekipi hulumtues kodoi gjetjet e hulumtimit në një bazë të dhënash të krijuar në përputhje me pyetjet e hulumtimit. Gjatë procesit të kodimit, të paktën dy anëtarë të ekipit analizuan çdo intervistë, duke përdorur fokusimin e hulumtuesve, drejt një vlefshmërie të shtuar. Gjithashtu, për të arritur vlefshmëri, autorët kanë shpërndarë draft raportin përfundimtar për kontrolle të pjesëmarrësve dhe redaktim nga kolegët. Rishikimet u bënë bazuar në informatat kthyesë të marra para publikimit të raportit.

RRETH KËTIJ RAPORTI

Kapitulli i parë analizon kornizën aktuale ligjore të Kosovës në lidhje me KS, drejt identifikimit të rishikimeve të mbetura të kërkuara për të adresuar në mënyrë adekuate dhunën me bazë gjinore në ligj si pjesë e rishikimit dhe ndryshimit të vazhdueshëm të kornizës ligjore të Kosovës. Kapitulli i dytë shqyrton përgjigjen institucionale për adresimin e dhunës me bazë gjinore, me pjesë që përqendrohen në secilin institucion përgjegjës, si dhe koordinimin ndërinstitutional. Kapitulli i fundit përfshin rekomandime që synojnë secilin institucion përkatës. Shtojcat përfshijnë një listë të të anketuarve në intervistë (1); statistikën mbi përhapjen e formave të ndryshme të dhunës me bazë gjinore të marra nga institucionet (2); dhe një përmbledhje të vlerësimit të pavarur të RrGK-së për zbatimin e SKMDHF-së (3).

³⁶ Për të gjitha të dhënat e pranura, shihni [Shtojcën 2](#).

ANALIZA LIGJORE

Ky kapitull analizon kornizën ligjore dhe të politikave në lidhje me dhunën me bazë gjinore në Kosovë. Së pari përshkruan kornizën përkatëse ligjore ndërkombëtare dhe më pas shqyrton çështje tematike në lidhje me KS. Pjesa tjetër analizon shkallën në të cilën ligji i Kosovës është harmonizuar me dispozitat thelbësore të KS, duke përfshirë vepra të ndryshme të dhunës me bazë gjinore dhe kompensimin e viktimave. Pastaj, vijon një ekzaminim për masën në të cilën korniza ligjore e Kosovës është në përputhje me dispozitat e KS në lidhje me hetimin, ndjekjen penale, ligjin procedural dhe masat mbrojtëse. Pjesët e fundit përshkruajnë masat në KS për parandalimin e dhunës dhe mbledhjen e të dhënave, në mënyrë respektive, dhe zbatueshmërinë e tyre në Kosovë.

KORNIZA LIGJORE NDËRKOMBËTARE

Kjo pjesë ofron një përmbledhje të kornizës ligjore të zbatueshme ndërkombëtare që ka të bëjë me adresimin e dhunës me bazë gjinore dhe mjetet me të cilat instrumentet ndërkombëtare janë të zbatueshme në kontekstin e Kosovës.

Konventa e Stambollit

KS hyri në fuqi në gusht 2014. KS kishte për qëllim të siguronte një sërë detyrimesh gjithëpërfshirëse për adresimin e dhunës me bazë gjinore ndaj grave brenda kornizës ligjore të ligjit ndërkombëtar për të drejtat e njeriut, duke e bërë atë instrumentin e parë ligjërish të detyrueshëm të llojit të tij në Europë.¹ KS u mbështet në Deklaratën e KB për Eliminimin e Dhunës ndaj Grave, duke njohur dhunën ndaj grave si një manifestim të marrëdhënieve historikisht të pabarabarta të pushtetit midis grave dhe burrave; këto pabarazi kanë çuar në dominimin dhe diskriminimin e grave nga burrat dhe kanë parandaluar përparimin e plotë të grave.²

KS përcakton dhe kriminalizon forma të ndryshme të dhunës dhe nënshkruesit duhet të bëjnë ndryshime legjislative në ligjin e brendshëm civil dhe penal nëse është e nevojshme. Krimet e listuara janë dhuna psikologjike, ndjekja, dhuna fizike, dhuna seksuale duke përfshirë përdhunimin, martesën e detyruar, gjymtimin gjenital femëror, abortin e detyruar, sterilizimin e detyruar dhe ngacmimin seksual. KS është holistike në qasjen e saj me katër shtyllat e saj duke adresuar parandalimin dhe mbrojtjen, shërbimet mbështetëse, ndjekjen penale dhe procedurën. Ajo gjithashtu parashikon që organet qeveritare të miratojnë politika gjithëpërfshirëse dhe të zbatojnë një gamë të gjerë masash drejt koordinimit.³

Më 25 shtator 2020, Kosova ndryshoi Kushtetutën e saj për të njohur KS si të zbatueshëm drejtpërdrejt brenda kornizës së saj ligjore.⁴ Kjo metodë për zbatimin e instrumenteve ndërkombëtare është përdorur nga Kosova për disa dokumente të rëndësishme të drejtave të njeriut, përfshirë

¹ K. Nousiainen dhe C. Chinkin, "Implikimet juridike të procesit të anëtarësimit në BE në Konventën e Stambollit", Komisioni Evropian, 2015, f. 39

² [Konventa e Këshillit të Evropës për parandalimin dhe luftimin e dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje](#), Hyrje.

³ Jürviste, Ü., Shërbimi i Kërkimit Parlamentar Evropian, "Konventa e Stambollit: një mjet për të trajtuar dhunën ndaj grave dhe vajzave", 2015, f. 1

⁴ Këshilli i Evropës, "[Kuvendi Kombëtar i Kosovës* vendos të zbatojë Konventën e Stambollit](#)", 2020.

CEDAW me rekomandimet e saj të përgjithshme 19 dhe 35 mbi dhunën ndaj grave, duke pasur parasysh që statusi aktual ligjor ndërkombëtar i Kosovës kufizon mundësinë e saj për të ratifikuar ose marrë pjesë plotësisht në konventat e Kombeve të Bashkuara (KB) ose Këshillit të Evropës.⁵ Ndërsa pranon simbolikën e shënuar me përfshirjen e KS në listën e marrëveshjeve ndërkombëtare të njohura kushtetuese të Kosovës, ky sistem i “kushtetutimit pa ratifikim” ka sfidat e tij.⁶ Kjo është veçanërisht për shkak të mungesës ndërkombëtare së mbikëqyrjes dhe mekanizmave të zbatimit në Kosovë. Sidoqoftë, KS u kërkon shteteve të sigurojnë ose inkurajojnë masa të caktuara përmes ndryshimit të kornizës së brendshme ligjore dhe të politikave. Prandaj, që dispozitat e KS të kenë një efekt praktik, Kosova duhet të ndërmarrë veprime të mëtijshme legislative të shoqëruar me veprimet rigoroze të llogaridhënies dhe monitorimit si dhe me zbatim të rreptë të ligjit. Duke pranuar që përfshirja e KS në Kushtetutë mund të ketë ndikim praktik pa ndërhyrje legislative, ky raport analizon shkallën që korniza ligjore e Kosovës aktualisht reflekton standardet e vendosura nga KS dhe çfarë ndryshimesh të mëtijshme mund të jenë të nevojshme.

Roli i ligjit të BE-së në luftimin e dhunës me bazë gjinore

Aktualisht, BE nuk ka ndonjë instrument të përgjithshëm ligjor në lidhje me dhunën me bazë gjinore. Përkundrazi, *acquis* e BE-së në këtë fushë kryesisht përbëhet nga konkluzione të Këshillit, rezoluta të Parlamentit dhe strategji të Komisionit; asnjë nga këto nuk i detyron Shtetet Anëtare për veprim.⁷ Direktivat përkatëse nuk janë specifike për dhunën me bazë gjinore dhe referojnë vetëm dhunën ndaj grave. Sidoqoftë, disa akte juridike janë të rëndësishme pasi Kosova duhet të harmonizojë legjislacionin e saj me atë të BE-së sipas Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit.⁸ Instrumentet kryesore përfshijnë Direktivën për të Drejtat e Viktimave⁹ dhe Direktivën Kundër Trafikimit.¹⁰ Instrumente të tjerë përkatës përfshijnë Direktivën e Trajtimit të Barabartë të Rindërtuar¹¹ dhe Direktivën e Mallrave dhe Shërbimeve Gjinore,¹² të cilat përkufizojnë dhe dënojnë ngacmimet¹³ dhe ngacmimet seksuale,¹⁴ dhe Direktivën për Luftimin e Abuzimit Seksual të Fëmijëve.¹⁵

⁵ Aderimi në Konventë është i mundur për shtetet që nuk janë anëtare të Këshillit të Evropës. Sidoqoftë, procesi me të cilin bëhet kjo ka të ngjarë të jetë i pa qasshëm për Kosovën. Palët në Konventë duhet të konsultohen dhe të merret pëlqimi i tyre unanim. Pas kësaj, Komiteti i Ministrave mund të ftojë çdo shtet të aderojë. Ky vendim kërkon një shumicë prej dy të tretave të parashikuara në nenin 20.d të Statutit të Këshillit të Evropës dhe votën unanime të Palëve të kësaj Konvente (neni 76). Aktualisht, 12 nga 47 anëtarët e Këshillit të Evropës nuk e njohin Kosovën.

⁶ De Hert, P. dhe Korenica, F., “Kushtetuta e Re e Kosovës dhe marrëdhënia e saj me Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut: Kushtetutimi “Pa” Ratifikimin në Shfaqjet Post-Konfliktuale”, ZaöRV 76 (I), 2016, f. 165

⁷ Bonewit, A., Drejtoria e Përgjithshme e Parlamentit Evropian për Politikën e Brendshme, “Studimi mbi Çështjen e Dhunës ndaj Grave në Bashkimin Evropian”, f. 44.

⁸ Marrëveshja e Stabilizim Asociimit ndërmjet Bashkimit Evropian dhe Kosovës (OJ L 71, 16.3.2016)

⁹ Direktiva 2012/29/BE mbi standardet minimale të përbashkëta për të drejtat, mbështetjen dhe mbrojtjen e viktimave.

¹⁰ Direktiva 2011/36/BE mbi parandalimin dhe luftimin e trafikimit të qenieve njerëzore dhe mbrojtjen e viktimave të tij.

¹¹ Direktiva 2006/54/KE mbi zbatimin e parimit të mundësive të barabarta dhe trajtimit të barabartë të burrave dhe grave në çështjet e punësimit dhe profesionit (rishikimi).

¹² Direktiva 2004/113/EC mbi zbatimin e parimit të trajtimit të barabartë midis burrave dhe grave në qasjen dhe furnizimin e mallrave dhe shërbimeve.

¹³ “Aty ku sjellja e padëshiruar në lidhje me seksin e një personi ndodh me qëllim ose efekt të cenimit të dinjitetit të një personi, dhe të krijimit të një mjedisi frikësues, armiqësor, degradues, poshtërues ose ofendues.”

¹⁴ “Kur ndodh ndonjë formë e sjelljes së padëshiruar verbale, joverbale ose fizike të një natyre seksuale, me qëllim ose efekt të cenimit të dinjitetit të një personi, veçanërisht kur krijon një mjedis frikësues, armiqësor, degradues, poshtërues ose ofendues.”

¹⁵ Direktiva 2011/93/BE mbi luftimin e abuzimit seksual dhe shfrytëzimit seksual të fëmijëve dhe pornografisë së fëmijëve. Mbrojtja gjendet gjithashtu në Direktivën 2011/99/BE mbi urdhurin evropian të mbrojtjes dhe rregulloren (BE) Nr. 606/2013 mbi njohtjen reciproke të masave mbrojtëse në çështje

ÇËSHTJET TEMATIKE SIPAS KS DHE ZBATUESHMËRIA E TYRË NË LIGJIN E KOSOVËS

Kjo pjesë shqyrton tema të veçanta brenda KS dhe shkallën në të cilën ato pasqyrohen brenda kornizës ligjore dhe të politikave të Kosovës, duke përfshirë integrimin e një perspektivë të përshtatshme gjinore në kornizën ligjore, koordinimin e një qasje gjithëpërfshirëse ndër-institucionale të përqendruar te viktimat dhe mekanizmat e mjaftueshëm të monitorimit.

Zbatimi i perspektivës gjinore të KS

“Seksi”

I referohet “dallimeve biologjike midis grave dhe burrave.”

(CEDAW, Rekomandimet e përgjithshme 28)

“Gjinia”

I referohet “identiteteve,tributeve dhe roleve të ndërtuara shoqërisht për gratë dhe burrat dhe kuptimit shoqëror dhe kulturor të shoqërisë... dallimet biologjike, duke rezultuar në marrëdhënie hierarkike midis grave dhe burrave dhe në ndarjen e pushtetit dhe të drejtave që favorizojnë burrat dhe vënë gratë në pozitë të pafavorshme. Pozita shoqërore e grave dhe burrave ndikohet nga faktorë politikë, ekonomikë, kulturorë, socialë, fetarë, ideologjikë dhe mjedisorë që mund të ndryshohen nga kultura, shoqëria dhe komuniteti”.

(CEDAW, Rekomandimet e përgjithshme 28)

“Dhuna në baza gjinore”

Nënkupton dhunën që është kryer ndaj një personi për shkak të gjinisë së ti/saj ose që prek personat e një gjinie të veçantë në mënyrë disproporcionale.

KS njeh natyrën strukturore të dhunës ndaj grave e që do të thotë se është manifestim i marrëdhënieve historikisht të pabarabarta të pushtetit midis grave dhe burrave. Përdorimi i termit “gjinia” është treguar të jetë kyç në përshkrimin e shtypjes strukturore të grave.¹⁶ Megjithatë termi ishte tashmë në përdorim në të drejtën ndërkombëtare për të drejtat e njeriut para futjes së KS (shih Kutinë),¹⁷ KS ishte traktati i parë ligjor detyrues ndërkombëtar që përkufizon “gjininë” në aspektin e konstruksionit social. Shtetet më parë kanë zgjedhur të mos përcaktojnë termin në një nivel multilateral për shkak të kuptimeve të

[jet civile](#). Sidoqoftë, zbatimi i këtyre instrumenteve është efektiv vetëm brenda BE-së.

¹⁶ M. Antiq dhe I. Radaçiq, “Të kuptuarit në zhvillim të gjinisë në të drejtën ndërkombëtare dhe refuzimi i ‘ideologjisë gjinore’ 25 vjet që nga Konferenca e Pekinit për Gratë”, Forumi Ndërkombëtar për Studime të Grave, 2020, 83.

¹⁷ Shih, për shembull, Rekomandimin e Përgjithshëm 28 të Komitetit për Eliminimin e Diskriminimit ndaj Grave (2010, pjesa 5). Shih, për shembull, Rekomandimin e Përgjithshëm 28 të Komitetit për Eliminimin e Diskriminimit ndaj Grave (2010, pjesa 5).

ndryshme të termit dhe polemikave të lidhura me të.¹⁸ Përkundrazi, OKB-ja ka përcaktuar termin dhe ka theksuar natyrën e tij të ndërtuar shoqërisht, kompleksitetin e këtij konstruksioni dhe ndikimet e kulturës, politikës, ekonomisë, racës dhe variablave të tjerë.¹⁹ Sidoqoftë, një përkufizim i tillë u hoq nga CEDAW në 1979, i cili përqendrohet në diskriminimin seksual.²⁰ Statuti i Romës i Gjykatës Penale Ndërkombëtare u bë traktati i parë ndërkombëtar që miratoi një përkufizim të “gjinisë” në vitin 2002. Kjo u bë baza e një debati të polarizuar midis shteteve, aktorëve jo-qeveritarë feministë dhe përfaqësuesve jo-qeveritarë konservatorë,²¹ që përfundimisht zgjidhet vetëm duke aplikuar dykuptimësi konstruktive.²²

KS pranon natyrën e ndërtuar shoqërisht të gjinisë, si “rolet, sjelljet, aktivitetet dhe atributet që një shoqëri e caktuar i konsideron të përshtatshme për gratë dhe burrat”. Ky interpretim progresiv i gjinisë e veçon KS-në nga traktatet e mëparshme ndërkombëtare. KS kërkon politika të ndjeshme gjinore dhe një perspektivë gjinore në zbatimin dhe vlerësimin e ndikimit të dispozitave të saj. Detyrimet për mbrojtjen, mbështetjen²³ dhe procesin penal duhet të bazohen në një kuptim gjinor të dhunës ndaj grave.²⁴ Shtetet palë duhet të marrin masa, kur është e përshtatshme, për të përfshirë materialin mësimor mbi barazinë midis grave dhe burrave, respektin e ndërsjellë dhe rolet gjinore jo stereotipike.²⁵ KS kërkon që shtetet të mbrojnë të drejtat e viktimave pa diskriminim mbi kurrfarë baze, duke përfshirë për herë të parë në një traktat ndërkombëtar edhe atë pa diskriminim mbi bazën e identitetit gjinor ose orientimit seksual.²⁶

KS është pjesërisht specifike për gjininë duke u përqendruar në dhunën e bazuar në gjini ndaj grave, e përkufizuar si “dhuna e drejtuar ndaj një gruaje për shkak të gjinisë së saj ose dhunës që prek gratë në mënyrë proporcionale”.²⁷ Sidoqoftë, në kontekstin e dhunës në familje, dispozitat e KS janë neutrale ndaj gjinisë. Duke synuar arritjen e një kompromisi për delegacionet ngurruese për të kuptuar dhunën në familje si dhunë me bazë gjinore,²⁸ KS zbatohet për të gjitha viktimat e dhunës në familje por i kushton vëmendje të veçantë grave viktimat të dhunës me bazë gjinore (neni 2). Ndërkohë, neni 3 (b) ofron një përkufizim neutral ndaj gjinisë. Për këtë arsye KS ka titullin e saj (“dhuna ndaj grave dhe dhuna në familje”).

¹⁸ Oosterveld, V., “Definicioni i ‘Gjinisë’ në Statutin e Romës të Organizatës Penale Ndërkombëtare: Një hap para apo prapa për Gjykatën Ndërkombëtare të Drejtësisë?”, *Harvard Human Rights Journal*, 18, 2005, p. 70.

¹⁹ Po aty, p. 71.

²⁰ Ndërsa termi “gjini” u përdor më vonë gjithnjë e më shumë nga Komiteti për Eliminimin e Diskriminimit ndaj Grave në Rekomandimet e tij të Përgjithshme (të tilla si Rekomandimi i Përgjithshëm 19 i cili përcaktoi “dhunën e bazuar në gjini” në 1992), rekomandimet nuk janë ligjërisht të detyrueshme për nënshkruesit, pavarësisht nga interpretimet autoritare të CEDAW.

²¹ Oosterveld, V., “Dykuptimësia konstruktive dhe kuptimi i ‘gjinisë’ për Gjykatën Penale Ndërkombëtare”, *Revista Ndërkombëtare Feministe e Politikës*, 2014, 16 (4), f. 563

²² “Dykuptimësia konstruktive” i referohet përdorimit të qëllimshëm të gjuhës së dykuptimtë për të zgjidhur këndvështrime të ndryshme për një çështje të ndjeshme.

²³ Nenet 18 dhe 49.

²⁴ Neni 6.

²⁵ Neni 14.

²⁶ Neni 4.3; Shih më poshtë pjesën e Qasjes Jo Diskriminuese dhe Ndërturës për adresimin e dhunës me bazë gjinore

²⁷ Neni 3(d).

²⁸ Disa delegacione argumentuan se dhuna në familje është gjinore neutrale, pasi ajo mund të ndikojë te burrat, fëmijët dhe të moshuarit, duke u ndërruar me moshën dhe gjininë (shih Nousiainen, K. dhe Chinkin, C., “[Ndikimet juridike të pranimit në BE të Konventës së Stambollit](#)”, *Komisioni Evropian*, 2015, f. 43)

Ndërsa kjo zgjidhje është përshkruar si inovative, rastet e dhunës në familje ndaj burrave nuk janë të rrënjësura në diskriminimin strukturor ose vartësinë.²⁹ Raportuesja e mëparshme Speciale e KB për Dhunën ndaj Grave, Rashida Manjoo, ka shkruar se përdorimi i neutralitetit gjinor në këtë kontekst “favorizon një kuptim më pragmatik dhe politikisht të pëlqyeshëm të gjinisë, domethënë thjesht një eufemizëm për ‘burrat dhe gratë’, sesa si një sistem i dominimit të burrave mbi gratë”.³⁰ Ajo argumenton se kjo sugjeron që viktimat meshkuj të dhunës “kërkojnë dhe meritojnë burime të krahasueshme me ato që u jepen viktimave femra, duke injoruar kështu realitetin se dhuna ndaj burrave nuk ndodh si rezultat i pabarazisë dhe diskriminimit të përhapur, dhe gjithashtu se nuk është as sistematike dhe as pandemike në mënyrën që është padiskutim dhuna ndaj grave.” Ajo vazhdon:

Dhuna ndaj grave nuk mund të analizohet rast pas rasti në izolim të faktorëve individualë, institucionalë dhe strukturorë që rregullojnë dhe formësojnë jetën e grave. Faktorë të tillë kërkojnë qasje specifike gjinore për të siguruar barazinë e rezultateve për gratë. Përpjekjet për të kombinuar ose sintetizuar të gjitha format e dhunës në një kornizë “gjinore neutrale”, priren të rezultojnë në një diskurs të depolitizuar ose të holluar, i cili braktis agjendën transformuese.

Për më tepër, manuali i KB për Legjislacionin mbi Dhunën ndaj Grave (me datë para hyrjes në fuqi të KS) thotë:

Një numër vendesh kanë miratuar legjislacionin neutral ndaj gjinisë, i zbatueshëm si për gratë ashtu edhe për burrat. Sidoqoftë, një legjislacion i tillë mund t’i nënshtrohet manipulimit nga shkelësit e dhunshëm. Për shembull, në disa vende, gratë e mbijetuara të dhunës janë ndjekur penalisht për paaftësinë për të mbrojtur fëmijët e tyre nga dhuna. Legjislacioni asnjans gjinor gjithashtu ka tentuar të ketë përparësi në stabilitetin e familjes mbi të drejtat e ankuesit/mbijetuarit (kryesisht femra) sepse nuk pasqyron ose adreson në mënyrë specifike përvojën e grave për dhunën e kryer ndaj tyre.³¹

Në Kosovë, Ligji mbi Barazinë Gjinore njeh dhunën e bazuar në gjini si një formë diskriminimi që “pengon seriozisht aftësinë e grave dhe burrave për të gëzuar të drejtat dhe liritë mbi bazën e barazisë”.³² Sidoqoftë, nuk ka asnjë dispozitë në kornizën ligjore të Kosovës që njeh ndikimin jashtëzakonisht joproporcional të kësaj dhune ndaj grave.³³ SKMDHF pranon që dhuna në familje prek kryesisht gratë dhe fëmijët,³⁴ ashtu si edhe Programi i Kosovës për Barazi Gjinore 2020-2024.³⁵ Sidoqoftë, akti kryesor ligjor në sferën e dhunës me bazë gjinore në Kosovë, Ligji për Mbrojtjen nga Dhuna në Familje (LM-

²⁹ Po aty.

³⁰ Manjoo, R. “[Raporti i Raportuesit Special për dhunën ndaj grave, shkaqet dhe pasojat e saj](#)”, (A/HRC/26/38), f. 17.

³¹ UN Women, [Manual për Legjislacionin mbi Dhunën ndaj Grave](#), New York, 2012, f. 12.

³² Ligji 05/L-020 për Barazi gjinore, Neni 4.2.

³³ Gavrić, S. për Lobin Evropian të Grave, “[Hartëzimi i politikave dhe legjislacionit mbi dhunën ndaj grave dhe Konventa e Stambollit në Kosovë](#)”, F. 18.

³⁴ SKMDHF, f. 8.

³⁵ ABGJ, [Programi i Kosovës për Barazi Gjinore 2020-2024](#).

DHF),³⁶ nuk pasqyron këtë kuptim. OSBE-ja ka komentuar se ai Ligj nuk arrin të pranojë në mënyrë adekuate se dhuna ndaj grave përbën një formë diskriminimi dhe shkelje të të drejtave të njeriut të grave.³⁷ Këshilli i Evropës ka bërë të njëjtin koment për kornizën më të gjerë legislative.³⁸ Procedurat Standarde të Veprimit për Mbrojtjen nga Dhuna në Familje (PSV) janë në mënyrë të ngjashme pa konsiderata gjinore. Për më tepër, nuk ka asnjë strategji kombëtare që adreson në mënyrë gjithëpërfshirëse dhunën me bazë gjinore jashtë kornizës së dhunës në familje ose që mbështet një përgjigje të integruar ndaj kësaj dhune. Madje edhe aty ku adresohet dhuna, neutraliteti gjinor është i theksuar. Nga perspektiva paraprake, është e dobishme të kuptohet ky deficit i kuptimit gjinor të dhunës dhe nevoja rrjedhimore për rishikime të ligjeve dhe politikave për të integruar gjininë në përputhje me KS, si çështjet tematike në kornizën e Kosovës.

Gjinia në të Drejtën Penale

Dispozitat penale të KS janë përgjithësisht neutrale gjinore, pasi gjinia e viktimës ose kryesit, në parim, nuk duhet të jetë element përbërës i një krimi. Kjo nuk ka për qëllim të parandalojë shtetet nga futja e dispozitave specifike gjinore,³⁹ dhe ka përjashtime. Në Kosovë, kuptimi i efekteve gjinore të dhunës në lidhje me krimin është disi i identifikueshëm. Drafti i Kodit të Procedurës Penale të Kosovës (KPPK) kërkon të prezantojë “vëmendjen e duhur” për “palën e dëmtuar ose viktimën e cila është viktimë e trafikimit njerëzor, dhunës me bazë gjinore, dhunës në marrëdhënie familjare, dhunës seksuale, shfrytëzimit ose diskriminimit dhe viktimat[t] që kanë pësuar dëm të konsiderueshëm për shkak të ashpërsisë së veprës penale”.⁴⁰ Asnjë përkufizim i gjinisë nuk është përfshirë në draftin e KPPK.

KPK kryesisht i kupton aspektet gjinore të dhunës vetëm brenda mjedisit shtëpiak. Ai përcakton një “viktimë të cenueshme” si: “një viktimë e një krimi që është... një grua shtatzënë,... ose person marrëdhënia apo varësia e të cilit ndaj kryesit e bën atë veçanërisht të ndjeshëm ndaj viktimizimit të përsëritur, frikësimit të përsëritur apo hakmarrjes së përsëritur”.⁴¹ “Viktimat e cenueshme” adresohen posaçërisht në disa krime që lidhen me dhunën me bazë gjinore,⁴² por çdo krim që është kryer kundër një viktime që është “veçanërisht e cenueshme” duhet të trajtohet si i rënduar gjatë dënimit.⁴³ Udhëzuesi për politikën ndëshkimore i Gjykatës Supreme shpjegon se konsiderata më e madhe gjatë ndëshkimit kur zbatohen këto dispozita është niveli i cenueshmërisë së viktimës dhe masa në të cilën kryesi e perceptoi atë cenueshmëri.⁴⁴ Në lidhje me dhunën në familje, Udhëzuesi thotë se “një periudhë e zgjatur e abuzimit mendor dhe fizik do të rrisë mungesën e mbrojtjes së viktimës dhe gjasat

³⁶ Ligji Nr. 03/L-182 [për mbrojtje nga dhuna në familje](#).

³⁷ OSBE, [Gjykimi i kërkesave për urdhrat e mbrojtjes në rastet e dhunës në familje në Kosovë](#), 2012, f. 23.

³⁸ Krol, et al., [Hartëzimi i shërbimeve mbështetëse për viktimat e dhunës ndaj grave në Kosovë](#), f. 78.

³⁹ “Raport shpjegues për Konventën e Këshillit të Evropës për parandalimin dhe luftimin e dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje”, Stamboll, 11.V.2011, f. 153.

⁴⁰ Draft Kodi i Procedurës Penale Nr. 06/L-151, neni 63.1.4.

⁴¹ Kodi Nr. 06/L-074 [Kodi Penal i Republikës së Kosovës](#), Neni 113.39.

⁴² Shikoni në veçanti: Lëndimi i lehtë trupor (neni 185), dëmtimi i rëndë trupor (neni 186), gjymtimi i organeve gjenitale të femrave (neni 180), sulmi (neni 184), rrëmbimi (neni 191) dhe heqja e paligjshme e lirisë (neni 193).

⁴³ Neni 70.2.6.

⁴⁴ Gjykata Supreme e Kosovës, [Udhëzuesi i politikave ndëshkimore](#), Botimi i Parë, 2018, f. 79.

e ndodhjes së një përkeqësimi të konsiderueshëm”.⁴⁵ Udhëzuesi përgjithësisht është i informuar për çështjet e dhunës në familje, megjithëse një kuptim i dhunës me bazë gjinore mungon dukshëm.

Krimet e tjera rëndohen kur kryesi ka një marrëdhënie familjare me viktimën,⁴⁶ dhe përsëri ekziston një faktor i përgjithshëm përkeqësues me të njëjtin parim.⁴⁷ Përkufizimi i “gjinisë” brenda KPK ende nuk është harmonizuar me KS; aktualisht përmban përkufizimin e paqartë të përdorur në Statutin e Romës (“Gjinia - i referohet dy gjinive, mashkullit dhe femrës, brenda kontekstit të shoqërisë”).⁴⁸ Pavarësisht, disa krime rëndohen nëse kryhen për shkak të gjinisë,⁴⁹ dhe ekziston një faktor rëndues përgjithësisht i zbatueshëm me të njëjtin parim.⁵⁰

Koordinimi i një përgjigjeje gjithëpërfshirëse institucionale

KS kërkon zbatimin e politikave të integruara, efektive, gjithëpërfshirëse dhe të koordinuara që përfshijnë të gjitha masat përkatëse për të luftuar dhe parandaluar të gjitha format e dhunës të mbuluara nga KS, dhe për të mbrojtur dhe mbështetur viktimat.⁵¹ Nënshkruesit duhet të vendosin një përgjigje holistike, me në qendër viktimat e dhunës ndaj grave.⁵² KS kërkon shpërndarjen e duhur të burimeve financiare dhe njerëzore për zbatimin adekuat të politikave, masave dhe programeve të integruara, përfshirë ato të kryera nga organizata joqeveritare (OJQ).⁵³ KS njeh punën e rëndësishme të OJQ-ve dhe shoqërisë civile, veçanërisht punën e OJQ-ve për të drejtat e grave, duke u kërkuar shteteve që të inkurajojnë dhe mbështesin punën e tyre.⁵⁴ Shtetet duhet të përcaktojnë organet qendrore përgjegjëse për koordinimin, zbatimin, monitorimin dhe vlerësimin e politikave dhe masave për të parandaluar dhe luftuar të gjitha format e dhunës në KS.⁵⁵

Në Kosovë, PSV-të përkatëse për dhunën në familje⁵⁶ dhe trafikimin⁵⁷ përcaktojnë rolet, përgjegjësitë dhe koordinimin ndërinstitucional të institucioneve përgjegjëse për adresimin e dhunës në familje dhe të trafikimit në mënyrë respektive. Sidoqoftë, këto përgjegjësi nuk kanë të bëjnë qartë me format e tjera të dhunës me bazë gjinore. As këto përgjegjësi, veçanërisht për koordinimin ndërinstitucional në programet e rehabilitimit, nuk njihen në ligj. Kjo ka implikime buxhetore dhe

⁴⁵ Po aty.

⁴⁶ Shikoni në veçanti: përdhunimi (neni 227), sulmin seksual (neni 229), degradimin e integritetit seksual (neni 230) dhe skllavërinë, kushtet e ngjashme me skllavërinë dhe punën e detyruar (neni 163).

⁴⁷ Neni 70.2.14.

⁴⁸ Neni 143.1.10. Disa argumentojnë se përdorimi i shprehjes “brenda kontekstit të shoqërisë” përfshin në mënyrë të qartë ndërtimin shoqëror të gjinisë (Copelon, R., “Krimet Gjinore si Krime Lufte: Integrimi i Krimeve Kundër Grave në të Drejtën Penale Ndërkombëtare”, *McGill Law Journal*, 46, 2000, 237), ndërsa vlerësimet konservatore të këtij përkufizimi në përgjithësi arrijnë në përfundimin se ai pozicionon gjininë brenda kufijve të seksit biologjik (Singson, S., “Konventa e re Evropiane e përkufizon ‘Gjininë’ si ndërtim social”, *Instituti i Familjes Katolike dhe i të Drejtave të Njeriut* [C-FAM], 7 prill 2000, 1).

⁴⁹ Shihni për shembull: vrasja e rëndë (neni 173), sulmi (neni 184) dhe lëndimi i rëndë trupor (neni 186).

⁵⁰ Neni 70.2.12.

⁵¹ Nenet 7.1 dhe 18.2, përkatësisht.

⁵² Neni 7.2.

⁵³ Neni 8.

⁵⁴ Neni 9.

⁵⁵ Neni 10.

⁵⁶ Zyra e Kryeministrit, [Procedurat Standarde të Veprimit për Mbrojtjen nga Dhuna në Familje në Kosovë](#).

⁵⁷ Ministria e Punëve të Brendshme, [Zyra e Koordinatorit Nacional Kundër Trafikimit, Procedurat Standarde të Veprimit për Personat e Trafikuar në Kosovë](#).

kontribuon në mungesën e mbështetjes financiare për programe të tilla dhe mekanizmat e koordinimit. SKMDHF njih mungesën e mekanizmave koordinues në Kosovë dhe nevojën për to në çdo komunë.⁵⁸ Deri në vitin 2020, një objektiv kryesor strategjik që synon:

Sigurimin e mekanizmave gjithëpërfshirës dhe efikas për reagim të shpejtë kundër dhunës në familje, si dhe bashkëpunim ndërinstitucional të përgjegjshëm midis aktorëve të nivelit qendror dhe lokal, për mbrojtjen dhe menaxhimin e këtyre rasteve.⁵⁹ [sic]

SKMDHF është zhvilluar mirë dhe shoqëruar me objektiva konkretë, të matshëm dhe të zbatueshëm, përfshirë kostot dhe burimet e financimit për secilën masë.⁶⁰ Shtyllat e strategjisë janë: parandalimi dhe ngritja e vetëdijes; mbrojtja dhe koordinimi; legjislacioni, hetimi dhe ndjekja penale; dhe rehabilitimi dhe ri-integrimi i viktimave.

Sidoqoftë, si përkufizim, çështja mbetet që SKMDHF është përqendruar me shumicë në dhunën në familje dhe nuk adresoi format e tjera të dhunës me bazë gjinore.⁶¹ Këshilli i Evropës ka tërhequr vëmendjen për faktin se shumë forma të dhunës të mbuluara nga KS përfshirë dhunën seksuale, martesën e detyruar, ndjekjen, sterilizimin e detyruar, abortin e detyruar, dhunën psikologjike dhe gjymtimin e organeve gjenitale të grave kanë munguar plotësisht nga ndërhyrjet e synuara të politikave në Kosovë.⁶² Në Shqipëri dhe Mal të Zi, organi i ngarkuar për të monitoruar zbatimin e KS, Grupi i Ekspertëve për Veprimin Kundër Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje ("GREVIO"), në mënyrë të ngjashme ka shprehur shqetësimin se strategjitë kombëtare nuk adresojnë në mënyrë gjithëpërfshirëse të gjitha format e dhunës kundër grave sipas KS.⁶³ Kur strategjitë qeveritare përqendrohen ekskluzivisht në dhunën në familje, burimet e pamjaftueshme u ndahen shërbimeve që merren me forma të tjera të dhunës me bazë gjinore. Sipas Krol et al., Kjo qasje gjithashtu kontribuon në kuptimin e pamjaftueshëm të dhunës ndaj grave midis ofruesve të shërbimeve, të cilët "veprojnë në pjesën më të madhe në bazë të një përkufizimi të bazuar në dhunën në familje ndaj gjinisë neutrale".⁶⁴ Në këtë drejtim, një raport i Këshillit të Evropës për Kosovën komentoi sa vijon:

Mbulimi i të gjitha formave të dhunës ndaj grave nga të dy specialistët dhe shërbimet e përgjithshme mbështetëse mbetet prapa shërbimeve mbështetëse për viktimat e dhunës në familje. Asnjë shërbim special i përkrahjes nuk ekziston për format e tjera të dhunës të mbuluara nga KS, dhe viktimat aktualisht nuk mbështeten sistematikisht brenda mandatit të shërbimeve të specializuara dhe të përgjithshme.⁶⁵

⁵⁸ SKMDHF, f. 30.

⁵⁹ Po aty, f. 9.

⁶⁰ Krol, et al., *Hartëzimi i shërbimeve mbështetëse për viktimat e dhunës ndaj grave në Kosovë*, f. 8.

⁶¹ *Shtojca 3* përfshin përkufizimet e formave të tjera të dhunës të mbuluara nga KS. Sidoqoftë, kjo nuk ka ndonjë ndikim thelbësor në masat në Strategji, sepse të gjitha objektivat specifike i referohen vetëm dhunës në familje.

⁶² Krol, et al., *Hartëzimi i shërbimeve mbështetëse për viktimat e dhunës ndaj grave në Kosovë*, f. 45.

⁶³ GREVIO *Raporti i Vlerësimit Bazë - Mali i Zi*, 2018, f. 15; dhe GREVIO *Raporti i Vlerësimit Bazë - Shqipëri*, 2017, f. 12.

⁶⁴ Krol, et al., *Hartëzimi i shërbimeve mbështetëse për viktimat e dhunës ndaj grave në Kosovë*, f. 78.

⁶⁵ Po aty.

Prandaj, Kosova ka një nevojë urgjente për të zhvilluar një strategji gjithëpërfshirëse për adresimin e të gjitha formave të dhunës ndaj grave, e cila përmban një kuptim gjinor të dhunës dhe një përgjigje holistike ndaj një dhune të tillë, duke marrë parasysh të gjitha masat e mbuluara nga KS. Këshilli i Evropës ka rekomanduar që një strategji e tillë në Kosovë të adresojë lidhjet ndërmjet të gjitha formave të dhunës ndaj grave në një mënyrë koherente dhe të qëndrueshme, si dhe të adresojë dhunën me bazë gjinore si një shkelje të të drejtave të njeriut dhe një formë diskriminimi.⁶⁶ Kjo është bërë edhe më urgjente që nga skadimi i SKMDhF.⁶⁷

Është bërë progres me Programin e Kosovës për Barazi Gjinore 2020-2024, i cili përmban një kuptim më të gjerë të dhunës me bazë gjinore. Programi ka për qëllim të adresojë disa pabarazi strukturore që prekin gratë dhe vajzat, duke marrë parasysh të gjitha dokumentet strategjike që ndikojnë në agjendën e barazisë gjinore, përfshirë SKMDhF, teksa nuk duplikon strategjitë përkatëse. Së pari, tërheq vëmendjen që gratë cenohen në mënyrë disproporcionale nga dhuna me bazë gjinore. Në lidhje me dhunën në familje, Programi diskuton vonesat në lëshimin dhe zbatimin e urdhrave të mbrojtjes dhe ndëshkimit joadekuat të autorëve, madje edhe në rastet e dhunës recidiviste. Programi gjithashtu diskuton trafikimin e qenieve njerëzore, sfidat e identifikimit dhe trajtimit të rasteve të ngacmimit seksual, përhapjen e martesave të hershme në komunitetet pakicë dhe rurale, dhe informacionin e pamjaftueshëm mbi dhunën e bazuar në gjini në lidhje me konfliktet. Programi gjithashtu diskuton raportimin e ulët të dhunës seksuale dhe informacionin e pamjaftueshëm mbi dhunën në emër të “nderit”. Pabarazitë strukturore po adresohen, të tilla si qasja e grave në tregun e punës. Programi tërheq vëmendjen për të dhëna të kufizuara të ndara gjinore mbi dhunën me bazë gjinore, mbrojtje më të ulët për gratë në pjesën veriore të Kosovës dhe mungesën e mekanizmave përcjellës për të monitoruar rastet e dhunës me bazë gjinore.

Për sa i përket objektivave, Programi nuk adreson në mënyrë të qartë disa forma të dhunës me bazë gjinore që nuk mbulohen nga SKMDhF-të e tanishme ose e ardhshme. Synimet përkatëse në këtë Program janë përqindja e rasteve të dhunës në familje të trajtuara nga gjyqësori; vështrimi i zbatimit të sanksioneve për autorët e dhunës me bazë gjinore, përfshirë dënimin adekuat për rastet e trafikimit me qenie njerëzore; përmirësimin e vlerësimit të aplikacioneve nga Komisioni për Verifikim për të mbijetuarit e dhunës seksuale të kryer gjatë luftës brenda afatit ligjor të mandatuar; integrimi i të dhënave të dhunës me bazë gjinore në Sistemin e Informacionit Shëndetësor; dhe monitorimin e përqindjes së vajzave dhe grave që kanë përjetuar dhunë fizike dhe psikologjike. Për sa i përket aktiviteteve, Programi përfshin caktimin e gjyqtarëve dhe prokurorëve të specializuar në trajtimin e çështjeve familjare, dhunës në familje, dhunës seksuale gjatë luftës, çështjeve të pronës dhe trashëgimisë; trajnimin e gjyqtarëve, prokurorëve dhe zyrtarëve të policisë në lidhje me përkufizimet e sapa miratuara në KPK, duke theksuar dhunën në familje dhe ngacmimet seksuale; përmirësimin e të dhënave në lidhje me viktimat dhe autorët e dhunës në familje; ndërgjegjësimin mbi të drejtat e grave, përfshirë

⁶⁶ Po aty, f. 79.

⁶⁷ Në një kumtesë për shtyp nga MD më 4 dhjetor 2020, KNMDHF në detyrë deklaroi se zyra e tij është “duke punuar në Strategjinë Kombëtare për Mbrojtjen nga Dhuna në Familje dhe ka dhënë mendim për adresimin e disa çështjeve brenda Projektligjit për Mbrojtjen nga Dhuna në Familje” (Ministria e Drejtësisë, “Zëvendësministri Dushi: Të ndërtojmë mekanizma lokal kundër dhunës në familje, të ngjashëm siç i kemi edhe në nivelin qendror”) 4 dhjetor 2020).

luftimin e dhunës në familje, stereotipat gjinorë dhe patriarkatin; përgatitjen e një analize të situatës për të kuptuar më mirë situatën e vajzave dhe grave të ndaluara në sistemin korrektues, duke përfshirë qasjen e tyre në shërbimet e shëndetit riprodhues; sigurimin e informacionit dhe trajnimit për vajzat dhe gratë në sistemet korrektuese dhe në burgje në lidhje me të drejtat e tyre, përfshirë rehabilitimin dhe ri-integrimin; dhe forcimin e kapacitetit të komisionit qeveritar që shqyrton aplikimet nga të mbi-jetuarit e dhunës seksuale gjatë luftës dhe të organizatave të licencuara për të rritur qasjen e grave në drejtësi.⁶⁸ Kështu, ndërsa njihet në Program, kuptimi më i gjerë i dhunës me bazë gjinore ende duhet të pasqyrohet plotësisht në një qasje gjithëpërfshirëse për adresimin e të gjitha formave të dhunës me bazë gjinore, siç parashikohet në KS.

Monitorimi

GREVIO ka për detyrë të monitorojë zbatimin e KS.⁶⁹ Palët e KS paraqesin raporte te GREVIO, por GREVIO nuk përpunon ankesat individuale të shkeljeve.⁷⁰ I vetmi organ që merret me ankesat individuale nën KS është Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (“GJEDNJ”). Meqenëse Kosova nuk është anëtare e Këshillit të Evropës dhe nuk është në gjendje të ratifikojë zyrtarisht KS, qytetarët e Kosovës nuk kanë qasje në GJEDNJ. Kështu, këta mekanizma monitorimi janë aktualisht të paarritshëm. Kosova mbase mund të angazhohet në negociata me Këshillin e Evropës për monitorimin e GREVIO, në mënyrë të ngashme me atë sesi Grupi i Ekspertëve për Veprim kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore monitoron Kosovën. Në ndërkohë, mungesa e qasjes në mekanizmat e monitorimit kushton më shumë rëndësi punës së shoqërisë civile, përfshirë OSHC-ve, akademikëve, sindikatave dhe shoqatave të avokatëve në monitorimin e zbatimit të kornizës ligjore.⁷¹ KS kërkon që shtetet të caktojnë organe zyrtare për të monitoruar dhe vlerësuar politikat dhe masat për të parandaluar dhe adresuar të gjitha format e dhunës.⁷² Ligji për Barazinë Gjinore tashmë parashikon që ABGJ të drejtojë zbatimin dhe të përgatisë raporte për CEDAW.⁷³ Mund të ekzistojnë mundësi për të zgjeruar këtë kompetencë për të përfshirë koordinimin nga një organ i pavarur ndër-institucional me përfaqësuesit e shoqërisë civile për monitorimin e zbatimit të KS, duke lehtësuar një sistem më të fortë të monitorimit të brendshëm. Ky dhe skenarë të tjerë të mundshëm për krijimin e organit të përhershëm të monitorimit mund të diskutohen dhe të adresohen më tej nga përfaqësuesit e institucioneve dhe shoqërisë civile teksa finalizojnë një ligj gjithëpërfshirës për dhunën me bazë gjinore.

E DREJTA MATERIALE

Në këtë pjesë shqyrtohet kapitulli i V e KS për të drejtën materiale, duke përfshirë format e dhunës

⁶⁸ ABGJ, [Programi i Kosovës për Barazi Gjinore 2020-2024](#), objektivi strategjik 3 (f. 60-61).

⁶⁹ Puna e organizatave të tilla njihet në Neni 66 e KS.

⁷⁰ Sidoqoftë, GREVIO mund të fillojë një procedurë hetimi kur ka informacion të besueshëm që tregon se kërkohet veprim për të parandaluar një model serioz, masiv ose të vazhdueshëm të çdo akti dhune të mbuluar nga KS (Neni 68).

⁷¹ Po aty, neni 9.

⁷² Neni 10.

⁷³ Neni 8.1.5.

me bazë gjinore që trajtohen në të dhe dispozitat për kompensimin e viktimave. Fokusi i kësaj pjese është në atë shkallë në të cilën këto dispozita thelbësore pasqyrohen në ligjin e Kosovës.

Dhuna në familje

KS përcakton dhunën në familje si, “të gjitha veprimet e dhunës fizike, seksuale, psikologjike ose ekonomike që ndodhin brenda familjes ose nësisë shtëpiake ose midis ish-bashkëshortëve ose partnerëve aktualë, pavarësisht nëse autori ndanë apo jo të njëjtin banim me viktimën”. Nga format e dhunës në KS, dhuna në familje është më e adresuara në kornizën ligjore të Kosovës. Aktet kryesore juridike janë LMDHF dhe KPK.

KS nuk kërkon një vepër penale të caktuar të dhunës në familje. Përkundrazi, ndonjë nga krimet nën KS mund të rëndohet në një mjedis të dhunës në familje; si kur vepra është kryer kundër një bashkëshorti ose partneri të mëparshëm ose aktual, nga një anëtar i familjes, një person që bashkëjeton me viktimën ose një person që ka abuzuar atë ose autoritetin e tij.⁷⁴ Kosova ka miratuar një qasje shumëplanëshe për trajtimin e dhunës në familje në KPK duke përfshirë edhe një shkelje të përkushtuar të dhunës në familje dhe duke i bërë marrëdhëniet familjare një rrethanë rënduese për krime të tjera.⁷⁵ Vepra e përkushtuar përmban dy formulime të dhunës në familje:⁷⁶

- Kushdo që e kryen dhunën ose keqtrajtimin fizik, psikologjik ose ekonomik me qëllim të cenimit të dinjitetit të personit tjetër brenda një marrëdhënieje familjare (neni 248.1),
- Çdo anëtar i familjes që ushtron dhunë ose keqtrajtim fizik, psikologjik, **seksual** ose ekonomik ndaj anëtarit tjetër të familjes së tij/saj (neni 248.3).

Ndërsa të dy mbajnë të njëjtin dënim, kjo përsëritje shkakton një mungesë qartësie të panevojshme veçanërisht për shkak të mos përfshirjes së dhunës në familje në formulimin e parë të veprës penale. Ligji do të ishte dukshëm më i qartë nëse thjeshtohet në vetëm një formulim që do të llogariste dhunën fizike, psikologjike, seksuale ose ekonomike ose keqtrajtimin brenda “marrëdhënies familjare”. Përkufizimi i “marrëdhënies familjare”, i përdorur në formulimin e parë të veprës përfshin personat që janë:

- të fejuar apo kanë qenë të fejuar ose janë të martuar ose kanë qenë të martuar ose që janë në bashkësi jashtëmartesore apo kanë qenë në bashkësi jashtëmartesore ose bashkëjetojnë në ekonomi të përbashkët ose kanë bashkëjetuar në ekonomi të përbashkët;
- që përdorin një shtëpi të përbashkët dhe janë në lidhje gjaku, martesë, adoptimi, krushqie apo janë në lidhje kujdestarie, duke përfshirë prindërit, gjyshërit, fëmijët, nipat dhe mbesat nga vajza dhe djali, vëllezërit dhe motrat, hallat dhe tezet, dajët dhe axhallarët, mbesat dhe nipërit nga

⁷⁴ Neni 46a.

⁷⁵ Neni 70.2.14. Një dënim shtesë u shqiptohet zyrtarëve publikë të cilët janë dënuar për dhunë në familje sipas KPK; atyre u ndalohet të ushtrojnë administratë publike ose shërbim për një deri në pesë vjet (neni 62.4).

⁷⁶ Neni 248.

- vëllai dhe motra, kushërinjtë; ose
- që janë prindër të një fëmije të përbashkët (neni I 13.25).

Njohja e aranzhimeve të jetesës si “shtëpi e përbashkët” mund të jetë e dobishme në kontekstin e Kosovës për të shpjeguar se ku jetojnë shumë familje ose familje të zgjeruara së bashku. Sidoqoftë, KS specifikon se është e parëndësishme nëse kryesi i dhunës ndan apo ka ndarë të njëjtën banesë me viktimën. Prandaj, lidhja e shtëpisë së përbashkët me marrëdhëniet e caktuara mund të jetë problematike duke kufizuar fushën e zbatimit të ligjit. Ky përkufizim duhet të sqarohet për të përfshirë të gjithë anëtarët e familjes (pavarësisht të rregullimeve të jetesës) ose çdo person që ndan vend të përbashkët të jetesës që (pavarësisht nga marrëdhënia). Sqarimi i përkufizimit gjithashtu do të ndikonte pozitivisht në dispozitat rënduese për krime të tjera që i referohen marrëdhënieve familjare.

Përkufizimi i dhunës në familje sipas LMDHF është më i detajuar sesa në KPK, duke përfshirë një listë jo-shteruese të veprimeve që përbëjnë dhunën në familje.⁷⁷ LMDHF përmban një përkufizim të ngjashëm të “marrëdhënies familjare” që duhet të sqarohet në përputhje si më sipër. LMDHF i kush-ton vëmendje të veçantë fëmijëve, personave të moshuar dhe personave me aftësi të kufizuara,⁷⁸ por nuk përmban ndonjë dispozitë që pranon se gratë preken në mënyrë disproporcionale nga dhuna në familje.

Dhuna psikologjike

KS kriminalizon dëmtimin serioz të qëllimshëm të integritetit psikologjik të një personi përmes detyrimit ose kërcënimeve.⁷⁹ Ajo që konsiderohet “serioze” nuk është përcaktuar, por parashikimi drejtohet drejt një sjelljeje e jo drejt një ngjarjeje të vetme.⁸⁰ Dhuna psikologjike hyn brenda përkufizimit të dhunës në familje në ligjin e Kosovës, si në LMDHF ashtu edhe në KPK. Kjo është e rëndësishme duke marrë parasysh se disa studime kanë treguar që mund të jetë forma më e përhapur e dhunës në një mjedis shtëpiak, duke përfshirë kufizimin e burimeve financiare, arsimimin ose kujdesin mjekësor, ose izolimin, poshtërimin dhe kërcënimet.⁸¹ Dhuna e tillë shpesh shoqëron abuzimin fizik ose seksual.⁸² Komisioni për Eliminimin e Diskriminimit ndaj Grave ka theksuar rëndësinë e njohjes së dhunës psikologjike në mjedisin e familjes në *VK kundër Bullgarisë*,⁸³ duke konkluduar se:

dhuna me bazë gjinore... në kuptimin e [CEDAW] dhe rekomandimi i përgjithshëm nr. 19, nuk kërkon një kërcënim të drejtpërdrejtë dhe të menjëhershëm për jetën ose shëndetin e

⁷⁷ Neni 2.1.2.

⁷⁸ Neni 1.

⁷⁹ Neni 33.

⁸⁰ “Raport shpjegues për Konventën e Këshillit të Evropës për parandalimin dhe luftimin e dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje”, Stamboll, 11.V.2011, f. 181.

⁸¹ Truchero Cuevas, J. dhe Khrystova, G., “Praktikat dhe Standardet e Mira Ndërkombëtare mbi Dhunën ndaj Grave dhe Dhunën në Familje”, Këshilli i Evropës, 2015, f. 24-25.

⁸² Krug, E., Dahlberg, L., Mercy, J., Zwi A. dhe Lozano, R. (red.) Për Organizatën Botërore të Shëndetësisë, *Raporti Botëror për Dhunën dhe Shëndetin: Kapitulli 4 - Dhuna nga Partnerët Intimë*, 2002, f. 89.

⁸³ Komiteti CEDAW, *VK kundër Bullgarisë* (CEDAW/C/49/D/20/2008).

viktimës. Dhuna e tillë nuk është e kufizuar në veprime që shkaktojnë dëm fizik, por gjithashtu përfshin veprime që sjellin dëmtime psikike ose seksuale ose vuajtje, kërcënime të ndonjë veprimi të tillë, detyrim dhe privime të tjera të lirisë.

GJEDNJ ka arritur në përfundime të ngjashme.⁸⁴ Për shembull, në rastin e *Hajduovà kundër Sllovakisë*, Gjykata gjeti se megjithëse kërcënimet e përsëritura të bëra nga ish-burri i një viktime nuk u materializuan kurrë, ato ishin të mjaftueshme për të ndikuar në integritetin psikologjik dhe mirëqenien e viktimës.⁸⁵ Kushtetuta e Kosovës parashikon që të drejtat e njeriut dhe liritë themelore të interpretohen në përputhje me vendimet e GJEDNJ,⁸⁶ kështu që kjo linjë arsyetimi mund të informojë gjykatat e Kosovës që merren me raste të dhunës psikologjike.

Sidoqoftë, dhuna psikologjike mund të ndodhë jashtë sferës së dhunës në familje dhe KS nuk e kufizon zbatimin e kësaj vepre në mjedisin në familje. Për shembull, Raporti Shpjegues për KS tërheq vëmendjen në vendin e punës ose mjedisin shkollor.⁸⁷ Kriminalizimi i dhunës psikologjike vetëm brenda një marrëdhënieje familjare mund të mos marrë në konsideratë modelet e sjelljes të parashikuara nga KS. Vepra penale e dhunës në familje mbështetet në një marrëdhënie të caktuar në të cilin ndodh dhuna psikologjike, e cila mund të mos vlejë për mjedise të tilla si puna ose shkolla (për shembull, kolegët ose mësuesit). Në Kosovë, veprat përkatëse në këtë kontekst përfshijnë kërcënime, shantazhe,⁸⁸ dhe ngacmime.⁸⁹ Megjithatë, një dispozitë e dedikuar për dhunën psikologjike në KPK mund të adresonte më mirë dhunën psikologjike nga perspektiva gjinore.

Dhuna fizike

KS kriminalizon çdo veprim të qëllimshëm të dhunës fizike ndaj një personi tjetër, pavarësisht nga konteksti në të cilin ndodhin akte të tilla.⁹⁰ Kjo i referohet dëmtimit trupor të pësuar pas forcës fizike.⁹¹ Dhuna fizike hyn brenda përkufizimit të dhunës në familje në KPK dhe LMDHF. Brenda KPK, tri vepra penale në përgjithësi ndalojnë dhunën fizike: sulmi, lëndimi i lehtë trupor dhe lëndimi i rëndë trupor.⁹² Këto vepra i nënshtrohen një dënimi më të lartë nëse vepra përfshin përdorimin e një arme, është kryer kundër një viktime të cënueshme,⁹³ dhe/ose motivohet nga një numër arsyesh të mbrojtura, përfshirë gjininë.

⁸⁴ Shihni për shembull: *Opuz kundër Turqisë* (Kërkesa nr. 33401/02); *A kundër Kroacisë* (Kërkesa nr. 55164/08); dhe *X dhe Y kundër Holandës* (Kërkesa nr. 8978/80).

⁸⁵ *Hajduovà kundër Sllovakisë* (Kërkesa nr. 2660/03).

⁸⁶ Neni 53.

⁸⁷ "Raport shpjegues për Konventën e Këshillit të Evropës për parandalimin dhe luftimin e dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje", Stamboll, 11.V.2011, f. 181.

⁸⁸ Neni 181 i KPK dhe 329, përkatësisht.

⁸⁹ Shih Ndjekja më poshtë.

⁹⁰ Neni 35 "Raport shpjegues për Konventën e Këshillit të Evropës për parandalimin dhe luftimin e dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje", Stamboll, 11.V.2011, f. 187.

⁹¹ Po aty, f. 188.

⁹² Nenet 184, 185 dhe 186, përkatësisht.

⁹³ Shikoni "[Gjinia në të Drejtën Penale](#)" pjesa sipër.

Femicidi dhe vëmendje e duhur

Femicidi i referohet vrasjes me bazë gjinore të grave dhe vajzave. Nuk ka një përkufizim të standardizuar të femicidit, por termi përfshin një sërë formash të njohura. KB e konsiderojnë që femicidi përfshinë, për shembull, vrasjen e grave dhe vajzave si rezultat i dhunës së partnerit intim, dhunës në familje, që lidhet me “nderin” ose pajën/prikën, dhe/ose vrasjen e grave punonjëse të seksit.⁹⁴ Instituti Evropian për Barazi Gjinore (EIGE) gjithashtu i referohet feticidit femëror, vdekjeve në lidhje me aborte të pasigurta dhe vdekjeve të lidhura me gjymtimin gjenital të femrave.⁹⁵

Brenda ligjit të Kosovës, vepra penale e vrasjes në KPK tërheq një dënim minimal prej pesë vjet burgim.⁹⁶ Vepra rëndohet nga një numër faktorësh, duke rritur dënimin në minimum dhjetë vjet ose burgim të përjetshëm, duke përfshirë: nëse viktimë është një fëmijë, një grua shtatzënë, një anëtar i familjes, ose nëse motivimi bazohet në një numër të arsyeve përfshirë gjininë, identitetin gjinor ose orientimin seksual.⁹⁷ Përkufizimi i “anëtarit të familjes” përfshin bashkëshortët dhe personat që “jetojnë në një bashkësi jashtëmartesore”.⁹⁸ Vepra e rëndë mund të zgjerohet për të përfshirë partnerë dhe ish-partnerë të cilët nuk jetojnë me viktimën. Për më tepër, disa krime që lidhen me dhunën me bazë gjinore tërheqin rritjen e ndëshkimit nëse krimi rezulton në vdekjen e viktimës: përdhunimi, sulmi seksual, aborti i detyruar, sterilizimi i detyruar dhe gjymtimi i organeve gjenitale të grave, përfshirë nxitjen ose ndihmën.⁹⁹

KS nuk përdor termin “femicid”, por krimi i dhunës fizike ka për qëllim të përfshijë dhunën që rezulton në vdekjen e viktimës.¹⁰⁰ Ndoshta më domethënëse është detyra e kujdesit të duhur që u imponohet shteteve për të parandaluar, hetuar, ndëshkuar dhe siguruar dëmshpërblim për aktet e dhunës të mbuluara nga KS që kryhen nga aktorë jo-shtetërorë.¹⁰¹ Kjo i referohet situatave të rrezikut ekstrem ku autoritetet shtetërore e dinin ose duhet ta kishin ditur rrezikun por nuk reagojnë. Kjo detyrë mund të shihet në kontekstin e dhunës së partnerit intim në praktikën gjyqësore të GJEDNJ,¹⁰² në të cilën gjykata u është referuar mendimeve të Komitetit për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit Kundër Grave dhe jurisprudencës së Gjykatës Ndër-Amerikane të të Drejtave të Njeriut për kujdesin e duhur. Në *Branko Tomasic kundër Kroacisë* GJEDNJ konfirmoi:

Një detyrim pozitiv do të lindë aty ku është vërtetuar se autoritetet e dinin ose duhet të kishin ditur në kohën e ekzistencës së një rreziku real dhe të menjëhershëm për jetën e një individi të identifikuar nga veprimet kriminale të një pale të tretë dhe se ata dështuan për të marrë masa brenda fushës së kompetencave të tyre, të cilat, gjykuar në mënyrë të arsyeshme, mund të

⁹⁴ Zyra e KB për Drogat dhe Krimin, *Studimi Global mbi Vrasjen: Vrasja e lidhur me gjininë e grave dhe vajzave*, 2018, f. 29-37.

⁹⁵ EIGE, *Terminologjia dhe Treguesit për Grumbullimin e të Dhënave: Përdhunimi, vrasja e grave dhe dhuna e partnerit intim*, 2017, f. 34-35.

⁹⁶ Neni 172.

⁹⁷ Neni 173.

⁹⁸ Neni 113.26.

⁹⁹ Nenet 227.5, 229.4, 178.3, 179.2 dhe 180.4, përkatësisht.

¹⁰⁰ Neni 35 “Raport shpjegues për Konventën e Këshillit të Evropës për parandalimin dhe luftimin e dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje”, Stamboll, 11.V.2011, f. 188.

¹⁰¹ Neni 5.

¹⁰² *Opuz kundër Turqisë* (Kërkesa nr. 33401/02).

priteshin për të shmangur atë rrezik.¹⁰³

Në Kosovë, në vitet e fundit, vëmendja e shtuar i është drejtuar femicidit në kontekstin e dhunës në familje dhe reagimit joadekuat institucional ndaj krimeve të tilla, përfshirë nga policia dhe dënimet. Nga viti 2017 deri në vitin 2020, të paktën 74 gra janë vrarë.¹⁰⁴ Detyrimi i procedurës së duhur sipas KS do të kërkonte hetim pas krimeve të tilla nëse autoritetet shtetërore kishin njohuri paraprake për ekspozimin e një gruaje që pëson dhunë, nëse institucionet shtetërore e dinin ose duhej ta dinin se jeta e gruas ishte në rrezik, dhe nëse ishin marrë masat e duhura.¹⁰⁵ Duhet të merret në konsideratë krijimi i një organi “mbikëqyrës të femicidit” të përqendruar në parandalimin duke identifikuar mangësitë në ligj, politikë ose zbatim.¹⁰⁶ Mjetet juridike nën KS duhet të jenë të arritshme për pasardhësit e viktimës në rast të vdekjes së saj ose të tij.¹⁰⁷

Martesa e detyruar

KS kërkon që shtetet të marrin masa për të siguruar që martesa e detyruar e një të rrituri ose fëmije të kriminalizohet.¹⁰⁸ KPK siguron në mënyrë adekuate këtë mbrojtje. Detyrimi i një personi të hyjë në martesë, ose lidhja e një martese duke e ditur se personi tjetër ishte i detyruar, dënohet me burgim.¹⁰⁹ Dënimi rritet nëse vepra penale është kryer kundër një fëmije (nën moshën 18 vjeç);¹¹⁰ nga një prind; dhe/ose nëse ekziston një element i përfitimit material. KPK dënon gjithashtu çdo zyrtar që me vetëdije lejon martesë të paligjshme.

E drejta civile ka një rol vendimtar në adresimin e martesave të detyruara. Kjo pasqyrohet në KS pasi martesat e lidhura me forcë duhet të anulohen ose zgjidhen pa barrë të tepërt financiare ose administrative mbi viktimën.¹¹¹ Ligji i Kosovës për Familje parashikon që martesa nuk është e vlefshme kur themelohet “nën shtrëngim, kërcënim ose gabimisht ose me ndonjë mungesë tjetër të vullnetit të lirë” dhe do të anulohet nëse “bashkëshorti” ka dhënë pëlqimin nën frikë, dhunë ose kërcënim të rëndë.¹¹²

Komentuesit kanë thënë se mund të jetë e vështirë të përmbushësh barrën e provës se martesa ishte “detyruar”; ndërsa gjykatat mund të pranojnë kërcënime fizike ose presione emocionale, ka pasur hezitim mes gjyqtarëve për të pranuar atë si të “detyruar” faktorë si frika nga ostracizmi ose

¹⁰³ Branko Tomasic kundër Kroacisë (Kërkesa nr. 46598/06).

¹⁰⁴ Të dhënat e siguruar për RrGK nga Policia e Kosovës. Shiko gjithashtu, Qendra Kosovare e Studimeve Gjinore, [Femicidi dhe perspektiva feministe](#), 2019 dhe monitorimin e RrGK.

¹⁰⁵ Duhaček, D., Branković, B. dhe Miražić, M. për Komisionin e Parlamentit Evropian për FEMM, [Të drejtat e grave në Ballkanin Perëndimor](#), janar 2019, f. 41.

¹⁰⁶ Zyra e Komisionerit të Lartë të Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Njeriut, “[Femicide Watch Call 2020](#)”.

¹⁰⁷ “Raport shpjegues për Konventën e Këshillit të Evropës për parandalimin dhe luftimin e dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje”, Stamboll, 11.V.2011, f. 164.

¹⁰⁸ Neni 37.1. Jashtë kriminalizimit është edhe joshja e një të rrituri ose fëmije në një territor tjetër nga vendi ku ata banojnë me qëllim të martesës së detyruar (neni 37.2).

¹⁰⁹ Neni 239.

¹¹⁰ Neni 113.22.

¹¹¹ Neni 32.

¹¹² Nr. 2004/32, përkatësisht nenet 18 dhe 63.

turpi, potencialisht shumë i rëndë për gratë në komunitetet e caktuara.¹¹³ Në Kosovë, martesat tek fëmijët dhe martesat e hershme ndodhin më shumë në komunitetet rome, ashkali, egjiptiane, rurale dhe diasporë.¹¹⁴ Kështu, gjyqtarët duhet të marrin trajnimin mbi martesën e detyruar dhe duhet të kenë vëmendjen tek fakti se disa aspekte kulturore ose gjinore përkatëse¹¹⁵ duhet të merren parasysh në kuptimin e tyre të asaj që mund të jetë “detyrimit” (dhe “kërcënimit” dhe “detyrimit” në Ligjin e Familjes). Ndërkohë, trajnimi duhet të bëjë të qartë se asnjë kulturë, zakon, fe, traditë ose i ashtuquajti “nder” nuk mund të justifikojë martesat e detyruara në asnjë rrethanë, siç kërkohet nga KS.¹¹⁶

Ndjekja

KS përkufizon ndjekjen si “sjellje e qëllimshme e përfshirjes në mënyrë të përsëritur në sjellje kërcënuese drejtuar një personi tjetër, duke shkaktuar që ai ose ajo frikësohet për sigurinë e saj ose tij”.¹¹⁷ Edhe pse KPK nuk e përdor termin “ndjekje”, vepra e “ngacmimit” kap të njëjtën sjellje.¹¹⁸ Ngacmimi në KPK është “një model i vëmendjes ose komunikimit të përsëritur dhe të padëshiruar me qëllim të ngacmimit, frikësimit, lëndimit, dëmtimit të pronës ose vrasjes së një personi tjetër ose fëmijëve të tij, familjes, të afërmve ose kafshëve shtëpiake” ose vendosja e një personi nën vëzhgim me të njëjtin qëllim.

Formulimi i kësaj dispozite në KS është përballur me disa kritika pasi thekson që pasojat e sjelljes mund të vendosin një prag veçanërisht të lartë për viktimën që e lë atë jashtë mase të pambrojtur.¹¹⁹ Disa argumentojnë se efekti mbi viktimën duhet të hiqet, pasi që ngarksa që i shkaktohet asaj në aspektin psikologjik dhe mendor është e mjaftueshme për t’u cilësuar si krim.¹²⁰ Ligji i Kosovës përballat me të njëjtat kritika duke kërkuar që viktima të vihet “nën frikë të arsyeshme nga vdekja, lëndim i rëndë trupor, dëmtimi i rëndë i pasurisë ose nën shqetësim të madh emocional”.¹²¹ Reforma e ardhshme duhet të konsiderojë heqjen e këtij aspekti të veprës penale.

Dënimi rritet nëse krimi është kryer ndaj një ish-partneri ose partneri aktual të familjes ose anëtarit të familjes. Një rrethanë e mëtejshme rënduese është kur përdoret një armë, instrument ose send tjetër.

Ngacmimi seksual

KS ndalon ngacmimet seksuale, të përcaktuara si: “çdo formë sjelljeje e padëshiruar verbale, joverbale ose fizike e natyrës seksuale me qëllim ose efekt të cenimit të dinjitetit të një personi, në veçanti kur

¹¹³ Agjencia Evropiane për të Drejtat Themelore, “Adresimi i martesës së detyruar në BE: dispozitat ligjore dhe praktikat premtuese”, 2014, f. 19.

¹¹⁴ Krol, et al., *Hartëzimi i shërbimeve mbështetëse për viktimat e dhunës ndaj grave në Kosovë*, f. 4.

¹¹⁵ Anitha, S. dhe Gill, A., “Shtrëngimi, pëlqimi dhe debati i martesës së detyruar në MB”, *Studime Ligjore Feministe*, 17 (2), 2009, 165-184, f. 175.

¹¹⁶ Neni 42.

¹¹⁷ Neni 34.

¹¹⁸ Neni 182. Disa komentatorë e kritikojnë këtë qasje, duke argumentuar se megjithëse ndjekja dhe ngacmimi janë të lidhura, ato janë fenomene të ndryshme dhe kërkojnë kriminalizim të veçantë (Van der Aa, S., “Trendët e Reja në Kriminalizimin e Ndjekjes në Shtetet Anëtare të BE”, *Revista Evropiane e Politikave dhe Kërkimeve Kriminale*, 24, 2018, 315-333, f. 326).

¹¹⁹ Po aty, f.325.

¹²⁰ Guelke, J. dhe Sorel, T., “Shkelja e privatësisë dhe ligjit: rasti i ndjekjes”, *Ligji, Etika dhe Filozofia*, 4, 2016, 32-60.

¹²¹ Neni 182.

krijon një mjedis frikësues, armiqësor, degradues, poshtërues ose ofendues”.¹²² KPK tani përmban një vepër të re, të ngjashme.¹²³ Ai mbron të gjithë personat nga ngacmimet seksuale, por u drejtohet posaçërisht atyre që janë “të cënueshëm” për shkak të moshës, sëmundjes, paaftësisë, varësisë, shtatzënisë ose paftësisë së rëndë fizike ose mendore, por jo bazuar në gjini. Ekziston një rritje e dënimit nëse kryesi është në një pozitë autoriteti mbi viktimën ose nëse përdoret një armë, instrument ose send.

Jashtë ligjit penal, si Ligji për Barazi Gjimore ashtu edhe Ligji për Mbrojtje nga Diskriminimi ndalojnë ngacmimet seksuale.¹²⁴ Këto vepra penale janë hartuar dobët.¹²⁵ Sidoqoftë, përfshirja e këtyre ndalimeve është pozitive sepse fusha e këtyre ligjeve është shumë e gjerë, duke përfshirë një gamë të gjerë të aspekteve të jetës publike dhe private, duke përfshirë por pa u kufizuar në punësim, arsim, qasje në mbrojtje sociale, komoditete sociale, trajtim të drejtë dhe të barabartë në procedurat gjyqësore, dhe qasja në vendet publike.

Dhuna seksuale

KS ndalon krime të ndryshme në lidhje me dhunën seksuale, duke përfshirë:

- A. përfshirjen në depërtimin jo-konsensual vagjinal, anal ose oral të një natyre seksuale të trupit të një personi tjetër me ndonjë pjesë trupore ose objekt;
- B. përfshirjen në veprime të tjera jo konsensuale të një natyre seksuale me një person;
- C. shkaktimin që një person tjetër të përfshihet në veprime jo-konsensuale të një natyre seksuale me një person të tretë.¹²⁶

KPK përmban veprat e përdhunimit dhe sulmit seksual, të cilat gjegjësisht korrespondojnë me veprat A dhe B më sipër, përkatësisht.¹²⁷ Përkufizimi i përdhunimit është nënshtrimi i një personi tjetër një veprim seksual pa pëlqimin e atij personi.¹²⁸ Sulmi seksual është kur një person prek një tjetër për një qëllim seksual ose e shtyn një person të prekë ata ose një person tjetër për një qëllim seksual, pa pëlqim.¹²⁹ KPK përmban një gamë të gjerë të rrethanave rënduese. Njëra është unike për përdhunimin: nëse akti shoqërohet nga një kërcënim “për të zbuluar një fakt që do të dëmtojë seriozisht nderin ose reputacionin e një personi të tillë ose të një personi të lidhur ngushtë”. Dënimet për përdhunimin dhe sulmin seksual rriten nëse ekziston një kërcënim i dhunës, rrezikut të pashmangshëm, shfrytëzimit, përdorimit të armës, torturës, lëndimit trupor, dehjes, vetëdijes për dobësitë e një viktime ose marrëdhënies familjare me viktimën.

¹²² Neni 40.

¹²³ Neni 183.

¹²⁴ Neni 3.1.12; dhe Ligji Nr. 05/L-021 për mbrojtje nga diskriminimi, Neni 4.1.3.

¹²⁵ Shih RrGK, *Diskriminimi me bazë gjinore dhe punësimi në Kosovë*, f. 19 dhe 23.

¹²⁶ Neni 36.

¹²⁷ Vepra e Degradimit të Integritetit Seksual (neni 230) ndjek gjerësisht strukturën e njëjtë të këtyre veprave penale, megjithëse me dënime të ndryshme. Kjo vepër është kur një person është i detyruar të ekspozojë pjesët private të trupit të tij, të masturbojë ose të kryejë një akt tjetër që degradon integritetin e tij seksual, pa pëlqimin e tij.

¹²⁸ Neni 227. Neni 225.4 përcakton “aktin seksual”.

¹²⁹ Neni 229.

Pëlqimi

KS miraton qasjen e ligjit ndërkombëtar dhe të të drejtave të njeriut në konsiderimin e autonomisë qendrore në përkufizimin e përdhunimit, duke deklaruar se “pëlqimi duhet të jepet vullnetarisht si rezultat i vullnetit të lirë të personit vlerësuar në kontekstin e rrethanave përreth”. Këshilli i Evropës ofron udhëzimet e mëposhtme:

Ndjekja penale e kësaj veprë do të kërkojë një vlerësim të ndjeshëm në kontekst të provave në mënyrë që të përcaktohet rast pas rasti nëse viktimë është pajtuar lirisht për veprën seksuale të kryer. Një vlerësim i tillë duhet të njohë gamën e gjerë të përgjigjeve të sjelljes ndaj dhunës seksuale dhe përdhunimit që shfaqin viktimat dhe nuk do të bazohet në supozime të sjelljes tipike në situata të tilla. Është po aq e rëndësishme të sigurohet që interpretimet e legjislacionit të përdhunimit dhe ndjekja penale e rasteve të përdhunimit nuk ndikohen nga stereotipet gjinorë dhe mitet për seksualitetin mashkullor dhe femëror.¹³⁰

Në Raportin Shpjegues për KS, Këshilli i Evropës gjithashtu tërheq vëmendjen për çështjen e GJEDNJ të *MC kundër Bullgarisë*:

gjykata është e bindur se çdo qasje e ngurtë ndaj ndjekjes penale të veprave seksuale, siç është kërkimi i provës së rezistencës fizike në të gjitha rrethanat, rrezikon të lërë lloje të caktuara të përdhunimit pa u ndëshkuar dhe duke rrezikuar kështu mbrojtjen efektive të autonomisë seksuale të individit.... [Shtetet anëtare duhet të kërkojnë] penalizimin dhe ndjekjen penale efektive të çdo akti seksual jo-konsensual, përfshirë këtu edhe mungesën e rezistencës fizike nga viktimë.¹³¹

Sipas KPK, “pëlqimi” do të thotë pajtim i vullnetshëm i personit i cili ka arritur moshën 16 vjet për të kryer aktin seksual.¹³² Mund të nënkuptojë gjithashtu marrëveshje vullnetare të dy personave të cilët kanë arritur moshën katërmëdhjetë (14) vjet dhe ku dallimi në moshën e tyre nuk tejkalon 2 vjet. Ekziston një mbrojtje sipas KPK kur një person gabimisht beson se një viktimë është mbi moshën 16 vjet për “arsye të justifikueshme”.¹³³ Në rrethana të tilla, një person nuk mund të jetë penalisht përgjegjës për përfshirjen në një akt seksual konsensual me një person nën moshën e pëlqimit. Neglizhenca e të akuzuarit është e pamjaftueshme për të përmbushur këtë mbrojtje, që do të thotë se autori i krimit duhet të dënohet nëse duhet të kishte qenë në dijeni se viktimë ishte nën moshën e pëlqimit ose nëse ai ka vepruar pa kujdes.

KPK përcakton disa rrethana jo shteruese kur nuk merret pëlqimi. Këto janë: kur viktimë

¹³⁰ “Raport shpjegues për Konventën e Këshillit të Evropës për parandalimin dhe luftimin e dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje”, Stamboll, 11.V.2011, f. 192.

¹³¹ Kërkesa nr. 39272/98.

¹³² Neni 225.1 - 225.2.

¹³³ Nenet 25 dhe 226.

shpreh me fjalë ose sjellje që nuk dëshiron të kryejë një akt seksual; ku pëlqimi shprehet nga dikush tjetër përveç viktimës; kur pëlqimi është marrë përmes mashtrimit, frikës ose frikësimit; ose kur dikush është i paaftë për të dhënë pajtimin për aktivitet seksual për shkak të aftësisë së zvogëluar mendore apo fizike ose dehjes.

Provat e papranueshme

Ndërsa rregulloret e *Gjykatës Penale Ndërkombëtare për ish Jugosllavinë* dhe *Gjykatës Penale Ndërkombëtare* shprehin të dyja se sjellja e mëparshme seksuale e një viktime nuk mund të pranohet si provë, KS lejon këtë “vetëm kur është e rëndësishme dhe e nevojshme”,¹³⁴ duke lejuar diskrecion të konsiderueshëm.¹³⁵ Në Kosovë, Drafti i KPPK-së kërkon të prezantojë sa vijon:

dhunën me bazë gjinore.²³⁵ KS kërkon që shtetet të marrin masa për të inkurajuar të gjithë anëtarët e shoqërisë, veçanërisht burrat dhe djemtë, për të kontribuar në mënyrë aktive në parandalimin e të gjitha formave të dhunës në KS.²³⁶ Angazhimi i burrave në parandalimin e dhunës me bazë gjinore është bërë një komponent gjithnjë e më i institucionalizuar i punës së barazisë gjinore në të gjithë botën. Angazhimi i tyre efektiv mund të përfitojë nga marrja në konsideratë e një kuptimi ndër-sektorial se si burrat mund të përjetojnë marginalizim bazuar në racë, klasë, seksualitet dhe vendndodhje të tjera shoqërore.²³⁷ Sidoqoftë, përhapja dhe ndikimi disproporcional i dhunës me bazë gjinore mbi gratë dhe adresimi i pabarazive gjinore duhet të trajtohen si përparësi.²³⁸ Angazhimi i burrave dhe djemve në parandalimin e dhunës ndaj grave duhet të bazohet në parimet feministe dhe të udhëhiqet nga organizatat për të drejtat e grave për të çuar përpjekjet përpara.

Ngritja e vetëdijes, arsimimi dhe trajnimi i profesionistëve

KS përfshin ngritjen e vetëdijes, arsimimin dhe trajnimin e profesionistëve nën kapitullin e parandalimit.²³⁹ Direktiva për të Drejtat e Viktimave gjithashtu thekson shumë nga këto pika.²⁴⁰ Në Kosovë, SKMDHF 2016-2020 përfshiu parandalimin si një objektiv primar strategjik: “Ulja e qëndrimeve dhe sjelljeve gjykuese që mbështesin dhunën në familje, përmes informacionit, arsimimit dhe shkollimit dhe ngritjes së ndërgjegjësimit të vazhdueshëm të profesionistëve, komunitetit dhe të gjithë shoqërisë”.²⁴¹ Për rritjen e ndërgjegjësimit, fushata të tilla duhet të kenë të bëjnë me fushatat e rregullta për të adresuar forma të ndryshme të dhunës, të drejtat e njeriut të grave, barazinë gjinore, të drejtën e grave për të jetuar të lira nga dhuna, përgjigjet me “tolerancë zero” dhe iniciativa të tjera.²⁴² Fushatat specifike gjithashtu duhet të përmirësojnë njohuritë e ligjeve që adresojnë dhunën ndaj grave dhe mjetet juridike. Në Kosovë, akterë të ndryshëm duhet të angazhohen në ngritjen e vetëdijësimit teksa ABGj bën koordinimin për masa të tilla.²⁴³

Sipas KS, arsimi në mënyrë të ngjashme duhet të përfshijë programe mësimore në “të gjitha nivelet” mbi “barazinë midis grave dhe burrave, role jo-stereotipe gjinore, respekt reciprok, zgjidhje jo të dhunshme të konflikteve në marrëdhëniet ndërpersonale, dhunë me bazë gjinore ndaj grave dhe të drejtën e integritetit personal”. “Të gjitha nivelet” përfshijnë objekte arsimore joformale, sporte,

²³⁵ Cook, R. dhe Cusack, S., *Stereotipat gjinorë, perspektivat juridike transnacionale*, University of Pennsylvania Press, 2010.

²³⁶ Neni 12.4.

²³⁷ Casey, E., Leek, E., Tolman, R., Allen, C., dhe Carlson, J., “Vendosja e burrave në dhomë: perceptimet e strategjive efektive për të filluar përfshirjen e burrave në parandalimin e dhunës me bazë gjinore në një mostër globale”, *Kultura, Shëndeti dhe Seksualiteti*, 19 (9), 2017, 979-995, f. 993.

²³⁸ Po aty. Ekzistojnë shqetësime që përfshirja e burrave riprodhon modelet e fuqisë dhe privilegjit të burrave dhe kërcënon udhëheqjen e grave në lëvizje (shih: MenEngage for UN Women dhe UNFPA, “Men, Masculinities and Changing Power: Një letër diskutimi mbi angazhimin e burrave në barazinë gjinore nga Pekini 1995 në 2015”, f. 43).

²³⁹ Casey, E., Leek, E., Tolman, R., Allen, C., dhe Carlson, J., “Vendosja e burrave në dhomë: perceptimet e strategjive efektive për të filluar përfshirjen e burrave në parandalimin e dhunës me bazë gjinore në një mostër globale”, *Kultura, Shëndeti dhe Seksualiteti*, 19 (9), 2017, 979-995, f. 993. Po aty. Ekzistojnë shqetësime që përfshirja e burrave riprodhon modelet e fuqisë dhe privilegjit të burrave dhe kërcënon udhëheqjen e grave në lëvizje (shih: MenEngage for UN Women dhe UNFPA, “Men, Masculinities and Changing Power: Një letër diskutimi mbi angazhimin e burrave në barazinë gjinore nga Pekini 1995 në 2015”, f. 43). Nenet 13 - 15.

²⁴⁰ Neni 26.

²⁴¹ SKMDHF 2016-2020, f. 9.

²⁴² Truchero Cuevas, J. dhe Khrystova, G., “Praktikat dhe Standardet e Mira Ndërkombëtare mbi Dhunën ndaj Grave dhe Dhunën në Familje”, *Këshilli i Evropës*, 2015, f. 12.

²⁴³ Ligji për Barazi Gjinore, nenet 7 dhe 8.1.10.

kulturë dhe media. Arsimi duhet të jetë i ndjeshëm ndaj gjinisë dhe të përfshijë informacione mbi ligjet që promovojnë të drejtat e grave dhe që adresojnë dhunën ndaj grave.²⁴⁴ Një praktikë e mirë është futja e një kërkesë ligjore për autoritetet e arsimit për të kryer “auditime gjinore” të materialeve shkollore, duke siguruar heqjen e stereotipeve seksiste dhe diskriminuese.²⁴⁵ Në Kosovë, kjo masë është përfshirë në Ligjin për Barazi Gjinore dhe një udhëzues metodologjik mbi “Parandalimin e Stereotipeve Gjinore dhe Promovimin e Barazisë Gjinore në Tekstet dhe Materialet Shkollore” është botuar nga ABGJ.²⁴⁶ Sidoqoftë, Programi për Barazi Gjinore thekson se pak përparim është bërë në ndërmarrjen e auditimit gjinor të teksteve dhe programeve mësimore.²⁴⁷ Përmirësimi i këtij është një objektiv strategjik i Programit.

KS kërkon trajnim për profesionistët, të cilët merren me viktimat ose kryes të dhunës, për parandalimin dhe zbulimin e dhunës, barazinë midis grave dhe burrave, nevojat dhe të drejtat e viktimave, nevojat e grave të marginalizuara, vlerësimin e rrezikut, dinamikën gjinore dhe si të parandalojnë viktimizimin sekondar. Kjo duhet të përfshijë bashkëpunimin e koordinuar shumë-agjencish për trajtimin gjithëpërfshirës dhe të duhur të referimeve. Trajnimi kërkohet gjithashtu sipas Direktivës për të Drejtat e Viktimave.²⁴⁸ Trajnimi i përgjithshëm dhe i specializuar është veçanërisht i rëndësishëm për policinë, prokurorët, gjyqësorin, personelin e gjykatës, avokatët, organizatat për mbështetjen e viktimave, punonjësit socialë dhe të kujdesit shëndetësor dhe zyrtarë të tjerë që mund të merren me viktimat.

Aktualisht, PSV-të që rregullojnë detyrat e profesionistëve në adresimin e dhunës në familje në Kosovë janë pjesërisht në përputhje me kërkesat e KS, pasi ato nuk arrijnë të adresojnë në mënyrë adekuate format e tjera të dhunës ndaj grave.²⁴⁹ ABGJ ka vërejtur se trajnimi joadekuat pengon zbatimin e duhur të PSV-ve mbi dhunën në familje.²⁵⁰ Në mënyrë ideale, protokollet dhe udhëzimet specifike duhet të futen në përdorim për profesionistët që merren me viktimat e të gjitha formave të dhunës në KS, dhe masa të tilla duhet të mbështeten nga një trajnim i vazhduar, i specializuar dhe sistematik.²⁵¹

Ndërsa respekton lirinë e shprehjes dhe pavarësinë, KS inkurajon sektorin privat dhe mediat që të marrin pjesë në hartimin dhe zbatimin e politikave, udhëzimeve dhe standardeve të vetë-rregullimit për të parandaluar dhunën ndaj grave.²⁵² Këshilli i Evropës ka komentuar rëndësinë e mediave në Kosovë në raportimin e dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje në një mënyrë të ndjeshme ndaj gjinisë, jo stereotipike.²⁵³ Media mund të formësojë opinionin publik, kështu që rritja e ndërgjegjë-

²⁴⁴ Truchero Cuevas, J. dhe Khrystova, G., f. 12.

²⁴⁵ Përshtatur nga Kapitulli I i Aktit Organik Spanjoll mbi Masat e Integruara të Mbrojtjes kundër Dhunës Gjinore, 2004.

²⁴⁶ Neni 21. Gjuha e kësaj dispozite është frymëzuese dhe duhet të forcohet; ABGJ, [“Parandalimi i stereotipeve gjinore dhe promovimi i barazisë gjinore në tekstet dhe materialet shkollore”](#).

²⁴⁷ ABGJ, [Programi i Kosovës për Barazi Gjinore 2020-2024](#), f. 32.

²⁴⁸ Neni 25.

²⁴⁹ Duhaček, D., Branković, B. dhe Miražić, M. për Komitetin FEMM, “Të Drejtat e Grave në Ballkanin Perëndimor”, 2019, f. 54.

²⁵⁰ ABGJ, [“Vlerësimi i nivelit të zbatimit të Procedurave Standarde të Veprimit për Mbrojtjen nga Dhuna në Familje në Kosovë”](#), 2019, f. 150.

²⁵¹ Krol, et al., [Hartëzimi i shërbimeve mbështetëse për viktimat e dhunës ndaj grave në Kosovë](#), f. 79.

²⁵² Neni 17.

²⁵³ Këshilli i Evropës, [“Rritja e ndërgjegjësisë për dhunën ndaj grave dhe dhunën në familje: puna me media në Kosovë”](#), 2019.

simet dhe qasjet më të ndjeshme ndaj gjinisë për raportimin mund të çojnë në mbështetje shoqërore në parandalimin dhe adresimin e dhunës ndaj grave.²⁵⁴ OSBE-ja në Kosovë ka përgatitur një dokument të dobishëm për gazetarët për raportimin e rasteve të dhunës në familje.²⁵⁵

MBLEDHJA E TË DHËNAVE

KS-ja detyron shtetet të mbledhin rregullisht të dhëna të ndara sipas gjinisë dhe të mbështesin hulumtimet për të gjitha format e dhunës të mbuluara nga KS në mënyrë që të studiojnë shkaqet e saj rrënjësore, efektet, incidencën, nivelet e dënimit dhe efikasitetin e masave të zbatimit.²⁵⁶ Në Kosovë, Ligji për Barazi Gjinore detyron të gjitha institucionet publike të mbledhin të dhëna statistikore të ndara sipas gjinisë dhe t'i paraqesin ato në Agjencinë e Statistikave të Kosovës.²⁵⁷ Mosrespektimi i kësaj dënohet me gjobë.²⁵⁸ Sistemi i drejtësisë vazhdon punën e vazhdueshme për ta bërë sistemin e tij të menaxhimit të rasteve (CMIS) plotësisht operacional dhe ka miratuar një manual mbi përdorimin e CMIS. Sistemi duhet të përfshijë detaje elektronike për të gjitha rastet, dokumentacionin dhe vendimet e përpunuara nga sistemi i drejtësisë: policia, prokuroria dhe gjykatat. Përfundimisht, ai mund të mundësojë përpunimin e të dhënave institucionale për të prodhuar statistika për përdorim publik dhe për të informuar politikëbërjen, e cila do të lehtësonte komunikimin e qeverisë me BE-në në lidhje me progresin e saj drejt kapitullit 23 të *acquis*, “gjyqësia dhe të drejtat themelore”. Megjithatë disa aktgjykime të gjykatave janë në dispozicion në internet, gjetja e rasteve gjyqësore përkatëse është jashtëzakonisht e vështirë pasi vendimet janë të organizuara në mënyrë kronologjike e jo në mënyrë tematike. Prandaj, është e vështirë të marrësh informacione se si gjykatat po trajtojnë rastet e dhunës me bazë gjinore në mënyrë specifike. Të dhënat e ndara sipas gjinisë ende nuk janë lehtësisht të arritshme në internet.

Kosova gjithashtu krijoji një bazë të dhënash të integruar për rastet e dhunës në baza gjinore në dhjetor 2018 të financuar nga UN Women dhe BE.²⁵⁹ Zëvendës Ministri i Drejtësisë dhe Koordinatori Nacional për Mbrojtjen nga Dhuna në Familje mbikëqyrë bazën e të dhënave. Ekzistojnë shqetësime në lidhje me përdorimin efikas të kohës së zyrtarëve për të futur të dhëna si në këtë, ashtu edhe në bazën e të dhënave të CMIS. Fakti që RrGK u përpoq dhe luftoi të siguronte informacion nga institucionet përkatëse për të informuar këtë raport sugjeron që menaxhimi i të dhënave ende nuk funksionon siç është parashikuar. Shumica e institucioneve relevante qartazi nuk po e përmbushin detyrën e tyre për të dorëzuar të dhëna në Agjencinë e Statistikave të Kosovës në përputhje me Ligjin për Barazinë Gjinore.

KONKLUZION

Miratimi i draftit të KPPK do të sjellë kornizën ligjore mbi dhunën me bazë gjinore në Kosovë në mënyrë

²⁵⁴ Po aty.

²⁵⁵ OSBE Kosovë, “Raportimi mbi Dhunën në Familje: Udhëzime për gazetarët”, 2018. Këshilli i Evropës gjithashtu ka përgatitur udhëzime.

²⁵⁶ Neni 11.

²⁵⁷ Neni 5.1.8.

²⁵⁸ Neni 23.5.

²⁵⁹ Komisioni Evropian, *Raporti i Kosovës 2019*, 2019, f. 28.

të konsiderueshme më afër Direktivës së KS dhe asaj për Mbrojtjen e Viktimave në kuptim të hetimeve dhe procedurave penale, si dhe mbrojtjes dhe mbështetjes. Teksa korniza do të pasqyrojë shumë nga dispozitat thelbësore të KS me këto ndryshime, fushat që kanë nevojë për përmirësim janë ato në kornizën ligjore, veçanërisht lidhur me vepra të tilla si dhuna në familje, dhuna psikologjike, ndjekja, gjymtimi i organeve gjenitale të grave dhe luftimi i formave të dhunës me bazë të lehtësuar nga TIK. Për më tepër, qasja në urdhrat e mbrojtjes urgjentisht duhet të zgjerohet për viktimat e të gjitha formave të dhunës me bazë gjinore. Çështja kryesore në kornizën ligjore dhe të politikave është mungesa e një kuptimi gjinor të dhunës ndaj grave, veçanërisht jashtë sferës së dhunës në familje.

Neutraliteti gjinor në ligj dhe mungesa e masave të synuara të politikave për të adresuar format e dhunës ndaj grave përveç dhunës në familje ilustron nevojën për masa shtesë ligjore dhe të politikave për zbatimin e kornizës së integruar, efektive, gjithëpërfshirëse dhe të koordinuar për të luftuar dhe parandaluar të gjitha format të dhunës me bazë gjinore të mandatuar nga KS. Nevojiten rregullime të mëtijshme për të institucionalizuar monitorimin, vlerësimin si dhe zbatimin.

PËRGJIGJA INSTITUCIONALE NDAJ DHUNËS ME BAZË GJINORE NË KOSOVË

Ky kapitull shqyrton përgjigjen institucionale ndaj dhunës me bazë gjinore në Kosovë, sipas kornizës ligjore ekzistuese. Kapitulli i identifikon mangësitë që kërkojnë adresë për të zbatuar plotësisht KS. Ky kapitull së pari ofron një pasqyrë të ndërgjegjësimit të përgjithshëm të institucioneve për kornizën ligjore, qëndrimet ndaj dhunës me bazë gjinore dhe zbatimin e kornizës ligjore, në përgjithësi. Së dyti, kapitulli diskuton koordinimin ndërinstitutional në adresimin e formave të ndryshme të dhunës me bazë gjinore në nivelet kombëtare dhe lokale. Kapitulli pastaj përfshin pjesë për secilin institucion, ose grupin e institucioneve, përgjegjës për adresimin e dhunës me bazë gjinore në Kosovë. Secila pjesë diskuton njohuritë, qëndrimet dhe performancën e tyre në adresimin e dhunës me bazë gjinore në përputhje me kornizën ligjore. Kapitulli bazohet në hulumtimet ekzistuese, intervistat, monitorimet dhe të dhëna. Ndërsa hulumtuesit përdorën fokusimin për të rritur vlefshmërinë e gjetjeve, nivele të tjera të njohurive dhe qëndrimeve mund të ekzistojnë në Kosovë që ekipi hulumtues nuk i ka hasur, duke pasur parasysh metodën e përdorur të mostrave. Sidoqoftë, fakti që temat përsëriten në mesin e të anketuarve sugjerojnë trende të ndërgjegjësimit dhe qëndrimeve, dhe autorët treguan ndryshime në gjetje, ku u identifikuan.

NDËRGJEGJËSIMI I PËRGJITHSHËM DHE ZBATIMI I KORNIZËS LIGJORE

Kjo pjesë ofron një pasqyrë të njohurive dhe qëndrimeve të institucioneve si dhe zbatimit të kornizës ligjore nga ana e tyre, përpara diskutimit individual për institucionet. Kjo përfshin nën-pjesët përkatëse për të siguruar një qasje ndër-sektoriale, jo-diskriminuese; dhe ndarjet e buxhetit për adresimin e dhunës me bazë gjinore.

Njohuritë dhe qëndrimet mbi dhunën me bazë gjinore

Sipas pikëpamjeve të tyre, përfaqësuesit e institucioneve kishin prirjen të bien dakord se ndërgjegjësimi dhe qëndrimet ndaj dhunës me bazë gjinore, veçanërisht dhunës në familje, janë përmirësuar që nga viti 2017. Përfaqësuesit e institucioneve të ndryshme të intervistuar nga RrGK dinin për formë të ndryshme të dhunës me bazë gjinore, sipas kornizës ligjore të Kosovës. Disa vunë re se dhuna me bazë gjinore përfshin dhunë ndaj një personi të një gjinie tjetër *shkaku* i gjinisë së tyre. Disa vunë në dukje se gratë përjetojnë dhunë më shumë sesa burrat dhe se ky është abuzim i të drejtave të njeriut. Megjithatë, më shpesh sesa jo, të anketuarve u mungonte një kuptim më i thellë konceptual. Ata ngatëronin në mënyrë të përsëritur gjininë me seksin, ose gratë. As që kishin tendencë të kuptonin plotësisht marrëdhëniet gjinore dhe se si ato kontribuojnë në dhunën strukturore ndaj grave. Kur u pyetën për të identifikuar format e dhunës me bazë gjinore, të anketuarit shpesh përmendnin dhunën fizike, psikologjike, seksuale dhe ekonomike. Më pak përmendën ndjekjen, ngacmimet seksuale, trafikimin seksual dhe gjymtimin e organeve gjenitale të grave. Të anketuarit shpesh përqendroheshin në dhunën në familje, duke demonstruar njohuri të kufizuara të formave të tjera të dhunës që ndodhin jashtë

marrëdhënieve familjare. Kështu, ky hulumtim vërtetoi konstatimin e Krol dhe të tjerëve që ofruesit e shërbimeve “veprojnë pothuajse kryesisht në bazë të një përkufizimi të bazuar në dhunën në familje ndaj gjinisë neutrale”.¹ Kjo mund t’i atribuohet fokusit të lartpërmendur të kornizës ligjore dhe të politikave ndaj masave të dhunës në familje dhe vëmendjes së kufizuar ndaj formave të tjera të dhunës me bazë gjinore. Duke pasur parasysh këtë fokus, institucionet kanë pasur më pak trajnime ose përvojë në trajtimin e formave të tjera të dhunës në mënyrë gjithëpërfshirëse. Në të vërtetë, të anketuarit raportuan në mënyrë të përsëritur se trajnimi, së bashku me përfshirjen e “dhunës në familje” në KPK, kanë kontribuar në përmirësimin e njohurive dhe ndërgjegjësimit në trajtimin e rasteve.

Me disa përjashtime të dukshme, të diskutuara në pjesët e mëvonshme, zyrtarët priren të jenë të njohur me ndryshimet e fundit në KPK dhe përkufizimet e reja të veprave penale. Sidoqoftë, të anketuarit në mënyrë të përsëritur ngatërronin sulmin seksual dhe ngacmimin seksual. Konfuzioni sillej gjithashtu rreth nenit të KPK-së “Nxitja për të ekspozuar pjesët intime të trupit”; një i anketuar tha:

Do të thotë, për shembull, ne kemi kodin e veshjes [në ministrinë tonë] dhe kemi dashur të rrisim vetëdijen. Është një situatë e shëmtuar kur gratë veshin pantallona të shkurtra dhe nuk duken mirë. Është diçka e keqe. Ne e mirëpritëm [faktin që dikujt] iu refuzua hyrja në këtë ndërtesë në mënyrë që ata të mos hynin pa e respektuar kodin e veshjes.

Komentet e dëguara, të tilla si ky, jo vetëm që ilustrojnë kuptimin e dobët të asaj që përfshin ky krim, por gjithashtu sugjerojnë norma dhe qëndrime më të gjera të socializuara gjinore, të cilat mund të ndikojnë në qasjet e zyrtarëve ndaj adresimit të dhunës me bazë gjinore.

Kishte gjithashtu keqkuptim të gjerë rreth nenit të ri të KPK për gjymtimin gjenital të femrave. Për shembull, një i anketuar tha: “gjymtimi është sinonim i lëndimit; mund të ndodhë kur dhuna seksuale bëhet me forcë, kur ekziston një element i sadizmit; dhunë e rëndë që mund të ushtrohet nga partneri juaj”. Deklaratat relativiste kulturore gjithashtu përsëriten, duke pyetur pse një nen i tillë kishte ndonjë rëndësi në Kosovë, ku njerëzit “nuk janë kafshë”. Komente të tilla sugjerojnë nevojën për ndërgjegjësim të mëtejshëm në lidhje me rëndësinë e tij në Kosovë dhe për mënyrat më të ndjeshme të diskutimit të çështjes.

Të anketuarit nga institucionet kanë tendencë të dinë për LMDHF, megjithëse ekzistonte një konfuzion në lidhje me përmbajtjen dhe qëllimin e tij, veçanërisht midis institucioneve që nuk janë të përfshira drejtpërdrejt në zbatimin e tij. Për shembull, disa diskutuan për zbatimin e dobët të programeve të rehabilitimit, megjithëse kjo adresohet vetëm pjesërisht dhe përkohësisht brenda LMDHF për sa i përket urdhrave të mbrojtjes dhe udhëzimeve shoqëruese administrative.² LMDHF në fakt nuk adreson në mënyrë gjithëpërfshirëse riintegrimin afatgjatë ose nuk ofron zgjidhje afatgjata për viktimat pasi skadojnë urdhrat e mbrojtjes. Përfaqësuesit në disa institucione duket se nuk e kuptuan këtë. Zyrtarët e angazhuar në zbatimin e PSV-ve në lidhje me dhunën në familje zakonisht i dinin përgjegjësitë e

¹ Krol, dhe të tjerët, *Hartëzimi i shërbimeve mbështetëse për viktimat e dhunës ndaj grave në Kosovë*, f. 78.

² Udhëzimi Administrativ Nr. 12/2012 për përcaktimin e vendit dhe mënyrës së trajtimit psikosocial të autorëve të dhunës në familje dhe Udhëzimi Administrativ Nr. 02/2013 mbi metodën e trajtimit të kryesve të dhunës në familje ndaj të cilëve është vendosur masa për trajtim të detyrueshëm mjekësor nga alkoolizmi dhe varësia ndaj substancave psikotrope.

tyre. Ndërkohë, pjesëmarrësit e hulumtimit nëpër institucione të ndryshme kishin tendencë të kishin më pak njohuri në lidhje me SKMDHF, veçanërisht për veprimet jashtë kompetencave të institucioneve të tyre.

“Ne e shmangim atë bisedë me burrat; brezi ynë nuk është i gatshëm të flasë për tema që janë tabu. Vetëm ne koleget femra flasim për këtë.”

- Grua, zyrtare në ministrinë kyçe

Për të vlerësuar qëndrimet brenda institucioneve dhe prirjen e tyre për të referuar raste sipas KPK, PSV dhe SKMDHF, RrGK pyeti zyrtarët se çfarë duhet të bëjë një grua nëse përjeton dhunë në familje. Zyrtarët tentuan të deklarojnë se viktimat duhet të raportojnë dhunën në polici. Sidoqoftë, pikëpamja që gratë duhet të merren me dhunën në familje në mënyrë private mbizotëronte në mesin e zyrtarëve nëpër institucione të ndryshme. Disa thanë se viktima

duhet së pari të shkojë në QPS ose në OSHC që mund të konsultojnë dhe udhëzojnë familjen; ajo duhet të kontaktojë policinë vetëm si mundësi të fundit, thanë ata. Nevoja për të “shpëtuar familjen” dukshëm e tejkalonte mirëqenien e viktimës ose të fëmijëve për disa të anketuar.

Në përgjithësi, duke përdorur një indeks për të vlerësuar njohuritë dhe qëndrimet e aktorëve përgjegjës ndaj dhunës me bazë gjinore, RrGK zbuloi se si njohuritë ashtu edhe qëndrimet janë përmirësuar që nga viti 2017. Për shembull, të anketuarit kishin më shumë të ngjarë që në vitin 2020 sesa në vitin 2017 të konsideronin kontrollimin e anëtarëve të familjes, kërcënimin e tyre, goditjen e një fëmije, prekjen e një anëtar të familjes seksualisht pa pëlqim, ose kryerjen e detyruar të marrëdhënies seksuale me një partner intim si forma të dhunës. Ata kishin më pak të ngjarë të “normalizonin” dhunën si “pjesë të çdo marrëdhënieje”, ose të konsideronin alkoolizmin ose papunësinë si shkas i arsyeshëm të dhunës. Këto ndryshime pozitive në njohuri dhe qëndrime, siç thuhet nga të anketuarit, mund të kontribuojnë në një përgjigje të përmirësuar ndaj dhunës me bazë gjinore.

Zbatimi i kornizës ligjore: Përmbledhje


Në përgjithësi, të anketuarit kanë tendencë të mendojnë se LMDHF është zbatuar pjesërisht. Një mangësi e përmendur në mënyrë të përsëritur ishte zbatimi i dobët i urdhrave të mbrojtjes. Përgjigjet sugjeruan gjithashtu që masat e parashikuara në LMDHF, të tilla si largimi i kryesit të krimit nga vendbanimi i përbashkët, kërkimi nga kryesit e krimit për të paguar alimentacion, ose kërkimi prej tyre për të paguar qira, mbesin pak të kërkuar, gjë që ndonjëherë i vë viktimat në rrezik të recidivizmit. Mungesa e programeve të rehabilitimit dhe riintegrit për viktimat dhe shërbimet e dobëta rehabilituese për kryesit e krimeve mbetën ndër sfidat kryesore më të dëguara.

Lidhur me zbatimin e PSV-ve, megjithëse vërehen përmirësime që nga viti 2017, sfidat e përmendura shpesh janë të ndërlidhura me bashkëpunimin ndër-institucional. Kufizimet financiare gjithashtu paraqitën pengesa, veçanërisht për burimet e mjaftueshme njerëzore për menaxhimin e duhur të rasteve dhe për mbulimin e kostove emergjente të viktimave (p.sh. ushqimi, veshja). Ky hulumtim nuk ka ekzaminuar zbatimin e PSV-ve për adresimin e trafikimit, dhe duhet cekur se PSV-të nuk ekzistojnë për trajtimin e formave të tjera të dhunës me bazë gjinore, të tilla si dhuna seksuale.

Mosrespektimi për të siguruar konfidencialitetin e klientit ka mbetur problem, thanë të an-

ketuarit. Një përfaqësues i strehimores tha: “Unë i shoh [zyrtarët e tjerë] në shumë takime, të cilët përmendin [emrat dhe mbiemrat e viktimave], dhe kjo është shumë e keqe. Më bezdis. Ju mund të [përmendni emra] në zyrë çdo ditë, [por] kur dilni, flisni pa emër dhe pa mbiemër.” Çështjet e vazhdueshme të sigurimit të konfidencialitetit këssoj mund të parandalojnë gratë që të besojnë dhe të raportojnë dhunën tek institucionet.

Grafiku 2. Zbatimi i SKMDHF 2016-2020 nga Shtyllat



Temë e përsëritur midis të anketuarve nga institucione të ndryshme ishte se SKMDHF për vitet 2016-2020, përfshirë planin e saj të veprimit,³ u zbatua vetëm pjesërisht. Vlerësimet e RrGK konfirmojnë këto përgjigje. Në përgjithësi, vetëm përafërsisht 27% e SKMDHF ishte zbatuar plotësisht dhe 52% u zbatua pjesërisht.⁴ Ndërkohë, rreth 21% me sa duket nuk ishte zbatuar fare. Shtylla 3 e planit të veprimit, “Legjislacioni, Hetimi dhe Procedimi”, u zbatua më së shumti, me 50% të veprimeve të saj të parashikuara të përfunduara (shih Grafikun 2). Shtylla 1, “Parandalimi dhe Rritja e Ndërgjegjësimit” u zbatua 29%, dhe Shtylla 4, “Rehabilitimi dhe Ri-integrimi”, kishte vetëm 19% të veprimeve të zbatuara plotësisht. Kjo gjetje u ritheksua gjatë intervistave, pasi të anketuarit e ndryshëm në mënyrë të përsëritur theksuan dështimet në zbatimin e programeve të rehabilitimit dhe riintegritit për viktimat dhe kryesit, kryesisht për shkak të fondeve të pamjaftueshme. Shtylla 2, “Mbrojtja dhe Koordinimi”, ishte zbatuar më së paku me vetëm 12% të zbatimit të plotë. Të anketuarit gjithashtu vunë re mangësi, veçanërisht në funksionimin e mekanizmave koordinues dhe bazën e të dhënave për menaxhimin e rasteve për viktimat e dhunës në familje.

Më konkretisht, nën Shtyllën 1, “Parandalimi dhe Ndërgjegjësimi”, Objektivi Strategjik I i SKMDHF u përpoq të ulte “qëndrimet dhe sjelljet gjyquese që mbështesin dhunën në familje”. Siç tregohet, është vërejtur një progres drejt këtij objektivi afatgjatë në atë që RrGK identifikoji më pak qëndrime

³ Të gjitha referencat për SKMDHF përfshijnë referencën për planin e saj të veprimit gjatë gjithë këtij raporti.

⁴ Për detaje dhe shpjegim të metodës së llogaritjes, shihni [Shtojcën 3](#).

dhe sjellje gjykuese në vitin 2020 sesa në vitin 2017, megjithëse këto ekzistojnë ende midis disa zyrtarëve. Më konkretisht, Objektivi 1.1. u përpoq të “rrisë kapacitetet profesionale të profesionistëve që ofrojnë shërbime themelore për parandalimin e dhunës në familje”. RrGK vuri re progres në shumicën e institucioneve, megjithëse disa zyrtarë ende nuk kishin marrë pjesë në trajnim dhe kapacitetet profesionale mund të avancohen më tej.⁵ Objektivi 1.2. synonte të “inkurajonte individët të raportonin rastet e dhunës në familje dhe rritjen e besimit të tyre në institucionet përkatëse”. Siç duket është bërë përparim në raportimin e rasteve të dhunës në familje, siç tregohet nga një rritje e përgjithshme mesatare e rasteve të raportuara në polici me 13% në vit. Objektivi 1.3. u përpoq të “rrisë ndërgjegjësimin e shoqërisë për mos pranimin dhe mos tolerimin e dhunës në familje”, dhe rritja e ndërgjegjësimit dukej e vëzhgueshme, siç tregohet nga rritja e angazhimit të grave dhe burrave të ndryshëm në demonstrata publike, diskutime në internet dhe në raportimin e dhunës në familje.⁶

Sipas Shtyllës 2 për “Mbrojtje dhe Koordinim”, qëllimi i përgjithshëm ishte “deri në vitin 2020, të sigurojë mekanizma gjithëpërfshirës dhe efikas për reagim të shpejtë kundër rasteve të dhunës në familje, si dhe bashkëpunim ndër-institucional të përgjegjshëm midis aktorëve të nivelit qendror dhe lokal, për mbrojtjen dhe menaxhimin e këtyre rasteve”. Monitorimi i RrGK sugjeroi që kjo ishte zbatuar pjesërisht. Ndërsa ekzistonin përmirësime me krijimin e Mekanizmave të rinj Koordinues (MK), të detajuar më vonë, RrGK gjeti prova të reagimit të ngadaltë dhe dobësive të vazhdueshme në bashkëpunimin ndër-institucional dhe menaxhimin e rasteve. Më konkretisht, sipas Objektivit 2.1., “avancimi i politikave gjithëpërfshirëse në kuadër të mbrojtjes së viktimave të dhunës në familje”, Kosova miratoi KS dhe ndryshoi KPK, gjë që krijoi një mjedis ligjor për ndryshimet e politikave. Ndërsa përpjekjet u filluan për të rishikuar LMDHF dhe PSV, në mesin e politikave të tjera, këto nuk u finalizuan. SKMDHF gjithashtu planifikoi për rritjen e funksionimit të MK ekzistues në nivelin lokal, si dhe krijimin e MK të rinj në komuna ku ata nuk ekzistojnë (Objektivi 2.2.). Në të vërtetë, MK-të të rinj u krijuan, por MK-të ende nuk ekzistojnë në disa komuna dhe jo të gjithë janë funksional dhe efikas. Sipas vlerësimit të RrGK-së, Objektivi 2.3. “Përmirësimi i koordinimit dhe bashkëpunimit ndër-institucional mes nivelit qendror, lokal dhe organizatave të shoqërisë civile, për mbrojtjen e viktimave duke sqaruar rolet, detyrat dhe përgjegjësitë e secilit institucion në ofrimin e shërbimeve të përshtatshme” gjithashtu u zbatua pjesërisht; koordinimi duket se është përmirësuar në mes të disa MK, por të disponueshëm mbeten shërbime të kufizuara. RrGK ia atribuon këtë pjesërisht kufizimeve të lartpërmendura në legjislacionin e Kosovës, i cili nuk specifikon qartë rolet, përgjegjësitë, dhe kështu ndarjet financiare për të siguruar funksionimin e duhur të MK.

Sipas Shtyllës 3, “Legjislacioni, Hetimi dhe Procedimi”, qëllimi kryesor ishte: “deri në vitin 2020, përmirësimi i infrastrukturës ligjore dhe rritja e efikasitetit në trajtimin e rasteve [të dhunës në familje], me fokus në nevojat e viktimave, si dhe arritja e dënimit adekuat për kryesit”. Institucionet kanë bërë përparim në këtë fushë duke miratuar KS, duke ndryshuar KPK, dhe duke bërë disa përmirësime në

⁵ Të dhënat ishin të padisponueshme për indikatorin përkatës të SKMDHF-së, kështu që ky konkluzion bazohet në kërkimin dhe monitorimin e RrGK-së (shih Shtojca 3 për më shumë informacione).

⁶ Matja e saktë e rritjes së ndërgjegjësimit nuk ishte e mundur sepse anketa e OSBE-së, *AnGrafiku 2. Zbatimi i SKMDHF 2016-2020 nga Shtyllaketë për Mirëqenien dhe Sigurinë e Grave në Kosovë* (2019), përdori indikatorë pak më të ndryshëm se anketa e RrGK-së 2015 (*Mjaft më me arsytetime*), dhe anketa e OSBE-së intervistoi vetëm gratë.

koordinim në lidhje me menaxhimin e rasteve. Ndërkohë, ka ekzistuar vetëm një përmirësim i vogël në dënim. Objektivi 3.1. që synon “përmirësimin e infrastrukturës ligjore dhe akteve të tjera për trajtimin efikas të rasteve të dhunës në familje”. Kjo u zbatua pjesërisht me ndryshimin e KPK dhe Kushtetutës. Sidoqoftë, një bazë e të dhënave e konsoliduar ende nuk ekziston brenda sistemit të drejtësisë për të matur me saktësi përqindjen e kryesve të dënuar sipas llojit të dhunës së kryer, dënimeve të tyre ose kohën e nevojshme për të kompletuar rastet. Objektivi 3.2., “profilizimi i hetuesve të policisë, punonjësve socialë, mbrojtësve të viktimave, prokurorëve dhe gjykatësve, për hetimin dhe ndjekjen penale të rasteve të dhunës në familje me urgjencë dhe kujdes të shtuar” u arrit pjesërisht, pasi disa institucione, megjithëse jo të gjitha, kanë zyrtarë të profilizuar përgjegjës për adresimin e dhunës në familje. Sipas Objektivit 3.3., “sqaroni rolet, detyrat dhe përgjegjësitë e secilit institucion në ofrimin e shërbimeve adekuate për rastet e dhunës në familje”, është bërë përparim në sqarimin e roleve, por disa mbeten të paqarta ose joadekuate. As politika e “tolerancës zero” ndaj dhunës në familje nuk mbështetet gjithmonë, sugjeroi monitorimi i RrGK.

Shtylla 4 për “Rehabilitim dhe Riintegrim” synon të “mundësojë qasje në shërbime të reja dhe ekzistuese që janë efikase dhe të qëndrueshme, për rehabilitimin afatgjatë dhe ri-integrimin e viktimave të dhunës në familje dhe të dhunës me bazë gjinore dhe rehabilitimin e kryesve, në të gjithë Kosovën”, deri në vitin 2020. Ky hulumtim tregoi pak përparim në sigurimin e shërbimeve të efektshme, të qëndrueshme dhe afatgjata të rehabilitimit dhe riintegrit. Më konkretisht, RrGK zbuloi se vetëm Objektivi 4.1., “krijimi i shërbimeve për rehabilitimin dhe fuqizimin e viktimave të dhunës në familje dhe rritjen e efikasitetit të tyre në nivelin qendror dhe komunal” ishte zbatuar pjesërisht. Tre objektivat e tjerë specifik të parashikuar siç duket nuk ishin zbatuar:

4.2. Vendosja e linjave buxhetore për shërbimet riintegruese afatgjata për viktimat e dhunës në familje, në nivelin qeveritar.

4.3. Përdorimi i politikave të integruara për përmirësimin e shërbimeve të rehabilitimit dhe riintegrit për viktimat e dhunës në familje.

4.4. Krijimi i institucioneve rehabilituese dhe qendrave këshillimore me programe të detyrueshme për kryesit e dhunës në familje. Pjesët e mëvonshme në këtë kapitull diskutojnë zbatimin e veprimeve të parashikuara nga SKMDHF të secilit institucion përgjegjës.

Mos-diskriminimi dhe qasja ndër-sektorale në adresimin e dhunës me bazë gjinore

KS kërkon që shtetet të marrin masa për të mbrojtur të drejtat e viktimave pa diskriminim në asnjë bazë, të tillë si seksi, gjinia, raca, ngjyra, gjuha, feja, mendimi politik ose mendimi tjetër, origjina kombëtare ose shoqërore, asociimi me pakicë kombëtare, pronësia, lindja, orientimi seksual, identiteti gjinor, mosha, gjendja shëndetësore, paafësia, statusi martesor, statusi i migrantit ose refugjatit, ose status tjetër.⁷ Për më tepër, një qasje ndër-sektorale për sigurimin e shërbimeve do të konsideronte mënyrat në të cilat pabarazitë dhe/ose dobësitë mund të pengojnë qasjen e grave të ndryshme në shërbime. Për shembull, gratë serbe rurale, gratë e reja me aftësi të kufizuara ose gratë migrante të

⁷ Neni 4.3.

izoluara që nuk flasin shqip, të gjitha mund të përballen me sfida të shtuara në qasjen në shërbime.

Pjesëmarrësit e hulumtimit nga OSHC-të që punojnë me grupe njerëzish që mund të kenë dobësi shtesë kishin pikëpamje të ndryshme në lidhje me përgjigjen institucionale ndaj dhunës me bazë gjinore. Grupet që punojnë me personat LGBTQIA+ vunë re disa përmirësime në reagimin e policisë, ndërsa grupet që punonin me gratë rome, ashkali dhe egjiptiane mendonin se policia nuk i merrte rastet mjaft seriozisht. Aktivistët thanë se gratë me aftësi të ndryshme rrallë kërkojnë ndihmë, kështu që ato nuk mund të vlerësonin përgjigjen institucionale. Në mënyrë të ngjashme, përvojat e aktivistëve me institucione të tjera, përveç policisë, ishin shumë të kufizuara për të lejuar ndonjë koment mbi cilësinë e shërbimeve.

Një anketë e Këshillit të Evropës për shërbimet mbështetëse në Kosovë zbuloi se më shumë se gjysma e ofruesve të shërbimeve nuk kishin ofruar trajnim rreth barazisë dhe diskriminimit për stafin e tyre.⁸ Siç vërehet, qasja në shërbime për grupet e cënueshme dhe të marginalizuara mbetet sfida (me vetëm 9% të ofruesve që ofrojnë shërbime të përshtatura për nevojat e tyre specifike), raporti rekomandoi sigurimin e trajnimeve të rregullta, të përshtatshme dhe efektive ndër-sektoriale për të gjithë stafin që ofron shërbime të specializuara dhe të përgjithshëm për të adresuar nevojat specifike të grupeve të ndjeshme të grave, të tilla si LGBT, me aftësi të kufizuara, rome dhe gra të tjera nga grupet e pakicave.⁹

Financimi për adresimin e dhunës me bazë gjinore

KS kërkon ndarjen e duhur të burimeve financiare dhe njerëzore për zbatimin adekuat të politikave, masave dhe programeve të integruara, përfshirë ato të kryera nga OSHC-të.¹⁰ Në Kosovë, secila organizatë buxhetore ka përgjegjësinë për të buxhetuar si duhet për zbatimin e përgjegjësisë së saj.¹¹ Ministria e Financave (MF) përcakton kufijtë e shpenzimeve, siguron udhëzime përmes qarkoreve buxhetore dhe përpilon buxhetin e konsoliduar të Kosovës përpara se ta paraqesë atë në kuvend për debat dhe miratim përfundimtar. Ndërsa ministritë përkatëse propozojnë ndarjet buxhetore, MF finalizon buxhetin e përgjithshëm të Kosovës dhe mund të kërkojë që ministritë të buxhetojnë mjaftueshëm për zbatimin e aktiviteteve të tyre, përfshirë adresimin e dhunës me bazë gjinore.

Një analizë e shpejtë e ligjeve të buxhetit të Kosovës për 2017-2020 identifikoi shumë pak linja specifike buxhetore në lidhje me adresimin e dhunës me bazë gjinore. Disa linja buxhetore kontribuojnë në këtë në mënyrë indirekte, të tilla si përmes linjave të rregullta buxhetore të institucioneve përgjegjëse (p.sh., policia, prokuroria). Sipas ligjit të Kosovës, strehimoret e licencuara nga shteti duhet të marrin fonde shtetërore.¹² Buxhetet e viteve 2019 dhe 2020 përmbanin një linjë buxhetore për “Shpenzimet themelore për strehimore” nën Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale (MPMS)

⁸ Krol, dhe të tjerët, [Hartëzimi i shërbimeve mbështetëse për viktimat e dhunës ndaj grave në Kosovë](#), f. 79.

⁹ Po aty, f. 79-80.


¹⁰ Neni 8.

¹¹ Në Kosovë, korniza ligjore i referohet secilit organ përgjegjës për buxhetim, përfshirë ministritë dhe komunat, ndër të tjera, si “organizata buxhetore”. Sipas Ligji Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, Neni 1, “Organizata Buxhetore” janë “çdo autoritet ose ndërmarrje publike e cila drejtpërdrejtë pranon një ndarje buxhetore sipas Ligjit mbi Ndarjet Buxhetore, ndarje buxhetore kjo që nuk është pjesë e një ndarje tjetër të përgjithshme buxhetore e cila i është bërë një autoriteti ose ndërmarrje tjetër publike”.

¹² Ligji Nr. 02/L-17, [Ligji për Shërbime Sociale dhe Familjare](#), Neni 8.

(880,000 € në vit).¹³ Kjo linjë specifike e buxhetit për strehimoret u krijua pas viteve të avokimit intensiv nga strehimoret, RrGK, ABGJ dhe Grupi i Sigurisë Gjimore, i cili përfshin aktorë të tjerë të interesuar. Megjithatë përpjekjet fillestare dështuan për të fituar mbështetje nga ministratë përkatëse, kuvendi përfshiu këtë linjë buxhetore pas avokimit intensiv pak para miratimit të buxhetit për vitin 2019. Pastaj pas avokimit të mëtejshëm, qeveria përfshiu të njëjtën linjë buxhetore përsëri në vitin 2020 (për (€880,000)).¹⁴ Para vitit 2019, strehimoret merrnin fonde përmes një linje të përgjithshme buxhetore të MPMS-së për shërbimet sociale. Mungesa e një buxheti të caktuar pengoi disbursimin në kohë dhe adekuat të fondeve, ndonjëherë duke kontribuar në mbylljen e strehimoreve që i vinte gratë dhe fëmijët në rrezik.¹⁵ Përkundër progresit të arritur në krijimin e kësaj linje buxhetore, ajo nuk është e përhershme. Në vitin 2020, Ministria e Drejtësisë gjithashtu kishte një linjë buxhetore për “Strehimoret për VTK” për Institucionin e Përkohshëm të Sigurisë të drejtuar nga shteti për viktimat e trafikimit (100,000 € fillimisht, ndryshuar në 90,683 €).¹⁶

Grafiku 3. SKMDHF Buxhetimi i planifikuar nga shtylla



¹³ RrGK ka rumbullakuar të gjitha shumatat në këtë raport në Euro më të afërt. Ligji Nr. 07/L-014 Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr. 07/L-001 për ndarjet buxhetore për buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2020, Tabela 3.1: Buxheti i Rishikuar për Nivelin Qendror (në euro), f. 27/68, gusht 2020. Në buxhetin fillestar për vitin 2020, “Shpenzimet Themelore për Strehimoret” ishte nën Ministrinë e Shëndetësisë, por më pas u zhvendos te MPMS në buxhetin e ndryshuar, në të njëjtën shumë; Ligji Nr. 06/L-133 [Ligji për ndarjet buxhetore për buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2019](#), Tabela 3.1: Buxheti Qendror (në euro), f. 27/67, shkurt 2019.

¹⁴ Për informacione të mëtejshme, shihni RrGK, “[Avokimi shtyn Qeverinë që të krijojë Linjën Buxhetore për Strehimoret](#)”, 28 maj 2020. Ndërsa ndryshonte nga shumata në buxhetin e Kosovës për vitin 2020, sipas ABGJ, 10 strehimore kishin një buxhet prej 600,000 (komment mbi draft raportin, 2021).

¹⁵ Shihni RrGK, “Ministria do të nxjerrë fondin e shumëpritur për strehimoret të aprovuar nga Kuvendi”, 1 mars 2019.

¹⁶ Ligji Nr. 07/L-001 Për ndarjet buxhetore për buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2020, Tabela 3.1: Buxheti Qendror (në euro), f. 38/55, mars 2020; Ligji Nr. 07/L-014 [Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr. 07/L-001 për ndarjet buxhetore për buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2020](#), Tabela 3.1: Buxheti i Rishikuar për Nivelin Qendror (në euro) f. 40/58, gusht 2020,

Në ligjet e buxhetit për vitet 2017-2020, komunat nuk kanë ndonjë linjë buxhetore specifike në lidhje me dhunën me bazë gjinore. Disa kanë një buxhet për qëndrimin social, kujdesin parësor shëndetësor dhe shpenzime të tjera, nga të cilat mund të ndahen fondet për adresimin e dhunës me bazë gjinore, por kjo nuk tregohet qartë në linjat e tyre buxhetore. Vetëm Komuna e Suharekës kishte një buxhet për “Mbështetje për strehimin e viktimave të dhunës në familje” nën buxhetin e saj të Kujdesit Parësor Shëndetësor (2,200 €) në vitin 2020.¹⁷

Në përgjithësi, SKMDHF planifikoi një buxhet të përgjithshëm prej 10.5 milion € me 7.3 milion € që pritet të vijnë nga qeveria dhe gati 3 milion nga donatorët (28%).¹⁸ Ndërsa ndarjet e planifikuara ishin shpërndarë në mënyrë të barabartë në të gjitha shtyllat e SKMDHF, përqindja më e ulët e financimit ishte planifikuar për Mbrojtjen dhe Koordinimin (12%). Siç duket, SKMDHF planifikoi të krijojte një vijë buxhetore për zyrtarët e barazisë gjinore (ZBGJ-të) në mbështetjen e funksionimit të MK (2.2.5.) Sidoqoftë, SKMDHF nuk ka buxhetuar për këtë. Mungesa e kësaj linje buxhetore komunale u përmend në mënyrë të përsëritur nga pjesëmarrësit në hulumtim. Sipas SKMDHF, MF gjithashtu duhej të rriste buxhetin për burimet dhe stafin për KNDHF (2.3.7), por nuk duket se është shtuar ndonjë vijë e qartë e buxhetit për personelin e përhershëm.

Lidhur me ndarjet aktuale të buxhetit, SKMDHF parashikoi që disa komuna dhe ministri do të ndanin fonde, përfshirë këtu edhe “fuqizimin ekonomik të viktimave në formën e subvencioneve nga ministritë përkatëse” (4.2.1.). Ndërsa SKMDHF duket se tregon se kjo do të pasqyrohej në secilën ministri dhe në “linjat buxhetore” të komunës, asnjë linjë specifike e buxhetit nuk ishte e identifikueshme në buxhetin e Kosovës. Buxhetet gjatë kësaj periudhe kohore nuk përmbajnë ndonjë referencë për “ndarjen e mjeteve buxhetore të secilës ministri/institucion për programe të posaçme për viktimat e [dhunës në familje]” (4.2.2.). Sidoqoftë, ministritë dhe komunat mund të kenë ndarë fonde të tilla përmes linjave më të gjera të papërcaktuara për subvencione të buxhetit. Ndarjet e tjera të buxhetit për zbatimin e SKMDHF diskutohen në lidhje me institucionet përgjegjëse në pjesët e mëvonshme.

Informacion jashtëzakonisht i kufizuar është në dispozicion në lidhje me ndarjet e buxhetit për adresimin e formave të dhunës me bazë gjinore përveç dhunës në familje. Në vitin 2019, buxheti përmend se “mbështetja financiare për viktimat e dhunës seksuale gjatë luftës” është një prioritet. Ndërsa nuk ekziston ndonjë linjë buxhetore specifike për këtë qëllim, ndarjet ekzistojnë brenda linjave të tjera buxhetore, përfshirë komisionin për shqyrtimin e aplikacioneve të të mbijetuarve (20,500 €), pagat e sekretarit për komisionin (18,540 €), për katër OSHC që mbështesin gratë e mbijetuara (96,000 €), dhe për pensionet e të mbijetuarve nën linjën e përgjithshme të buxhetit të MPMS-së për pensionet për viktimat civile të luftës (1,098,319 €).¹⁹

Si në këtë shembull, ekziston mundësia që disa shërbime janë të buxhetuara si pjesë e shpenzimeve të përgjithshme të institucioneve, të cilat nuk mund të identifikohen duke pasur parasysh përdorimin e kategorive të shpenzimeve nga Kosova sesa buxhetimin e zërave të linjës. Në të vërtetë, sistemi aktual i buxhetit të Kosovës e bën të vështirë monitorimin e caktimit të saktë të buxhetit, dhe

¹⁷ Ligji Nr. 07/L-001 [Për ndarjet buxhetore për buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2020, f. 51, mars 2020](#); Ligji Nr. 07/L-014 [Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr. 07/L-001 për ndarjet buxhetore për buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2020](#), f. 66, gusht 2020.

¹⁸ MD, SKMDHF, 2017.

¹⁹ Informacioni i siguruar nga ABGJ, cituar në RrGK, “[Monitorimi i zbatimit të indikatorit 5.c.1 të SDG-së në Kosovë 2020](#)”, f. 3.

pak institucione të intervistuar nga RrGK mund të sigurojnë informacion të saktë në lidhje me ndarjet e tyre buxhetore për adresimin e dhunës me bazë gjinore.

Siç shpjegohet në Analizën Ligjore, mandati ligjor për financimin e shërbimeve mbështetëse për disa forma të dhunës me bazë gjinore është mjaft i qartë. Si rezultat, institucionet nuk kanë bërë apo nuk kanë mundur të bëjnë buxhet për këto shpenzime. Edhe për zbatimin e përgjegjësive ekzistuese ligjore, të tilla si në lidhje me dhunën në familje, “Nuk ka buxhet”, ishte një temë e dëgjuar në mënyrë të përsëritur midis pjesëmarrësve të hulumtimit nëpër institucione. Ndarjet e pamjaftueshme të buxhetit, veçanërisht për shërbimet e rehabilitimit dhe ri-integritit, u përmendën vazhdimisht si ndër sfidat kryesore për zbatimin e kornizës ligjore për adresimin e dhunës me bazë gjinore. Ndarjet e pamjaftueshme të buxhetit gjithashtu e bënë të vështirë për QPS-të, MV-të dhe strehimoret, ndër të tjera, të kryejnë detyrat dhe përgjegjësitë e tyre siç përcaktohet në PSV-të, sepse atyre u mungonin burimet njerëzore dhe qasja në transport të besueshëm.

Konkluzion

Gjetjet sugjerojnë përmirësime në njohuritë dhe qëndrimet e zyrtarëve përgjegjës në lidhje me dhunën me bazë gjinore. Sidoqoftë, një kuptim gjithëpërfshirës i dhunës me bazë gjinore dhe njohja e plotë e formave të dhunës përveç dhunës në familje mbeten jo adekuate në mesin e shumë zyrtarëve. Të anketuarit nga institucione të ndryshme kishin prirje të besonin se zbatimi i kornizës ligjore ishte përmirësuar, megjithëse disa fusha kërkojnë përmirësim të mëtejshëm. SKMDHF-ja është zbatuar vetëm pjesërisht, dhe përparimi drejt krijimit të shërbimeve të rehabilitimit dhe ri-integritit ishte veçanërisht i kufizuar. Grupet e cënueshme me sa duket nuk kanë informacion të mjaftueshëm ose qasje në shërbime me një qasje ndër-sektoriale për të adresuar nevojat e tyre. Kosovës i mungon një kornizë gjithëpërfshirëse ligjore dhe e politikave për trajtimin e formave të ndryshme të dhunës me bazë gjinore. Kjo ka kontribuar në njohuri, procedura dhe ndarje të pamjaftueshme të buxhetit për adresimin e të gjitha formave të dhunës me bazë gjinore sipas KS.

KOORDINIMI NDËRINSTITUCIONAL

Kjo pjesë diskuton koordinimin ndërinstitucional. Sipas KS, shtetet duhet të përcaktojnë organet zyrtare përgjegjëse për koordinimin, zbatimin, monitorimin dhe vlerësimin e politikave dhe masave për të parandaluar dhe adresuar të gjitha format e dhunës me bazë gjinore.²⁰ Kosova ka krijuar organe koordinuese në nivelin kombëtar, si dhe brenda disa komunave, të përqendruara kryesisht në dhunën në familje dhe trafikimin (që nuk diskutohen këtu). Përkatësisht, nën-pjesët përqendrohen në secilin prej organeve dhe akterëve të mëposhtëm: bashkëpunimin në njohjen dhe mbështetjen e të mbijetuarve të dhunës seksuale në kohë lufte; Grupin Koordinues Ndërmintor kundër Dhunës në Familje; Koordinatorin Nacional kundër Dhunës në Familje; Agjencinë për Barazi Gjinore; dhe përgjigjen komunale ndaj dhunës me bazë gjinore.

²⁰ Neni 10.

Bashkëpunimi në njohjen dhe mbështetjen e të mbijetuarve të dhunës seksuale të luftës

Që nga viti 1999, disa grupe për të drejtat e grave (OSHC-të) kanë ofruar shërbime gjithëpërfshirëse psikosociale, shëndetësore, ligjore dhe ekonomike për gratë që përjetuan dhunë seksuale gjatë luftës. Në vitin 2014, ish Presidentja e Kosovës Atifete Jahjaga themeloi Këshillin Kombëtar për të Mbijetuarit e Dhunës Seksuale gjatë Luftës përmes një dekreti të posaçëm Presidencial. Këshilli angazhoi përfaqësues të ministrive kyçe, OSHC-ve dhe aktorëve ndërkombëtarë. Këshilli u përpoq të krijonte një përgjigje të përmirësuar, të koordinuar më mirë ndaj mbështetjes psikosociale, kujdesit shëndetësor, drejtësisë, njohjes ligjore dhe fuqizimit ekonomik për të mbijetuarit e dhunës seksuale të ndërlidhur me konfliktin. Këshilli u shpërnda pasi mandati i Presidentes Jahjaga përfundoi në vitin 2016. Sidoqoftë, anëtarët e grupit kanë vazhduar të takohen jozyrtarisht për të planifikuar, koordinuar dhe zbatuar shërbime gjithëpërfshirëse të mbështetjes, të financuara kryesisht përmes OSHC-ve dhe donatorëve të huaj. Pasi Kuvendi ndryshoi ligjin për statusin dhe të drejtat e personave të prekur nga lufta për të përfshirë “Se Viktimat e Dhunës Seksuale gjatë Luftës” në vitin 2015,²¹ Në vitin 2016, Qeveria nxori një rregullore për krijimin e kushteve, kriterëve dhe procedurave për njohjen dhe verifikimin e statusit të personave që përjetuan dhunë seksuale të ndërlidhur me konfliktin.²² Rregullorja përcaktoi detyrat dhe përgjegjësitë e Komisionit Qeveritar për Njohjen dhe Verifikimin e Statusit të Viktimave të Dhunës Seksuale gjatë Luftës Çlirimtare të Kosovës (Komisioni). Që nga shkurti 2018, Komisioni i ka shqyrtuar aplikimet dhe ka verifikuar që njerëzit që kanë përjetuar dhunë seksuale kualifikohen për kompensim shtetëror. Bazuar në legjislacion, aplikuesit e aprovuar më pas kualifikohen për të pasur qasje në përfitime, duke përfshirë pensionin, shërbimet shëndetësore, mbështetjen e rehabilitimit, trajtimin me prioritet në kërkimin e punësimit, lirin nga tatimi në pronë, kujdesin shtëpiak, prioritetin në qasje në arsimin publik dhe arsimin falas në universitetet publike.²³

Mes këtyre masave pozitive. Amnesty International ka shprehur shqetësimin se Ligji e përcaktoi luftën të përfunduar më 20 qershor 1999, kështu që diskriminon gratë e dhunuara pas kësaj kohe; disa gra, veçanërisht ato serbe, rome dhe disa shqiptare, nuk kanë qasje në përfitimet e lartpërmendura shtetërore.²⁴ Amnesty International gjithashtu ka përmendur se Ligji ndalon përfituesit nga marrja e dy pensione në rastet kur të mbijetuarit tashmë marrin një pagesë tjetër të lidhur me luftën (p.sh., për gratë e veja, burrat e të cilave vdiqën ose u plagosën). Gratë duhet të zgjedhin se cilin përfitim të marrin, gjë që minon qëllimin për të njohur që ky krim lufte është kryer kundër tyre posaçërisht dhe se ato meritojnë kompensim. Për më tepër, Ligji u dha të mbijetuarve vetëm pesë vjet për të vendosur të aplikojnë për njohje dhe përfitime, të cilat Amnesty International i konsideron si një periudhë shumë të shkurtër. Në të vërtetë, duke pasur parasysh stigmën shoqërore ende të pranishme që lidhet me

²¹ [Ligji nr. 04/L-172](#) për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-054 për statusin dhe të drejtat e dëshmorëve, invalidëve, veteranëve, pjesëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, viktimave civile dhe familjeve të tyre.

²² Qeveria e Kosovës, [Rregullorja Nr. 22/2015 për Përcaktimin e Procedurës për Njohjen dhe Verifikimin e Statusit të Viktimave të Dhunës Seksuale gjatë Luftës Çlirimtare të Kosovës, në pajtim me nenin 93 mbi kompetencat e qeverisë \(paragrafi 4\) i Kushtetutës së Republikës së Kosovës; Neni 15 \(Paragrafi 10 dhe Paragrafi 12\) i Ligji Nr. 04/L-172](#) mbi ndryshimin dhe plotësimin e [Ligjit Nr. 04/L-054](#) mbi statusin dhe të drejtat e dëshmorëve, invalidëve, veteranëve, pjesëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, Viktimave të Dhunës Seksuale të luftës, viktimave civile dhe familjeve të tyre; Rregullorja e Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, Nr. 09/2011, neni 19.

²³ Po aty, neni 5.

²⁴ Amnesty International, [Plagë që të djegin shpirtin: Kompensimi për të mbijetuarit e përdhunimit gjatë luftës në Kosovë, por drejtësi s'ka akoma](#), 2017, f. 9.

dhunën seksuale dhe pozitat dhe rrethanat e ndryshme shoqërore të grave, mund të duhet kohë që gratë të paraqiten për të kërkuar përfitimet. Ndërkohë, periudha për të aplikuar është vendosur të përfundojë tashmë në vitin 2021.

Komisioni Qeveritar i krijuar për verifikimin e aplikimeve përfshin profesionistë jashtëzakonisht të kualifikuar dhe të zgjedhur me kujdes. Ata shfrytëzojnë procedurat e krijuara përmes një procesi të gjerë konsultimi që angazhoi aktivistë për të drejtat e grave të specializuar në punën me gratë e mbijet-uara, drejt sigurimit të mbrojtjes, dinjitetit dhe konfidencialitetit të plotë të grave. Për këtë, Komisioni është bërë i njohur për praktikën më të mirë në rajon.²⁵ Sidoqoftë, Komisioni ka përjetuar disa sfida. Numri i konsiderueshëm i aplikacioneve të pranuar ka kontribuar në disa vonesa në përpunimin e aplikacioneve. Duke pasur parasysh ekspertizën e tyre profesionale, anëtarët e Komisionit gjithashtu punojnë punë shtesë dhe mund të punojnë vetëm me orar të pjesshëm për të shqyrtuar rastet. Orët e gjata të kaluara duke përpunuar aplikimet, shoqëruar me mungesën e mbikëqyrjes psikologjike mes historive shpesh shqetësuese që ata dëgjojnë çdo ditë, mund t'i vënë anëtarët e Komisionit në rrezik të kenë “burnout” (shterrije).

Grupi Koordinues Ndërmintor kundër Dhunës në Familje

Në vitin 2012, Qeveria e Kosovës krijoi një Grup Koordinues Ndërmintor kundër Dhunës në Familje, bazuar në një Vendim të Qeverisë.²⁶ Grupi kryesohet nga Koordinatori Nacional kundër Dhunës në Familje (KNDHF) në Ministrinë e Drejtësisë (MD) dhe nën-kryesues është ABGJ. Vendimi nuk përshkruan rolet dhe përgjegjësitë e Grupit; as RrGK nuk mund të gjente një politikë zyrtare që tregonte rolin e saj. Anëtarët zyrtarë të Grupit përfshijnë MD, MPMS, Ministrinë e Punëve të Brendshme, Ministrinë e Shëndetësisë (MSH), Ministrinë e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT), MF, Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Policinë e Kosovës dhe Agjencinë e Statistikave të Kosovës. Prokuroria e Shtetit, Këshilli Gjyqësor i Kosovës, Instituti Gjyqësor i Kosovës dhe Koalicioni i Strehimoreve shërbyen si vëzhgues dhe ekspertë. Grupi, ndër të tjera, u angazhua në hartimin e SKMDHF për vitet 2016-2020.²⁷

Siç raportohet, Grupi nuk ka funksionuar siç ishte parashikuar fillimisht.²⁸ Pa një KNDHF, takimet zhvilloheshin vetëm në mënyrë sporadike. Kur u mbajtën takimet, ministritë e caktuara thuhet se dërguan në takime zyrtarë ministrorë të barazisë gjinore (ZBGJ). Ndërsa ata dhanë kontribute të frytshme në diskutim, pak veprime rezultuan nga Grupi sepse ZBGJ-të nuk kishin pushtet politik ose kompetenca ekzekutive për të çuar përpara vendimet, sipas ish-KNDHF. ZBGJ-të nuk kishin pozicita brenda ministrive të tyre që u mundësonin atyre të krijojnë dhe miratojnë programe zyrtare, strategji ose buxhete për një përgjigje më të koordinuar, ndër-institucionale ndaj dhunës në familje.

²⁵ Intervistë e RrGK-së, 2021.

²⁶ Qeveria e Kosovës, [Vendimi Nr. 04/83](#), 11 korrik 2012.

²⁷ Siç gjendet në: Ministria e Drejtësisë, [Raporti i Vlerësimit të Programit të Kosovës kundër Dhunës në Familje dhe Plani i Veprimit 2011-2014](#), 2015.

²⁸ Intervistë e RrGK-së me ish KNDHF, 2021, ndër të tjera.

Koordinatori Nacional kundër Dhunës në Familje

Bazuar në një vendim të marrë nga qeveria më 11 korrik 2012, Zëvendës Ministri i Drejtësisë mban pozitën e Koordinatorit Nacional kundër Dhunës në Familje (KNDHF), ndërsa ABGJ mban pozitën e Nën-Kryesuesit.²⁹ Nën mbikëqyrjen e KNDHF dhe ABGJ, institucionet përgjegjëse krijuan PSV-të për mbrojtje nga dhuna në familje në vitin 2013.³⁰ KNDHF duhet të mbikëqyrë zbatimin e SKMDHF në nivelin kombëtar; të koordinojë masat dhe politikat në lidhje me dhunën në familje; të mbikëqyrë bazën e të dhënave për rastet e dhunës në familje; dhe të koordinojë punën e Grupit Koordinues Ndërminstoror për Dhunën në Familje. KNDHF gjithashtu harton raporte monitorimi dhe vlerësimi për SKMDHF.³¹

Duke pasur parasysh që Zëvendës Ministri i Drejtësisë duhet të mbajë pozitën e KNDHF, pas rënies së qeverisë pas votimit të mosbesimit në 10 maj 2017, Kosova nuk kishte ndonjë KNDHF nga qershori 2017 deri në fillim të vitit 2018. Pasi qeveria u shpërbë përsëri në gusht 2019, pozita ishte përsëri e lirë deri në korrik 2020. Si përmbledhje, gjatë kohëzgjatjes së SKMDHF për vitet 2016-2020, KNDHF ka ndryshuar tre herë dhe pozita qëndroi e paplotësuar për më shumë se një vit. Shumica e veprimeve drejt zbatimit të SKMDHF-së u përfunduan gjatë mandatit të KNDHF-së së dytë, i cili ishte në këtë pozitë për periudhën më të gjatë (një vit e gjysmë). Sidoqoftë, mungesa e një KNDHF të qëndrueshëm ka penguar progresin në zbatimin e SKMDHF, si dhe monitorimin e saj. Për më tepër, ndryshimet në KNDHF kanë kontribuar në parregullsi në takimet e Grupit Koordinues Ndërminstoror.³² Kjo ilustron rëndësinë e ekzistencës së një KNDHF të përhershëm për të siguruar progres në adresimin e dhunës në familje. Për më tepër, mungesat e burimeve njerëzore në zyrën e KNDHF kanë penguar punën e tij.³³ Siç deklaroi një përfaqësues i ABGJ-së gjatë një takimi në vitin 2018, “është momenti që zyra e Koordinatorit Nacional të fuqizohet me një staf profesional”.³⁴ Sipas ABGJ, “duhet të ekzistojë një staf i përhershëm që do të shërbejë si kujtesë institucionale për secilin koordinator që vjen deri në momentin që emërohet një tjetër”.³⁵

Në përputhje me kërkesën e KS për të caktuar organet zyrtare përgjegjëse për koordinimin, zbatimin, monitorimin dhe vlerësimin e politikave dhe masave për të parandaluar dhe luftuar të gjitha format e dhunës me bazë gjinore,³⁶ RrGK vazhdimisht ka theksuar nevojën që KNDHF të jetë një pozitë e përhershme e nëpunësit civil, sesa një pozitë politike. Kjo do të institucionalizonte rolin e tij dhe do të parandalonte ndërprerjet në zbatimin e mandatit të tij midis mjedisit politik të paqëndrueshëm të Kosovës.³⁷ GREVIO në mënyrë të ngjashme ka rekomanduar në Malin e Zi dhe në Serbi që organet

²⁹ Qeveria e Republikës së Kosovës, Vendimi Nr. 04/83, 11 korrik 2012.

³⁰ ABGJ, *Procedurat Standarde të Veprimit për Mbrojtjen nga Dhuna në Familje në Kosovë*, (PSV) 2013.

³¹ MD, SKMDHF, 2017.

³² Berisha dhe të tjerët, për RrGK, Nga Fjalët në Veprim, 2017; Ministria e Drejtësisë, *Zyra e Ministrit të Drejtësisë*, 7 korrik 2020 RrGK nuk intervistoi KNDHF të ri për këtë raport, pasi pozicioni ishte emëruar rishtas drejt fundit të punës në terren.

³³ Kjo ishte një temë e përsëritur midis pjesëmarrësve në hulumtim (intervista të RrGK-së, 2020).

³⁴ Kosova Live, *Krijohet databaza kombëtare e të mbijetuarve të dhunës në familje*, 13 mars 2018.

³⁵ ABGJ, koment i bërë gjatë rishqyrtimit kolegjial të draft raportit, 2021.

³⁶ Neni 10.

³⁷ Berisha etj. për RrGK, *Nga Fjalët në Vepra*, 2017, f. 84.

përkatëse koordinuese duhet të institucionalizohen plotësisht me një ndarje adekuate të burimeve njerëzore dhe financiare, të kenë përgjegjësi të qarta dhe të kenë organe të ndara për zbatimin dhe monitorimin dhe vlerësimin për të siguruar objektivitetin.³⁸ Kështu, ndërsa KNDHF plotëson kërkesat e KS si një organ koordinues për zbatimin, monitorimin dhe vlerësimin, për përmirësimin e përgjegjësisë, praktika e mirë mbase do të kërkonte ndarjen e funksioneve të zbatimit dhe monitorimit dhe vlerësimit në organe të veçanta përgjegjëse.

Ky hulumtim gjithashtu shqyrtoi veprimet e KNDHF drejt zbatimit të SKMDHF. Nën aktivitetin “1.2.5. Zbatimi i përgjegjshëm dhe profesional i PSV-ve”, KNDHF duhet të kishte krijuar mekanizma funksionalë të ankesave në mënyrë që njerëzit të raportonin mangësitë në institucionet që kryejnë detyrat e tyre, por këto nuk duket se ekzistojnë.³⁹ KNDHF së bashku me ABGJ, ministritë e linjës, institucionet lokale, donatorët dhe OSHC-të, duhet të kishin publikuar “1.3.2. Hulumtimin periodik kombëtar mbi fenomenin, nivelin, profilin e kryesve/viktimave të dhunës në familje” dhe “buletinet statistikore vjetore për numrin e rasteve të raportuara dhe rasteve të trajtuara në mënyrë multidisiplinare” (1.3.3.). Disa institucione i kishin këto të dhëna, siç është buletini vjetor statistikor i AV-ve, por të dhëna të tilla nuk u bënë publike brenda një raporti të konsoliduar, përveç në këtë raport aktual.

Sipas Shtyllës 2, KNDHF duhet të kishte koordinuar, së bashku me ABGJ “2.1.1. Rishikimin dhe shqyrtimin e politikave dhe programeve ekzistuese”. LMDHF është ende në shqyrtim. ABGJ vlerësoi zbatimin e PSV-ve në vitin 2019. PSV-të do të rishikohen dhe eventualisht do të rishikohen pasi të kenë kompletuar kornizën ligjore me ndryshimet ligjore të planifikuara. Asnjë proces nuk ka përfunduar dhe asnjë politikë dhe program tjetër i njohur nuk janë hartuar nën këtë SKMDHF. KNDHF ka përmbushur përgjegjësinë e tij për të krijuar një sistem të menaxhimit të të dhënave për trajtimin e koordinuar të rasteve nga MK-të, së bashku me komunat (2.2.2.), në dy gjuhë, mbështetur nga UN Women (UNW).⁴⁰ Është nënshkruar Memorandumi i Mirëkuptimit ndërmjet MD, së mandatuar për të koordinuar sistemin dhe KGJK-së, Policisë së Kosovës dhe Këshillit Prokurorial të Kosovës, përmes së cilit u zotuan se do të futen të dhënat në bazën e integruar të të dhënave.⁴¹ Për më tepër, ofruesit e shërbimeve sociale dhe strehimoret mund të fusin të dhëna. Të gjithë ofruesit e shërbimeve nga këto institucione janë trajnuar për futjen e të dhënave dhe trajnimi është institucionalizuar, në rast të largimit ose zëvendësimit të stafit.⁴² Baza e të dhënave e integruar mbulon të gjitha format e dhunës sipas KS, si dhe informacionin mbi kryesit e veprave, duke mundësuar monitorimin e rasteve pasi ato trajtohen nga institucione të ndryshme përkatëse. Si “mjet i gjallë”, baza e të dhënave po azhurnohet çdo muaj me karakteristika të reja, infografikë dhe tabela, dhe të dhënat përmbledhëse eventualisht do të jetë në

³⁸ GREVIO *Raporti i Vlerësimit Bazë - Mali i Zi*, 2018, f. 19; GREVIO *Raporti i Vlerësimit Bazë - Serbi*, 2019, f. 18.

³⁹ As MASHT nuk kishte informacion në lidhje me këtë.

⁴⁰ Ministria e Drejtësisë, “*Krijohet Databaza Kombëtare e të Mbijetuarve të Dhunës në Familje dhe Dhunës ndaj Grave*”, 12 mars 2018.

⁴¹ UNW, *Kosova do të fillojë përdorimin e një baze të të dhënave të integruar për rastet e dhunës në familje*, 2019.

⁴² Informacioni në këtë paragraf i siguruar nga UNW gjatë shqyrtimit kolegjial të draft raportit, 2021. Edhe pse UNW ka financuar mirëmbajtjen e bazës së të dhënave deri më sot, ekzistonin plane që qeveria të fillonte ta financonte atë që nga viti 2021. Procesi i krijimit të bazës së të dhënave përfshinte konsultime me organizatat dhe institucionet për të drejtat e grave, përfshirë Agjencinë për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, drejt sigurimit të mbrojtjes së të dhënave personale të personave që përjetojnë dhunë.

dispozicion për publikun, sipas KS.⁴³ Sidoqoftë, intervistat e RrGK-së sugjeruan që jo çdo institucion vazhdimisht i fut të gjitha të dhënat, dhe raportet e parashikuara periodike të parapara nga SKMDHF nuk ishin ende në dispozicion. KNDHF thuhet se ka krijuar një “sistem të konsoliduar monitorimi dhe vlerësimi” për ndjekjen e zbatimit të SKMDHF (2.3.8.); ka krijuar një bazë të dhënash të përbashkëta të rasteve të ndihmuara nga policia, prokuroria dhe gjyqësori; dhe ka trajnuar personelin në përdorimin e kësaj baze të të dhënave (2.3.9.).⁴⁴ Sidoqoftë, raportet e bazuara në këtë sistem dhe bazën e të dhënave nuk u bënë të disponueshme për publikun, gjë që e ka bërë të vështirë monitorimin e pavarur të progresit.

Sipas Shtyllës 4, KNDHF duhej të siguronte “4.1.6. Trajnimin e personelit në strehimoret ekzistuese në mënyrë që të jemi të gatshëm të ofrojmë shërbime cilësore, bazuar në kategori të ndryshme” për viktime dhunës në familje, përfshirë LGBT, komunitetin Rom, Ashkali dhe Egjiptian dhe minoritetet e tjera”. Stafi i strehimoreve i intervistuar nuk ka treguar që ata kishin marrë pjesë në një trajnim të tillë. Padyshim, MPMS mund të jetë më e përshtatshme për të organizuar dhe ofruar trajnime të tilla si pjesë e procedurave të licencimit.

Agjencia për Barazi Gjinore

E themeluar në vitin 2005 sipas Ligjit për Barazinë Gjinore, Agjencia për Barazi Gjinore (ABGJ) ndodhet në Zyrën e Kryeministrit. Ajo ka për detyrë rritjen e ndërgjegjësimit; dhe promovimin e pjesëmarrjes së barabartë të burrave dhe grave në jetën politike, ekonomike, sociale dhe kulturore. Ajo gjithashtu monitoron zbatimin e ligjeve, akteve dhe dispozitave të ndryshme nga institucionet përkatëse. ABGJ mbështet rrjetin e ZBGJ-ve në komuna dhe ministri, dhe ata duhet t’i raportojnë ABGJ-së për përpjekjet e tyre për të adresuar dhunën në familje. ABGJ është një institucion kyç i angazhuar në grupe të ndryshme pune që hartojnë ligje, politika dhe programe për formë të ndryshme të dhunës me bazë gjinore. Siç u përmend, ABGJ shërben si nën-kryesuese e Grupit Koordinues Ndërminstrior kundër Dhunës në Familje. ABGJ ka udhëhequr shumë fushata të ndërgjegjësimit rreth dhunës me bazë gjinore, përfshirë ato të ndërlidhura me ngacmimet seksuale dhe dhunën në familje. ABGJ konsultohet dhe bashkëpunon shumë ngushtë me organizatat për të drejtat e grave, duke përfshirë strehimoret, për të gjitha reformat ligjore dhe të politikave, si dhe përpjekjet për rritjen e ndërgjegjësimit në lidhje me adresimin e dhunës me bazë gjinore.

Sa i përket SKMDHF, ABGJ kishte disa përgjegjësi për të mbështetur institucionet e tjera. Përgjegjësitë e caktuara posaçërisht për ABGJ përfshijnë “2.1.2. Rishikimi i nevojave për plotësimin dhe ndryshimin e formave të PSV-së”, një proces që nuk mund të fillonte sepse LMDHF i ri nuk u ndryshua. Sidoqoftë, ndërkohë në vitin 2019, ABGJ e ka mbështetur këtë iniciativë duke organizuar pesë punëtori. Së bashku me MPMS, MASHT dhe MSH, ABGJ gjithashtu duhej të ofronte “4.1.8. Trajnime për zyrtarët për punësim, kujdes shëndetësor, arsim, shërbime sociale dhe të tjerët për një qasje të ndjeshme gjinore”. Janë ofruar disa trajnime të tilla, përfshirë edhe me mbështetjen e aktorëve të tjerë. Vetëm

⁴³ Neni 11.

⁴⁴ UNW mbështeti krijimin e bazës së të dhënave dhe për trajnime (Kosova do të fillojë përdorimin e një baze të integruar të të dhënave për rastet e dhunës në familje, 2019).

në vitin 2019, 218 pjesëmarrës morën certifikata.⁴⁵ Ndërkohë siç u përmend, përgjigjet nga zyrtarët e intervistuar sugjerojnë nevojën për një trajnim të mëtejshëm mbi qasjen e ndjeshme gjinore, dhe disa të anketuar deklaruan se nuk kishin ndjekur një trajnim të tillë.

Gjatë pandemisë COVID-19 në vitin 2020, ABGJ mori iniciativën për të siguruar strehim emergjent për gratë dhe fëmijët viktime të dhunës derisa të mund të testoheshin për COVID-19, si dhe për ata që rezultuan pozitivë për COVID-19. ABGJ bashkëpunoi ngushtë me MSH, MD, UNW dhe UNFPA për të siguruar krijimin me kohë të kësaj strehimoreje. Siguroi mbrojtje për këto gra dhe fëmijë, duke shmangur rrezikun e mundshëm për gratë, fëmijët dhe anëtarët e personelit në strehimore të ekzistues të Kosovës. ABGJ gjithashtu bëri ndërlidhje me financuesit, duke përfshirë UNW dhe UNFPA, për të koordinuar shpërndarjen në kohë të furnizimeve emergjente në strehimore, duke përfshirë veshje, ushqime, furnizime pastrimi, pajisje mbrojtëse emergjente dhe pajisje tjera.

Përgjigja komunale ndaj dhunës me bazë gjinore

Pas decentralizimit, komunat luajnë një rol të rëndësishëm në menaxhimin e përgjigjes ndër-institucionale ndaj dhunës me bazë gjinore. Komunat menaxhojnë shëndetin, arsimin, trajnimin, punësimin dhe shërbimet sociale. Këto financohen kryesisht përmes transferimeve të buxhetit nga buxheti i përgjithshëm i Kosovës. Komunat varen shumë nga Granti i Përgjithshëm nga niveli qendror, i cili përbën më shumë se 80% të buxhetit të tyre në pothuajse të gjitha komunat përveç Prishtinës.⁴⁶ Në mënyrë hipotetike, ato mund të krijojnë të ardhurat e tyre, duke i ndarë për adresimin e çështjeve të tilla si dhuna me bazë gjinore, por pak prej tyre e bëjnë. Kjo mbështetje në transferimet e buxhetit të qeverisë qendrore do të thotë që komunat janë të kufizuara në sasinë e fondeve që mund të kërkojnë për të financuar shërbime për adresimin e dhunës me bazë gjinore.

Zyrtarët komunalë të intervistuar nuk kishin pasur trajnim mbi dhunën me bazë gjinore, dhe disa nuk kishin njohuri dhe kuptim të ngacmimeve seksuale, dhunës seksuale, ndjekjes dhe gjymtimit të organeve gjinitale të grave. Në praktikë, komunat nuk duket se janë marrë shumë me forma të dhunës me bazë gjinore përveç dhunës në familje, për të cilat ata kanë kompetenca të qarta. Sipas PSV-ve, Drejtoria e Shëndetit dhe Mirëqenies Sociale menaxhon shërbimet sociale dhe Drejtoria e Arsimit mbikëqyrë arsimin për viktimat e dhunës në familje, të rriturit dhe fëmijët. Sidoqoftë, zyrtarët komunalë të intervistuar kishin pak ose aspak njohuri në lidhje me PSV-të, SKMDHF-në, ose se ata kishin ndonjë përgjegjësi nën SKMDHF-në.⁴⁷ Në përgjithësi, kjo mungesë njohurish mund të ketë kontribuar në zbatimin e dobët të përgjegjësisë të tyre.

Përveç mbështetjes së disa aktiviteteve në SKMDHF, komunat kishin përgjegjësinë specifike për të krijuar partneritete rajonale, ndër-komunale për identifikimin, referimin, strehimin, rehabilitimin dhe fuqizimin e viktimave të dhunës në familje, në bashkëpunim me Ministrinë e Punëve të Brendshme (MPB) dhe MPMS (2.3.4 Sipas MPMS-së, 64 marrëveshje rajonale janë nënshkruar nga viti 2017 deri

⁴⁵ Komenti i ABGJ-së mbi draft raportin, 2021.

⁴⁶ Zyra Kombëtare e Auditimit, *Raporti i Auditimit të Performancës*, 2018, f. 7.

⁴⁷ Për këtë raport, u intervistuan katër drejtorë në disa komuna: Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, Drejtoria për Barazi Gjinore, Drejtoria e Arsimit dhe Drejtoria e Financave. RrGK zhvilloi 28 intervista me përfaqësuesit e këtyre drejtorive.

në vitin 2020 dhe katër komuna kanë ndarë buxhetet e tyre (Peja, Prizreni, Mitrovica dhe Gjakova).⁴⁸ Pra, vetëm disa komuna duket se ndajnë buxhetet për adresimin e dhunës në familje, siç parashikohet nga SKMDHF.

Mekanizmat e koordinimit (MK) duhet të bashkëpunojnë për të adresuar dhunën në familje dhe për të menaxhuar raste specifike në nivelin komunal, sipas kornizës ligjore. Anëtarët e MK-ve përfshijnë ZBGJ, PK, gjyqtarë, QPS, MV, drejtoritë komunale të arsimit, Zyrat e Punësimit (ZP), OSHC duke përfshirë strehimoret dhe, në disa komuna, gratë anëtare të kuvendit komunal.⁴⁹ Sipas SKMDHF, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL) ishte përgjegjëse për krijimin e MK-ve në komuna që nuk i kishin ato (2.2.4) dhe krijimin e një linje buxhetore për zyrat komunale për barazi gjinore për koordinimin e MK-ve (2.2.5.). Duke filluar nga viti 2017, SKMDHF parashikoi që tetë MK të rinj do të krijoheshin çdo vit në komuna ku ata nuk ekzistonin. Kur u pyet, përfaqësuesi i MAPL-së i intervistuar nuk ishte në dijeni të këtyre përgjegjësive, gjë që mund të shpjegojë pse MAPL nuk i ka zbatuar ato. Më shumë MK u krijuan, por jo në të gjitha komunat. Që nga viti 2020, 19 komuna duket se kishin MK (50%). Aktorët ndërkombëtarë si UNW (nëntë) dhe OSBE (dymbëdhjetë) raportuan se financuan krijimin e KM-ve. Komunat, ABGj dhe UNW bashkëpunuan për të trajnuar më shumë se 80 anëtarë të CM në shtatë komune Mitrovicës së Veriut, Zveçanit, Leposaviqit, Zubin Potokut, Gjilanit, Gjakovës dhe Dragashit mbi PSV-të dhe format e tjera të dhunës të mbuluara nga duke u përqëndruar në parandalimin e riviktimizimit.⁵⁰ Megjithatë, MAPL nuk ka krijuar linjën e paraparë buxhetore që do t'i mundësonte Qeverisë së Kosovës të institucionalizojë ndarjet e buxhetit për mbështetjen e MK-ve.

Zyrtarët komunalë për barazi gjinore (ZBGJ) koordinojnë MK-të në shumicën e komunave. Ekzistojnë përjashtime, të tilla si në Ferizaj, ku Nënkrjetari i Komunës koordinon MK-në. Raportohet se, në disa komuna, ZBGJ-të nuk kanë ndikim politik ose mbështetje nga ndërmjetësit e pushtetit brenda komunës, gjë që pengoi aftësinë e tyre për të siguruar mbështetje politike dhe ndarje të përshtatshme buxhetore për punën e MK-ve.⁵¹ SKMDHF gjithashtu parashikoi që të gjithë ZBGJ-të do të merrnin trajnim për të rritur kapacitetet e tyre për të koordinuar MK-të. Ndërsa disa ZBGJ morën pjesë në një trajnim të tillë, shumica nuk kishin marrë pjesë. Edhe pasi ndoqën një trajnim të specializuar, disa ZBGJ nuk kishin njohuri dhe kuptim rreth dhunës me bazë gjinore.⁵²

SKMDHF parashikoi që komunat do të pasqyronin përgjegjësitë e reja të ZBGJ-ve në përshkrimet e tyre të punës dhe do të rrisnin pagat e tyre, duke i kompensuar ata për përgjegjësitë e rritura (2.2.1.). RrGK nuk gjeti prova se komunat kishin rishikuar përshkrimet e punës së ZBGJ-ve ose kishin rritur pagat e tyre. Një ZBGJ shpjegoi se ata nuk prisnin që komuna t'u jepte atyre një nxitje për të punuar; MK mori iniciativën për të bërë strategjinë e tyre për trajtimin e rasteve. "Kur kemi një mekanizëm të fuqishëm, atëherë gjithçka është në rregull dhe mbështetja është e qartë", tha ZBGJ.⁵³ Ndërsa është i lavdërueshëm, siç është parashikuar nga KS dhe SKMDHF, funksionimi i MK-ve në të

⁴⁸ Të dhënat e siguruar për RrGK-në, Nëntor 2020.

⁴⁹ UNW, raporti i progresit i dhënë RrGK-së më 18 maj 2020, i pabotuar, 2019.

⁵⁰ Komenti i UNW mbi draft raportin, 2021.

⁵¹ Intervistë e RrGK-së me ish KNDHF, 2021.

⁵² Interpretimi i RrGK-së bazuar në intervistat me ZBGJ-të dhe komentet e bëra.

⁵³ Intervistë e RrGK-së me një ZBGJ, 2020.

gjithë Kosovën nuk duhet t'i lihet vullnetit individual, por duhet të ketë një qasje të institucionalizuar.

Siç raportohet, asnjë nga komunat nuk kishte ndarë fonde për punën e ZBGJ-ve në lidhje me MK-të.⁵⁴ Ndërsa disa komuna kanë linja të përgjithshme buxhetore për barazinë gjinore, këto nuk janë të destinuara për MK-të ose për adresimin e dhunës në familje. Për shembull, ZBGJ në Mitrovicë raportoi se ndonjëherë e përdori linjën e buxhetit të barazisë gjinore për të adresuar dhunën në familje.⁵⁵ Sidoqoftë, buxheti i komunës nuk specifikon shumën e fondeve të ndara për dhunën në familje ose për mbështetjen e MK-së. Në të vërtetë, një shqetësim i ngritur në mënyrë të përsëritur midis anëtarëve të MK-ve, veçanërisht ZBGJ, ishte buxheti i pamjaftueshëm për MK-të për të ofruar shërbime të parashikuara në SKMDHF.

Institucionet e tjera të angazhuara në MK-të në përgjithësi ranë dakord që MK-të e kanë bërë menaxhimin e rasteve shumë më të lehtë, si dhe kanë lehtësuar bashkëpunimin midis institucioneve. Përkundrazi, të anketuarit në disa komuna raportuan se MK-të nuk takoheshin rregullisht dhe se disa nga institucionet përgjegjëse nuk morën pjesë fare. Disa MK nuk kishin hapësirë adekuate për takime.

Komunat duhet të siguronin përfshirjen e viktimave të dhunës në familje në “programet ekzistuese” dhe të hartonin “programe për fuqizimin ekonomik të viktimave të dhunës në familje, në bashkëpunim me bizneset private dhe donatorët” (4.3.5.). RrGK nuk identifikoi ndonjë shembull për këtë. Në asnjë nga shtatë komunat e monitoruara nga UNW në vitin 2019, MK-të nuk kishin mbështetur viktimat përmes ZP-ve për t'u punësuar.⁵⁶ Në vitin 2018, këto shtatë komuna mbështetën vetëm shtatë gra me përfitime qiraje, strehimi social dhe trajnimi profesional. Nga të gjitha rastet e raportuara (266), UNW zbuloi se MK-të ndihmuan 137 gra, por asnjëra nuk duket se është bërë plotësisht autonome, kryesisht për shkak se ato nuk kanë siguruar punë. Megjithatë SKMDHF ka një shtyllë kushtuar riintegrit, një temë e përsëritur e të anketuarve nga institucionet përkatëse, përfshirë anëtarët e MK-ve, ishte mungesa e programeve të riintegritit për viktimat, veçanërisht strehimit dhe punësimit.

Për më tepër, SKMDHF u dha komunave disa përgjegjësi në lidhje me strehimin dhe banimin social. Komunat duhej të hapnin një “strehimore për djem dhe burra viktimë të dhunës në familje” (4.1.5.). Kjo nuk u arrit. Ndoshta fakti që SKMDHF nuk specifikoi qartë se cila komunë kishte detyrimin financiar për të hapur këtë strehimore kontribuoi që kjo veprimtari të mos zbatohej. Komunat gjithashtu kishin një përgjegjësi të siguronin strehim afatgjatë për viktimat, përmes “marrëveshjeve të mirëkuptimit midis komunave, shtëpive strehimore, QPS dhe Komisionit për Strehimin Social, përfshirë strehimin rajonal përmes marrëveshjeve ndër-komunale” (4.1.7.). RrGK zbuloi se Gjakova, Gjilani, Mitrovica e Veriut dhe Prizreni kanë rezervuar banim social për viktimat, por komunat e tjera të intervistuar nuk e kishin bërë këtë.⁵⁷ Komunat gjithashtu duhej të bashkëpunonin me MPMS për të siguruar objekte në pronësi të komunave për të shërbyer si strehimore për dhunën në familje, si dhe për të përfshirë viktimat si kategori për banimin social (4.3.1.). Disa komuna kanë ofruar prona komunale për

⁵⁴ Intervistë e RrGK-së me ish KNDHF, 2021.

⁵⁵ Buxheti total i zyrës së ZBGJ ishte 37,312 € në vitin 2018, 30,513 € në vitin 2019 dhe 28,007 € në vitin 2020.

⁵⁶ UNW, raporti i progresit i dhënë RrGK-së më 18 maj 2020, i pabotuar, 2019. Raporti monitoroi shtatë komunat që mbështeste UNW: Gjilan, Gjakovë, Dragash, Mitrovicë e Veriut, Zveçan, Zubin Potok dhe Leposaviq.

⁵⁷ E konfirmuar nga KNMDHF (Intervista e RrGK-së, 2021).

strehimore (p.sh., Gjlani, Prizreni, Gjakova, Peja) dhe disa komuna mbështesin strehimoret në pagimin e qirasë.⁵⁸ Sidoqoftë, jo të gjitha strehimoret kanë hapësira të përhershme të financuara nga qeveria. Veçanërisht, gjatë pandemisë COVID-19, qeveria shfrytëzoi pronën publike në Prishtinë për strehimin e përkohshëm të lartpërmendur. Ishte e paqartë nëse komunat përdornin ndonjë objekt tjetër qeveritar për strehimore ose banesa sociale, përfshirë pasuritë e konfiskuara (4.3.2.).⁵⁹ Komunat gjithashtu duhet të kenë mbështetur strehimoret duke përdorur buxhetin e tyre vjetor për të blerë shërbime (4.3.4.). Disa komuna kanë mbështetur strehimoret, por jo të gjitha dhe, përsëri, një mbështetje e tillë nuk është institucionalizuar.

Konkluzion

Kosova ka disa organe koordinuese, të përqendruara kryesisht në adresimin e dhunës në familje dhe dhunës seksuale të kryer gjatë luftës. Lidhur me dhunën seksuale të kryer gjatë luftës, OSHC-të për të drejtat e grave ofrojnë shumicën e shërbimeve gjithëpërfshirëse. Komisioni qeveritar për shqyrtimin e aplikimeve për njohje dhe përfitime shtetërore është një praktikë më e mirë. Sidoqoftë, mandati i tij do të skadojë së shpejti, dhe mbrojtjet adekuate nuk ekzistojnë për të gjitha gratë. Kosova nuk ka organe koordinuese për adresimin e formave të dhunës me bazë gjinore brenda fushëveprimit të KS, përveç dhunës në familje dhe trafikimit njerëzor.

Organeve koordinuese që merren me dhunën në familje u mungon një mandat i qartë ligjor të parashikuar në ligj në nivelin kombëtar dhe kështu edhe burimet e qëndrueshme njerëzore dhe financiare për të siguruar funksionimin e tyre të besueshëm. Kjo përfshin role të qarta, përgjegjësi dhe ndarje të detyrave të zbatimit, monitorimit dhe vlerësimit. Më shumë MK janë krijuar brenda komunave dhe funksionimi i tyre është përmirësuar që nga viti 2017. Sidoqoftë, disa komuna ende nuk kanë MK funksional, siç parashikohet nga SKMDHF. ZBGJ-të që udhëheqin MK-të nuk kanë të gjithë njohuri të përshtatshme, kapacitete, përshkrime të azhurnuara të vendeve të punës, kompensim adekuat dhe ndikim politik për këtë detyrë, sipas SKMDHF. Komunat nuk kanë ndarë buxhete të mjaftueshme për shërbime rehabilituese dhe riintegruuese gjithëpërfshirëse të fokusuara në viktimë, siç parashikohet nga KS dhe SKMDHF.

⁵⁸ Sipas MPMS, Prizreni ka siguruar deri në 17 apartamente në një vit të caktuar që nga viti 2017 për strehim të përkohshëm social kurse Gjlani një. Në total, 57 viktimë kanë qëndruar në këto nga viti 2017 deri në nëntor 2020 (Korrespondenca e RrGK me MPMS, nëntor 2020).

⁵⁹ Siç është parashikuar në bazë të KPPK-së për pasuritë e konfiskuara, neni 284 (4).

POLICIA E KOSOVËS

Ministria e Punëve të Brendshme (MPB) duhet të sigurojë që policia të jetë e trajnuar dhe e aftë për të mbrojtur dhe mbështetur të gjitha viktimat e dhunës me bazë gjinore. Policia e Kosovës (PK) është përgjegjëse për hetimin dhe ndjekjen penale të të gjitha krimeve që përfshijnë dhunën me bazë gjinore siç përcaktohet nga KPK dhe KPPK; për përgjigjen ndaj raporteve të dhunës në familje sipas LMDHF;⁶⁰ për kryerjen e vlerësimeve të rrezikut për viktimat; për referimin e viktimave në shërbimet mbështetëse; për ekzekutimin e urdhrave të mbrojtjes dhe procedimin e kërkesave për UMPE.⁶¹ Njësitë për Hetimin e Dhunës në Familje (NJHDHF) të PK përfshijnë gra dhe burra policë në secilën komunë të cilët janë trajnuar posaçërisht për t'u marrë me rastet e dhunës në familje. Shefi i Njësisë Rajonale të Policisë së Kosovës kundër Dhunës në Familje përcakton dhënien e UMPE-ve. Ndërkohë, Inspektorati Policor parandalon, zbulon dhe heton veprat penale dhe shkeljet e tjera nga zyrtarët e policisë.⁶²

Zakonisht, PK është pika e parë e kontaktit për dikë që ka përjetuar dhunë me bazë gjinore. Kështu, PK-ja tenton të jetë institucioni i parë që vë në lëvizje zbatimin e PSV-ve përkatësisht të dhunës në familje dhe trafikimit. Një përgjigje profesionale dhe adekuate është e domosdoshme për të mbështetur viktimat, pasi një përgjigje joadekuate mund të çojë në viktimizim të serishëm.⁶³ Reagimi i dobët i policisë gjithashtu mund të çojë në ndonjë rast të mundshëm që nuk do të paraqitet zyrtarisht. Thuhet se PK se nuk ka një qasje të standardizuar për t'iu përgjigjur rasteve në rajone të ndryshme, siç ilustron nga ekzaminimi i vonuar mjekësor i viktimave, i cili mund të dëmtojë rikthimin e provave fizike.⁶⁴

Hapi i parë përfshin kryerjen e një vlerësimi të duhur të rrezikut të situatës, vlerësimin e potencialit për dhunë të vazhdueshme dhe për shërbimet e nevojshme si dhe për sigurimin e provave. Pas vlerësimit të rrezikut, policia ka një detyrim për të mbrojtur viktimat dhe për t'i informuar ato për të drejtat e tyre, të cilat mund të përfshijnë informimin e tyre për lloje të ndryshme të urdhrave të mbrojtjes, dhënien e UMPE-ve dhe lidhjen me aktorë të tjerë për të siguruar mbështetje psikologjike, ndihmë juridike, strehim dhe ndihmë tjetër.⁶⁵ Ata duhet të kenë një plan adekuat të mbrojtjes për viktimën pasi viktimat të vihet në siguri. Policia gjithashtu duhet të shoqërojë viktimat në shtëpitë e tyre për të mbledhur gjërat e tyre nëse kërkohet. Çdo njësi policore duhet të sigurojë që të ka burime të mjaftueshme njerëzore dhe teknike për të luftuar dhunën në familje në rrethin e tyre.⁶⁶

Për të shqyrtuar çdo ndryshim në vetëdijesimin dhe performancën institucionale që nga viti 2017, RrGK ka zhvilluar 37 intervista me zyrtarë policorë në të gjithë Kosovën në vitin 2020. Lidhur me njohuritë, gjysma e të anketuarve pranuan që dhuna me bazë gjinore përfshinte dhunë të kryer ndaj dikujt për shkak të gjinisë së tyre, por të tjerëve u mungonte ky kuptim konceptual. Zyrtarët në mënyrë të përsëritur identifikuan dhunën fizike, psikologjike dhe ekonomike si forma të dhunës me

⁶⁰ Neni 24.

⁶¹ ABGJ, *Procedurat Standarde të Veprimit për mbrojtjen nga dhuna në familje në Kosovë*, 2013.

⁶² Ligji Nr. 03/L-231 për *Inspektoratin Policor të Kosovës*.

⁶³ Morina, D. dhe Demolli, L., *Dhuna me bazë gjinore në Kosovë: një përmbledhje kritike e reagimit të policisë*, 2019.

⁶⁴ EULEX, komenti mbi draft raportin, 2021.

⁶⁵ ABGJ, *Procedurat Standarde të Veprimit për mbrojtjen nga dhuna në familje në Kosovë*, 2013, f. 31.

⁶⁶ Po aty, dhe MJ, SKMDHF, 2017.

bazë gjinore. Zyrtarët gjithashtu njohën veprat e reja penale në KPK si ngacmimi seksual, gjymtimi i organeve gjenitale të grave dhe ndjekja. Sidoqoftë, zyrtarët prireshin të ngatërronin dhunën me bazë gjinore me dhunën në familje dhe të kishin më pak njohuri në lidhje me sulmin seksual dhe ngacmimin seksual.

“Rastet [e dhunës në familje] të komunitetit LGBTIAQ+ rrallë raportohen në polici, sepse policia i klasifikon [këto krime] si krime të urrejtjes dhe jo si krime të dhunës në familje dhe nuk i trajton me prioritet.”

- Aktivist

Zyrtarët e intervistuar nuk kishin trajtuar drejtpërdrejt ndonjë rast të ngacmimit seksual, të gjymtimit gjenital të femrave, ose të ndjekjes, ose madje nuk kishin dëgjuar për ndonjë rast të tillë që raportohet ose procedohet. Asnjë rast i gjymtimit gjenital të femrave nuk është raportuar ende në PK dhe disa raste të dhunës seksuale, janë raportuar dhe rastet e përdhunimit janë rritur me kalimin e kohës (Grafiku 3).⁶⁷ Kjo mund të jetë për shkak se njerëzit kanë frikë të raportojnë ato, duke pasur parasysh natyrën e tyre private dhe të ndjeshme. Në disa raste, mbase policia nuk regjistroi raste të tilla ose i dekurajoi gratë nga paraqitja e rasteve.⁶⁸

Hulumtime të tjera kanë sugjeruar që policia jo gjithmonë ka trajtuar si duhet ngacmimet seksuale dhe format e tjera të dhunës seksuale.⁶⁹ Zyrtarët u thanë viktimave se kishin nevojë për më shumë prova; dhe disa zyrtarë bënë komente poshtëruese, bënë pyetje të papërshtatshme ose kërkuan që viktimat të përsërisin historinë e tyre shumë herë, duke kontribuar potencialisht në ri-traumatizim. Pak raste të tilla u hetuan pas pranimit fillestar.⁷⁰ Duke qenë se zyrtarët e intervistuar nuk kishin përvojë në trajtimin e rasteve të tilla, RrGK nuk mund të vlerësonte përgjigjen e tyre.

Është shqetësuese që disa zyrtarë ende kishin qëndrime që i ngjanin fajësimit të viktimës. Lidhur me një rast që përfshinte përdhunimin e përsëritur dhe viktimizimin e një të miture nga një zyrtar policie dhe një profesor shkolle, një zyrtar policie tha:

Të gjitha [problemet në lidhje me këtë rast] janë të lidhura me këtë femër, e cila mendoj se nuk mund të rri pa një mashkull. ... Me të gjithë që kjo vajzë kishte kontakte, ajo përfundoi në një hotel. Pse gjithçka lidhet me këtë femër?

I anketuari sugjeron se ishte faji i vajzës që ajo u përdhunua, pasi, sipas mendimit të tij, “ajo nuk mund të rri pa një mashkull”. Fajësimi i një viktime të tillë mund të pengojë qasjen në drejtësi dhe një qasje të fokusuar te viktimat për mbrojtjen dhe mirëqenien e viktimës. Raporti Shpjegues për KS tregon se masat dhe shërbimet të cilat nuk marrin në konsideratë efektet shkatërruese të dhunës dhe

⁶⁷ Burimi: PK. RrGK kombinoi raste sipas neneve të rinj dhe të vjetër të KPK-së për prezantimin e konsoliduar të të dhënave. Grafiku përfshin vetëm dhunën ndaj grave sepse në afërsisht 90% të të gjitha rasteve të dhunës seksuale gjatë kësaj periudhe, gratë ishin viktimat. Ndërsa më shumë burra sesa gra ishin viktimat të vrasjes dhe lëndimit trupor, një dhunë e tillë ndaj grave ka shumë të ngjarë të sjellë dhunë të bazuar në gjini, që është dhuna e kryer ndaj grave sepse ato janë gra; për më tepër, shpesh dhuna e tillë kryhet nga një anëtar i familjes mashkull.


⁶⁸ Bisedat e RrGK-së me gra të reja dhe monitorimi, 2020.

⁶⁹ Qosaj-Mustafa, A. dhe Morina, D. *Qasja në drejtësi e viktimave të dhunës me bazë gjinore në Kosovë: Përfundimi i mosndëshkimit të autorëve të krimit*, 2018.

⁷⁰ Po aty.

kohëzgjatjen e procesit të rimëkëmbjes, ose që trajtojnë viktimat në mënyrë të pandjeshme, rrezikojnë të ri-viktimizojnë përdoruesit e shërbimeve.⁷¹

Grafiku 4. Krimet e dhunës ndaj grave të raportuara në Policinë e Kosovës, 2015 -2020



Fajësimi i Viktimës

Sipas Shoqatës Amerikane të Psikologjisë, “Fajësimi i Viktimës” është një fenomen psikologjik social në të cilin individët ose grupet përpiqen të përballen me gjërat e këqija që u kanë ndodhur të tjerëve duke ia ngarkuar fajin viktimës së traumës ose tragjedisë.

Fajësimi i viktimës shërben për të krijuar një distancë psikologjike midis sulmuesit dhe viktimës, mund të racionalizojë një dështim për të ndërhyrë nëse sulmuesi ishte një kalimtar i rastit, dhe krijon një mbrojtje psikologjike për sulmuesin nga ndjenjat e cenueshmërisë.


PK kishte më shumë përvojë me raste të dhunës në familje sesa me raste të dhunës seksuale. Zyrtarët përgjithësisht besuan se PK dhe institucionet e tjera përkatëse që trajtojnë dhunën në familje janë më të vetëdijshëm për detyrat e tyre dhe mënyrën e trajtimit të rasteve të tilla sesa që ishin në vitin 2017. Ata thanë që meqenëse KPK i ri përfshiu dhunën në familje si vepër penale specifike, këto raste trajtohen me prioritet, më shumë sesa në vitin 2017. Ndërkohë, zyrtarët e intervistuar ishin të prirë të kishin njohuri të pjesshme në lidhje me SKMDHF dhe PSV. Ndërsa kishin dëgjuar për këto dokumente, ata demonstuan pak njohuri në lidhje me përmbajtjen e saktë ose zbatimin e tyre.

Që nga viti 2017, raportohen më shumë raste të dhunës në familje. Të dhënat e siguruar nga

⁷¹ “Raport shpjegues për Konventën e Këshillit të Evropës për parandalimin dhe luftimin e dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje”, Stamboll, 11. V. 2011, f. 117. Shërbimet mbrojtëse dhe mbështetëse, përfshirë brenda kontekstit të policisë, duhet të synojnë shmangien e viktimizimit sekondar sipas KS (neni 18.3).

PK ilustron një rritje eksponenciale të rasteve të raportuara (Grafiku 4). Në përgjithësi, të anketuarit ia atribuuan këtë rritje njohurisë së përmirësuar të njerëzve për të drejtat e tyre dhe besimit të përmirësuar në institucione (dhe jo domosdoshmërisht një rritjeje të dhunës). Zyrtarët e PK-së ia atribuuan atë rritjes së besimit në polici. Raportimi i dhunës është bërë gjithashtu më i lehtë; aplikacioni telefonik i PK-së për raportimin e krimeve është azhurnuar për të përfshirë dhunën në familje, dhe kjo u reklamua gjerësisht me mbështetjen e UNW.⁷² Disa e kanë atribuar rritjen e konsiderueshme të rasteve të raportuara në vitin 2020 rritjes së dhunës gjatë pandemisë COVID-19.⁷³

Grafiku 5. Numri i rasteve të dhunës në familje të raportuara në Policinë e Kosovës sipas vitit



“Ka shumë gjëra që duhet të përmirësohen, por policia është institucioni që duhet të trajtojë me besueshmëri rastet e dhunës në familje, veçanërisht për anëtarët e komunitetit LGBTI.”

- Aktivist

Mes përmirësimeve të përmendura shpesh në besim, intervistat me grupe potencialisht më të rrezikuara sugjerojnë që jo të gjithë ndihen rehat t'i drejtohen policisë për ndihmë. Brenga ekzistonte në lidhje me raportimin e martesës së hershme në veçanti:

Shqetësime të tilla të ngritura nga aktivistë që punojnë me gra romë, ashkali dhe egjiptiane kërkojnë adresë, në mënyrë që ata të besojnë se policia do t'i mbështesë ato nëse paraqiten. Nëse ato nuk ndihen të sigurta për të raportuar

krime të tilla, policia nuk mund të përmbushë detyrën e saj për të mbrojtur fëmijët, si ndër më të rrezikuarit. Në të vërtetë, KS e bën të qartë se perceptimet relativiste kulturore janë të parëndësishme kur bëhet fjalë për të siguruar mbrojtje nga dhuna me bazë gjinore. Nëse perceptime të tilla për romët, ashkalinjtë dhe egjiptianët, me të vërtetë ekzistojnë midis zyrtarëve të policisë, kjo kërkon vëmendje. Për më tepër, mbase policimi dhe komunikimi me komunitetin mund të kontribuojë në përmirësimin e marrëdhënieve dhe besimit, së bashku me trajnimin e përqendruar që integron aspektet kulturore dhe

⁷² UNW, komenti për draft raportin, 2021.

⁷³ Farnsworth dhe të tjerët për RrGK, [Pandemia nuk njeht gjini? Analizë gjinore fiskale buxhetore: Reagimi i Qeverisë së Kosovës ndaj pandemisë COVID-19 nga perspektiva gjinore](#), 2020

gjinore të rëndësishme lokale.⁷⁴

Në përgjithësi, zyrtarët e policisë të intervistuar e dinin se ata duhet të ndiqnin rastet sipas detyrës zyrtare kur ata dyshojnë se është kryer një veprë penale që përfshin dhunë me bazë gjinore, edhe nëse viktimat e tërheq dëshminë. Sidoqoftë, në praktikë, ndodhën përjashtime, siç përshkruhen nga një monitorues gjykatë: “Pas një raporti fillestar të dhunës në familje, Policia e Kosovës nuk e vazhdoi rastin te Prokurori sepse gruaja e fali burrin e saj për dhunën e përdorur.”⁷⁵ Ndërsa ka përmirësim që prej vitit 2017,⁷⁶ disa raste të tilla ende kanë ndodhur kur policia nuk ka proceduar çështje në prokurori kur janë kryer krime dhe ka inkurajuar familjen të “pajtohet” (shih kutinë).

Zyrtarët e policisë kanë prirje të dinë se ata duhet t’u ofrojnë viktimave mbrojtje. Sidoqoftë, ata nuk kishin njohuri në lidhje me të gjithë hapat përkatës të parashikuar nga KS. Për shembull, ABGJ ka vërejtur mangësi te zyrtarët e policisë që kryejnë vlerësime të rrezikut.⁷⁷ Edhe pse SKMDHF parashikoi që PK duhet të ndërmerre

“vlerësim të veçantë të rrethanave dhe menaxhim të rrezikut në të gjitha veprat penale me elemente të DHF” (3.2.1.), intervistat dhe monitorimi i RrGK-së gjithashtu zbuluan se policia jo gjithmonë kryente analiza të rrezikut. Në vitin 2018, dështimi i policisë për të kryer një vlerësim të duhur të rrezikut lejoi një grindje fatale.⁷⁸

Në vitin 2017, policia tha se ata shpesh i largonin viktimat nga shtëpitë e tyre dhe i çonin në stacionin e policisë pas raportit fillestar të dhunës, ndërsa kryesisht ktheheshin në shtëpinë e përbashkët.⁷⁹ Kjo praktikë vazhdoi në vitin 2020.⁸⁰ Në përgjithësi, gati një e treta e të gjithë të anketuarve për humtimin e RrGK-së ranë dakord që gruaja duhet të shkojë në strehimore dhe burri duhet të mbetet

Sipas vëzhgimeve të një monitoruesi të RrGK-së, gjatë një seance më 4 prill 2020 në Gjykatën Themelore të Prishtinës, policia shoqëroi kryesin e pretenduar, M.G. Kur seanca përfundoi, monitoruesit e RrGK-së vëzhguan ndërsa zyrtari i policisë pyeste gruan që e kishte raportuar dhunën, D.G.,

“Pse nuk kthehesh tek ai... kthehu e bashkohuni?”

Në rastin numër 145/2020, të monitoruar nga RrGK, pas seancave gjyqësore më 25 qershor 2020 dhe 9 korrik 2020 në Gjykatën Themelore të Prizrenit, dega Suharekë, policia u urdhërua të shoqëronte D.G. për të marrë gjërat e saj personale nga shtëpia ku F.K., kryesi i saj, po jetonte. Edhe me vendim të gjykatës, policia në Suharekë nuk e shoqëroi atë.

⁷⁴ Anitha, S. dhe Gill, A., “Coercion, consent and the forced marriage debate in the UK” (Shtrëngimi, pëlqimi dhe debati i martesës së detyruar në MB), *Studime Ligjore Feministe*, 17(2), 2009, 165-184, f. 175.

⁷⁵ Gjykata Themelore në Pejë, Çështja P. Nr. 1720/2019.

⁷⁶ Berisha dhe të tjerët për RrGK, *Nga Fjalët në Vepra*, 2017.

⁷⁷ ABGJ, “Vlerësimi i nivelit të zbatimit të Procedurave Standarde të Veprimit për Mbrojtjen nga Dhuna në Familje në Kosovë”, 2019, f. 126 dhe 154.

⁷⁸ Qosaj-Mustafa, A. dhe Morina, D., *Qasja në drejtësi e viktimave të dhunës me bazë gjinore në Kosovë: Përfundimi i mosndëshkimit të autorëve të krimit*, 2018

⁷⁹ Berisha dhe të tjerët për RrGK, *Nga Fjalët në Vepra*, 2017.

⁸⁰ Intervistat e RrGK me PK dhe institucione të tjera, 2020.

në shtëpi. Përkundrazi, sipas PSV-ve, në situata të tilla policia duhet të ndalojë kryesin e dyshuar.⁸¹ Për më tepër, policia duhet të informojë viktimat se ata mund të marrin urdhra mbrojtjeje për të larguar kryesit nga shtëpia e përbashkët. Largimi i kryesit të krimit dhe mundësia e qëndrimit të viktimës duhet të jenë prioritet, siç pasqyrohet në KS.⁸²

Zyrtarët e policisë treguan se varësia ekonomike e grave nga kryesi i veprës penale dhe mungesa e të drejtave pronësore nënkuptonte që gratë të vazhdonin të qëndronin me kryesit e krimeve, edhe kur urdhrat e mbrojtjes përfshinin masa që distanconin kryesit nga viktimat. Për këtë, ndër arsytet e tjera, zyrtarët thanë se ata vazhduan të përballen me vështirësi në zbatimin e urdhrave të mbrojtjes.⁸³ Një i anketuar tha:

Ne shpesh jemi ata që duhet të zbatojnë urdhrin e mbrojtjes. Është e pamundur për ne si zyrtarë policie ta bëjmë këtë, kur këto i janë caktuar një viktime dhe kryesit që jetojnë së bashku, të mbikëqyrin nëse [masa e mos afrimit me viktimën] po shkelet apo jo. Mund të ndodhë një vepër penale. Ne e kemi të vështirë për të monitoruar [këtë] kur kryesi i krimit dhe viktimat jetojnë së bashku.⁸⁴

Kërkesa dhe sigurimi i masave shtesë, të tilla si largimi i kryesit nga vendbanimi i përbashkët ose kërkimi prej tij për të paguar qira mund të përdoret për të anuluar situata të tilla, duke bërë të mundur zbatimin më të lehtë të urdhrave të mbrojtjes. Policia mund të informojë viktimat për të drejtën e tyre për të kërkuar masa të tilla.

Që nga viti 2020, zyrtarët kishin prirje të mos dinin për shkallën në të cilën PK kishte zbatuar SKMDHF. Analiza e RrGK-së sugjeroi që PK ka përparuar që nga viti 2017, duke zbatuar pjesërisht përgjegjësitë e saj. SKMDHF parashikoi “I.I.I. Trajnimin dhe certifikimin e vazhdueshëm të zyrtarëve të policisë të fokusuar në DHF, në tema të përcaktuara mirë dhe module të miratuara”. E gjithë pjesëtarët e NjPLMDhF trajnuar, ndërsa reaguesit e parë të intervistuar nga RrGK nuk ishin trajnuar.⁸⁵

Përndryshe, RrGK zbuloi se ishte bërë njëfarë progresi. Zyrtarët e policisë të intervistuar kishin prirje të deklaronin se ata kishin marrë pjesë në të paktën një trajnim për barazinë gjinore dhe parandalimin e dhunës në familje të ofruar nga Akademia e Kosovës për Siguri Publike (AKSP) ose subjekte të tjera që nga viti 2017. Të dhënat e policisë sugjeruan gjithashtu që në vitin 2017, 38 pjesëmarrës morën pjesë në tri trajnime, dhe në vitin 2018, 25 zyrtarë morën pjesë në dy trajnime. Misioni i Bashkimit Evropian për Sundimin e Ligjit në Kosovë (EULEX) trajnoi afërsisht 60 reagues të pare në vitin 2020.⁸⁶ Në përgjithësi një përqindje mjaft e vogël e forcës të policisë duket se ka marrë pjesë, ndoshta sepse trajnimi nuk ishte i detyrueshëm. Ishte e paqartë nëse trajnimi gjithmonë rriti kapacitetet profesionale.

⁸¹ ABGJ, *Procedurat Standarde të Veprimit për mbrojtjen nga dhuna në familje në Kosovë*, 2013, f. 31.

⁸² “Raport shpjegues për Konventën e Këshillit të Evropës për parandalimin dhe luftimin e dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje”, Stamboll, I.I.V. 2011, f. 264.

⁸³ MV-të gjithashtu vërejtën se PK mund të përmirësonte monitorimin e tyre të urdhrave të mbrojtjes (intervistat e RrGK-së, 2020). Sipas OSBE-së, rreth 74% e urdhrave të mbrojtjes po monitorohen nga policia (Të dhënat e siguruar për RrGGK, 2020).

⁸⁴ Intervistë e RrGK-së me një zyrtar policie, 2020.

⁸⁵ Vërtetuar nga intervista e RrGK me KNDHF, 2021.

⁸⁶ Komenti i EULEX-it mbi draft raportin, 2021.

Në vitin 2017, monitorimi i RrGK-së sugjeroi që policia ndonjëherë kishte vështirësi për të ndihmuar viktimat sepse disa stacione nuk kishin hapësirë të caktuar për intervista. SKMDHF parashi-koi që MPB do të siguronte infrastrukturë të përshtatshme për policinë (3.2.2.). Siç raportohet, çdo stacion i PK-së në të gjitha komunat tani ka të paktën një dhomë për intervistimin e viktimave. MPB gjithashtu ishte përgjegjëse për të siguruar që zyrtarët e policisë të flasin serbisht, ndër gjuhët e tjera përkatëse (p.sh., gjuhë turke, rome) (3.2.3.). Kjo gjithashtu u raportua si e kryer.

Konkluzion

Ndërsa zyrtarët e policisë kanë njohuri të përgjithshme rreth formave të ndryshme të dhunës pasi ato kanë të bëjnë me veprat penale, duke përfshirë edhe veprat e reja në KPK, ata kishin prirje të ngatër-ronin dhunën me bazë gjinore me dhunën në familje. Kuptimi i plotë i formave të ndryshme të dhunës seksuale gjithashtu dukej i kufizuar. Fajësimi i viktimave dhe arsyetimet relativisht kulturore për reagimin e pamjaftueshëm të policisë mund të ekzistojnë akoma. Zyrtarët ende duken të prirë të largojnë vik-timat e jo kryesit nga vendbanimet e përbashkëta. Gjithashtu, policia nuk kryen gjithmonë vlerësime gjithëpërfshirëse të rrezikut për të siguruar mbrojtjen e duhur të viktimave. Sidoqoftë, reagimi i përg-jithshëm i PK-së ndaj dhunës në familje dhe zbatimi i SKMDHF duket se janë përmirësuar, edhe pse duket se është i nevojshëm trajnim i mëtejshëm.

INSTITUTI I MJEKËSISË LIGJORE

Instituti i Mjekësisë Ligjore (IML) ndihmon hetimin e çdo lloji të dhunës me bazë gjinore. Aty bëhet ekzaminimi (kontrolli mjekësor) i viktimave dhe mbledhen provat përkatëse (biologjike, materiale, fizike) për t'u përdorur në gjykatë. Për t'u kontrolluar, viktimat duhet të japin pëlqimin. Në rastin ideal, ato duhet të kontrollohen brenda 72 orëve pas ngjarjes ose sa më shpejt të jetë e mundur, në mënyrë që të sigurohen dëshmitë relevante apo edhe për bërë një përshkrim të saktë të lëndimeve.⁸⁷ IML gjithashtu bën ekzaminimin e kryesve të dhunës, sa herë që ekziston dyshimi se i njëjti mund të ketë prova biologjike në trupin e tij, lëndime apo edhe për të përcaktuar nëse ata kanë abuzuar me drogë dhe/ose me alkool. Mjekët ligjorë të IML-së duhet të sigurojnë konfidencialitetin, të mbeten objektivë dhe të trajtojnë çdo pacient në mënyrë të barabartë.

Për sa i përket ndërgjegjësimit, personeli i IML-së i ka përmirësuar njohuritë se si të trajtojnë rastet e dhunës me bazë gjinore që nga viti 2017. EULEX dhe Agjencia Suedeze për Zhvillim dhe Bashkëpunim Ndërkombëtar ka mbështetur personelin e IML-së me trajnime, të tilla si në mbledhjen e provave biologjike në lidhje me dhunën seksuale. Në vitin 2017, publiku dukej mjaft i informuar për IML-në dhe punën e tij. Kështu, IML u përpoq të informonte viktimat se ato duhet të kërkonin ndihmë shpejt, pasi që provat biologjike mund të merren më së miri menjëherë pas një incidenti.⁸⁸ Në bashkëpunim me EULEX-in, IML ndërmori disa fushata për të rritur ndërgjegjësimin për rëndësinë e provave biologjike në gjykimin e rasteve të dhunës seksuale. IML ka bërë përpjekje për të informuar

⁸⁷ ABGJ, [PSV](#), 2013

⁸⁸ Berisha dhe të tjerët për RrGK, [Nga Fjalët në Vepra](#), 2017.

njerëzit, veçanërisht të miturit, për rëndësinë e raportimit të krimeve në kohën e duhur, të tilla si përdhunimi dhe sulmet seksuale. Përpjekjet edukative synuan edhe të miturit, duke pasur parasysh që të dhënat e ILM sugjerojnë se ato përbëjnë shumicën e viktimave.

Një zyrtar i IML-së deklaroi se ata pranojnë të paktën 100 raste të përdhunimit në vit, ndërsa 59% e rasteve të dhunës seksuale të raportuara në vitin 2017 përfshinin të mitur.⁸⁹

Kjo është interesante kur krahasohet me të dhënat e policisë, të cilat regjistruan më pak se 50 raste në vit gjatë së njëjtës periudhë, duke sugjeruar që disa raste të trajtuara nga IML mund të mos regjistrohen nga policia. Sipas IML-së, dhe konfirmuar nga të dhënat e policisë, “90% e viktimave të dhunës seksuale janë femra”. Për fat të keq, ata thanë se ata mund të mbledhin prova biologjike vetëm në 28% të rasteve të raportuara atyre.⁹⁰ Nga rastet e adresuara në IML, në 81% të rasteve të dhunës seksuale, dhunuesi është person i njohur për viktimën.

Zyrtarët e IML deklaruan se kur fëmijët janë viktimë të sulmit seksual ose përdhunimit, në disa raste anëtarët e familjes së tyre prireshin të kujdeseshin më shumë nëse vajza mbetet e virgjër sesa për pasojat që fëmija mund të përjetojë. “Është vërejtur që shumë shpesh lëshohet urdhri [nga prokuroria] për kontroll mjekësor vetëm për të ‘vërtetuar virgjërinë’ e personit që raporton sepse familja këmbëngul, dhe ky është një shtrembërim apo edhe abuzim i qëllimit të ekzaminimit”, tha përfaqësuesi i IML, duke vërejtur nevojën që institucionet e tjera të kenë trajnime të mëtejshme në mënyrë që të parandalojnë kërkesat e tilla.⁹¹ Stigma sociale dhe normat kulturore që rrethojnë virgjërinë dhe martesën, posaçërisht për vajzat, mund të ndikojnë në trajtimin e vajzave që kanë pësuar dhunë seksuale, veçanërisht duke pasur parasysh mungesën e programeve për t’i ndihmuar ato. Në shumë raste, ngjarjet mund të jenë shumë traumatizuese për viktimat për të mos u paraqitur fare, dhe kontrollimi mjekësor mund të kontribuojë në ri-traumatizim.⁹² Çështje të tilla vazhduan në vitin 2020. Ndoshta këto çështje mund të japin arsye pse disa raste u raportuan në IML por jo në polici; familjet nuk donin ose nuk lejonin drejtësinë, veçanërisht në rastet që përfshijnë të mitur. Sidoqoftë, në mbrojtjen e të drejtave të grave dhe vajzave, institucionet duhet të procedojnë me ndjekjen penale të krimeve të tilla sipas detyrës zyrtare. Në të vërtetë, përfaqësuesit e IML-së shprehën nevojën për bashkëpunim të përmirësuar me policinë dhe gjykatat.

Kosova ende nuk ka një qendër urgjente për rastet e dhunës seksuale ose qendër të krizës së përdhunimit të specializuar në një trajtim të tillë siç parashikohet nga KS. Shërbimet e emergjencës gjithashtu duhet të sigurojnë qasje në profilaksinë pas ekspozimit (një ilaç urgjence për të parandaluar HIV pas ekspozimit). Gjatë krijimit të një qendre të tillë, ekzistojnë mundësitë që Kosova të bazohet në shembujt në rajon. Për shembull, Liliun - Qendra e Menaxhimit të Krizës për Rastet e Dhunës Seksuale, e krijuar kohët e fundit në Tiranë, Shqipëri, ofron shërbime të integruara emergjente për viktimat.⁹³ Ajo ofron shërbime falas të kujdesit shëndetësor urgjent, kujdes psikologjik dhe këshillim,

⁸⁹ Për shembull, në vitin 2017, 2% të rasteve ishin fëmijë të moshave 0-10 vjeç; 59% ishin të moshave 11-16; 13% ishin të moshave 17-20 vjeç; 16% ishin të moshave 21 - 30; dhe 10% ishin të moshave 30+ (Intervistë e RrGK-së, 2020).

⁹⁰ IML, Broshura, *Ma thuaj me kohë, dhuna seksuale është krim*.

⁹¹ Komenti mbi raportin, 2020.

⁹² Broshura e IML.

⁹³ Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, “*Liliun Qendra e Menaxhimit të Krizës për Rastet e Dhunës Seksuale*”, Shqipëri. UNDP, UNW dhe UNFPA në mbështetjen e krijimit të saj bazuar në praktikat më të mira ndërkombëtare, me mbështetjen e Agjencisë Suedeze të Zhvillimit Ndërkombëtar.

kontrolle mjeko-ligjore për të mbledhur prova për procedurat e drejtësisë penale dhe shërbime referimi në institucione të tjera, duke përfshirë strehimoret. Të gjitha shërbimet ofrohen në një vend nga profesionistë të specializuar në trajtimin e dhunës seksuale. Për më tepër, e gjithë qendra financohet nga qeveria.

Konkluzion

IML ka përmirësuar njohuritë dhe kapacitetet e veta në mënyrën e trajtimit të rasteve të dhunës me bazë gjinore që nga viti 2017. Për më tepër, IML ka bërë përpjekje për të informuar njerëzit, veçanërisht të miturit, për rëndësinë e raportimit të krimeve në kohën e duhur, të tilla si përdhunimi dhe sulmet seksuale. Sidoqoftë, stigmatizimi dhe presioni shoqëror, përfshirë anëtarët e familjes, mund të parandalojnë gratë dhe vajzat të paraqiten ose të kërkojnë drejtësi. Bashkëpunimi i pamjaftueshëm ndërmjet PK-së, IFM-së dhe prokurorisë me sa duket pengon referimin në kohë të rasteve të dhunës seksuale në mënyrë që të ruhen provat biologjike. Kosova ende nuk ka një qendër referimi të dhunës seksuale ose një qendër krize të përdhunimit të specializuar në një trajtim të tillë siç parashikohet nga KS.

PROKURORIA

Prokuroria e Shtetit shqyrton provat dhe vendos nëse do të procedohet me ndjekje penale; siguron mbledhjen korrekte të provave; mbikëqyr NJHDHF-të; dhe fillon procedura të caktuara penale sipas detyrës zyrtare, përfshirë shkeljet e urdhrave të mbrojtjes. Për të ndjekur me sukses një rast, prokurori duhet të informohet nga PK. Pas një vlerësimi, prokurori i shtetit mund të ndjekë ose refuzojë një rast.

Në një rast të përshkruar për RrGK-në në lidhje me përdhunimin martesor, prokurorja deklaroi se ishte e vështirë të gjendeshin prova sepse viktimi refuzoi të kontrollohej. Ata u desh ta mbyllnin rastin për shkak të mungesës së provave. Në përgjithësi, ajo tha se është e vështirë të marrësh prova për këto raste sepse ato duhet të jenë “të freskëta”. Kjo sugjeron njohuri të pamjaftueshme të udhëzimeve të KS që provat fizike nuk janë gjithmonë të nevojshme.

Sipas KPK, prokurori zgjedh veprat përkatëse me të cilat do të akuzojë një kryes të veprës. Prokurorët duhet të marrin pjesë në trajnim mbi dhunën në familje, dhe ata duhet t’i japin prioritet këtyre rasteve.⁹⁴

Për këtë raport, RrGK intervistoi shtatë prokurorë. Ata prireshin të dinin përgjegjësitë e tyre,⁹⁵ si dhe forma të ndryshme të dhunës me bazë gjinore në KPK, përveç gjymtimit gjenital të femrave. Prokurorët gjithashtu kishin prirje të ngatërronin sulmin seksual me ngacmimin seksual. Në përgjithësi, ata kishin përvojë jashtëzakonisht të kufizuar me rastet e dhunës seksuale.⁹⁶ Prokurorët treguan se ata, dhe institucionet e tjera, janë më të vetëdijshëm për dhunën me bazë gjinore sesa në vitin 2017, duke pasur parasysh bashkëpunimin e zgjeruar midis institucioneve dhe prioritetin e rasteve të dhunës

⁹⁴ ABGJ, PSV, 2013, dhe MD, SKMDHF, 2017.

⁹⁵ Sidoqoftë, disa prokurorë i dinin përgjegjësitë e tyre nën PSV vetëm pasi u ishin përmendur. Kjo sugjeron që mbase ata zbatojnë përgjegjësitë e tyre pa e ditur që këto janë në PSV

⁹⁶ Vetëm një prokuror i intervistuar nga RrGK ishte marrë me një rast të tillë.

Rasti P.nr. 16/20

Monitorimi i RrGK-së i seancave gjyqësore sugjeroi që në disa raste prokurorët nuk i marrin parasysh të gjitha rrethanat përkatëse në një rast. Për shembull, në Gjykatën Themelore të Pejës, në një seancë dëgjimore më 4 mars 2020, prokurori përfshiu vetëm “dhunën në familje” dhe jo “ngacmimin” në aktakuzë, megjithëse viktimat kishin përjetuar frikësim dhe kërcënime të përsëritura nga abuzuesi i saj dhe ndihej e rrezikuar. Kjo ndikon në aktakuzë dhe mund të çojë në një dënim më të ulët për kryesin, varësisht se si është ngritur aktakuza.

në familje. Sidoqoftë, disa raportuan se kishin hasur sfida gjatë përdorimit të nenit të ri të KPK-së mbi dhunën në familje. Për shembull, mënyra e përcaktimit të “familjes” në lidhje me nenin e ri të KPK-së shkaktoi konfuzion, edhe pse KPK përcaktoi “anëtarin e familjes” dhe “marrëdhënien familjare”.

Një temë tjetër e përsëritur midis prokurorëve ishte pasiguria nëse ata duhet të përdorin veprën penale të dhunës në familje ose atë të lëndimit trupor. Një i anketuar tha se dy nenet kundërshtoheshin. Siç raportohet, në

disa raste, gjykatat kanë hedhur poshtë aktakuzat që përfshijnë edhe dhunën në familje dhe edhe vepra të tjera penale si lëndim i lehtë trupor, duke kërkuar që prokuroria t'i ri-kualifikojë këto raste. Gjykatat duket se sugjerojnë në këto raste që të dyja veprat penale të mos përmenden në një rast të caktuar. Edhe pse vepra penale e dhunës në familje mbivendoset me vepra të tjera, duke përfshirë lëndime të lehta trupore, ato nuk janë domosdoshmërisht kontradiktore. Në parim, një kryes mund të dënohet për vepra të njëkohshme,⁹⁷ por çështja e përdorimit të të dyjave në këtë kontekst mund të jetë se nuk ekzistojnë elemente të dallueshme materialisht në veprat penale në rrethanat specifike të një rasti të caktuar.⁹⁸ Kështu, zgjedhja e akuzave duhet të jetë specifike për rastin, bazuar në të cilin do të ishte më së miri të sigurohet një dënim i bazuar në fakte dhe të pasqyrohet sa e rëndë ishte ajo që ka ndodhur. Në këtë drejtim, *Manuali mbi përgjigjet efektive të prokurorisë ndaj dhunës ndaj grave dhe vajzave* i UNODC rekomandon:

Kryesi mund të ketë kryer më shumë se një vepër penale. Prokurorët duhet të marrin në konsideratë të gjitha akuzat që mund të rezultojnë nga përdorimi i frikësimit, shtrëngimit dhe dhunës së përsëritur. Duhet të kihet parasysh se për cilat vepra penale të tjera mund të ngrihet akuzë së bashku me veprën penale kryesore.⁹⁹

Në veçanti, prokurorët duhet të marrin në konsideratë nëse një akuzë duhet të shtohet për shkeljen e një urdhri mbrojtjeje ose gjykatë, nëse ka pasur shkelje paraprake kundër së njëjtës viktimë, nëse për vepër(at) penale duhet të ngritet akuzë si e rënduar, nëse ka pasur frikësim të vazhdueshëm

⁹⁷ KPK, neni 76.

⁹⁸ Gjykata e Apelit (EULEX) [aktgjykimi](#) u mor me këtë çështje në vitin 2013. U vu re se KPK në atë kohë nuk siguronte rregulla të qarta për përcaktimin e rasteve në të cilat e njëjta vepër plotëson përkufizimet e veprave të shumta. Sidoqoftë, gjykata gjeti se dënimet kumulative mund të vendosen në lidhje me veprat penale të njëkohshme nëse krimet konsiderohen mjaft të dallueshme ose posedojnë “një element materialisht të veçantë” që nuk gjendet në tjetrin. Kjo i referohej nenit 71 të Kodit të Përkohshëm Penal të Kosovës ([UNMIK/REG/2003/25](#)), por KPK aktual mban të njëjtën dispozitë (neni 76).

⁹⁹ UNODC, *Manual mbi përgjigjet efektive të prokurorisë ndaj dhunës ndaj grave dhe vajzave*, 2014, f. 82.

në mënyrë që ngacmimi të jetë i zbatueshëm, dhe çdo veprim përkatës në pengimin e drejtësisë.¹⁰⁰

Në Kosovë, vepra e dhunës në familje ka një përkufizim veçanërisht më të gjerë të dhunës fizike (“sulm fizik pavarësisht nga pasojat”¹⁰¹) sesa kërkesat e bazuara në dëm të lëndimit të lehtë trupor, dhe kjo mund të mundësojë një dënim, në varësi të natyrës së fakteve. Një akuzë për lëndim të lehtë ose të rëndë trupor ndaj një viktime të cënueshme mund të jetë e përshtatshme në varësi të ashpërsisë së veprës penale dhe/ose dëmtimit, por mund të jetë e papërshtatshme në varësi të natyrës së marrëdhënies midis viktimës dhe kryesit. Vepra e dhunës në familje llogaritet forma të tjera të dhunës (psikologjike, ekonomike ose keqtrajtimi), të cilat mund të jenë mjaftueshëm të dallueshme materialisht për të arritur në një vepër shtesë, në varësi të rastit. Trajnimi i mëtejshëm, përfshirë studimet e rasteve, të shoqëruara me udhëzime nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës, mund të mbështesin sqarimin e këtyre çështjeve.

Prokurorët kishin prirje të dinë përgjegjësitë e tyre sipas SKMDHF. SKMDHF ka parashikuar që Prokuroria e Shtetit të caktojë prokurorë të specializuar në trajtimin e rasteve të dhunës në familje. Në të vërtetë, janë caktuar prokurorë të specializuar. Sidoqoftë, të anketuarit thanë se disa komuna nuk kanë prokurorë të specializuar, gjë që e bën të vështirë koordinimin ndërmjet institucioneve. Kjo sfidë ka mbetur që nga viti 2017, kur disa komuna gjithashtu raportuan se nuk kishin prokurorë të specializuar.¹⁰² Kështu, ndërsa SKMDHF parashikoi që prokuroria do t'i jepte përparësi të gjitha rasteve të dhunës në familje si shkelje të të drejtave të njeriut (3.1.1.), kjo siç duket nuk ndodh gjithmonë në praktikë.

Sipas SKMDHF, Këshilli Prokurorial duhej të siguronte infrastrukturën e duhur në zyrat e prokurorisë për trajtimin e rasteve (3.2.4.). Dhomat speciale miqësore për intervista janë instaluar në pesë komuna, por Mitrovica dhe Gjakova ende nuk i kanë ato. Prokuroria gjithashtu duhet të sigurojë disponueshmërinë e prokurorëve që flasin gjuhën serbe, ndër gjuhët e tjera (3.2.5.). Sipas Këshillit Prokurorial, të gjitha zyrat e prokurorisë kanë prokurorë që flasin serbisht, dhe dy prokurorë në Prizren flasin turqisht, por nuk ka prokurorë që flasin gjuhën rome. SKMDHF parashikoi “1.1.3. Trajnimin dhe certifikimin e vazhdueshëm të prokurorëve të fokusuar në DHF në tema të përcaktuara mirë dhe module të miratuara”, të cilat MD i raportoi si të kryera.¹⁰³ Të gjithë të anketuarit e intervistuar gjithashtu thanë se ata ndoqën disa trajnime mbi dhunën në familje. Për më tepër, SKMDHF parashikoi që prokuroria do të mbante “ligjërata të vazhdueshme çdo vit nga gjyqtarë dhe prokurorë për ndërgjegjësimin e profesionistëve të rinj në lidhje me trajtimin e rasteve të dhunës në familje” (1.3.6.). Këshilli Prokurorial raportoi se e kryente këtë çdo vit.

Konkluzion

Prokurorët kanë prirje të jenë të informuar në lidhje me format e ndryshme të dhunës me bazë gjinore,

¹⁰⁰ Po aty.

¹⁰¹ LMDHF, neni 2.1.2.4, siç zbatohet në bazë të KPK, neni 248.3.2.

¹⁰² Berisha dhe të tjerët për RrGK, *Nga Fjalët në Vepra*, 2017.

¹⁰³ Ministria e Drejtësisë, “*Raporti i Parë i Monitorimit mbi Zbatimin e Planit të Veprimit të Strategjisë Kombëtare për Mbrojtjen nga Dhuna në Familje 2016-2020*”, 2018.

përveç gjymtimit gjenital të femrave. Disa gjithashtu ngatërruan sulmin seksual me ngacmimin seksual. Disa shprehën pasiguri në lidhje me mënyrën se si të përdorët vepra e re penale e dhunës në familje, veçanërisht në kombinim me vepra të tjera. Disa prokurorë specialë janë emëruar. Prokurorët kishin marrë pjesë në trajnimin mbi dhunën në familje siç kërkohet nga SKMDHF, dhe ata kishin prirje të dinin përgjegjësitë e tyre në SKMDHF dhe PSV-të. Përfaqësuesit e institucioneve të tjera konfirmuan se prokurorët e kryen mirë rolin e tyre. Kjo sugjeron përmirësim që nga viti 2017, kur disa prokurorëve u dukej se nuk kishin njohuri dhe profesionalizëm në adresimin e dhunës me bazë gjinore. Përvoja e tyre në trajtimin e dhunës seksuale mbetet e kufizuar, kryesisht për shkak të raportimit të ulët të këtyre krimeve.

MBROJTËSIT E VIKTIMAVE

Zyra e Avokimit dhe Ndhmës së Viktimave (ZANV) është brenda Prokurorisë së Shtetit të Kosovës. Mbrojtësit e Viktimave (MV) i takojnë viktimat, sigurohen që ata i kuptojnë shërbimet shtetërore në dispozicion, i përfaqësojnë viktimat sipas KPK dhe KPPK, aplikojnë në emër të viktimave për urdhra mbrojtjeje, marrin pjesë ose monitorojnë procedurat gjyqësore, kryejnë vlerësime të rrezikut për viktimat dhe operojnë 24 orë në linjën telefonike të ndihmës pa pagesë. Viktimat mund të telefonojnë në këtë linjë për t'u ndihmuar dhe për t'u referuar në institucione përkatëse.¹⁰⁴

RrGK intervistoi shtatë MV nga komuna të ndryshme. Në shumicën e rasteve, MV ishin në dijeni në lidhje me format e ndryshme të dhunës me bazë gjinore dhe përgjegjësitë e tyre ligjore. Sidoqoftë, ata tentuan të përdorin termat “dhunë me bazë gjinore” dhe “dhunë në familje” në mënyrë të ndërsjellë. MV-të kishin mendime të ndryshme nëse dhuna me bazë gjinore përfshinte dhunë ndaj grave apo dhunë ndaj një gjinie tjetër. Gama e pikëpamjeve të hasura sugjeron të kuptuarit e pamjaftueshëm të konceptit të dhunës me bazë gjinore, veçanërisht sipas KS.

MV-të dukeshin të vetëdijshme për ndryshimet e reja në KPK, dhe njëri vërejti se nenet e rinj e bënin punën e tyre më të lehtë, veçanërisht artikulli i ri për dhunën në familje. MV-të, sikur institucionet e tjera, ishin të prirë të kishin më shumë përvojë në asistimin e rasteve të dhunës në familje sesa në rastet e tjera të dhunës me bazë gjinore.¹⁰⁵ Për shembull, nga tetori 2019 deri në shtator 2020, MV-të mbështetën 423 raste të dhunës në familje, pesë raste të trafikimit dhe dy raste të dhunës seksuale.¹⁰⁶

MV-të kanë disa përgjegjësi në lidhje me asistimin e viktimave të dhunës në familje. Zakonisht, menjëherë pasi që dhuna në familje raportohet në polici, MV-të takohen me viktimat për t'i informuar ato për të drejtat e tyre shërbimet shtetërore në dispozicion. Gjatë këtij kontakti fillestar, MV-të duhet të ndërtojnë marrëdhënie me viktimat. MV-të luajnë rol kyç në mbrojtjen e të drejtave të viktimave gjatë procedurave penale; ata duhet të marrin pjesë në të gjitha seancat dëgjimore dhe të monitorojnë proceset gjyqësore.¹⁰⁷ Viktimat mund të refuzojnë ndihmën. Në raste të tilla, MV-të duhet të zmbra-

¹⁰⁴ ABGJ, PSV, 2013; MD, SKMDHF, 2017; Krol, dhe të tjerët, [Hartëzimi i shërbimeve mbështetëse për viktimat e dhunës ndaj grave në Kosovë](#).

¹⁰⁵ Ndërsa disa MV kishin dëgjuar për raste të tilla, vetëm dy apo tre kishin mbështetur raste të tilla, dhe ata ofruan informacion të kufizuar në lidhje me përvojat e tyre në trajtimin e rasteve të tilla.

¹⁰⁶ Republika e Kosovës, Prokuroria e Shtetit, ZMNV, Buletini, Nr. 7, 2020.

¹⁰⁷ Krol, dhe të tjerët, [Hartëzimi i shërbimeve mbështetëse për viktimat e dhunës ndaj grave në Kosovë](#), 2017.

psen por të informojnë viktimat për të drejtat e tyre për të thirrur MV-të nëse ndërrojnë mendje. Gjatë procedurave paragjyqësore, MV-të mund të kërkojnë të rishikojnë urdhrat paragjyqësorë dhe të vlerësojnë nëse këto kanë prekur të drejtat e viktimave.¹⁰⁸

Rrjeti Ballkanik i Gazetarisë Hulumtuese (BIRN) dhe monitorimi i RrGK-së i rasteve të dhunës në familje në vitin 2017 zbuluan se shumica e viktimave i referohen MV-së nga policia.¹⁰⁹ MV-të duket se i dinin dhe i kryenin detyrat e tyre në përputhje me PSV-të. Kështu, ata i referuan viktimat tek institucionet dhe shërbimet përkatëse; u folën atyre në një vend të sigurt; dhe i informuan për të drejtat e tyre. Vetëm në disa raste viktimat u informuan për të drejtën e tyre për kompensim, sidoqoftë, gjë që MV-të duhet të bëjnë në çdo rast. MV-të gjithashtu përmenden se ata u përballën me sfida për shkak të mbështetjes së pamjaftueshme nga institucionet e tjera përkatëse dhe recidivizmit të përhapur.

Të gjithë MV-të ranë dakord që një viktimë që vuan nga dhuna në familje duhet të kontaktojë policinë. Sidoqoftë, disa treguan se kur kanë fëmijë kjo mund ta bëjë më të vështirë procesin e ndarjes. Ata ia atribuuan këtë faktit se viktimat e dhunës në familje zakonisht varen ekonomikisht nga abuzuesit e tyre dhe nuk do të ishin në gjendje të mbanin fëmijët e tyre vetë. Kryesit e veprave penale mund të përpiqen të marrin kujdestarinë e plotë të fëmijëve, të manipulojnë viktimën për të qëndruar ose t'i ndëshkojnë ato për largim. Kjo sugjeron njohuri të pamjaftueshme të përgjegjësisë së institucioneve për të mbrojtur viktimat dhe personat dhe të varurit e tyre nga kryesit e krimeve, siç parashikohet nga KS. Përderisa Kosova ka mjete juridike në dispozicion, përfshirë kujdestarinë e fëmijëve, si dhe pagesën e qirasë dhe alimentacionit nga kryesit e veprës, këto masa përdoren fare pak. MV-të janë të pozicionuar mirë për të këshilluar më mirë viktimat për të kërkuar masa të tilla brenda urdhrave të mbrojtjes dhe procedurave gjyqësore civile.

Në përgjithësi, MV-të kanë vërejtur se ndërgjegjësimi dhe performanca e tyre ishte përmirësuar që nga viti 2017, ashtu si edhe ajo e institucioneve të tjera. Ata kishin prirje të deklaronin se kishin bashkëpunim të mirë me institucionet e tjera. Ndërkohë, disa të anketuar nga institucionet e tjera treguan se MV-të nuk i vizitojnë rastet aq shumë sa më parë. Në të kaluarën, një MV zakonisht ishte i pranishëm kur një viktimë për herë të parë jepte një deklaratë në stacionin e policisë. Tani, MV-të kanë tendencë të mos jenë të pranishëm për deklaratat të tilla për shkak të mungesës së burimeve njerëzore, thanë të anketuarit. Si rezultat, viktimat duhet të japin deklaratat e tyre dy herë, gjë që mund të kontribuojnë në ri-traumatizim. . Për më tepër, MV jo gjithmonë ndihmojnë viktimat në paraqitjen e kërkesave për kompensim.¹¹⁰

Monitoruesit e gjykatave nga RrGK gjithashtu vunë re mungesën e MV-ve në seancat gjyqësore. Në disa raste, gjykata nuk ftoi MV-të në seancë.¹¹¹ Në të tjera raste, MV-të ishin të ftuar por nuk morën pjesë.¹¹² Një mospjesëmarrje e tillë mund të minojë përfaqësimin e duhur të viktimës dhe të pengojë monitorimin e duhur të gjykimit në emër të viktimës. Zgjerimi i përgjegjësisë të MV-ve për të përfshirë

¹⁰⁸ ABGJ, *Procedurat Standarde të Veprimit për mbrojtjen nga dhuna në familje në Kosovë*, 2013.

¹⁰⁹ Berisha dhe të tjerët për RrGK, *Nga Fjalët në Vepra*, 2017.

¹¹⁰ Koment mbi draft raportin, 2021.

¹¹¹ Për shembuj, ju lutemi shikoni pjesën për "Gjykatat Themelore".

¹¹² Për shembull, në një seancë dëgjimore për një urdhër mbrojtje të mbajtur në qershor 2020 në Gjykatën Themelore të Prishtinës, MV nuk mori pjesë, megjithëse i ftuar nga Gjykata (numri i rastit 788/2020).

mbështetjen për viktimat e shtuara, pa ndarë fonde shtesë për punësimin dhe trajnimin e më shumë burimeve njerëzore, i ka mbingarkuar burimet e tyre njerëzore dhe ka penguar përgjigjen e tyre në kohë dhe me cilësi. Siç vëzhgoi Instituti Kosovar për Kërkime dhe Zhvillime të Politikave (KIPRED) në vitin 2018:

Mbrojtësit e viktimave përballen me probleme të ndryshme përfshirë mbingarkesën, personelin e pamjaftueshëm dhe mungesën e buxhetit. Tani ekzistojnë vetëm 23 avokatë të viktimave që mbulojnë 38 komuna dhe shtatë rajone. Për shembull, në rajonin e Mitrovicës ka vetëm tre avokatë të viktimave që mbulojnë 7 komuna.¹¹³ [sic]

Gjatë vëzhgimit të progresit të përgjithshëm, MV-të gjithashtu i atribuon mungesën e personelit mangësive në zbatimin e SKMDHF-së. SKMDHF ka parashikuar trajnim dhe certifikim të vazhdueshëm të MV-ve, të fokusuar në dhunën në familje dhe përdorimin e moduleve të miratuara (1.1.5.). Sipas ZMNV, MV-të janë trajnuar vazhdimisht mbi dhunën me bazë gjinore dhe dhunën në familje, por kjo nuk përfshinte module të aprovuara dhe certifikim, siç parashikohet nga SKMDHF.¹¹⁴ Monitorimi i RrGK-së sugjeroi që gjysma e MV-ve kishin marrë pjesë në trajnim mbi dhunën në familje dhe gjysma nuk kishte marrë pjesë. Në ndërkohë, të gjithë përveç njërit kishin marrë pjesë në trajnim për ngacmimin seksual dhe identifikimin e abuzimit seksual midis partnerëve. Për më tepër, SKMDHF ka planifikuar rritjen e numrit të MV-ve që flasin serbisht, ndër gjuhët e tjera të pakicave, si dhe krijimin e zyrave të MV-ve aty ku nuk ekzistojnë, të tilla si në veri të Kosovës (2.3.2.). Kjo u zbatua pjesërisht pasi dy MV të rinj flasin serbisht dhe turqisht. Asnjë zyrë e re nuk u krijua, dhe ZMNV vërejti që meqenëse 15 MV flasin serbisht, përfshirë një të vendosur në Mitrovicën e Veriut, nuk ka nevojë për zyra të reja.¹¹⁵ . Sipas KS dhe SKMDHF, MV-të nuk e kanë rritur numrin e personelit që ofron shërbime të linjës së ndihmës në gjuhët serbe dhe turke por jo rome (2.3.3.), dhe ata vunë në dispozicion linjën telefonike të ndihmës në veri.¹¹⁶

Ndërsa linja e ndihmës për MV u mundëson viktimave të raportojnë krimet në mënyrë konfidenciale, si dhe të marrin informacion në lidhje me të drejtat e tyre dhe shërbimet ekzistuese,¹¹⁷ nuk i përmbush plotësisht standardet e KS. Një linjë ndihme duhet të përdoret posaçërisht për format e dhunës me bazë gjinore të mbuluara nga KS; linja e ndihmës së MV ofron mbështetje në lidhje me krime të ndryshme, dhe jo vetëm ato që përfshijnë dhunë të bazuar në gjini.¹¹⁸ Për më tepër, Kosova nuk ka ndonjë linjë ndihme e cila ofron këshillime për krizat.¹¹⁹

¹¹³ Qosaj-Mustafa, A. dhe Morina, D. për KIPRED, *Kompensimi i viktimave të krimit: Qasja ndaj rasteve të dhunës në familje dhe trafikimit me qenie njerëzore në Kosovë*, 2018.

¹¹⁴ Koment mbi draft raportin, 2021.

¹¹⁵ Ibidem.

¹¹⁶ Ibid.

¹¹⁷ Faqja e internetit e Prokurorit të Shtetit mbi linjën e ndihmës të MV.

¹¹⁸ Neni 24.

¹¹⁹ "Raport shpjegues i Konventës i Këshillit të Evropës mbi parandalimin dhe luftimin e dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje", Stamboll, 11.V.2011, paragrafi 136.

Konkluzion

MV-të kishin prirje të përdornin termat “dhunë me bazë gjinore” dhe “dhunë në familje” në mënyrë të ndërsjellë. Ndërsa zakonisht këshillojnë gratë të raportojnë dhunën në polici, disa MV mund t’i këshillojnë gratë të qëndrojnë me kryesit e krimit nëse kanë fëmijë, gjë që mund t’i vendosë gratë dhe fëmijët në rrezik. MV-të nuk janë gjithmonë të pranishëm në stacionet e policisë kur viktimat raportojnë dhunë dhe shpesh mungojnë në seancat gjyqësore, për shkak të burimeve të pamjaftueshme njerëzore. Ata gjithashtu nuk i ndihmojnë gjithmonë viktimat në paraqitjen e kërkesave për kompensim. Përndryshe, MV-të kanë prirje të zbatojnë detyrat e tyre sipas PSV-ve. Në lidhje me SKMDHF, disponueshmëria e shërbimeve të ndryshme gjuhësore mund të përmirësohet më tej dhe shërbimet e linjës së ndihmës të zgjerohen për të siguruar këshillim profesional psikologjik sipas KS.

ZYRAT PËR NDIHMË JURIDIKE FALAS

Ligji i Kosovës për Ndhimë Juridike Falas ka përfshirë viktimat e dhunës në familje në listën e personave që kanë të drejtë të kërkojnë ndihmë juridike falas që nga viti 2012.¹²⁰ Zyrtarët e Ndhimës Juridike (znl) kanë mandat për të siguruar shërbime juridike falas për anëtarët e cënueshëm të shoqërisë. ZNJ-të informojnë dhe këshillojnë viktimat e të gjitha formave të dhunës me bazë gjinore, përfshirë viktimat e dhunës në familje, për të drejtat e tyre ligjore; angazhohen në procedura ligjore; përpilojnë memorandume dhe dokumente ligjore; përfaqësojnë ato në procedurat penale, civile, administrative dhe për kundërvajtje në gjykata; dhe koordinojnë me institucionet e tjera.¹²¹ ZNJ-të mbështesin viktimat në procedurat e kujdestarisë së fëmijëve, shkurorëzim, alimentacion dhe çështje të tjera që mund të paraqiten pasi të ketë përfunduar një padi penale.¹²²

Një sfidë e vazhdueshme për ZNJ-të ka qenë financimi; tetë zyra u desh të mbyllen në vitin 2015, duke lënë vetëm pesë funksionale.¹²³ Që nga viti 2020, shtatë rajone kishin Zyra të Ndhimës Juridike, me një përmirësim të dukshëm (Prishtina, Prizreni, Peja, Mitrovica, Gjiçani, Ferizaj dhe Gjakova).¹²⁴ Ndërkohë, dy deri në tri ditë në javë ZNJ gjithashtu vizitoi komunat e Fushë Kosovës, Drenasit, Istogut, Deçanit, Dragashit, Suharekës, Mitrovicës së Veriut, Skenderajt, Malishevës, Graçanicës dhe Kamenicës. Qasja e dobët e ZNJ-ve në transportin e besueshëm gjithashtu thuhet se pengoi punën e tyre, veçanërisht udhëtimet për të vizituar viktimat në zonat rurale. Disa ZNJ kanë filluar të ofrojnë seanca këshillimi në internet, të cilat mund të ndihmojnë për të adresuar këtë sfidë.

Në vitin 2020, RrGK intervistoi gjashtë ZNJ. Ata demonstuan ca njohuri rreth dhunës me bazë gjinore, por njohuri të kufizuara rreth dhunës ekonomike. Shumica dinin për veprën penale të dhunës në familje, por ata nuk kishin parë ndonjë rast të proceduar me nenin e ri të KPK. ZNJ-të ishin të prirë të mos kishin njohuri për SKMDHF, dhe gjysma nuk kishin dëgjuar fare për të. Të anketuarit treguan se ndërgjegjësimi në institucionin e tyre ka mbetur i njëjtë me kalimin e kohës. Disa pranuan

¹²⁰ Neni 31.

¹²¹ ABGJ, PSV, 2013

¹²² Po aty.

¹²³ Farnsworth dhe të tjerët për RrGK, *Mjaft më me arsye*, 2015.

¹²⁴ Republika e Kosovës, “*Agjencia e Ndhimës Juridike Falas*”, 2020.

se kolegët e tyre ende e shohin dhunën në familje si diçka të pashmangshme në shoqëri, madje edhe si diçka “qesharake”. Një i anketuar përmendi se “[Kolegu] që ishte me ne në zyrë ndonjëherë thotë që të godasësh me shpullë në fytyrë një grua është normale dhe nuk duhet të raportohet”.¹²⁵ ZNJ-të gjithashtu shprehën shqetësimin se si të trajtojnë natyrën e ndjeshme të rasteve dhe të kenë qasjen e duhur me të mbijetuarit. Ata gjithashtu deklaruan se gratë nuk kanë pronë ose pasuri dhe duhet të qëndrojnë me kryesin e veprës. Kjo sugjeron që ZNJ-të mund të mos i këshillojnë viktimat për të gjitha masat e mundshme në dispozicion të tyre. Të gjitha këto deklarata tregojnë një nevojë për trajnim të mëtijshëm. Në të vërtetë, gjysma e të anketuarve thanë se nuk kishin marrë ndonjë trajnim mbi dhunën në familje deri më tani.

Për më tepër, SKMDHF parashikoi që MD do të rrisë “shërbimet e ndihmës juridike falas të ofruara për viktimat e dhunës në familje” (2.3.1.). Sipas LAO, që nga korriku 2018, ata hapën 14 zyra mobile; përveç shtatë zyrave të lartpërmendura. MV-të luajnë një rol të rëndësishëm në informimin e viktimave për të drejtën e tyre për ndihmë juridike falas kur ata nuk janë në gjendje të paguajnë për këshilla ligjore dhe përfaqësim. Mund të ekzistojë një konfuzion sa i përket dallimit ndërmjet roleve të MV dhe ZNJ ; ndonëse MV këshillojnë dhe mbështesin viktimat menjëherë, ata mund t’i referojnë ato tek ZNJ për mbështetje të mëtijshme, afatgjate, në rastet, përfshirë edhe ato që lidhen me divorcin, kujdestarinë ndaj fëmijëve dhe çështjet e tjera. Pra, bashkëpunimi mes ZNJ dhe MV është i rëndësishëm për të siguruar që viktimat kuptojnë dhe dinë plotësisht për shërbimet që i kanë në dispozicion dhe të drejtën e tyre për të pasur qasje në këshilla ligjore dhe përfaqësim kur është e nevojshme. ZNJ-të gjithashtu kanë një linjë telefonike për ndihmë falas, e cila mund të kontaktohet drejtpërdrejt nga viktimat. Megjithatë, kjo linjë e ndihmës nuk është në përputhje me standardet e rekomanduara të KS pasi nuk ofron mbështetje të specializuar që lidhet vetëm me dhunën me bazë gjinore e as ZNJ nuk duken të trajnuar në mënyrë adekuate për të siguruar një mbështetje të tillë. Posedimi i dy linjave telefonike për ndihmë dhe linja e ndihmës MV duket më e përshtatshme për qëllimin e paraparë në KS, natyrisht nëse adresohen çështjet e lartpërmendura. Gjatë reklamimit të linjës së ndihmës ZNJ do të ishte i rëndësishëm qartësimi e qëllimit të saj si i ndryshëm nga linja telefonike e ndihmës për rastet e dhunës me bazë gjinore.

Konkluzion

ZNJ-të kishin ca njohuri rreth formave të caktuara të dhunës me bazë gjinore, por nuk e kuptonin dhunën ekonomike. Duket se ata nuk kishin dijeni të mjaftueshme të masave të ndryshme në dispozicion për të mbështetur ekonomikisht viktimat, që mund të nënkuptojë se ata mund të mos u sigurojnë viktimave informacion, referim dhe ndihmë gjithëpërfshirëse. Në përgjithësi, ZNJ-të nuk kishin trajnim të mjaftueshëm për dhunën në familje dhe format e tjera të dhunës me bazë gjinore. Infrastruktura e dobët do të thoshte që ZNJ-të nuk mund të vizitonin gjithmonë viktimat në zonat rurale, por kjo është përmirësuar, dhe ata ndonjëherë ofronin këshilla në internet. Qartësimi i rolit të MV dhe ZNJ për viktimat është i rëndësishëm për t’u siguruar që ata i kuptojnë qartë shërbimet që janë në dispozicionin

¹²⁵ Intervistë e RrGK me një zyrtar të ndihmës juridike.

e tyre nga secili akter.

GJYKATAT

Kosova ka shtatë gjykata themelore që trajtojnë rastet penale dhe civile. Gjykatat themelore duhet të sigurojnë trajtimin e duhur procedural të të gjitha palëve në procedurat ligjore.¹²⁶ Gjykatat duhet t'i trajtojnë çështjet me paanësi, duke mbështetur të drejtat dhe interesat e të dy palëve. KGJK ka emëruar gjyqtarë të specializuar dhe përgjegjës për dhënien e prioritetit rasteve të dhunës në familje në procedura penale dhe civile, përfshirë përshpejtimin e lëshimit të urdhrave të mbrojtjes.¹²⁷ Në rastet e dhunës në familje, të dy procedurat civile dhe penale mund të parashtrohen njëkohësisht.

Kjo pjesë analizon njohuritë, qëndrimet dhe performancën e gjykatave sipas kornizës ligjore dhe drejt zbatimit të KS.¹²⁸ Së pari shqyrton njohuritë dhe qëndrimet e tyre të përgjithshme në lidhje me dhunën me bazë gjinore, pasuar nga zbatimi i gjyqësorit së përgjegjësive ligjore në lidhje me SKMDHF. Nën-pjesët përkatëse diskutojnë më pas gjykatat penale dhe gjykatat civile, duke pasur parasysh mandatet e tyre të ndryshme.

Njohuritë, Qëndrimet dhe Zbatimi i SKMDHF

Gjyqtarët e intervistuar kishin prirje të dinin për veprat e reja penale në lidhje me dhunën me bazë gjinore në KPK, por jo të gjithë gjyqtarët i kuptuan saktësisht përkufizimet e tyre. Për shembull, degradimi i integritetit seksual nuk kuptohej gjithmonë si duhet; një gjyqtar e përcaktoi atë si përdhunim, duke deklaruar se është “një formë e dhunës seksuale, ku qëllimi është të arrihet kënaqësi”.¹²⁹ Një gjyqtar tjetër me sa duket e konsideroi gjymtimin gjenital të femrave vetëm brenda kontekstit të dhunës në familje ose dhunës familjare të ngatërruar me dhunën me bazë gjinore, duke deklaruar: “Ky është një dëmtim trupor shumë i rëndë ... dhuna në familje ka të gjitha llojet e elementeve”.¹³⁰ Deklarata të tilla sugjerojnë një nevojë për trajnime të mëtejshme, të detyrueshme mbi dhunën me bazë gjinore.

Gjatë përkufizimit të dhunës me bazë gjinore, gjyqtarët e intervistuar përmendën në mënyrë të përsëritur dhunën fizike, psikologjike dhe ekonomike, por pak përmendën dhunën seksuale. Në të vërtetë, vetëm tre nga 17 gjyqtarët e intervistuar e dinin se ngacmimi seksual tani është një vepër kriminale, sipas KPK. Njëri nga këta tre gjyqtarë përcaktoi ngacmimin seksual si:

Kur njëra palë shikon ose prek [një palë tjetër] dhe duke bërë këtë dëmton integritetin e palës tjetër, është ngacmim. Unë madje nuk merrem me këtë [në jetën time personale]. Kryesisht janë [gratë] ato që duhet të jenë të kujdesshme.¹³¹

¹²⁶ Ligji Nr. 06/L-054 për [Gjykatat](#).

¹²⁷ Krol, dhe të tjerët, [Hartëzimi i shërbimeve mbështetëse për viktimat e dhunës ndaj grave në Kosovë](#); MD, SKMDHF, 2017.

¹²⁸ Kjo pjesë bazohet në literaturën ekzistuese, monitorimin gjyqësor dhe intervistat e RrGK-së me 17 të anketuar nga gjykatat themelore (tetë gjyqtarë penalë dhe nëntë gjyqtarë civilë); dy gjyqtarë nga Gjykata e Apelit; dy gjyqtarë nga Gjykata Supreme; përkatësisht nga një i anketuar nga Gjykata Kushtetuese dhe KGJK-ja, respektivisht; dhe reflektime nga institucionet e tjera.

¹²⁹ Intervistë e RrGK-së me një gjyqtar të gjykatës civile, 2020.

¹³⁰ Intervistë e RrGK-së me një gjyqtar, 2020.

¹³¹ Intervistë e RrGK-së me një gjyqtar, 2020.

Kjo deklaratë pranon natyrën gjinore të ngacmimit seksual, në atë që gratë mund të preken në mënyrë disproporcionale nga vepra penale. Sidoqoftë, duke vepruar kështu, kjo tregon një përqendrim të papërshtatshëm në sjelljen e viktimave, sesa në denoncimin adekuat të kryerjes së krimeve të tilla.

Lidhur me gjyktimin gjinital të femrave, disa gjyqtarë nuk e konsideruan veprën penale një formë të dhunës me bazë gjinore dhe u mungonte njohuria për të. Një gjyqtar përmendi:

Unë thjesht nuk e di se sa [bëhet gjyktimi gjinital i femrave] në shoqërinë tonë. Unë nuk di ndonjë rast, prandaj mendoj se [përfshirja] e tij në kodin e ri penal është e panevojshme. Më duket se [gjyktimi gjinital i femrave] karakterizon shoqëritë primitive. Ne [në Kosovë] nuk jemi kafshë. Nuk e di pse u përfshi.¹³²

Kjo ilustron një trend të përsëritur në mendimin se përfshirja e gjyktimit gjinital të femrave si krim në KPK ishte e panevojshme sepse perceptohet se nuk ekziston në Kosovë. Kjo deklaratë, si të tjera, tregon se gjyktimi i organeve gjinitale të grave mund të shihet më shumë si fenomen kulturor sesa si shkelje e të drejtave të njeriut, e cila mund të ndikojë në trajtimin adekuat të shkeljes nëse paraqiten raste.

Sikur institucionet tjera, gjyqtarët kishin më shumë njohuri dhe përvojë me dhunën në familje sesa me format e tjera të dhunës me bazë gjinore. Gjyqtarët e intervistuar kishin prirje ta konceptonin dhunën e bazuar në gjini si dhunë në familje, siç përcaktohet në KPK. Pak e kuptuan atë më gjerë për të përfshirë forma të tjera të dhunës me bazë gjinore, marrëdhënie gjinore midis grave dhe burrave, ose që lidhen me efektin disproporcional të kësaj dhune mbi gratë.

Kur u pyeten se çfarë duhet të bëjë një viktimë nëse përjeton dhunë në familje, një gjyqtar sugjeroi që viktima duhet të përpiqet të arrijë një mirëkuptim, duke thënë, “kur [dy palët] kanë një fëmijë së bashku, ata gjithashtu kanë një detyrim ndaj tij [fëmijës], jo vetëm për veten e tyre. Sidomos kur [fëmijët] janë të mitur, ata kanë një detyrim shoqëror.”¹³³ I njëjti mendim u përsërit nga gjyqtarët e tjerë. Kjo nënvizon gjetjet që gjyqtarët mund të inkurajojnë çiftet të pajtohen, duke i dhënë përparësi kësaj mbi sigurinë e viktimës, siç detajohet në një nën-pjesë të mëvonshme.

Disa gjyqtarë kishin vështirësi se si të trajtonin dhunën psikologjike. Për shembull, një gjyqtar tha se ka komplikime për të dëshmuar dhunën psikologjike, për shkak të natyrës së saj të vazhdueshme. Ai tha se “ekziston mundësia që femrat vazhdimisht të shkaktojnë dhunë psikologjike ndaj meshkujve dhe në një moment të caktuar kur burri përgjigjet, ai përgjigjet fizikisht dhe jo psikologjikisht”.¹³⁴ Kjo sugjeron që pikëpamjet patriarkale të dhunës vazhdojnë.

¹³² Intervistë e RrGK-së me një gjyqtar, 2020.

¹³³ Intervistë e RrGK-së me një gjyqtar të gjykatës penale, 2020.

¹³⁴ Intervistë e RrGK-së me një gjyqtar të gjykatës civile, 2020.

Normat mashkullore gjinore, të cilat diktojnë që burrat të jenë “të fuqishëm, të vetë-mbështetur dhe të kontrolluar emocionalisht” mund të veprojnë si pengesë për burrat që të raportojnë dhunë psikologjike, si dhe forma të tjera të dhunës në familje.¹³⁵ Kjo mund të nënkuptojë që dhuna psikologjike ndaj burrave është më pak e raportuar. Hulumtimet kanë mbështetur nocionin se burrat që kanë ideologji “që lidhen me maskulinitetin tradicional kanë qëndrime më negative ndaj kërkimit të ndihmës”.¹³⁶ Megjithatë, kjo nuk arsyeton përgjigjen me dhunë fizike dhe sigurisht nuk duhet të konsiderohet nga gjykata si faktor për të ulur dënimin. GREVIO ka rekomanduar shprehimisht që “shqetësimi psikiatrik i shkaktuar nga provokimi ose veprimet e padrejta të viktimës ose ndonjë personi tjetër nuk duhet të konsiderohen si rrethana lehtësuese në rastet e dhunës me bazë gjinore ndaj grave”.¹³⁷

Lidhur me PSV-të dhe SKMDHF-në, gjyqtarëve nëpër gjykata të ndryshme u mungonte njohuria, gjë që mund të pengonte zbatimin. As ata nuk e dinin shkallën në të cilën ishin zbatuar përgjegjësitë e sistemit të drejtësisë. SKMDHF parashikoi “trajnim dhe certifikim të vazhdueshëm të gjyqtarëve të fokusuar në DHF, në tema të përcaktuara mirë dhe module të miratuara” (I.1.4.). Sipas Akademisë së Drejtësisë, trajnimi ishte ad-hoc dhe ofrohej vetëm nëse gjyqtarët e kërkonin atë. Monitorimi i RrGK konfirmoi që kjo ishte zbatuar vetëm pjesërisht. Një trend i përsëritur midis gjyqtarëve të intervistuar ishte se ata nuk mund të merrnin pjesë në trajnim jo të detyrueshëm për shkak të ngarkesës së tyre të madhe me raste.

SKMDHF parashikoi që gjykatat do t’i jepnin prioritet rasteve të dhunës në familje si shkelje të të drejtave të njeriut (3.1.1.). Ishte temë e përsëritur midis gjyqtarëve të intervistuar në gjykata të ndryshme se gjyqësori është më i vetëdijshëm tani sesa në vitin 2017 që rastet e dhunës në familje duhet të trajtohen me seriozitet dhe si prioritet. Monitorimi i RrGK-së sugjeroi që kjo ndodhte ndonjëherë por jo gjithmonë, siç detajohet më vonë në këtë pjesë. SKMDHF gjithashtu bëri thirrje për “shmangien e fragmentimit të procedurave penale dhe civile gjatë trajtimit të rasteve [të dhunës në familje] me prioritet nga prokuroria dhe gjykata” duke unifikuar procedurat për të siguruar që “urdhërimi i një urdhri mbrojtje në procedimin civil të bëhet pjesë e dosjes së prokurorisë për ndjekje penale” (3.1.4.). Gjyqtarët deklaruan se kjo ka ndodhur në praktikë.¹³⁸ RrGK nuk gjeti prova se gjyqësori po “zbaton në mënyrë efikase deklaratën për dëm (që synon materializimin e kompensimit nga i akuzuari në procedimin penal)” (3.1.5.). Përkundrazi, gjyqtarët tentuan të deklarojnë se viktimat “nuk duan” kompensim. Gjyqësori gjithashtu duhej të siguronte disponueshmërinë e gjyqtarëve që flasin gjuhën serbe, ndër të tjera (3.2.6.). Të gjitha gjykatat e kanë këtë në dispozicion ose përkthyes, edhe pse gjuha turke dhe rome mund të jenë të kufizuara. Përfundimisht, sipas SKMDHF, MD duhet të hartonte një Udhëzim Administrativ ose Vendim të Kryeministrit “për subvencionimin e bizneseve për viktimat e DhF” (4.3.3.), Por kjo nuk duket se ekziston.

¹³⁵ Bates, A., “No One Would Ever Believe Me: An Exploration of the Impact of Intimate Partner Violence Victimization on Men” (*Askush nuk do të më besonte kurrë: Një hulumtim i ndikimit të viktimizimit të dhunës së partnerit intim te burrat*), *Psychology of Men & Masculinities* (Psikologjia e burrave dhe maskuliniteteve), 2020, 21 (4), 497.

¹³⁶ Po aty. Shih gjithashtu Bates, E. Dhe të tjerët, *What about the Male Victims? Exploring the Impact of Gender Stereotyping on Implicit Attitudes and Behavioral Intentions Associated with Intimate Partner Violence* (Po në lidhje me viktimat meshkuj? Eksplorimi i ndikimit të stereotipave gjinore në qëndrimet implicite dhe qëllimet e sjelljes të shoqëruara me dhunën e partnerit intim) [2018] 81 *Rolet e Seksit* 1.

¹³⁷ GREVIO *Raporti i Vlerësimit Bazë - Shqipëri*, 2017, f. 51.

¹³⁸ Ish- KNDHF vërtetoi se kjo ka përfunduar (intervista e RrGGK, 2021).

Rastet Penale

Gjykatat penale përcaktojnë dënimet për kryesit e krimeve që përfshijnë dhunë me bazë gjinore. Kjo përfshin dënime për kryesit e dhunës në familje, si dhe personat që shkelin urdhrat e mbrojtjes. Megjithëse rreth 10,000 gra përjetuan përdhunim gjatë luftës në Kosovë, deri më sot shumë pak ka pasur dënime.¹³⁹ Gjykata Penale Ndërkombëtare për ish-Jugosllavinë (GjPNJ) dënoi dy individë për persekutim përmes dhunës seksuale në Kosovë.¹⁴⁰ Sipas Amnesty International në vitin 2017, brenda gjykatave të Kosovës “vetëm tri ndjekje penale për përdhunim në kohë lufte kanë përfunduar; secila rezultoi me lirim pas apelimit, pasi gjykatat gjetën se nuk kishte prova të mjaftueshme për të identifikuar kryesin e pretenduar”.¹⁴¹ As Misioni i Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK) dhe as EULEX-i nuk bënë përparim për këtë çështje kur i udhëhoqën institucionet gjyqësore të Kosovës.¹⁴² Qeveria e Kosovës ka ndërmarrë disa hapa për të bërë ndjekjen penale dhe gjykimin e këtyre rasteve. Mungesa e drejtësisë për përdhunimet në kohën e luftës demotivon më tej të mbijetuarit nga kërkimi i drejtësisë. Në përgjithësi, gjykatat kishin përvojë të kufizuar në rastet që përfshijnë dhunë me bazë gjinore, përveç rasteve të dhunës në familje.

Sipas KPPK-së, një gjyqtar i caktuar i procedurës duhet të “caktojë një seancë fillestare që do të mbahet brenda tridhjetë (30) ditësh nga ngritja e aktakuzës”.¹⁴³ Sidoqoftë, monitoruesit e gjykatës nga RrGK hasën në mënyrë të përsëritur vonesa në trajtimin e rasteve të dhunës me bazë gjinore. Sipas një monitoruesi të gjykatës:

Në Gjykatën Themelore, Departamenti për Krime të Rënda, në Prishtinë, një i pandehur u dënua më 9 shtator 2019 për një krim të përdhunimit të dhunshëm të kryer më 19 dhjetor 2001. Viktima kishte kryer vetëvrasje pak më vonë, në janar 2002. I pandehuri u dënua me katër vjet burg dhe një gjobë prej 500 €.

Monitoruesit e gjykatës gjithashtu raportuan vëzhgimin e rasteve të trafikimit dhe dhunës seksuale që datojnë nga viti 2001 ose 2008 që filluan gjykimin në vitin 2020.

Megjithëse gjyqtarët gjatë intervistave treguan se sistemi gjyqësor tani u jep përparësi rasteve të dhunës në familje, vonesat gjithashtu vazhduan me këto raste. IAP gjithashtu vërejti vonesa në procedurat gjyqësore në lidhje me dhunën në familje.¹⁴⁴ Për shembull, në Gjykatën Themelore të Ferizaj, Prokuroria ngriti një rast kundër një burri për pretendimin e kryerjes së dhunës në familje ndaj gruas

¹³⁹ Për detaje të mëtejshme në lidhje me numrin e grave, shih Farnsworth, N. për RrGK, [Hulumtim kërkimor mbi nivelin e Dhunës në Baza Gjinore në Kosovë dhe ndikimin e tij në Shëndetin Riprodhues të Grave](#), 2008, f. 14

¹⁴⁰ Vllastimir Gjorgjeviq në çështjen Prokurori kundër Vllastimir Djorgjeviqit (Nr. i lëndës IT-05-87/I-A, 27 janar 2014) dhe Nebojsa Pavkoviq në çështjen Prokurori kundër Milutinoviqit dhe të tjerët (Lënda nr. IT-05-87-T, 26 shkurt 2009). Në apelin e Millutinoviq dhe të tjerëve ndaj aktgjykimit të 2014, Gjykata e Apelit gjeti pika shtesë të aktakuzës për dhunë seksuale kundër Pavkoviqit dhe hodhi poshtë aktgjykimet liruese ndaj Nikolla Shainoviq dhe Sreten Llukiq përndjekje përmes dhunës seksuale, por refuzoi të nxjerrë aktgjykime të reja për këto akuza (Prokurori kundër Shainoviq dhe të tjerët, Nr. i lëndës :IT-05-87-A, 23 janar 2014).

¹⁴¹ Amnesty International, [Wounds that Burn Our Souls: Compensation for Kosovo's war time rape survivors, but still no justice](#), 2017, p. 7.

¹⁴² Amnesty International shkroi: “Ky raport dokumenton dështimet e Misionit të Përkohshëm të Administratës së Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK) dhe Misionit të Policisë dhe Drejtësisë të udhëhequr nga BE në hetimin dhe ndjekjen penale të rasteve të dhunës seksuale të lidhura me konfliktet. Dhunimi dhe dhuna seksuale gjatë luftës nuk ishte një përparësi për asnjërin nga këto autoritete ndërkombëtare” (po aty, f. 7).

¹⁴³ Neni 242.4.

¹⁴⁴ Institucioni i Avokatit të Popullit, [Raporti Vjetor Nr. 18](#), 2018, f. 109.

së tij më 24 korrik 2019, por seanca gjyqësore nuk u mbajt deri më 17 korrik 2020, gati një vit më vonë.¹⁴⁵ Seancat fillestare të aktakuzave të ngritura në vitin 2019 shpesh nuk u zhvilluan deri pas një viti, veçanërisht në Ferizaj. Përveç vonesave në mbajtjen e seancave fillestare, seanca kryesore u shty për muaj apo madje me vite në disa raste, raportuan monitoruesit e RrGK-së. Vonesat kanë ndodhur për arsye të ndryshme, të tilla si i pandehuri nuk është paraqitur në procedurë përkundër ftesave të rregullta gjyqësore, ka munguar pala e dëmtuar ose ka munguar prokurori në gjykim. Për më tepër, në disa raste, Gjykata Themelore e Pejës dështoi të ftojë QPS dhe MV.¹⁴⁶

Një temë e përsëritur në mesin e gjyqtarëve ishte fakti që viktimat shpesh “tërheqin” rastet e tyre kundër kryesit të veprës. Zyrtarët nga institucionet e tjera vunë re në mënyrë të ngjashme që gjyqtarët ndonjëherë nuk e ndjekin me rastin sepse viktimat “tërhiqen”.¹⁴⁷ Në procedurat penale, gjyqësori duhet të ndjekë sipas detyrës zyrtare me akuza pavarësisht nga vendimi i viktimës.¹⁴⁸ Siç theksoi një përfaqësues i KGJK-së, “nëse është rast penal, ata duhet ta ndjekin atë deri në fund”. Në të vërtetë, raportohet se kjo praktikë vazhdon, si në vitet e mëparshme, janë shqetësuese.

Në vitin 2017, më shumë se gjysma e të gjitha akuzave penale që lidhën me dhunën në familje u hodhën poshtë. Ky numër mbeti i lartë edhe në vitin 2018.¹⁴⁹ Në aktgjykimet e fajësisë, dënimet për kryesit e dhunës në familje mbeten të ulëta, edhe pse një përkufizim i dhunës në familje dhe sanksionet ndaj tij janë të përfshira në KPK. Hulumtimi dhe monitorimi i RrGK-së gjithashtu ka theksuar mangësitë e mbetura në dënimin e duhur. Një gjyqtar i Gjykatës Supreme vërejti:

Trajtimi i rasteve të dhunës në familje është i vonuar edhe pse ato tani janë me prioritet përsëri. Ata [gjyqtarët] nuk i ndjekin deri në fund çështjet e sanksionimit dhe dënimeve. Këto janë disa

“Në gjykatat tona, viktimat shpesh i falin kryesit sepse nuk kishin mjete për t’u ndarë dhe për të jetuar të pavarur.”

- Gjyqtar i Gjykatës Civile

“Ndonjëherë gjyqtarët ende përpiqen [të pajtojnë palët], ata thonë, ‘E, çka t’i bësh, është burri yt. Hajt, se keni fëmijë’, por me ndikimin tonë ne i themi gjyqtarit të ndalet: ‘Ne jemi këtu për një vepër penale’. Ka ndodhur ndonjëherë që ata janë përpjekur të pajtojnë [palët].”

- Burrë, AV

“Zakonisht ndodh që ky mund të jetë rasti i parë i dhunës në familje. Mund të ndodh që nuk ka ndodhur dhunë me pasoja shumë të rënda dhe viktimat e falë kryesin.”

- Burrë, Gjyqtar i Gjykatës Penale

¹⁴⁵ Rasti PP.II.nr. I 139-12/2019. Kjo ishte e rëndësishme për nenin 248 të KPK-së.

¹⁴⁶ Kjo ndodhi në C.nr.174/20 më 24 Shkurt 2020; P.nr.876/19 më 28 Shkurt 2020; me numër 723/20 më 22 Korrik 2020; C.nr.590/20 më 6 Korrik 2020; P.nr. 849/19 më 6 Korrik; P.nr.985/19 më 20 Korrik 2020; P.nr. 1041/10 dhe P.nr.763/19 më 12 Qershor 2020.

¹⁴⁷ Intervistat e RrGK-së me përfaqësuesin e KGJK-së dhe zyrtarin e PK-së, 2020.

¹⁴⁸ Neni 363 i KPK-së; Neni 365 i KPK-së.

¹⁴⁹ Qosaj-Mustafa, A. dhe Morina, D. *Qasja në drejtësi e viktimave të dhunës me bazë gjinore në Kosovë: Përfundimi i mosndëshkimit të autorëve të krimit*. RrGGK kërkoi të dhëna të ndara sipas gjinisë shumë herë, por ato nuk u siguruan, kështu që llogaritjet më të fundit nuk mund të bëheshin.

nga mangësitë që ende duhet të adresohen.¹⁵⁰

I anketuari vazhdoi, duke shprehur pakënaqësi me dënimin e ulët për kryesit e dhunës në familje. Një zyrtar policie shprehu një shqetësim të ngjashëm: “Unë kam shumë kontakte me gjyqtarët, kur flasim për [raste të dhunës në familje], ata thonë se dënojnë kryesit me një vit me kusht dhe ata mendojnë se është shumë.”¹⁵¹ Kjo tregon se gjyqtarët mund të mos jenë të vetëdijshëm se po shqiptojnë dënime të ulëta. MV-të kanë prirje të bien dakord që gjyqtarët të japin dënime të ulëta:

Ka shumë arsye të dhëna nga gjyqtarët. Ajo që kam dëgjuar më shumë është: “Ne mund të shqiptojmë dënime më të ashpra. Sidoqoftë, kur i shqiptojmë këto dënime më të ashpra, marrëdhënia familjare përkeqësohet edhe më shumë. Qëllimi i ndëshkimit të këtyre kryesve të veprave penale është t’i edukojmë [ata] dhe të sjellim familjen përsëri së bashku, dhe jo të prishim marrëdhëniet midis burrit dhe gruas. Është mirë nëse kthehen së bashku sepse nuk kanë ku të shkojnë. Asgjë për të bërë.” Dhe gjykatat analizojnë këtë situatë dhe vijnë në këto përfundime.¹⁵²

Kështu, me sa duket, disa gjyqtarë shqiptojnë dënime të ulëta me motivin e pajtimit të dy partnerëve. Sipas monitoruesve të gjykatave nga RrGK, gjyqtarët ndonjëherë ndikohen në këtë drejtim nga kërkesat e viktimave për një dënim të butë:

Në seancën dëgjimore të mbajtur më 3 korrik 2020, pala e akuzuar, H.K., u akuzua për lëndim të lehtë trupor dhe kërcënim (nenet 188 dhe 185 të KPK-së së mëparshme), që pretendohet të jenë kryer më 23 shkurt 2018. Pala e dëmtuar, B.K., kërkoi nga gjykata që të shqiptojë një dënim të butë, duke deklaruar: “Nëse i shqiptoni një dënim më të rëndë burrit tim, atëherë ky dënim do të ndikojë në prishjen e marrëdhënieve tona familjare, pasi ne gjithashtu kemi probleme ekonomike sepse jetojmë me ndihma sociale.” Prokurori i shtetit lejoi palën e dëmtuar të tërheqë akuzën e kërcënimit. I pandehuri në fund u dënua për lëndim të lehtë trupor dhe u dënua me vërejtje gjyqësore.

Sanksionet për veprat penale të mbuluara nga KS duhet të jenë efektive, proporcionale dhe dekurajuese, duke marrë parasysh seriozitetin e tyre dhe rrethanat përkatëse rënduese.¹⁵³ Komisioni Evropian ka ngritur shqetësime në lidhje me dënimin e butë në rastet e dhunës me bazë gjinore në Kosovë.¹⁵⁴ Në kontekstin e dhunës në familje, SKMDHF sugjeroi që politikat ndëshkuese të gjykatave penale duhet të jenë më të rrepta, me kërkesa për dënime më të gjata, përfshirë ato që shkelin urdhrat e mbrojtjes. Udhëzuesi për Politikën Ndëshkimore i Gjykatës Supreme është përpjekur t’i adresojnë

¹⁵⁰ Intervistë e RrGK-së me një gjyqtar, 2020.

¹⁵¹ Intervistë e RrGK-së me PK-në, 2020.

¹⁵² Intervistë e RrGK-së me një MV, 2020.

¹⁵³ Nenet 45.1 dhe 46, përkatësisht.

¹⁵⁴ Komisioni Evropian, Raporti i Kosovës 2019, 2019, f. 28.

këto çështje duke u dhënë më shumë detaje gjyqtarëve, duke shpresuar që objektiviteti dhe qëndrueshmëria të zhvillohen në zbatimin e faktorëve rëndues dhe lehtësues.¹⁵⁵ Fatkeqësisht, Instituti i Kosovës për Drejtësi zbuloi në vitin 2019 se nuk kishte pasur “praktikisht asnjë zbatim të Udhëzuesit”, nuk kishte qëndrueshmëri në arsyetimin gjyqësor dhe që faktorët lehtësues dhe rëndues nuk ishin zbatuar në përputhje me Udhëzuesin.¹⁵⁶ ABGJ gjithashtu shprehu shqetësimin se kur përcaktojnë rastet e dhunës në familje, gjyqtarët përdorin “praktikat e tyre në vendimet e dënimit si praktikë e tyre që [nuk] është domosdoshmërisht në përputhje me Udhëzuesin për Politikën Ndëshkimore”.¹⁵⁷ Kjo sugjeron një nevojë për vëmendje të shtuar ndaj dështimeve të gjyqësorit për të dhënë në mënyrë adekuate dënimet e duhura. Instituti i Kosovës për Drejtësi rekomandon trajnime intensive për gjyqtarët dhe që Udhëzuesi duhet të referohet posaçërisht kur shqiptohen dënimet.¹⁵⁸

Rastet Civile

Gjykatat civile duhet të rishikojnë UM dhe UME-të në kohën e duhur, duke vendosur për masat e mbrojtjes brenda kornizës së LMDHF. Gjykatat civile gjithashtu vendosin për disa raste që kanë rëndësi kontekstuale për personat që kanë përjetuar dhunë me bazë gjinore, të tilla si çështjet që lidhen me pronën, trashëgiminë, shkurorëzimin, alimentacionin dhe kujdestarinë e fëmijëve.

Përgjigjet e gjyqtarëve të gjykatave civile ishin mjaft të paqarta nëse mendonin se gjyqtarët ishin më të vetëdijshëm për dhunën në familje tani sesa në vitin 2017. Sidoqoftë, gjyqtarët kishin prirje të bien dakord që viktimat e dhunës në familje duhet të raportojnë menjëherë rastet. Sidoqoftë, dy gjyqtarë përmendën që viktimat duhet të gjejnë një vend për të jetuar ose të kontaktojnë anëtarët e familjes në vend që të raportojnë menjëherë dhunën. U gjetën prova që disa gjyqtarë mund t'i këshillojnë viktimat të “pajtohen” me kryesit e krimeve, në vend se të pranojnë kërkesat e viktimave për urdhra mbrojtjeje. Për shembull, një gjyqtar argumentoi që urdhrat e mbrojtjes janë efektivë sepse “[UM-të] po i rregullojnë marrëdhëniet midis partnerëve dhe unë mendoj se kryesi i dhunës do të vendosë të mos kryejë më dhunë në familje”.¹⁵⁹ Gjyqtari me sa duket mban idenë se urdhrat e mbrojtjes më tepër synojnë të lehtësojnë pajtimin, sesa të kryejnë qëllimin e tyre të qartë për të mbrojtur viktimat.

Ndoshta gjetja më shqetësuese nga ky monitorim i kryer ishte tema e përsëritur e “pajtimit”. Gjyqtarët e

“[Kur palët paraqesin kërkesën] për shkurorëzim, gjyqtarët kanë detyrimin t’u kërkojnë atyre që të pajtohen. Është e detyrueshme sipas Ligjit [për Familje]. Në gjykatë shpesh shohim që gratë falin [kryesit] sepse nuk kanë mjete për t’u ndarë dhe për të jetuar të pavarura.”

- Grua, Gjyqtare e Gjykatës Penale

¹⁵⁵ Gjykata Supreme e Kosovës, *Udhëzuesi për Politikën Ndëshkimore, Botimi i Parë*, 2018.

¹⁵⁶ Instituti Ligjor i Kosovës, “Politika e Dënimit në Kosovë: Analizë mbi zbatimin e Udhëtuesit për Politikën Ndëshkimore nga Gjykatat e Kosovës”, 2019, f. 5.

¹⁵⁷ ABGJ, “Vlerësimi i nivelit të zbatimit të Procedurave Standarde të Veprimit për Mbrojtjen nga Dhuna në Familje në Kosovë”, 2019, f. 134.

¹⁵⁸ Instituti Ligjor i Kosovës, “Politika e Dënimit në Kosovë: Analizë mbi zbatimin e Udhëtuesit për Politikën Ndëshkimore nga Gjykatat e Kosovës”, 2019, f. 246.

¹⁵⁹ Intervistë e RrGK-së me një gjyqtar në Gjykatën e Apelit.

gjykatës civile duket se ende përdorin dispozitat e mbetura, të vjetruara të Ligjit të Familjes, të cilat inkurajojnë bashkëshortët të pajtohen për të shpëtuar martesën e tyre.¹⁶⁰ Sidoqoftë, e njëjta dispozitë thekson nevojën për të shmangur çdo rrezik të mundshëm të lëndimit ose dhunës ndaj bashkëshortëve ose fëmijëve. Përkundër kësaj, kjo çështje është vërejtur vazhdimisht që nga viti 2008.¹⁶¹ Gjyqtarët vazhdojnë të kërkojnë pajtimin e çifteve, duke deklaruar se ose prindërit duhet të pajtohen për hir të fëmijëve të tyre ose se dhuna është pjesë normale e një marrëdhënieje. Një monitorues i gjykatës nga RrGK regjistroi një rast të tillë:

Në Gjykatën Themelore në Prizren, gjatë një seancë për urdhër mbrojtjeje dhe për kujdestarinë e fëmijëve, një monitorues i RrGK-së vërejti se gjyqtari u përpoq të pajtojë kryesin e pretenduar dhe viktimën, edhe pse kishte prova dërmuese se dhuna kishte ndodhur, përfshirë raportet mjekësore dhe policore. Për më tepër, i akuzuari pranoi në gjykatë se dhuna kishte ndodhur në datën e përmendur. Viktima e bëri të qartë se ajo nuk donte ta falte të akuzuarin, duke deklaruar: “Ai u pendua edhe herën e fundit. Pastaj ai vazhdoi [të jetë abuziv].” Viktima e deklaroi këtë pasi MV dhe gjyqtari i thanë asaj se i akuzuari u pendua për veprimet e tij. Sidoqoftë, gjyqtari rekomandoi pajtimin, në mënyrë që familja të qëndronte e paprekur dhe fëmijët të qëndronin me babanë e tyre. Gjyqtari tha: “Ju jeni ata që vendosni. Vetëm për hir të fëmijëve, që të mos i abuzoni, ju jeni ata që duhet të mendoni për këtë”. Pasi viktima tregoi për herë të dytë se nuk donte të pajtohej, kërkesa e saj për një urdhër mbrojtjeje u dha.

Një tjetër monitor i gjykatës nga RrGK raportoi:

Në një rast të dhunës në familje në Gjykatën Themelore në Gjiilan, gjyqtari u përpoq të bindte viktimën dhe abuzuesin e pretenduar të vazhdonin martesën e tyre. Të dy palët ishin të pranishme në gjykatë për të zgjidhur administrimin e provave, kërkesën për alimentacion, ndarjen e pasurisë dhe çështjet e kujdestarisë së fëmijëve. Gjyqtari i tha AV: “Ju nuk keni pse të vini në zyrën time për të me treguar se çfarë të bëj; ata duan të ribashkohen.” Pas seancës dëgjimore, gjyqtari rekomandoi që të dy palët “të gjenin forcën dhe të ishin të fortë për fëmijët tuaj; të diskutojnë dhe të mos marrin këtë vendim [për t’u ndarë]”.¹⁶²

Raste të tilla, të cilat ndodhën në mënyrë të përsëritur, përfshinin presion të padrejtë mbi viktimat nga gjyqtarët dhe reviktimizim të mundshëm. Një gjyqtar tjetër shprehu ankesa për ndalimin ligjor të ndërmjetësimit të detyrueshëm në rastet e dhunës në familje.¹⁶³

¹⁶⁰ Neni 59.

¹⁶¹ Farnsworth, N. dhe Qosaj-Mustafa, A. për RrGK dhe ABGJ, *Siguria fillon në shtëpi: Kërkime për të informuar strategjinë kombëtare dhe planin e veprimit kundër dhunës në familje në Kosovë*, ABGJ: 2008, f. 106; Farnsworth dhe të tjerët për RrGK, *Mjaft më me arsyetime*, 2015, f. 13; Berisha etj. për RrGK, *Nga Fjalët në Vepra*, 2017, f. 20

¹⁶² Raportet e monitoruesve të RrGK-së, 2020.

¹⁶³ Drafti i Kodit të Procedurës Penale, Neni 231; dhe Ligji Nr. 06/L-009, Neni 2.3.

Ajo që është e gabuar me [procedurën] është fakti që ndërmjetësimi nuk lejohet më, domethënë, ne nuk mund të dërgojmë raste të dhunës në familje për ndërmjetësim. Nuk e di pse e bënë ligjin në atë mënyrë, por do të ishte mirë të shihet se ku ekziston mundësia që kur ato raste [vijne në gjykatë] për herë të parë që të dërgohen për ndërmjetësim. Kjo u jep një shans bashkëshortëve për t'u pajtuar, për të parë nëse ata mund të konsolidohen dhe të vazhdojnë jetën e tyre më tej së bashku.¹⁶⁴

Pikëpamje të tilla ishin një temë e përsëritur në intervista dhe monitorim të gjykatës.¹⁶⁵ Monitoruesit e RrGK-së kanë vërejtur në mënyrë të përsëritur seancat në të cilat gjyqtarët u bënëin presion çifteve për t'u pajtuar, pavarësisht rreziqeve të dukshme të dhunës. Në një rast tjetër në Gjykatën Themelore në Prizren, dega Suhareka, që përfshinte një kërkesë për një urdhër mbrojtjeje më 26 qershor 2020, monitoruesi i gjykatës vuri re:

Gjyqtari fillimisht ishte këmbëngulës që palët të pajtoheshin, edhe pse viktimat kishin raporte të detajuara mjekësore që vërtetonte se ajo kishte përjetuar dhunë. Kryesi i pretenduar dukej se kishte abuzuar në mënyrë të përsëritur me viktimën, por ishte ribashkuar me viktimën në shumë raste me mbështetjen e të moshuarve në shtëpi. Në fund të seancës, viktimat deklaroi qartë se nuk dëshironte të ishte me të pandehurin dhunues. Pavarësisht kësaj, gjyqtari i tha viktimës, “Ju keni kohë për të menduar dhe për të reflektuar derisa të merret vendimi, për t'u bashkuar me bashkëshortin tuaj për hir të fëmijëve tuaj” dhe “për hir të fëmijëve tuaj, ju duhet të mendoheni për këtë”.¹⁶⁶

Gjithashtu në vitin 2018, institucionet e drejtësisë thuhet se arsyetonin presionin ndaj çifteve për t'u pajtuar sepse ishte e nevojshme për qëllimin e “shpëtimit të familjes”.¹⁶⁷ Pikëpamjet dhe supozimet tradicionale të gjyqtarëve në lidhje me familjen, dhe përpjekjet e vazhdueshme drejt pajtimit, mund të rrezikojnë viktimat. Një monitorues i RrGK përshkroi një rast të tillë:

Në Gjykatën Themelore në Pejë, një viktimë dhe abuzues kishin vendosur që të ndaheshin. Burri jetonte në banesën e përbashkët, ndërsa gruaja jetonte në një banesë me qira me fëmijët e tyre. Kur abuzuesi mori fëmijët për disa ditë dhe nuk e lejoi gruan e tij t'i shihte, ajo shkoi në banesën e përbashkët për të parë fëmijët. Burri i saj e sulmoi fizikisht, dhe e largoi me forcë nga banesa. Gjatë seancës në të cilën viktimat kërkojnë një urdhër mbrojtjeje, gjyqtari iu drejtua viktimës, duke thënë: “Pse shkoje në banesë? Pse insistove që të qëndrosh në banesë?” Pothuajse në lot, pala e mbrojtur deklaroi: “Unë, gjyqtar, nuk i kisha parë fëmijët për ditë me radhë. [Ai nuk më linte] t'i shihja ata”. Gjyqtari u përgjigj: “Është e qartë që ju jeni ende të dashuruar.” Me

¹⁶⁴ Intervistë e RrGK-së me një gjyqtar, Prishtinë, 2020.

¹⁶⁵ Në një rast tjetër në Gjykatën Themelore të Gjilanit, gjyqtari u tha viktimës dhe kryesit të krimit që “të gjenin forcën dhe të ishin të fortë për fëmijët; të diskutojnë dhe [mos] të bëjnë gjendjen më të keqe” (rasti nr. 412/2020).

¹⁶⁶ Rasti nr. 201/2020.

¹⁶⁷ Qosaj-Mustafa, A. dhe Morina, D., *Qasja në drejtësi e viktimave të dhunës me bazë gjinore në Kosovë: Përfundimi i mosndëshkimit të autorëve të krimit*.

këto “prova” gjykata vendosi të refuzojë kërkesën e saj për një urdhër mbrojtjeje.¹⁶⁸

Gjyqtari në këtë rast e shpërfilli dhunën që kishte ndodhur, uzurpimin e kujdestarisë së fëmijës nga ana e kryesit, si dhe kërkesën e viktimës për mbrojtje. Ky vendim e vendosi viktimën në rrezik të dhunës së mëtejshme. Për më tepër, vendimi injoroi plotësisht masat e mundshme të urdhrat të mbrojtjes që mund të mbronin viktimën dhe fëmijët e saj, të tilla si sigurimi i saj i kujdestarisë së përkohshme dhe kërkimi nga kryesi i veprës që të paguante qiranë ose të largohej nga mjediset e përbashkëta. Siç është cekur në pjesën për PK, largimi i kryesve nga një shtëpi e përbashkët dhe mundësimi i qëndrimit të viktimës duhet të jetë prioritet, siç pasqyrohet në KS.¹⁶⁹

Gjyqtarët dhe MV-të ranë dakord që rastet e dhunës në familje trajtohen me më shumë prioritet tani sesa në vitin 2017. Sidoqoftë, disa gjyqtarë ende nuk duket se e kuptojnë urgjencën e çështjeve të tilla. Për shembull, në një rast të monitoruar nga RrGK, Gjykata Themelore në Pejë mori një kërkesë për një urdhër mbrojtjeje më 12 korrik 2019, por seanca fillestare nuk ndodhi deri më 3 mars 2020.¹⁷⁰ Gjykata nuk e respektoi parimin e prioritetit për shqyrtimin urgjent të rasteve të dhunës në familje, as LMDHF, që thotë se gjykata duhet të paraqesë një vendim brenda 15 ditëve nga marrja e kërkesës për një urdhër mbrojtjeje.¹⁷¹ Përveç shkeljes së ligjit, vonesat e tilla e rrezikojnë viktimën nga lëndimi. Në disa raste, veçanërisht në Gjykatën Themelore të Pejës, vëzhguesit gjithashtu vunë re se gjykata dështoi të ftojë MV-të dhe QPS në seancat dëgjimore mbi dhunën në familje ose për urdhrat e mbrojtjes, përfshirë rastet kur palët kishin fëmijë.¹⁷²

“Ka shumë vështirësi në caktimin e një urdhri mbrojtjeje [veçanërisht kur] viktimat dhe kryesi janë nën të njëjtin kulm. Ne patëm një rast të tillë i cili përfundoi me vrasje. Nuk ka kuptim që një kryes i veprës duhet të qëndrojë larg një viktime vetëm 200 metra ose 100 metra.”

- Burrë, Punonjës Social, Prishtinë

Vështirësitë e sigurimit dhe zbatimit të masave të përshtatshme brenda urdhrave të mbrojtjes mbetën një temë e përsëritur midis pjesëmarrësve të hulumtimit nga institucione të ndryshme. Së pari, gjyqtarët vunë re se ndonjëherë viktimat kërkojnë vetëm një urdhër ndalimi dhe jo masa të tjera të mundshme që mund t'i mbrojnë ato. Për më tepër, urdhrat e ndalimit vazhdojnë të mos respektohen, duke pasur parasysh situatat e jetesës në Kosovë në të cilën disa anëtarë të familjes banojnë në të njëjtën shtëpi. Siç u përmend, policia gjithashtu vuri re vështirësi në zbatimin e urdhrave të mbrojtjes me masa që ndalojnë afrimin ndaj viktimës në situata kur viktimat dhe kryesi banonin së bashku. Kjo çështje është raportuar vazhdimisht nga institucionet përkatëse që nga viti 2008, duke ilustruar mirëkuptimin e

kufizuar të vazhdueshëm dhe potencialisht të ndikuar nga ana kulturore në mangësitë e gjyqtarëve që

¹⁶⁸ Rasti nr. 170/20, më 20 Korrik 2020.

¹⁶⁹ “Raport shpjegues për Konventën e Këshillit të Evropës për parandalimin dhe luftimin e dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje”, Stamboll, 11. V. 2011, f. 264.

¹⁷⁰ Rasti nr. P.nr.670/19.

¹⁷¹ Neni 15.

¹⁷² Gjatë seancave që përfshinin kërkesa për urdhra mbrojtjeje më 24 shkurt 2020 (rasti nr. 174/20) dhe më 22 korrik 2020 (rasti nr. 723/20), përkatësisht, QPS nuk u ftua. Në një seancë tjetër më 6 korrik 2020, as QPS dhe as MV nuk ishin ftuar (rasti nr. 590/20).

sigurojnë masa të tjera të parashikuara me ligj. Ndërsa gjyqtarët mund të siguronin masa shtesë që kërkonin që kryesit e pretenduar të largoheshin nga një vendbanim i përbashkët, të paguanin qira për viktimën për të jetuar diku tjetër dhe/ose të paguanin alimentacion, gjyqtarët thuhet se kanë hezituuar t'i përdorin këto masa nga shqetësimi që kryesi të mos jetë në gjendje të paguajë financiarisht. Shqetësimi nuk duhet të jetë për situatën ekonomike të kryesit, por më tepër për mbrojtjen e duhur dhe të menjëhershme të viktimave, siç kërkohet nga KS.

Monitoruesit e gjykatës nga RrGK gjithashtu vëzhguan raste në të cilat viktimat tërhiqeshin ose zgjodhën të mos ndiqnin kërkesat për urdhër mbrojtjeje. Sipas një monitoruesi gjykate:

Në një seancë për të kërkuar një urdhër mbrojtje, një rast në Divizionin Civil në Pejë më 12 mars 2020, pala e mbrojtur tërhoqi një kërkesë për një urdhër mbrojtjeje me arsyetimin se ata kishin përmirësuar marrëdhëniet me të paditurin, megjithëse nuk ishte hera e parë që i padituri kishte përdorur dhunë ndaj viktimës.¹⁷³ Raste të ngjashme kur kërkesat për urdhra të mbrojtjes u tërhoqën gjithashtu janë vërejtur në Gjykatën Themelore në Prishtinë në shkurt 2020

Hetim i mëtejshëm duhet të bëhet në lidhje me arsyet për tërheqjen e kërkesave të viktimave nga urdhrat e mbrojtjes dhe, në veçanti, nëse vendime të tilla ndikohen nga presioni nga kryesit e krimit, faktorët socio-kulturorë, përpjekjet e pajtimit gjyqësor ose sfida më të gjera për viktimat kur angazhohen me sistemin ligjor (siç janë qasja në këshillat ligjore ose vonesat në përcaktimin e kërkesave).

Procedurat e kujdestarisë së fëmijëve mund të lidhen ngushtë me rastet e dhunës në familje. Për shembull, në një rast të dokumentuar nga monitoruesit e RrGK-së, bazuar në informacionin nga një AV:

[N]jë ish-burrë i mori fëmijët, duke i mohuar nënës së tyre kujdestarinë dhe të drejtën e saj legjitime për të parë fëmijët e saj. Pas pak, ai vdiq dhe fëmijët vazhduan të jetonin me prindërit e babait të tyre. Prindërit e burrit ende nuk e lejojnë nënën të shohë fëmijët e saj. Ajo e ka paraqitur rastin në përpjekje për të marrë kujdestarinë e fëmijëve të saj, por sistemi gjyqësor vetëm e ka vonuar rastin e saj. MV kërkoi një urdhër mbrojtjeje në mënyrë që fëmijët t'i besohen përkohësisht nënës, por gjykata e refuzoi kërkesën duke deklaruar se kujdestaria e fëmijëve ishte një procedurë e veçantë. Kërkimi i kujdestarisë mund të zgjasë me vite.

Nga një perspektivë strukturore, duke pasur parasysh normat kulturore, sipas të cilave supozohet se kujdestaria e fëmijëve duhet të bjerë brenda një linje patriarkale, domethënë, me familjen e babait të tyre, gjykatat kanë tentuar t'u japin kujdestarinë baballarëve, edhe kur ata kanë qenë kryes të dhunës.¹⁷⁴ Gjykatat civile kanë tentuar t'ua caktojnë kujdestarinë baballarëve gjithashtu bazuar në argumentin se baballarët kanë shanse më të mira për të mbështetur fëmijët, gjë që teorikisht mund të mbajë një farë probabiliteti të së vërtetës, duke pasur parasysh diskriminimin më të gjerë strukturor

¹⁷³ Rasti nr, 284/20.

¹⁷⁴ Berisha dhe të tjerët për RrGK, *Nga Fjalët në Vepra*, 2017.

që ekziston në Kosovë ndaj grave në lidhje me të drejtat e pronës, punësimin, dhe qasje në burime. Megjithatë kjo qasje nuk mbështetet nga korniza ligjore, gjyqtarët mund të përforcojnë normat shoqërore tradicionale që burrat, si mbajtës të ekonomisë, duhet të kujdesen për fëmijët, pavarësisht nëse babai është abuziv. Vendime të tilla të marra në seancat e kujdestarisë së fëmijëve, në lidhje me Ligjin për Familje nuk janë në përputhje me qasjen e fokusuar në viktimë dhe nevojat e fëmijët, siç është menduar nga KS dhe ligji i Kosovës. Për më tepër, frika nga rezultatet e tilla mund të parandalojë gratë nga kërkimi i mbrojtjes, raportimi i dhunës ose ngritja e procedurave të shkurorëzimit, nga frika e humbjes së kujdestarisë së fëmijëve të tyre. Këshilli i Evropës ka dhënë komentimin e mëposhtëm mbi çështjet e kujdestarisë sipas KS:

Është në kontekstin e gjetjes së zgjidhjeve holistike që shmangin viktimizimin sekondar që Konventa e Stambollit u kërkon gjyqtarëve të marrin në konsideratë çdo incident të njohur të dhunës në familje kur vendosin për të drejtat e kujdestarisë ose të vizitës (neni 31). Ka pasur shembuj që prindit abuziv i është dhënë e drejta e vizitës apo edhe e kujdestarisë thjesht sepse konsiderohej se ishte në interesin më të mirë të fëmijës mbajtja e kontaktit. Sidoqoftë, Konventa e Stambollit përcakton qartë se dhuna ndaj kujdestarit jo abuziv ose fëmijës gjithmonë do të duhet të faktorizohet në vendime për ushtrimin e të drejtave prindërore dhe se ushtrimi i të drejtave të vizitës ose kujdestarisë nuk duhet të rrezikojë kurrë sigurinë e viktimave. ose atë të fëmijëve të tyre.¹⁷⁵

LMDHF parasheh që një viktimë e dhunës në familje mund të kërkojë kujdestari të përkohshme të fëmijëve, deri në skadimin e një urdhri mbrojtjeje dhe një vendimi gjyqësor për të drejtat e kujdestarisë afatgjatë të fëmijëve. Sidoqoftë, duke pasur parasysh normat dhe marrëdhëniet shoqërore tradicionale të lartpërmendura, gjyqtarët e gjykatave civile thuhet se nuk mund t'i zbatojnë gjithmonë këto dispozita në mënyrë korrekte. Një gjyqtar vërejt:

[LMDHF] neni 6, paragrafi 2 thotë që kujdestaria e fëmijës i besohet përkohësisht viktimës së dhunës në familje ndërsa e drejta prindërore [përkohësisht] i hiqet kryesit të dhunës në familje. ... Tani, në praktikë, kur nuk ka dhunë ndaj fëmijëve, gjykatat caktojnë kontakte të rregullta për babanë me fëmijën, gjë që bie në kundërshtim me dispozitat [në LMDHF]. ... Me këtë dispozitë [LMDHF], pa marrë parasysh nëse ka pasur dhunë ndaj fëmijëve, për mua, është një mënyrë për të sanksionuar prindin që u soll keq ndaj nënës. Zakonisht në këto raste, gjyqtarët u caktojnë [fëmijëve] vizita të rregullta me kryesin e dhunës pa marrë parasysh këtë.¹⁷⁶

Kjo sugjeron që gjyqtarët mund të imponojnë të drejta vizite pavarësisht se të drejtat e tilla nuk janë parashikuar nga LMDHF. OSBE-ja vërejt përsëri në vitin 2012 që gjyqtarët po e tejkalonin

¹⁷⁵ Këshilli i Evropës, *Të drejtat e fëmijëve*, 2019.

¹⁷⁶ Intervistë e RrGK-së me një gjyqtar, 2020.

juridiksionin e tyre duke vendosur masa të paparashikuara nga LMDHF.¹⁷⁷ Një interpretim tjetër është se disa gjyqtarë mund të ndryshojnë ose modifikojnë urdhrat e mbrojtjes,¹⁷⁸ të cilat i kanë dhënë kujdestari të përkohshme fëmijës një viktime të dhunës, duke u dhënë kryesve të drejta vizite pasi një urdhër mbrojtjeje i kishte hequr të drejtën prindërore kryesit të veprës. Një hetim i mëtejshëm mund të hetojë këtë çështje dhe si trajtohet kujdestaria e fëmijëve në lidhje me urdhrat e mbrojtjes.

Një çështje tjetër e përmendur vazhdimisht midis të anketuarve në intervista nga institucione të ndryshme përgjegjëse ishte se gjyqtarët rrallë caktojnë masat e parashikuara për rehabilitimin nga varësia nga droga ose alkooli. Qendra Klinike Universitare e Kosovës ofron shërbime të tilla me sa duket që nga viti 2017. OSHC-të gjithashtu ofrojnë disa shërbime të kufizuara. Kështu që, mbase institucioneve përkatëse u mungon njohuria se këto shërbime janë në dispozicion, nuk i kërkojnë këto masa ose nuk e konsiderojnë të nevojshme caktimin e këtyre masave. Siç duket, kryesit e krimit, siç raportohet, nuk kanë gjithmonë qasje në shërbime të përshtatshme dhe të dobishme rehabilitimi.¹⁷⁹ Me shërbime të tilla të disponueshme vetëm në Prishtinë, kjo gjithashtu mund të paraqesë një sfidë për disa kryes të veprave që të kenë qasje në to.

“Nuk ka shumë institucione serioze shëndetësore që punojnë në rehabilitimin e njerëzve që janë të varur nga alkooli ose narkotikët.”

- Përfaqësues i KGJK-së

Konkluzion

Megjithëse gjyqtarët ishin në dijeni të ndryshimeve në KPK dhe përfshirjen e KS në Kushtetutën e Kosovës, jo të gjithë kishin një kuptim gjithëpërfshirës të dhunës me bazë gjinore, veçanërisht të formave të ndryshme të dhunës seksuale. Gjykatat kishin hasur në disa raste ndjekjeje, sulmi seksual, përdhunimi ose ngacmimi seksual. Shumica e rasteve të dhunës me bazë gjinore që kishin trajtuar kishin të bënin me dhunën në familje. Gjyqtarët ranë dakord që rastet e dhunës në familje tani janë me prioritet më shumë se më parë, por monitorimi sugjeron që vonesat vazhdojnë, duke i vendosur gratë në rrezik të madh të dhunës së mëtejshme. Fenomeni i grave që “tërheqin” dëshmitë e tyre dhe akuzave penale që u hodhën siç duket vazhdon, pavarësisht nga detyrimet e qarta ligjore për të vazhduar sipas detyrës zyrtare ndjekjen penale. Dënimi për krimet e dhunës në familje mbetet i ulët. Disa gjyqtarë ende kërkojnë të pajtojnë familjet, megjithëse kjo nuk është brenda mandatit të tyre kur gratë dhe fëmijët janë në rrezik të dhunës. Ende caktohen disa masa në urdhrat e mbrojtjes, gjë që pengon një qasje gjithëpërfshirëse, të fokusuar te viktimat. Nevojiten hulumtime të mëtejshme në lidhje me shkaqet e viktimave që tërheqin kërkesat për urdhër mbrojtjeje ose kërkojnë dënime të buta, si dhe mbi kujdestarinë e fëmijëve në lidhje me urdhrat e mbrojtjes.

¹⁷⁷ Misioni i OSBE-së në Kosovë, “Gjykimi i kërkesave për urdhrat e mbrojtjes në rastet e dhunës në familje në Kosovë”, 2012.

¹⁷⁸ LMDHF, neni 20 parashikon: “Kur rrethanat kanë ndryshuar, pala e mbrojtur ose kryesi i dhunës mund t’i parashtrijë kërkesë gjykatës, për ndryshimin ose ndërprerjen e urdhrit për mbrojtje, me ç’rast gjykata mund të vendosë që urdhri për mbrojtje: (1) të mbetet në fuqi, (2) të ndryshohet, (3) të ndërpritet, nëse gjykata vlerëson se kanë pushuar të gjitha shkaqet mbi bazën e të cilave është shqiptuar urdhri mbrojtës”.

¹⁷⁹ Berisha dhe të tjerët për RrGK, *Nga Fjalët në Vepra*, 2017.

SHËRBIMI KORREKTUES I KOSOVËS

Sipas ligjit të Kosovës, posaçërisht me KPK, Shërbimi Korrektues i Kosovës (SHKK) është përgjegjës për rehabilitimin e të burgosurve. Misioni i SHKK-së është të “risocializojë të burgosurit duke respektuar të drejtat e tyre themelore pavarësisht racës, gjuhës dhe fesë, si dhe sigurimin e një ambienti të sigurt për personelin, të burgosurit dhe shoqërinë”.¹⁸⁰ Kryesit e veprave penale mund të kenë nevojë për mbështetje ose ndihmë psikologjike në shërimin nga varësia nga alkooli dhe/ose droga.¹⁸¹

Në vitin 2017, punonjësit e SHKK-së nuk kishin njohuri në lidhje me kornizën ligjore në lidhje me dhunën në familje, si dhe detyrat dhe detyrimet e tyre në punën me shkelësit e ligjit.¹⁸² Në vitin 2020, intervistat sugjeruan që punonjësit e SHKK-së tani kanë më shumë njohuri në lidhje me kornizën ligjore në lidhje me dhunën me bazë gjinore, KPK-në e re dhe detyrimet e tyre ligjore. Ata kishin prirje të dinin për format më të theksuara të dhunës në Kosovë, përfshirë dhunën në familje, ngacmimet seksuale dhe dhunën me bazë gjinore përgjithësisht, por nuk kishin njohuri për sulmin seksual, nxitjen për të ekspozuar pjesët intime të trupit, përdhunimin, gjymtimin e organeve gjenitale të grave, dhe ndjekjen. Zyrtarët e SHKK-së kanë prirje të mos kenë informacion në lidhje me PSV-të dhe SKM-DHF-në, detyrat dhe detyrimet e tyre sipas tyre, ose mënyrën e zbatimit të legjislacionit përkatës.

Sipas SKMDHF, SHKK, e mbështetur nga MD, duhej të krijonte programe rehabilitimi dhe “infrastrukturë të përshtatshme për të punuar me kryesit e dhunës në familje”, sipas LMDHF (4.4.1.). SHKK-ja ka terapi të veçantë në grup për kryesit e dhunës, por seancat nuk janë të detyrueshme. Kështu, zyrtarët e SHKK-së vërejtën se marrin pjesë vetëm shkelësit që vendosin të marrin pjesë. SHKK ende nuk ka një program gjithëpërfshirës që punon në mënyrë të qartë me kryesit e dhunës me bazë gjinore. As sa duket, nuk janë përfshirë masat specifike të rehabilitimit të lidhura me dhunën gjinore në planet e tyre personale të rehabilitimit. Një zyrtar i SHKK-së vërejtë se mungesa e programeve speciale e bën rehabilitimin të vështirë: “Disa persona kanë një ndjenjë dhune brenda, dhe, në momente të caktuara, ajo shpërthen, sikur të ishte diçka organike. Njerëzit [që ne i trajtojmë] prirën të jenë të dhunshëm dhe të shpërthejnë dhe të kthehen në të njëjtën pikë”.¹⁸³ Përfaqësuesi dukej se tregoi se dhuna është diçka që është e natyrshme për një person, e cila ndoshta mund të veprojë si një formë arsyetimi për dhunën në familje. SHKK-ja duhet të ofrojë shërbime dhe mesazhe që theksojnë se nuk ekziston asnjë arsyetim për dhunën. Siç është raportuar në vitin 2017, planet personale të rehabilitimit të shkelësve duhet të përfshijnë “ri-socializimin në lidhje me marrëdhëniet e pushtetit dhe rolet tradicionale gjinore” drejt transformimit të marrëdhënieve tradicionale gjinore dhe parandalimit të dhunës recidiviste.¹⁸⁴ Në përputhje me KS, Kosova duhet të konsiderojë krijimin e një programi rehabilitimi me standarde minimale që synojnë ndryshimin e modeleve të sjelljes së dhunshme duke miratuar sjellje jo të dhunshme në marrëdhëniet ndërpersonale, duke ruajtur, si shqetësimin kryesor,

¹⁸⁰ MD, SKMDHF, 2017, f. 20.

¹⁸¹ Po aty.

¹⁸² Berisha dhe të tjerët për RrGK, *Nga Fjalët në Vepra*, 2017.

¹⁸³ Intervistë e RrGK-së me një përfaqësues të SHKK-së, 2020.

¹⁸⁴ Berisha dhe të tjerët për RrGK, *Nga Fjalët në Vepra*, 2017.

sigurinë, mbështetjen dhe të drejtat e viktimave.¹⁸⁵

SKMDHF gjithashtu parashikoi që SHKK, e mbështetur nga MD, të “monitoronte rehabilitimin dhe ri-integrimin e shkelësve të ligjit” (4.4.3.). Ndërsa u ngrit si çështje edhe në vitin 2017,¹⁸⁶ SHKK-ja ende nuk mban të dhëna lidhur me atë nëse personat e trajtuar kishin kryer dhunë me bazë gjinore. As SHKK-ja nuk mban të dhëna për trajtimin e saj të rasteve recidiviste të dhunës me bazë gjinore. Kështu, SHKK-ja ende nuk ka sistem që mundëson monitorimin.

Konkluzion

Ndërsa zyrtarët e SHKK-së kanë më shumë njohuri sesa në vitin 2017, ata ende nuk kanë mirëkuptim në lidhje me kornizën përkatëse ligjore, dhe detyrat dhe detyrimet e tyre në lidhje me adresimin e dhunës me bazë gjinore. SHKK ende nuk ofron ndonjë program gjithëpërfshirës të trajtimit special për rehabilitimin e personave që kanë kryer dhunë me bazë gjinore. Edhe pse janë potencialisht të dobishme, programet speciale të terapisë për kryesit e dhunës nuk janë të detyrueshme dhe kështu duket se kanë pasur ndikim minimal. Një program më gjithëpërfshirës është i nevojshëm për të transformuar modelet e sjelljes, sipas KS. Sistemet e menaxhimit të të dhënave të SHKK-së ende nuk i ndjekin llojet e krimeve të kryera nga klientët e tyre, gjë që pengon monitorimin e duhur.

SHËRBIMI SPROVUES

Shërbimi Sprovues është përgjegjës për organizimin, zbatimin dhe mbikëqyrjen e dënimeve alternative, si dhe ri-integrimin shoqëror të personave të dënuar. Sipas SKMDHF, shërbimi duhet të mbikëqyrë dhe mbështesë kriminelët e dënuar të cilët janë të liruar me kusht përmes:

zhvillimit të programeve individuale të mbikëqyrjes; hartimit të raporteve për zbatimin e dënimeve alternative dhe për personat me kusht për Prokurorët, Gjykatat dhe Paneli për Lirimin me Kusht; përmes udhëzimit dhe mbështetjes së personave të dënuar pas kryerjes së dënimit të tyre; përmes mbajtjes së shënimeve dhe regjistrave për zbatimin e masave alternative dhe ndëshkimeve në sistemin elektronik të menaxhimit të të dhënave.¹⁸⁷

Sipas një përfaqësuesi të Shërbimit Sprovues, njohuritë dhe qëndrimet e përgjithshme të punonjësve ndaj dhunës në familje kanë ndryshuar dhe janë përmirësuar që nga trajnimi.¹⁸⁸ Sidoqoftë, ashtu si në vitin 2017, punonjësit e Shërbimit Sprovues të intervistuar në vitin 2020 kishin prirje të mos kishin njohuri në lidhje me SKMDHF dhe këto përgjegjësi.¹⁸⁹ Kur u pyetën për dhunën me bazë gjinore, të anketuarit nuk kuptuan forma të ndryshme, duke përfshirë ngacmimin seksual, sulmin seksual, nxit-

¹⁸⁵ Neni 16.

¹⁸⁶ Berisha dhe të tjerët për RrGK, *Nga Fjalët në Vepra*, 2017, f. 24.

¹⁸⁷ MD, SKMDHF, 2017, f. 20-21.

¹⁸⁸ Intervistë e RrGK, 2020.

¹⁸⁹ Berisha dhe të tjerët për RrGK, *Nga Fjalët në Vepra* 2017.

jen për të ekspozuar pjesët private, përdhunimin, dhunën në familje, gjymtimin e organeve gjenitale të femrave dhe ndjekjen. Të anketuarit e dinin që këto vepra janë të dënueshme sipas KPK-së së re, por nuk i kuptuan ato si forma të dhunës me bazë gjinore.

Sipas prokurorëve, shumica e rasteve të dhunës me bazë gjinore marrin dënime me kusht. Sidoqoftë, Shërbimi Sprovues nuk i përcjellë rastet e tilla. As nuk kanë ndonjë shërbim specifik për personat që kanë kryer dhunë me bazë gjinore. Kësisoj, ashtu siç konkludoi RrGK në vitin 2017, “duket se ekziston infrastrukturë e pamjaftueshme për rehabilitimin e kryesve të dhunës me bazë gjinore”.¹⁹⁰ Kjo sugjeron që përgjegjësitë e tyre të lartpërmendura siç janë parashikuar në SKMDHF nuk janë zbatuar.

Në përgjithësi, Shërbimi Sprovues i takon të liruarit me kusht. Duke monitoruar rastet e liruara me kusht, ata thanë se përpiqen të ulin recidivizmin. Përgjegjësitë e tyre kryesore përfshijnë matjen e sjelljes së të liruave me kusht, kuptimin e së kaluarës së tyre kriminale dhe vlerësimin nëse kryesi i veprës është i dhunshëm. Bazuar në këta faktorë, ata vlerësojnë nëse personi ka të ngjarë të kryejë një vepër tjetër. Shërbimi Sprovues nuk duket se ka udhëzime të qarta për këto vlerësime që përfshijnë vëmendjen ndaj kryesve për të kuptuar marrëdhëniet gjinore, midis faktorëve të tjerë. Kjo lejon vlerësime subjektive dhe vlerësime të tilla mund të kenë mungesë të informacionit adekuat për një plan të menaxhimit të rastit për të parandaluar dhunën recidiviste. Kështu, Shërbimi Sprovues ende nuk ka sisteme adekuate për të ndihmuar kryesit e krimeve në adresimin e çështjeve socio-psikologjike që mund të lejojnë përsëritjen e recidivizmit.¹⁹¹

Konkluzion

Punonjësve të Shërbimit Sprovues u mungon njohuria në lidhje me format e ndryshme të dhunës me bazë gjinore, dhe përgjegjësitë e tyre ligjore sipas SKMDHF. Ata ende nuk kanë një regjistër për përcjelljen e rasteve të dhunës me bazë gjinore, ose programe specifike të trajtimit që mund të kontribuojnë në uljen e recidivizmit dhe parandalimin e dhunës.

SHËRBIMET SOCIALE

Kjo pjesë shqyrton shërbime të ndryshme sociale të mbikëqyrura nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, përfshirë Qendrat për Punë Sociale (QPS), strehimoreve, Zyra të Punësimit (ZP) dhe Qendrave të Aftësimit Profesional (QAP). Çdo nën-pjesë në këto organe përkatëse shqyrton njohuritë, qëndrimet dhe shërbimet e tyre të ofruara, në përputhje me përgjegjësitë e tyre ligjore dhe KS.

Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale

Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale (MPMS) është përgjegjëse për organizimin e cilësisë së shërbimeve sociale për “personat në nevojë” në Kosovë. Sipas Ligjit për Familje dhe Shërbimet Sociale, kjo posaçërisht përfshin viktimat e dhunës në familje, të trafikimit njerëzor dhe familjet ku një

¹⁹⁰ Po aty, f. 25.

¹⁹¹ Kjo u identifikua gjithashtu si një çështje në Farnsworth dhe të tjerët për RrGK, *Mjaft më me arsyetime*, 2015.

prind ka qenë abuziv.¹⁹² MPMS mbikëqyrë licencimin dhe performancën profesionale të OJQ-ve lokale që ofrojnë shërbime për grupe të cënueshme, përfshirë viktimat e dhunës me bazë gjinore.¹⁹³ MPMS duhet të sigurojë që shërbimet sociale janë në dispozicion për të gjithë banorët “pa asnjë dallim, të tillë si raca, etnia, gjinia, gjuha, feja, mendimi politik, prejardhja kombëtare ose sociale, pasuria, lindja ose diçka tjetër”.¹⁹⁴ Përmes drejtorive komunale të mirëqenies sociale, MPMS monitoron punën e ofruesve të ndryshëm të shërbimeve, veçanërisht atyre që merren me shërbime rehabilitimi dhe riintegrimi.¹⁹⁵

Kështu shërbimet sociale janë të decentralizuara në Kosovë. Komunitet individuale janë vetë përgjegjëse për ofrimin e shërbimeve sociale,¹⁹⁶ dhe kjo pasqyrohet në Ligjin për Vetëqeverisje Lokale dhe Ligjin për Shërbime Sociale dhe Familjare.¹⁹⁷ Sidoqoftë, kur një komunë ose organizatë tjetër që ofron Shërbime Sociale dhe Familjare vazhdimisht nuk arrin të përmbushë standardet minimale të përcaktuara nga MPMS për ofrimin e këtyre shërbimeve, “[MPMS] do të jetë drejtpërdrejt përgjegjëse për ofrimin e shërbimeve të tilla, për aq kohë sa është e nevojshme për të ndrequr situatën.”¹⁹⁸ Ndërsa decentralizimi reflektohet në ligj, financimi dhe infrastruktura aktualisht nuk janë të mjaftueshme.¹⁹⁹

Në përgjithësi, sipas Ligjit për Shërbime Sociale dhe Familjare: “Me qëllim që, komunitet ose organizatat që ofrojnë shërbime sociale dhe familjare në emër të saj, të ju mundësohet kryerja e këtyre funksioneve, [MPMS] do t’u ndajë fonde vjetore për këtë destinim me një shpallje publike për blerjen e shërbimeve”.²⁰⁰ Siç detajohet në pjesët vijuese, ofruesve të shërbimeve përfshirë QPS-ve dhe strehimoreve u ka munguar ndarja e mjaftueshme buxhetore për kryerjen e përgjegjësisë të tyre ligjore, veçanërisht për burimet njerëzore, automjetet dhe hapësirën e duhur. Një përfaqësues i MPMS-së gjithashtu vuri re se nuk kishte fonde të mjaftueshme për zbatimin e PSV-ve mbi dhunën në familje sepse punonjësit socialë nuk kishin automjete për të vizituar viktimat.²⁰¹ Është përgjegjësi e MPMS-së të sigurojë ndarjen e mjaftueshme të buxhetit për këto qëllime. Sidoqoftë, formula e tanishme e financimit e vendosur për shërbimet sociale përgjithësisht të pazhvilluara është e paqëndrueshme, sipas një raporti të Komisionit Evropian të vitit 2019:

Shërbimet financohen përmes projekteve pilot kombëtare për komunitet dhe fondet e tyre të komunitet. Sidoqoftë, kjo ka rezultuar problematike për shumë komuna, posaçërisht ato të vogla, të cilat nuk mund të ndajnë buxhete për shërbime fare - veçanërisht për shërbimet që ishin nënkontraktuar për OJQ-të. Sipas [MPMS], ka disa komuna ku shërbime të caktuara so-

¹⁹² Ligji Nr. 02/L-17, Neni 1.3.

¹⁹³ Ligji Nr. 02/L-17, Neni 8; Këshilli i Evropës, “Raporti i Vlerësimit të Nevojave: Udhëzime të cilësisë për strehimoret në mbështetje të viktimave të dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje në Kosovë”, 2019.

¹⁹⁴ Ligji Nr. 02/L-17, Neni 2.1.

¹⁹⁵ Ligji Nr. 02/L-17, Neni 2-3.

¹⁹⁶ Qendra Evropiane për Politikë dhe Kërkime të Mirëqenies Sociale, “Monitorimi dhe vlerësimi i shërbimeve sociale në Kosovë - sfidat e politikave dhe rekomandimet”, Policy Brief, 2019/14.

¹⁹⁷ Ligji Nr. 03/L-040 dhe Ligji Nr. 02/L-17, përkatësisht.

¹⁹⁸ Ligji Nr. 02/L-17, Neni 2.7.

¹⁹⁹ Qendra Evropiane për Politikë dhe Kërkime të Mirëqenies Sociale, “Decentralizimi i Shërbimeve Sociale në Kosovë - Sfidat e Politikave dhe Rekomandimet”, Policy Brief, 2018/5.

²⁰⁰ Neni 2.10, i ndryshuar.

²⁰¹ Intervistë e RrGK-së, 2020.

cialë dhe OJQ mungojnë plotësisht.²⁰²

Lidhur posaçërisht me dhunën në familje, sipas LMDHF, MPMS e ka përgjegjësinë të sigurojë që QPS-të dhe strehimoret të ofrojnë shërbime sociale cilësore.²⁰³ Një përfaqësues i MPMS raportoi se ata i monitorojnë periodikisht QPS-të dhe monitoruan strehimoret posaçërisht gjatë pandemisë COVID-19, megjithëse në mënyra të ndryshme. Nëse monitorimi ekspozon ndonjë parregullsi në strehimore, ata mund të fillojnë inspekte, të cilat rezultojnë në raporte me rekomandime për strehimoret. Ata gjithashtu monitorojnë shpenzimet financiare.

MPMS-ja tregoi se Ministria i ka zbatuar të gjitha detyrat e saj nën SKMDHF.²⁰⁴ SKMDHF para-shikoi që MPMS do të siguronte “trajnim dhe certifikim të vazhdueshëm të punonjësve të QPS, QAP dhe ZP të fokusuar në DHF, në tema të përcaktuara mirë dhe module të miratuara” (1.1.6.). Sipas MPMS-së, nga viti 2017 deri në vitin 2020 u mbajtën 161 trajnime mbi dhunën në familje, përmes të cilave u certifikuan 447 zyrtarë.²⁰⁵ Monitorimi nga RrGK zbuloi se shumica e punonjësve socialë kanë marrë trajnim mbi dhunën në familje, por ata ende nuk kanë pasur trajnim mbi ngacmimet seksuale ose si të identifikojnë shenjat e abuzimit seksual brenda një marrëdhënieje partnere. Për më tepër, disa kufizime të njohurive mbetën midis punonjësve socialë, siç u diskutua në nën-pjesën tjetër. Jo të gjithë punonjësit e QAP-ve dhe ZP-ve kanë marrë pjesë në trajnim, sugjerojnë intervistat e RrGK-së. SKMDHF gjithashtu planifikoi për “trajnim dhe certifikim të vazhdueshëm të punonjësve të OJQ-ve të fokusuar në DHF” (1.1.9.). Disa OJQ organizuan dhe morën pjesë në trajnim, dhe trajnime të rregullta mbi dhunën në familje u mbajtën në 2018 dhe 2019 përmes ABGJ dhe MPMS. Në trajnime morën pjesë Policia e Kosovës, QPS-të, MV-të, punëtorët shëndetësorë dhe punonjësit e OSHC-ve. MPMS gjithashtu kishte përgjegjësinë për të përmirësuar “standartet e shërbimit për viktimat e dhunës në familje/të mbijetuarit” (2.1.3.) dhe përshtatjen e “shërbimeve të mbrojtjes në mënyrë që ato të jenë të arritshme nga grupe me nevoja të veçanta (të tilla si personat me aftësi të kufizuara, LGBT, pakicat – ofrimin e shërbimit në gjuhën e tyre, etj.) në përputhje me standartet e përmirësuar dhe të miratuara të bazuara në ato ndërkombëtare” (2.3.6.), së bashku me KNDHF. RrGK nuk identifikoi progres të qartë në asnjërën nga këto.²⁰⁶ Intervistat sugjeruan që personat me aftësi të ndryshme ende përballen me sfida me qasje në shërbime dhe shërbimet specifike të mbrojtjes për personat LGBT nuk mund të identifikohen.²⁰⁷ Lidhur me riintegrimin, MPMS duhet të ndihmojë në sigurimin e “ofrimit të këshillimit psikologjik-social afatshkurtër dhe afatgjatë për viktimat e dhunës në familje nga profesionistë të certifikuar” (4.1.1.). MSH deklaroi se shtatë Qendrat e Shëndetit Mendor ofrojnë këshillim psikosocial për viktimat e dhunës me bazë gjinore, dhe viktimat shpesh kërkojnë ndihmë në këto qendra. Ndërkohë, QPS-të nuk kanë gjithmonë psikologë, të cilët mund të rrisin disponueshmërinë e shërbimeve për vikti-

²⁰² Mustafa, A. dhe Haxhikadrija, A. për Komisionin Evropian, “Financimi i mbrojtjes sociale - Kosovë”, 2019, f. 11.

²⁰³ Neni 27.

²⁰⁴ Intervistë e RrGK-së me një përfaqësues të MPMS, 2020.

²⁰⁵ Të dhënat e siguruar për RrGK nga MPMS, nëntor 2020.

²⁰⁶ Në monitorim, MD gjithashtu nuk raportoi “progres” (“raporti i parë i Monitorimit mbi Zbatimin e Planit të Veprimit të Strategjisë Kombëtare për Mbrojtjen nga Dhuna në Familje 2016-2020”, 2018).

²⁰⁷ Intervistat e RrGK-së, 2020.

mat. Në përgjithësi, shqyrtimi nga RrGK i zbatimit të SKMDHF sugjeron që MPMS ka zbatuar pjesërisht përgjegjësitë e saj në lidhje me SKMDHF.

Konkluzion

MPMS nuk i ka zbatuar plotësisht përgjegjësitë e saj në lidhje me trajnimin gjithëpërfshirës për të gjithë aktorët që ofrojnë shërbime sociale; në krijimin e politikave dhe standardeve të shërbimit për mbrojtjen dhe trajtimin e duhur të viktimave; në sigurimin e një qasje ndërsektoriale ndaj shërbimeve që adresojnë nevojat e më të rrezikuara, siç janë personat me aftësi të ndryshme, personat LGBTQIA+ dhe pakicat; në sigurimin e shërbimeve gjithëpërfshirëse psikosociale; dhe, në mënyrë thelbësore, në caktimin e ndarjeve të mjaftueshme buxhetore për burime njerëzore dhe pajisje të mjaftueshme për të zbatuar kornizën ekzistuese ligjore.

Qendrat për Punë Sociale

Ndërsa personeli i kujdesit shëndetësor i intervistuar kishte prirje për njohuri rreth dhunës fizike brenda një marrëdhënieje me dhunë në familje, ata dinin më pak për format e tjera të dhunës me bazë gjinore dhe trajtimin e tyre të duhur. Për shembull, një punonjës i kujdesit shëndetësor tha: “Sulmi seksual është ngacmim i një femre pa pëlqimin e saj. Ose [sulmi seksual] bëhet në një vend që nuk është i përshtatshëm për të kryer një veprim të tillë”. Punonjësve shëndetësor u mungonte të kuptuarit e sulmeve seksuale, ngacmimeve seksuale, përdhunimeve, gjymtimeve gjenitale të grave dhe nxitjes për të ekspozuar pjesët intime të trupit. Për shembull, një punonjës i kujdesit shëndetësor tha: “Gjymtimi i organeve gjenitale mund të ndodhë gjatë seksit të dhunshëm”.²⁸³ Punonjësit shëndetësorë deklaruan se ata nuk kanë ndonjë protokoll të veçantë për trajtimin e gjymtimit gjenital të femrave, dhe ata do të përdorin vetëm protokollin operativ të mjekësisë ligjore. Në vitin 2013, MSH së bashku me UNFPA hartuan udhëzime për ofruesit e kujdesit shëndetësor se si të trajtojnë forma të ndryshme të

²⁷⁵ ABGJ, PSV, 2013.

²⁷⁶ MD, SKMDHF, 2017.

²⁷⁷ ABGJ, PSV, 2013.

²⁷⁸ ABGJ, PSV 2013, f. 40 dhe 68.

²⁷⁹ ABGJ, PSV, 2013, Shtojca 13.

²⁸⁰ Punonjësit mjekësorë ngritën shqetësime në lidhje me këtë gjatë intervistave (RrGK, 2020).

²⁸¹ Neni 378.

²⁸² Ligji Nr. 06/L-082 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

²⁸³ Intervistë e RrGK-së, 2020.

dhunës me bazë gjinore, por këto nuk përfshijnë gjymtimin e organeve gjenitale të grave.²⁸⁴ Për dhunën në familje, procedurat ishin më të qarta sesa për format e tjera të dhunës. Personeli mjekësor i intervistuar tentonte të thoshte se ishin në gjendje të zbulonin dhunën në familje dhe ata e dinin se ata duhet ta raportonin këtë dhunë në polici. Sidoqoftë, atyre u mungonte njohuria për LMDHF, PSV-të dhe SKMDHF.

SKMDHF parashikoi “trajnim dhe certifikim të vazhdueshëm të zyrtarëve të kujdesit shëndetësor të fokusuar në DHF, në tema të përcaktuara mirë dhe module të miratuara” (1.1.2.). MD 2017-2018 raportoi se kjo ishte kryer.²⁸⁵ Sidoqoftë, monitorimi i RrGK-së sugjeron që vetëm disa punonjës të kujdesit shëndetësor kanë ndjekur trajnim, veçanërisht duke pasur parasysh mangësitë e lartpërmendura në njohuritë e tyre mbi dhunën me bazë gjinore dhe kornizën ligjore përkatëse. Punonjësit mjekësor të intervistuar prireshin të mos kenë ndjekur ndonjë trajnim për identifikimin e shenjave të dhunës, mënyrën e komunikimit me personat që kanë përjetuar dhunën dhe rëndësinë e konfidencialitetit.

Punonjësit shëndetësor thanë se ata gjithmonë e përmbushin detyrën e tyre për të raportuar dhunën me bazë gjinore në polici. Sidoqoftë, ata shprehën shqetësim në lidhje me recidivizmin, siç tha një:

Procedurat nuk kryhen siç duhet bërë. Ka raste, për shembull, kur një nënë erdhi në emergjencë 13 herë për shkak të dhunës dhe fëmija i saj kërkoi ndihmë. [Një rast tjetër] ishte kur një fëmijë ishte lënduar shumë. [Kryesi] gati e mbyti atë por mbetet i lirë.²⁸⁶

Punonjësit shëndetësor thanë se ata shpesh hasnin raste të dhunës recidiviste dhe kështu mendonin se institucionet e tjera mund të mos ishin duke përmbushur përgjegjësitë e tyre. Ata thanë që institucionet e tjera nuk i komunikuan rezultatet e rasteve të tilla me punonjësit e kujdesit shëndetësor më pas, gjë që, thanë ata, mund t'i ndihmojë ata të trajtojnë më mirë rastet. Në lidhje me shërbimet e rehabilitimit, sipas SKMDHF, MSH duhet të mbështesë “sigurimin e këshillimit psikologjik-social afatshkurtër dhe afatgjatë për viktimat e dhunës në familje nga profesionistë të certifikuar” (4.1.1.). Sipas MSH, këshillimi psikosocial sigurohet në shtatë qendra rajonale të shëndetit mendor dhe viktimat e dhunës në familje shpesh kërkojnë ndihmë në këto qendra. Disa nga mjekët dhe infermierët e intervistuar i thanë RrGK-së se institucionet shëndetësore duhet t'i kanë këto shërbime më të disponueshme për kur viktimat kërkojnë kujdes mjekësor, pasi kjo do t'i ndihmonte ato. MSH gjithashtu duhet të sigurojë “trajtim mjekësor dhe këshillim për viktimat e dhunës në institucionet ekzistuese shëndetësore (qendrat e shëndetit mendor, psikologë, psikiatër)” (4.1.2.). Viktimat thuhet se morën trajtime të tilla mjekësore. MSH gjithashtu duhej të krijonte “qendra këshillimi për viktimat” (4.1.9.) dhe të trajnonte personelin e programit të rehabilitimit (4.4.2). Sipas MSH, personeli i programit të rehabilitimit është i trajnuar dhe i certifikuar, por punonjësit shëndetësor nuk ishin të informuar për këto trajnime. Fakti që

²⁸⁴ Udhëzimet iu siguruan RrGK-së nga MSH më 23 shkurt 2021.

²⁸⁵ MD, “Raporti i Parë i Monitorimit mbi Zbatimin e Planit të Veprimit të Strategjisë Kombëtare për Mbrojtjen nga Dhuna në Familje 2016-2020”, 2018.

²⁸⁶ Intervistë e RrGK-së, 2020.

përfaqësuesi i punonjësve shëndetësor nuk ishte në dijeni nëse MSH kishte zbatuar SKMDHF më tej sugjeroi që MSH ka ndërmarrë disa hapa drejt zbatimit të këtyre përgjegjësi.

Në lidhje me LMDHF, institucionet shëndetësore gjithashtu kanë përgjegjësi të ofrojnë shërbime rehabilitimi për kryesit e krimeve.²⁸⁷ Institucionet shëndetësore publike duhet të ekzekutojnë trajtimin mjekësor të urdhëruar nga gjykata për abuzimin e substancave në mesin e kryesve të dhunës. Një temë e përsëritur midis përfaqësuesve të institucioneve të ndryshme ishte se institucionet mjekësore ende nuk ofrojnë programe të duhura rehabilitimi për njerëzit që kanë nevojë për trajtim për abuzimin e substancave.²⁸⁸ Siç u përmend, Qendra Klinike Universitare e Kosovës ka ofruar shërbime rehabilituese për sëmundjet e varësisë që nga viti 2004; ata ofrojnë shërbime për trajtimin e drogës dhe alkoolit. Sidoqoftë, ose aktorët e tjerë përgjegjës nuk dinë për këto shërbime, ose kryesit jetojnë shumë larg shërbimeve për të qenë në gjendje të marrin ndihmën e nevojshme. Duket se nuk ekziston asnjë program trajtimi brenda institucioneve shëndetësore që kryesit e krimeve të punojnë drejt adresimit të faktorëve të tjerë që mund të kontribuojnë në dhunë, të tilla si trajtimi psikologjik në lidhje me marrëdhëniet e pushtetit, menaxhimi i zemërimit dhe çështje të tjera të shëndetit mendor.

Konkluzion

Ashtu si në vitin 2017, punonjësit e kujdesit shëndetësor ende nuk kishin njohuri rreth formave të ndryshme të dhunës me bazë gjinore përveç dhunës në familje, LMDHF, PSV-të, SKMDHF dhe mënyrën më të mirë për të trajtuar personat që vuanin dhunë me bazë gjinore, kryesisht sepse nuk kishin ndjekur trajnim. Punonjësit shëndetësor kanë një protokoll të veçantë për trajtimin e formave të dhunës me bazë gjinore përveç gjymtimit të organeve gjenitale. Ata e dinë detyrën e tyre për t'i referuar viktimat në polici dhe thanë se e bëjnë rregullisht këtë. Kujdesi shëndetësor fizik dhe mendor është në dispozicion për viktimat. Ndërkohë, shërbime gjithëpërfshirëse të rehabilitimit si për viktimat ashtu edhe për kryesit e krimeve mund të përmirësohen duke avancuar kapacitetet profesionale të punonjësve të kujdesit shëndetësor, përfshirë trajtimin e normave gjinore, menaxhimin e zemërimit dhe marrëdhëniet tradicionale të pushtetit.

INSTITUCIONET DHE SHËRBIMET ARSIMORE

Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT) duhet të sigurojë që shkollat, përmes arsimit, të parandalojnë dhunën si dhe të zbulojnë dhe referojnë rastet e identifikuara të dhunës me bazë gjinore. Institucionet arsimore gjithashtu janë përgjegjëse për arsimin e viktimave. Kjo pjesë përfshin përkatësisht nën-pjesët që shqyrtojnë parandalimin e dhunës dhe referimet, si dhe mbështetjen arsimore për viktimat.

Parandalimi i dhunës dhe referimet

Në përputhje me KS, SKMDHF parashikoi angazhimin e institucioneve arsimore në ngritjen e vetëdijes

²⁸⁷ LMDHF, nenet 4 dhe 9.

²⁸⁸ Kjo ishte gjithashtu një çështje më parë (Berisha dhe të tjerët për RrGK, *Nga Fjalët në Vepra*, 2017).

për forma të ndryshme të dhunës, mënyrën e raportimit të tyre dhe adresimin e shkaqeve themelore të dhunës me bazë gjinore, drejt transformimit të normave tradicionale gjinore. Në vitin 2014, MASHT publikoi një manual, në bashkëpunim me Save the Children në Kosovë.²⁸⁹ Manuali thotë që fëmijët në klasën e tetë (afërisht 13-14 vjeç) duhet të mësojnë përmes programeve mësimore për forma të ndryshme të dhunës dhe se si ata mund të raportojnë dhunën. MASHT gjithashtu ka zhvilluar kurrikula për dhunën në familje, të cilat mësohen në shkolla. Në drejtim të rritjes së ndërgjegjësimit për dhunën në familje, sipas SKMDHF, MASHT duhet të ketë rishikuar kurrikulën për arsimin parauniversitar, drejt sigurimit të përfshirjes së informacionit të standardizuar për dhunën në familje, llojet e dhunës dhe mënyrën e raportimit të dhunës (1.3.1.). Do të duhej të kishte përfshirë vëmendje të veçantë ndaj dhunës ndaj grave, fëmijëve, të moshuarve, personave me aftësi të ndryshme, personave LGBT dhe pakicave etnike. Sipas MASHT-it, të gjitha format e dhunës me bazë gjinore tani janë pjesë e kurrikulës shkollore, dhe disa materiale didaktike që adresojnë rastet e dhunës në familje janë shpërndarë nëpër shkolla.

SKMDHF parashikoi trajnim dhe çertifikim të vazhdueshëm vjetor të mësuesve, drejtorëve, këshilltarëve, psikologëve, komiteteve të menaxhimit në shkolla, prindërve dhe zyrtarëve në Drejtorinë Komunale të Arsimit të fokusuar në dhunën në familje (1.1.7.). Monitorimi që prej vitit 2017, ka zbuluar se arsimtarët nuk kanë ndjekur trajnime siç parashikohet nga SKMDHF; atyre në përgjithësi u mungonte njohuria në lidhje me SKMDHF dhe përgjegjësitë e tyre në lidhje me të.²⁹⁰ MASHT tha se disa takime u mbajtën në shkolla me arsimtarë dhe psikologë, por nuk kishin informacion nëse ishin mbajtur trajnime për dhunën në familje. Në vitin 2020, RrGK akoma gjeti prova minimale se trajnimi kishte arritur mjaftueshëm të arsimtarët dhe profesionistët e arsimit.

Për më tepër, intervistat e RrGK-së me përfaqësues të institucioneve arsimore në vitin 2020 sugjeruan që ata kishin njohuri minimale rreth dhunës me bazë gjinore, përfshirë sulmin seksual, dhunën në familje, përdhunimin, nxitjen për të ekspozuar pjesët intime të trupit dhe ngacmimet seksuale. Kur u pyetën se çfarë duhet të bëjë një grua që përjeton dhunë në familje, disa ranë dakord që ajo të qëndronte në familje, veçanërisht në rastet kur ata kanë fëmijë, në mënyrë që të përpiqen të arrijnë një mirëkuptim. Qëndrime të tilla, së bashku me kuptimin e dobët të dhunës me bazë gjinore dhe çështjet strukturore që mbështesin atë, mund të nënkuptojnë që arsimtarët nuk i ndihmojnë në mënyrë të duhur viktimat, përfshirë fëmijët, siç parashikohet në KS dhe kornizën ligjore të Kosovës.

Sipas KPK-së dhe PSV-ve, arsimtarët kanë detyrim ligjor të raportojnë dhunën në familje menjëherë kur dyshojnë se po i ndodh një nxënësi.²⁹¹ Në vitin 2015, arsimtarët e intervistuar nuk duket se e dinin këtë përgjegjësi.²⁹² Që nga viti 2013, Sistemi i Menaxhimit të Informacionit në Arsim e ka bërë më të lehtë raportimin e rasteve të mundshme të dhunës në familje. Sidoqoftë, ky program në vitin 2017 u përdor vetëm sipas rastit sepse personeli arsimor nuk kishte informacion në lidhje me numrin e rasteve

²⁸⁹ Arenliu, A., Ibra-Zariqi, Q., Puka, E., dhe Bahtiri, S., *Manuali Didaktik për Parandalimin e Dhunës*, 2014, f. 55.

²⁹⁰ Berisha dhe të tjerët për RrGK, *Nga Fjalët në Vepra*, 2017; MD, "Raporti i Parë i Monitorimit mbi Zbatimin e Planit të Veprimit të Strategjisë Kombëtare për Mbrojtjen nga Dhuna në Familje 2016-2020", 2018.

²⁹¹ IAP, neni 378; MD, SKMDHF, 2017.

²⁹² Farnsworth dhe të tjerët për RrGK, *Mjaft më me arsytje*, 2015.

të raportuara.²⁹³ Situata mbeti e njëjtë në vitin 2020; një pjesë e personelit arsimor nuk kishin dijeni se ekziston një platformë për raportimin e rasteve të dhunës në familje. MASHT deklaroi se rastet raportohen ende në internet, por personeli nuk ka informacion në lidhje me numrin e rasteve të raportuara.

Për më tepër, MASHT duhej të siguronte “sistematizimin e pedagogëve dhe psikologëve në shkolla” duke punësuar 80 pedagogë dhe psikologë të rinj çdo vit (1.2.1.). Këta psikologë dhe pedagogë duhej të ndihmonin fëmijët që kishin vështirësi me dhunë në familje. Për të lehtësuar emërimin e psikologëve dhe pedagogëve, SKMDHF parashikoi që MASHT të ndryshojë Udhëzimin Administrativ për “emërimin e pedagogëve dhe psikologëve” në mënyrë që të mos kufizojë emërimin e tyre bazuar në numrin e nxënësve në një shkollë, por përkundrazi të mundësojë që çdo shkollë të kanë të vetin.²⁹⁴ Sipas MASHT, Udhëzimi Administrativ u ndryshua, por zbatimi i tij ka munguar.²⁹⁵

Që nga viti 2015, vetëm komunat e Pejës dhe Gjilanit kishin angazhuar psikologë dhe pedagogë. Në vitin 2017, Kosova ka pasur 79 pedagogë dhe psikologë.²⁹⁶ Në vitin 2018 dhe 2019, është rritur në 84 dhe 99. Kurse në vitin 2020, janë 109 psikologë dhe pedagogë në total. Pavarësisht progresit, kjo nuk e përmbushi synimin e SKMDHF për punësimin e 80 psikologëve dhe pedagogëve çdo vit. Disa Drejtorit Komunalet të Arsimit treguan se në zonat rurale në veçanti mungojnë psikologët dhe pedagogët. Ata theksuan se nevojiten më shumë. Disa zona urbane gjithashtu duken se kanë mungesë; për shembull, vetëm nëntë psikologë dhe katër pedagogë u shërbejnë të gjithë 40,000 nxënësve në Komunën e Prishtinës, dhe ata nuk ndahen proporcionalisht nëpër shkolla. Për më tepër, psikologët që punojnë në shkolla me sa duket nuk kanë pasur trajnim adekuat mbi temat e dhunës në familje ose si të ndihmojnë në mënyrë të përshtatshme viktimat.

SKMDHF gjithashtu parashikoi që MASHT të bashkëpunonte me Drejtoritë Komunalet të Arsimit dhe ZBGJ-të në komuna për “prodhimin/shpërndarjen e informacionit mbi legjislacionin në fuqi, mbrojtjen që ofrohet dhe institucionet përkatëse ku mund të referohen (broshura)” (1.2.4.). Ky informacion është shpërndarë gjerësisht, përfshirë nga OSHC-të në bashkëpunim me institucionet. Për shembull, RrGK bashkëpunoi me ABGJ dhe IAP, mbështetur nga UNW dhe Agjencia Austriake e Zhvillimit, për disa fushata të mediave fizike dhe sociale duke shpjeguar se ku njerëzit mund të qasen për ndihmë. Në disa komuna, disa grupe me nxënës vizituan ekspozitat në rrugë, ku nxënësit mësuuan më shumë për institucionet që të drejtohen. Gjithashtu lidhur me arsimin, sipas SKMDHF, Zyra e Qeverisjes së Mirë ishte përgjegjëse për “organizimin e fushatave kombëtare të ndërgjegjësimit çdo vit, me tema të vendosura në përputhje me ditët ndërkombëtare/fushatat e organizuara..., dhe që synonin grupe të ndryshme individësh të cilët preken më shumë nga dhuna në familje, siç janë gratë, fëmijët, të moshuarit, personat me aftësi të kufizuara, komunitetet LGBT, RAE” (1.3.4.). RrGK nuk gjeti prova se Zyra për Qeverisje të Mirë kishte kryer këto fushata. Sidoqoftë, disa fushata u organizuan nga të tjerët. Më e rëndësishmja, një varg aktorësh të ndryshëm janë angazhuar në fushatën vjetore 16 Ditë kundër Dhunës ndaj Grave me veprime në përputhje me një kalendar të përbashkët, të koordinuar nga UNW.

²⁹³ Berisha dhe të tjerët për RrGK, *Nga Fjalët në Vepra* 2017.

²⁹⁴ SKMDHF, veprimi 1.2.2. Udhëzuesi Administrativ 26/2013.

²⁹⁵ RrGK në pajtueshmëri me MASHT, 2021.

²⁹⁶ Të dhënat e siguruar për RrGK nga MASHT, 2021.

Numri i përgjithshëm i pjesëmarrësve është i vështirë të vlerësohet. Fushatat dhe përpjekjet specifike kanë synuar gratë, fëmijët, personat me aftësi të kufizuara, LGBT dhe RAE.²⁹⁷ Sidoqoftë, ishte e paqartë nëse ndonjë fushatë kishte shënjestruar veçanërisht të moshuarit.

Mbështetja arsimore për viktimat

Drejtoritë Komunale të Arsimit janë përgjegjëse për sigurimin e arsimit për viktimat e dhunës në familje dhe mbështetjen e arsimimit të fëmijëve gjatë qëndrimit të tyre në strehimore.²⁹⁸ Edukatorët dhe psikologët e intervistuar nga RrGK thanë se fëmijët që kishin pësuar dhunë në familje morën të njëjtin trajtim si shokët e tyre të shkollës dhe asnjë shërbim të veçantë. Ndërkohë, ata vunë re se fëmijët që kanë qenë viktimat të dhunës në familje ose përballen me dhunë në familje performojnë dobët në shkollë. Sipas arsimtarëve, ata duhet të punojnë më shumë me këta fëmijë. Sidoqoftë, shkollat nuk mund ta ofrojnë mbështetje individuale sepse klasat janë të mbingarkuara dhe personeli arsimor “nuk ka kohë të mjaftueshme” për të punuar posaçërisht me fëmijët që kanë përjetuar dhunë në familje.

Sipas PSV-ve, viktimat duhet t'i identifikojnë kurset përkatëse arsimore në të cilat duan të marrin pjesë dhe kështu cilat institucione arsimore duhet t'i mbështesin ato në planet e rehabilitimit të lartpërmendura të krijuara së bashku me menaxherët e tyre të rasteve nga strehimoret ose QPS-të.²⁹⁹ Sipas PSV-ve, këto plane synojnë të “zhvillojnë kapacitetet profesionale të viktimës, të ndihmojnë në gjetjen e mundësive të punësimit dhe të integrojnë viktimën në shoqëri”.³⁰⁰ Për më tepër, sipas SKMDHF, MASHT duhet të ketë punuar në drejtim të “përfshirjes së viktimave të DHF në programet ekzistuese arsimore për të rritur” (4.1.3.). MASHT raportoi se ishte në kontakt me universitetet për të regjistruar viktimat mbi moshën 18 vjeç në programet bachelor. Megjithatë, nuk ekzistonte asnjë informacion në lidhje me hartimin e planifikuar të programeve arsimore bazuar në Ligjin për Arsimin e të Rriturve Nr. 04/L-143; mbi numrin e viktimave të përfshira në programet arsimore në vit; ose për bursat e dhëna. MASHT gjithashtu ka shpërndarë PSV-të nëpër institucione arsimore, sipas të cilave këto institucione duhet të mbështesin viktimat në vazhdimin e arsimimit të tyre. Sipas PSV-ve dhe SKMDHF-së, viktimat thuhet se po marrin ndihmë arsimore.³⁰¹

Konkluzion

Kurrikulat arsimore përfshijnë informacion mbi dhunën në familje, por ndoshta më pak për format e tjera të dhunës me bazë gjinore dhe për transformimin e roleve tradicionale gjinore. Sistemi i Menaxhimit të Informacionit në Arsim e ka bërë më të lehtë raportimin e rasteve të mundshme të dhunës në familje, por personeli arsimor nuk është në dijeni të tij dhe kështu nuk e përdorin atë. Edukatorët kishin njohuri minimale në lidhje me format e ndryshme të dhunës me bazë gjinore dhe si të ndërveprojnë me personat që kanë pësuar dhunë. Kjo, e shoqëruar me normat kulturore, mund të nënkuptojë që

²⁹⁷ Për shembull, mbështetur nga UNW, RrGK financoi tri organizata për të arritur këto grupe specifike në vitin 2020.

²⁹⁸ Berisha dhe të tjerët për RrGK, *Nga Fjalët në Vepra*, 2017.

²⁹⁹ ABGJ, PSV, 2013.

³⁰⁰ Po aty., f. 51.

³⁰¹ Intervistë e RrGK-së me zyrtarin e MASHT-it, 2020.

edukatorët jo gjithmonë raportojnë dhunën kur ajo ndodh, përkundër detyrimit të tyre ligjor për ta bërë këtë. Kjo sugjeron një nevojë për trajnime të mëtejshme të detyrueshme. Shkollat nuk kanë mjaft arsimtarë ose psikologë për të ndihmuar në mënyrë adekuate fëmijët që kanë nevojë për ndihmë shtesë. Programet e posaçme arsimore të financuara nga qeveria ekzistojnë për viktimat.

INSTITUCIONI I AVOKATIT TË POPULLIT

Institucioni i Avokatit të Popullit të Kosovës (IAP) është përgjegjës për adresimin e akuzave se shteti ka shkelur të drejtat e njeriut ose nuk ka përmbushur detyrimet e tij. Kur personat mendojnë se shteti ka shkelur të drejtat e tyre, të tilla si kur raportojnë një krim, IAP mund t'i ndihmojë ata të kërkojnë drejtësi. Prandaj, IAP është “ndalesa e fundit” për mbështetje kur institucionet e tjera kanë dështuar në përgjegjësitë e tyre. Personat që kanë pësuar dhunë me bazë gjinore, përfshirë dhunë në familje, mund t'i drejtohen IAP-së për hetim dhe ndihmë nëse besojnë se rasti i tyre është trajtuar keq nga institucionet.³⁰² Siç deklaroi Raporti Vjetor i IAP 2019, ata hetojnë për të siguruar që “i gjithë zinxhiri i institucioneve që adresojnë dhunën në familje të funksionojë si duhet”.³⁰³ IAP ka themeluar një Departament për Mbrojtje nga Diskriminimi, i cili merret me çështjet e barazisë gjinore. IAP ka shtatë zyra rajonale, dhe çdo zyrë ka një Njësi të Barazisë Gjinore dhe një Zyrtar për Barazi Gjinore.

Raportet vjetore të IAP-së për vitet 2017, 2018 dhe 2019 nuk përmendin sa ankesa kanë marrë në lidhje me dhunën me bazë gjinore. Në vitin 2019, IAP pranoi 65 raste në lidhje me barazinë gjinore, dhe 39 raste janë hapur për hetim, por raporti i tyre nuk specifikon nëse këto kishin të bënin me dhunën me bazë gjinore.³⁰⁴ IAP ende nuk ka një sistem adekuat të menaxhimit të të dhënave për të gjurmuar në mënyrë sasiore llojet e rasteve të ndihmuara dhe rezultatet e tyre, por ka është në planifikim që të zhvillohet një bazë të tillë të të dhënave.³⁰⁵ Në përgjithësi, IAP ka deklaruar se vendosja e dhunës në familje në KPK është një hap pozitiv, dhe fakti që më shumë njerëz raportojnë dhunë tregon se ata janë të vetëdijshëm për të drejtat e tyre dhe mund t'i kërkojnë ato.³⁰⁶

IAP mund të luajë një rol të rëndësishëm në zbatimin e parimit të kujdesit të duhur sipas KS,³⁰⁷ duke theksuar dështimet institucionale në përgjigjen ndaj dhunës me bazë gjinore, veçanërisht kur janë ndërmarrë hapa joadekuat për të parandaluar një vepër fatale. Të afërmit e personave që kanë vdekur mund të japin pëlqimin për hetimet e IAP.³⁰⁸ Kur IAP zbulon një vepër penale, organi përkatës kompetent informohet për të filluar një hetim.³⁰⁹

³⁰² MD, SKMDHF, 2017; ABGJ, PSV, 2013; Farnsworth dhe të tjerët për RrGK, *Mjaft më me arsytje*, 2015; Krol, dhe të tjerët, *Krijimi i hartës së shërbimeve mbështetëse për viktimat e dhunës ndaj grave në Kosovë*.

³⁰³ IAP, *Raporti Vjetor Nr. 19*, 2019, f. 79.

³⁰⁴ Po aty.

³⁰⁵ KWN interview, 2021.

³⁰⁶ IAP, *Raporti Vjetor Nr. 19*, 2019.

³⁰⁷ Shiko *Femicidi dhe detyra e kujdesit të duhur* më lart.

³⁰⁸ Ligji Nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit, Neni 16.6.

³⁰⁹ Po aty, neni 16.5.

ORGANIZATAT E SHOQËRISË CIVILE

Përveç strehimoreve, PSV-të dhe SKMDHF parashikojnë që organizatat e tjera të shoqërisë civile (OSHC) gjithashtu mund të mbështesin viktimat përmes këshillimit psikologjik ose ligjor, ndërgjegjësimi dhe/ose ndihmës në aplikimin për një UMPE.³¹⁰ Disa OSHC ofrojnë strehim gjatë ditës për viktimat e formave të ndryshme të dhunës me bazë gjinore, përfshirë shërbime specifike për personat LGBTQIA+, gratë me aftësi të kufizuara dhe gratë që kanë përjetuar dhunë seksuale ose forma të tjera të dhunës gjatë luftës.³¹¹ Në vitin 2017, të anketuarit nga OSHC-të treguan se viktimat e dhunës në familje ndjehen me rehatshëm të vijnë tek ata sesa të shkojnë në polici, për shkak të stigmave shoqërore që lidhen me dhunën në familje.³¹² Për më tepër, OSHC-të mund të luajnë një rol të rëndësishëm në monitorimin e qeverisë dhe mbajtjen e institucioneve përgjegjëse për zbatimin e kornizës ligjore përkatëse. OSHC-të gjithashtu mbështesin qeverinë për të zbatuar më mirë kornizën ligjore përmes ekspertizës së tyre.

Duke qenë se SKMDHF parashikon shprehimisht që OSHC-të do të angazhohen në mbështetjen e zbatimit të saj, praktika e mirë e parashikuar nga KS do të përfshinte shtetin i cili do të ndante fonde për të mbështetur përpjekjet e tyre për të kontribuar në zbatimin e kësaj strategjie qeveritare dhe plani të veprimit.³¹³ Sidoqoftë, SKMDHF nuk parashikoi ndonjë buxhet për OSHC-të. Ndërsa disa mikrogrante mund të jenë dhënë përmes ABGJ-së ose komunave, në përgjithësi qeveria nuk ka caktuar fonde për angazhimin dhe mbështetjen e OSHC-ve në rritjen e ndërgjegjësimi, ofrimin e shërbimeve ose rolet e tyre të monitorimit, përveç ndarjeve të sipërpërmendura të buxhetit të bëra për strehimore.

Të anketuarit e OSHC-ve të intervistuar në vitin 2017 kishin mungesë njohurish në lidhje me SKMDHF dhe rolin që parashikon që OSHC-të të kenë në zbatimin e saj, megjithëse disa kishin ndjekur trajnime siç parashikohet nga SKMDHF. Megjithatë disa OSHC nuk kishin njohuri për SKMDHF, ekzistonin raste të OSHC-ve që zbatonin SKMDHF pa e bërë qëllimisht atë. Për shembull, disa të anketuar përmendën organizimin e fushatave të shumta për rritjen e ndërgjegjësimi në lidhje me dhunën me bazë gjinore.³¹⁴ OSHC të shumta punojnë me grupe të marginalizuara të cilat mund ta kenë të vështirë të kërkojnë ndihmë nga aktorë të tjerë për shkak të frikës se institucionet shtetërore mund t'i diskriminojnë ata, ose ata kanë pak qasje në burime

“Për fat të mirë, kohët e fundit, dhuna nuk po rritet. Realisht, numri i njerëzve që raportojnë dhunë po rritet. Organizatat e shoqërisë civile dhe Rrjeti i Grave të Kosovës kanë bërë shumë fushata ndërgjegjëse, [dhe tani] një përqindje e grave janë më të vetëdijshme se si të mbrohen.”

- Përfaqësues i MD

³¹⁰ ABGJ, PSV, 2013; MD, SKMDHF, 2017.

³¹¹ Berisha dhe të tjerët për RrGK, *Nga Fjalët në Vepra*, 2017.

³¹² Po aty.

³¹³ Për informacion të mëtejshëm mbi rëndësinë e financimit të OSHC-ve në mënyrë të qëndrueshme, shih Farnsworth, N., Guri, N., Morina, D., Kohnen, T., për RrGK, *Ku janë paratë për të drejtat e grave*, 2020.

³¹⁴ Berisha dhe të tjerët për RrGK, *Nga Fjalët në Vepra*, 2017.

të disponueshme. Në këtë mënyrë, OSHC-të, pa e ditur, kanë kontribuar në zbatimin e SKMDHF.³¹⁵ OSHC-të ndërmorën disa iniciativa për të rritur ndërgjegjësimin në lidhje me dhunën me bazë gjinore, veçanërisht dhunën në familje, duke kontribuar kështu në objektivin e SKMDHF “1.3. Rritja e ndërgjegjësimit të shoqërisë për mos pranimin dhe mos tolerimin e dhunës në familje”. Për shembull, Gratë Aktive të Gjakovës ofruan ligjërata mbi dhunën në familje dhe dhunën në shkollë. Rrjeti i Organizatave të Grave Rome, Ashkali dhe Egjiptiane të Kosovës (RROGRAEK) ngriti me sukses ndërgjegjësimin për dhunën me bazë gjinore në këto komunitete, siç tregohet nga hulumtimi i tyre para dhe pas fushatës. Ata angazhuan dhe trajnuan vajza dhe djem për të kryer shtrirjen derë më derë brenda këtyre komuniteteve, duke informuar njerëzit për shkaqet dhe pasojat e dhunës me bazë gjinore dhe si ta raportojnë atë.³¹⁶ Qendra për Këshillim, Shërbime Sociale dhe Hulumtime (SIT) organizoi punëtorin dhe trajnime për të informuar njerëzit në lidhje me format e dhunës në familje. Të mbështetur nga UN Women dhe Agjencia Austriake e Zhvillimit, anëtarët e RrGK-së, përfshirë strehimoret, bashkëpunuan për të organizuar një ekspozitë interaktive në rrugë që udhëtoi në të gjithë Kosovën, duke rritur ndërgjegjësimin rreth formave të dhunës në familje dhe mënyrën se si njerëzit mund ta raportojnë atë, si dhe cilat institucione duhet të kontaktojnë nëse njerëzit nuk marrin një përgjigje të përshtatshme shtetërore. Artpolis angazhoi njerëz, veçanërisht të rinj, në fushatën globale të ndërgjegjësimit Një Miliard në Këmbë, duke informuar njerëzit se një miliard gra vuajnë nga dhuna me bazë gjinore çdo vit dhe duke i angazhuar njerëzit në ngritje kundër dhunës përmes muzikës dhe vallëzimit. Disa organizata kanë adresuar ngacmimet seksuale përmes fushatave të mediave sociale. Qendra Kosovare për Rehabilitimin e të Mbijetuarve të Torturës organizoi fushatë, ekspozita dhe dokumentarë për të fuqizuar viktimat dhe për të rritur ndërgjegjësimin në lidhje me dhunën seksuale të kryer gjatë luftës, përfitimet në dispozicion dhe për të fuqizuar viktimat. Zyrtarët vunë re se përpjekjet e shumta të OSHC-ve për ngritjen e vetëdijes kanë kontribuar në rritjen e ndërgjegjësimit dhe raportimin e rasteve, veçanërisht në zonat rurale.³¹⁷

OSHC-të gjithashtu ofruan referime dhe ndihmuan grupe potencialisht të marginalizuara ose të cenueshme. Qendra për Barazi dhe Liri, të cilat punojnë me persona LGBTQIA+, mbështetën dhe referuan raste të dhunës në familje në strehimoren e specializuar në Tiranë, pasi në Kosovë nuk ekziston një strehimore e tillë. Qendra për Zhvillimin e Grupeve Shoqërore, e cila gjithashtu punon me persona LGBTQIA+, dhe Qendra për Barazi dhe Liri gjithashtu ndihmuan individët me raportimin e dhunës në polici. Në mënyrë të ngjashme, duke pasur parasysh marrëdhëniet e tyre të ngushta me institucionet, RROGRAEK funksionon si një urë midis institucioneve dhe viktimave të dhunës në familje. Qendra për Ndihmën Juridike dhe Zhvillimin Rajonal ofron ndihmë juridike falas në rastet kur MV-të nuk mund të ndihmojnë. RrGK ka referuar raste tek institucionet përkatëse, ka monitoruar trajtimin e rasteve të dhunës me bazë gjinore nga institucionet shtetërore dhe ka ofruar ndihmë juridike në raste që nuk mund të kenë qasje në mbështetjen institucionale.

Institucione të shumta shtetërore përmendën gjithashtu se ato kanë marrë trajnim mbi dhunën me bazë gjinore ose dhunën në familje nga OSHC-të. Për shembull, RrGK ka mbështetur trajnimin e

³¹⁵ Po aty.

³¹⁶ Komentet e bëra gjatë kontrollit të pjesëmarrësve, 2021

³¹⁷ Intervistat e RrGGK me një përfaqësues të GEO dhe MD, 2020.

institucioneve të ndryshme për qasjen e tyre ndaj personave që kanë përjetuar dhunë me bazë gjinore. SIT gjithashtu punon me institucionet në drejtim të përmirësimit të shërbimeve që ata ofrojnë, përfshirë rehabilitimin e kryesve të veprës, gjë që mund të kontribuojë në parandalimin e dhunës në familje.

Lidhur me rehabilitimin dhe ri-integrimin, OSHC-të kontribuuan në zbatimin e objektivave të SKMDHF-së 4.1. “Themelimi i shërbimeve për rehabilitimin dhe fuqizimin e viktimave të dhunës në familje dhe rritjen e efikasitetit të tyre në nivelin qendror dhe komunal” dhe 4.4. “Krijimi i institucioneve të rehabilitimit dhe qendrave këshillimore me programe të detyrueshme për kryesit e dhunës në familje.” Meqenëse institucionet shtetërore kanë pak shërbime të tilla në dispozicion, disa OSHC ofrojnë mbështetje për rehabilitim dhe riintegrim. Qendra Kosovare e Rehabilitimit për Mbijetuarve e Torturës, Medica Gjakova dhe Medica Kosova ofrojnë trajtim psikosocial për viktimat e dhunës në familje dhe për të mbijetuarit e dhunës seksuale. Artpolis gjithashtu ofron trajnime për menaxhimin e stresit për viktimat e dhunës në familje dhe për personelin e strehimoreve. OShC-të që punojnë me personat me aftësi të kufizuara ofrojnë këshillim psikologjik për viktimat e dhunës në familje me aftësi të kufizuara. Për më tepër, disa strehimore, SIT dhe Medica Gjakova trajtojnë kryesit e dhunës. Gjatë pandemisë COVID-19, disa OShC-ve u desh të ndërpresin shërbimet e tyre, të paktën nga marsi deri në maj të vitit 2020, duke kufizuar kështu qasjen e grave në shërbime të rëndësishme mbështetëse gjatë asaj kohe.³¹⁸

Në përgjithësi, OSHC-të kanë kontribuar kështu në zbatimin e kornizës përkatëse ligjore përmes ndërgjegjësimit, referimeve, ofrimit të shërbimeve, monitorimit të gjykatave, ndihmës juridike dhe institucioneve të trajnimit, megjithëse ato rrallë kanë mbështetje financiare nga qeveria për këtë punë.

AKTORËT NDËRKOMBËTAR

Disa aktorë ndërkombëtarë kanë punuar drejt adresimit të dhunës me bazë gjinore në Kosovë (shiko Tabelën 1). Ata kanë mbështetur zhvillimin e kornizës ligjore të zbatueshme, mbështetur shërbime, investojnë në avancimin e kapaciteteve të institucioneve të ndryshme përgjegjëse, monitorojnë institucionet dhe financojnë përmirësimet e infrastrukturës shtetërore. Mbështetja e tyre ka ndihmuar në përmirësimin e shërbimeve në dispozicion të viktimave dhe koordinimin ndërmjet institucioneve në përgjigjen e tyre ndaj dhunës në familje, të tillë si përmes mbështetjes për MK. Ata kanë ofruar trajnime për PK-në, QPS-të, gjykatësit dhe strehimoret. Aktorët ndërkombëtar gjithashtu financuan fushatat e ngritjes së vetëdijes së OSHC-ve, instalimin e dhomave speciale të intervistave në QPS dhe stacionet e policisë dhe kamerat e trupit për policinë.

Duhet cekur se SKMDHF parashikon që aktorët ndërkombëtarë do të jenë përgjegjës për disa aktivitete brenda këtij plani qeveritar. Ndërsa Kosova mbase varet disi nga financimi ndërkombëtar, duhet të hartohen plane për të siguruar financim afatgjatë për zbatimin e legjislacionit dhe politikave që kanë të bëjnë me dhunën me bazë gjinore. Shteti nuk mund të varet në mënyrë të pafundme nga ndihma e huaj, dhe rolet dhe përgjegjësitë e institucioneve, veçanërisht siç parashikohen nga KS dhe ligji

³¹⁸ UNW, *Ndikimi i pandemisë COVID-19 në shërbimet e specializuara për viktimat dhe të mbijetuarit e dhunës në Kosovë **, një propozim për adresimin e nevojave, 2020.

kombëtar, duhet të buxhetohen brenda linjave të përhershme të buxhetit të Republikës së Kosovës.

Tabela 1. Përprojekjet e aktorëve ndërkombëtarë për të adresuar dhunën me bazë gjinore			
Aktori	Programet	Kur	Rezultatet
Shumica e të gjithë aktorëve më poshtë	16 Ditët e Aktivizimit Kundër Dhunës me Bazë Gjinore	2017-2020	Aktorë të ndryshëm kanë krijuar partneritete për të ngritur vetëdijen për dhunën ndaj grave. UNW koordinoi kalendarin e aktiviteteve të ndërmarra nga aktorë të ndryshëm.
Këshilli i Evropës	Hartëzimi i Shërbimeve për Viktimat e Dhunës me bazë Gjinore	2016-2021	Janë gjetur të gjitha shërbimet për gratë-viktima të dhunës, janë bërë rekomandime dhe organizuar trajnime për institucionet e përshtatshme, sipas Konventës së Stambollit .
	Raporti i Vlerësimit të Nevojave për Strehimore	2019-2020	Janë hulumtuar nevojat e strehimoreve në përputhje me KS.
	Edukimi për të Drejtat e Njeriut për Profesionistët Ligjorë (HELP) në kursin mbi Dhunën me Bazë Gjinore	2019-2020	Është përkthyer dhe përshtatur kursi i HELP i Këshillit të Evropës për Kosovën në gjuhët lokale (shqip dhe serbisht). Profesionistët ligjorë (gjyqtarë, prokurorë, avokatë, mbrojtës të viktimave dhe policia) janë trajnuar në kursin 12-javor mbi dhunën ndaj grave dhe dhunës në familje, sipas standardeve të KS dhe Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.
	Udhëzime të sigurimit të cilësisë për strehimore	2020	Kanë për qëllim të ndihmojnë autoritetet lokale në sigurimin e standardeve për viktimat në përputhje me KS.
	Kurrikula për Prokurorët dhe Gjyqtarët mbi Dhunën me Bazë Gjinore	2020	Rritja e kapaciteteve të profesionistëve ligjorë, kryesisht prokurorëve dhe gjykatësve, për të luftuar dhunën ndaj grave dhe dhunën në familje në Kosovë, duke përdorur kurrikulën e trajnerëve me Manualit dhe Udhëzuesit për Burimet e Trajnerëve të ofruar për Akademinë e Drejtësisë së Kosovës.

Tabela 1. Përpjekjet e aktorëve ndërkombëtarë për të adresuar dhunën me bazë gjinore

Aktori	Programet	Kur	Rezultatet
	Programet e trajtimit të kryesve të veprave: Analiza e kornizës ligjore të Kosovës * dhe raporti i praktikave të mira	2020-2021	Hulumtimi vlerësoi kornizën aktuale ligjore dhe të politikave në lidhje me kryesit e dhunës me bazë gjinore për të identifikuar nevojat, dhe identifikoi programet ekzistuese, duke propozuar rekomandime sipas standardeve dhe udhëzimeve ndërkombëtare.
	Udhëzime për rritjen e ndërgjegjësimit mbi dhunën me bazë gjinore	2020-2021	Me qëllim kishte informimin e nismave dhe fushatave të ndërgjegjësimit të autoriteteve, sipas standardeve të KS.
EU	Mbështetje për adresimin e dhunës me bazë gjinore (aktivitete të ndryshme)	2016-2020	U rishikua projekt legjislativ në përputhje me legjislativin e BE-së për barazi gjinore (EU Gender Equality Acquis) dhe u këshillua qeveria për ndryshimet e kërkuara ligjore dhe të politikave të nevojshme për të adresuar më mirë dhunën me bazë gjinore. Programi i Zbatimit të Normave dhe Ndryshimit të Mendjeve i mbështetur nga UN Women, përfshirë mbështetjen për Koordinatorin Kombëtar dhe menaxhimin e të dhënave, ndër aktivitete të tjera. Financimi është siguruar për strehimoret dhe qendrat ditore që trajtojnë personat që përjetuar dhunë me bazë gjinore. Mbështetja në reagimin ndaj COVID-19 përfshiu vëmendjen ndaj dhunës me bazë gjinore.
EULEX	Monitorimi i Dhunës me Bazë Gjinore	Mandati	Rritja e ndërgjegjësimit dhe standardeve të raportimit në lidhje me rastet e dhunës në familje, sulmit seksual dhe trafikimit me qenie njerëzore brenda policisë dhe institucioneve gjyqësore.
	Mbështetje e strehimoreve		Janë ndarë donacione strehimoreve.
	Rritja e kapaciteteve të Policisë së Kosovës	2019-2021	Trajnime për ngritjen e kapaciteteve për policinë për të rritur njohuritë e tyre në trajtimin e rasteve të dhunës me bazë gjinore, si të njohin shenjat e abuzimit dhe të flasin siç duhet me viktimat.

Tabela I. Përpjekjet e aktorëve ndërkombëtarë për të adresuar dhunën me bazë gjinore

Aktori	Programet	Kur	Rezultatet
	Fushata “Ma thuaj me kohë”	2019-2020	Fushata në shkolla në lidhje me dhunën seksuale, çfarë të bëhet kur ndodh sulmi seksual dhe rëndësia e provave biologjike. U vizituan 33 shkolla para pandemisë dhe u vazhdua me reklamat në TV dhe mediat sociale.
	Mbështetje për Komisionin		Mbështetje për Komisionin për Verifikimin e Statusit të të Mbijetuarve të Dhunës Seksuale së lidhur me konfliktin
KFOR	Mbështetja e aktorëve kombëtarë dhe ndërkombëtarë për të adresuar dhunën me bazë gjinore	2015-2020	U mbështeten strehimoret me furnizime të ndryshme thelbësore; u mbajtën prezantime mbi stereotipat gjinorë në shkollat e mesme; u ndihmuan OJQ-të e shumta me projekte humanitare në lidhje me dhunën me bazë gjinore; u organizua një konferencë online për 20 vjetorin e Rezolutës 1325
OSCE	Barazia gjinore në shkolla	2016-2017	U organizuan 20 sesione informuese mbi barazinë gjinore dhe dhunën me bazë gjinore me mësues dhe drejtorë të shkollave në komuna të ndryshme në gjithë Kosovën.
	Mbështetje për Grupin Punues Ndërmënyor kundër Dhunës në Familje	2017	U dhanë këshilla Grupit Punues të fokusuar në zbatimin e e kornizës së politikave për dhunën në familje.
	Mbështetje për Ofruesit e Kujdesit Shëndetësor mbi Dhunën në Familje	2017	U mbajtën pesë punëtori mbi atë se si të identifikohen, referohen dhe trajtohen viktimat e dhunës në familje. 100 ofrues të kujdesit shëndetësor dhe Policia e Kosovës mësuan përgjegjësitë e tyre siç përshkruhen në PSV-të
	Tryeza të rrumbullakta me temën Dhuna në Familje	2017	Tryeza të organizuara për 24 gjyqtarë, prokurorë, zyrtarë policorë, përfaqësues të QPS dhe MV nga rajone të zgjedhura për të diskutuar rastet e dhunës në familje, përfshirë ndjeshmërinë kulturore dhe ndërlikimet në ndjekjen penale.
	Mbështetje për viktimat e dhunës në familje	2017-2020	U diskutua me institucionet për të përmirësuar mekanizmat e mbrojtjes dhe mbështetjen e qëndrueshme për viktimat e dhunës në familje në rajonin e Prishtinës

Tabela I. Përpjekjet e aktorëve ndërkombëtarë për të adresuar dhunën me bazë gjinore

Aktori	Programet	Kur	Rezultatet
	Vlerësimi i reagimit të gjyqësorit ndaj dhunës në familje	Mandate	Monitorimi dhe raportimi mbi rastet e dhunës në familje dhe trajtimi i tyre nga institucionet e sistemit të drejtësisë.
	Mbështetja e Forumit të Grave Gjyqtare dhe Prokurore të Kosovës	2017	U mbështet Forumi për të organizuar një seri tryezash të rrumbullakëta mbi kornizën ligjore në lidhje me dhunën në familje dhe vështirësitë me zbatimin e saj në praktikë.
	Trajnime për gjyqtarë dhe prokurorë	2017-2020	U mbështet trajnimi mbi dhunën në familje për gjyqtarët, prokurorët, hetuesit e policisë, MV-të dhe punonjësit socialë.
	Barazia gjinore ka të bëjë edhe me burrat e djemtë	2017-2018	U mbështet puna me djemtë në shkolla për t'i dhënë fund dhunës me bazë gjinore. Është kryer studimi i parë gjithëpërfshirës mbi qëndrimet dhe praktikat e burrave ndaj dhunës me bazë gjinore.
	Sondazh mbi mirëqenien dhe sigurinë e grave	2018-2019	U ofruan të dhëna të hollësishme për modelet e dhunës ndaj grave, qëndrimet ndaj roleve gjinore dhe ndikimin e dhunës në jetën e grave të prekura.
	Strehimoret për Viktimat e Dhunës në Familje në Kosovë	2018-2019	Ofruan pasqyrën e situatës aktuale në strehimoret për dhunën në familje; përshkruan kornizën ligjore që rregullon funksionimin e tyre; dhe mekanizmat komunalë të mbrojtjes.
	Fëmijët së pari: Roli i QPS-ve në procedurat gjyqësore	2019-2020	Hetuan mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve të përfshirë në sistemin e drejtësisë në Kosovë. Vëzhgimet nga monitorimi i gjykitimit dhe intervistat me stafin gjyqësor dhe jo-gjyqësor të analizuar në dritën e ligjeve dhe standardeve vendore dhe ndërkombëtare
	Ngritja e kapaciteteve të operatorëve të linjës së ndihmës SOS	2020	Ngritja e kapaciteteve të operatorëve të linjës së ndihmës; trajnim mbi mbështetjen psiko-sociale për ZANV dhe operatorët e strehimoreve

Tabela I. Përpjekjet e aktorëve ndërkombëtarë për të adresuar dhunën me bazë gjinore

Aktori	Programet	Kur	Rezultatet
	Fushata për ngritjen e vetëdijes për parandalimin e dhunës me bazë gjinore	2020	Organizuan fushata për ngritjen e vetëdijes për të informuar të mbijetuarit rreth shërbimeve të disponueshme gjatë mbylljes për shkak të COVID-19. Avokuan për nënshkrimin e tre Memorandumeve të Mirëkuptimit ndërmjet komunave dhe strehimoreve për financimin e strehimoreve
	Sesion informues me Grupin e Grave Deputete të Kuvendit të Kosovës mbi KS.	2020	sesion Organizuan një sesion informues mbi parimet dhe përgjegjësitë kyçe të KS para se të votohet për KS në seancën plenare.
	Mbështetje për Ofruesit e Kujdesit Shëndetësor dhe Punëtorët Social mbi Dhunën në Familje	2020	Organizuan 5 punëtori rajonale për më shumë se 130 ofrues të kujdesit shëndetësor për përpunimin e rasteve të dhunës në familje. Përgatitën një broshurë informuese për përmirësimin e përgjigjes në adresimin e rasteve në bashkëpunim me UNFPA dhe IFM
UN Women	Drejtësia tranzicionale e ndjeshme gjinore	2015-2020	Mbështetje për krijimin dhe funksionimin e Komisionit Qeveritar për Verifikimin dhe Njohjen e të mbijetuarve të Dhunës Sexuale Lidhur me Konfliktin. U mbështeten prokurorët, hetuesit dhe avokatët në rastet e tyre.

Tabela I. Përpjekjet e aktorëve ndërkombëtarë për të adresuar dhunën me bazë gjinore

Aktori	Programet	Kur	Rezultatet
	Programi Rajonal në Ballkanin Perëndimor dhe Turqi: Zbatimi i Normave, Ndryshimi i Mendjeve, financuar nga BE	2017-2020	Mbështetën IO OShC në mbajtjen e qeverive të përgjegjshme, avokimin zbatimit efektiv të legjislacionit dhe monitorimin e reagimit të institucioneve ndaj dhunës ndaj grave, sipas CEDAW dhe KS, duke përfshirë adresimin e martesave të hershme dhe diskriminimin, veçanërisht për grupet në nevojë (p.sh., gratë me aftësi të ndryshme, gratë pakica dhe personat LGBT). Mbështetën MD dhe KNKDHF, krijimin e bazës kombëtare së të dhënave për dhunë me bazë gjinore. Forcuan kapacitete e ofruesve të shërbimeve, përkatësisht KM-ve për të rritur efikasitetin menaxherial lokal të rasteve të dhunës në familje, sipas KS. Ofruan trajnime të specializuara për institucionet kryesore. Forcuan rolin e Institucionit të Avokatit të Popullit dhe njohuritë e njerëzve lidhur me të. Mbështetën strehimore gjatë pandemisë COVID-19. Mbështetën MD për të adresuar boshllëqet në ligje, politika dhe shërbime. Mbështetën OSHCG në avokimin e tyre që KS të përfshihet në KPK. Nënshkruan memorandumin e mirëkuptimit me Komisionin e Pavarur të Mediave për të avokuar për ndalimin e stereotipave seksiste. Mbështetën marrëveshjen ndërmjet MD, RrGK-së dhe Rrjetit e Shitësve me Pakicë për të punësuar gratë që përjetuan dhunë. Organizuan konferencën rajonale me temën “Qasja në Drejtësi për Viktimat e Dhunës në Familje dhe Dhunës me Bazë Gjinore” në 2018.

Tabela I. Përpjekjet e aktorëve ndërkombëtarë për të adresuar dhunën me bazë gjinore

Aktori	Programet	Kur	Rezultatet
	Programi i Përbashkët për Drejtësi dhe Sundim të Ligjit	2019 – 2020	Rritja e njohurive dhe shkathtësive për të integruar në mënyrë strategjike barazinë gjinore dhe dhunën ndaj grave dhe vajzave në strategjitë lokale dhe planet e veprimit. Raport i përpiluar i progresit për SNKDHF për KNKDHF.. U siguruan 10 strehimore me furnizime esenciale (p.sh. veshje, laptopë për shkollim online dhe TV) mesCOVID-19. U angazhuan në fushatën për ngritjen e vetëdijes për dhunën me bazë gjinore.
	Asistimi i komuniteteve të pakicave të Kosovës dhe të mbijetuarve të dhunës në familje gjatë pandemisë	2020	Aplikacioni telefonik i PK-së për raportimin e rasteve u azhurnua për të përfshirë një veçori për raportimin e rasteve të dhunës në familje. Informacioni në lidhje me aplikacionin e ri u transmetua në media. U mbështetën strehimoret për të gjeneruar të ardhura përmes pajisjeve të dhëna donation. Të kuptuarit e nevojshëm të stafit të strehimoreve dhe MK-vepër procedurat e sigurisë gjatë urgjencave të shëndetit publik dhe protokollit të zhvilluar të sigurisë..
	Qasjet dhe përpjekjet e përgjegjshme gjinore për të luftuar shpërthimin e COVID-19 në Kosovë, mbështetur nga Ambasada e Kanadasë në Kroaci dhe Kosovë	2020	Ofruan mbrojtje të menjëhershme sociale dhe mbështetje psikosociale për gratë dhe burrat e marginalizuar në Kosovë. Dorëzuan 800 pako ushqimore dhe higjienike për gratë nga komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian. Organizuan diskutime për 8 OShC për gratë me aftësi të kufizuara për të diskutuar se si pandemia po ndikon tek anëtarët e tyre.
	Grupi për Siguri dhe Barazi Gjinore	2017-2020	Koordinon Grupin për Siguri dhe Barazi Gjinore, përfshirë avokimin e përbashkët dhe punët e tjera në lidhje me adresimin e dhunës. Në vitin 2020, nëngrupi i GSBGj për dhunën në familje u riaktivizua me ABGj si kryesese dhe UNW si sekretariat.

Tabela 1. Përpjekjet e aktorëve ndërkombëtarë për të adresuar dhunën me bazë gjinore

Aktori	Programet	Kur	Rezultatet
UNDP, UNW, UNFPA	Vlerësimi i shpejtë i ndikimit socio-ekonomik i COVID-19 në Kosovë	2020	Kryen dy vlerësime të ndikimit socio-ekonomik në maj dhe nëntor 2020 në lidhje me COVID-19, të cilat përfshinin një pyetje mbi dhunën në familje, me informacion në internet: Global Tracker. Mbështetën MF për të ndërmarrë analiza gjinore për të informuar ri-balancimin e buxhetit për të adresuar ndikimin e COVID-19 në gratë. Mbështetën përpjekjet e ABGj për të zbatuar masën COVID-19 në lidhje me fuqizimin ekonomik të grave dhe edukimin përfshirës gjatë fëmijërisë së hershme. Ofruan 10 trajnime mbi shërbimet e koordinuara multi-sektoriale në parandalimin dhe trajtimin e rasteve të dhunës në familje gjatë COVID-19 në nivelin lokal. Morën pjesë ofruesit e shërbimeve në MK nga 16 komuna..
UNDP	Projekti për siguri në Kosovë	2017-2020	U zhvillua korniza përkatëse ligjore, strategjitë dhe planet e veprimit të përqendruara në kontrollin e armëve të vogla, komunitetet më të sigurta dhe parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm..
UNICEF, UNFPA, UNW	Anketa e grupeve me tregues të shumëfishtë në Kosovë (MICS)	2019-2020	Mbështetën zbatimin e sondazhit përfaqësues kombëtar të familjes me popullatën e përgjithshme dhe një sondazh të veçantë të familjes duke u përqendruar në komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian në Kosovë, i cili mati qëndrimet për disa forma të dhunës, përfshirë dhunën në familje.
UNICEF	Analiza e Situatës së Grave dhe Fëmijëve në Kosovë	2019	Kryen analizën e situatës duke u fokusuar në fëmijët dhe gratë në Kosovë.
	Të jetosh në pandemi si i sapolindur, adoleshent dhe i ri	2020	Mbështetën vlerësimin e ndikimit të COVID-19 në fëmijë dhe gra në Kosovë.

Tabela I. Përpjekjet e aktorëve ndërkombëtarë për të adresuar dhunën me bazë gjinore

Aktori	Programet	Kur	Rezultatet
UNFPA	Zhvillimi i politikave dhe avokimi për shëndetin seksual dhe riprodhues, barazinë gjinore	Mandati	Mbështetën MSH-në në zhvillimin e udhëzimeve dhe protokolleve mbi dhunën me bazë gjinore, shëndetin e nënës, HIV dhe dhunën seksuale, dhe rishikimin e ligjit të shëndetit seksual dhe riprodhues. Mbështetën MASHT-in në zhvillimin e programeve mësimore dhe ndërtimin e kapaciteteve të mësuesve për Edukimin Gjithëpërfshirës Seksual, përfshirë barazinë gjinore dhe parandalimin e dhunës me bazë gjinore. Mbështetën OShC-të që adresojnë çështje të lidhura me dhunën me bazë gjinore përmes promovimit të shëndetit, edukimit me bazë teatrin dhe ndërgjegjësimin. Mbështetën strehimoret gjatë pandemisë COVID-19. Mbështetën planifikimin e familjes dhe shëndetin seksual dhe riprodhues me Shërbimet e Shëndetit gjatë COVID-19 në Prishtinë.
	Ngritja kapaciteteve të Ofruesve të Kujdesit Shëndetësor në Adresimin e Dhunës me Bazë Gjinore	2016 Në vazhdim	Ndërtuan kapacitetet institucionale të sektorit shëndetësor për të adresuar dhunën me bazë gjinore dhe të drejtat e shëndetit seksual dhe riprodhues, përfshirë parandalimin e kancerit të qafës së mitrës dhe gjirit në shëndetësinë primare përmes trajnimit, programeve dhe protokolleve.
	Adresimi i Barazisë Gjinore, Dhuna me Bazë Gjinore, Praktikë e Dëmshme dhe Diskriminimi	2016- Në vazhdim	U angazhuan me burra për të ndryshuar normat shoqërore dhe mentalitetin patriarkal drejt barazisë gjinore dhe parandalimit të dhunës me bazë gjinore, në partneritet me organizata të bazuara në besim dhe OSHC përmes iniciativave Men Engage dhe Men Care. Informimi i bazuar në komunitet për të rritur ndërgjegjësimin e popullatës mbi praktikë negative dhe të dëmshme të tilla si zgjedhja e seksit dhe martesë e hershme.
	Hulumtim mbi Qasjen në Kujdesin Shëndetësor për Personat me Aftësi të Kufizuara	2020	U hulumtua qasja e personave me aftësi të kufizuara në shërbimet që lidhen me shëndetin seksual dhe riprodhues, përfshirë shërbimet për të adresuar dhunën me bazë gjinore.

Tabela I. Përpjekjet e aktorëve ndërkombëtarë për të adresuar dhunën me bazë gjinore

Aktori	Programe	Kur	Rezultatet
UNMIK	Gratë, Paqja dhe Siguria	Mandate	Avokuan për miratimin e Rezolutës 1325 për gratë, paqen dhe sigurinë dhe zbatimin e saj në Kosovë. Mbështetën gratë të mbijetuara të dhunës seksuale gjatë luftës. Promovojnë, mbështesin dhe avokojnë për zbatimin e Rezolutës 1325.
	Mbështetje për OShCG-të e ndryshme	Mandate	Forcuan kapacitetet e OSHCG-ve. Për shembull, mbështetën INJECT-in për të avokuar për të drejtat e grave në për trashëgiminë e pronës dhe Fondacionin Jahjaga si dhe Medica Gjakova për të fuqizuar të mbijetuarit e dhunës seksuale.
	Mbështetja e luftës kundër dhunës me bazë gjinore	2017-2020 2018-2020	Mbështetën vlerësimin e përgjigjeve institucionale ndaj rasteve të dhunës me bazë gjinore; mbështetën KNMDHF përmes trajnimit për bazën e integruar e të dhënave; rritën njohuritë e profesionistëve ligjorë në raportimin, mbështetjen e viktimave dhe përgjegjësisë e kryesve të veprave e; ngritën performancën e institucioneve të zbatimit të ligjit dhe ato korrektuese në përputhje me normat dhe standardet e zbatueshme të drejtësisë penale dhe të të drejtave të njeriut; mbështetën rishikimin e PSV-ve; dhe morën pjesë në fushata. Fuqizuan kapacitetet e Shoqatës së Grave në Kosovë në Shërbimin Korrektues në lidhje me promovimin e barazisë gjinore dhe mosdiskriminimin; mbështetën krijimin e Qendrës për Ndihmë Ligjore për të ofruar shërbime për ata më në nevojë, përfshirë gratë dhe grupet e pakicave; mbështetën hetuesit e policisë për dhunën në familje në rritjen e kapaciteteve të tyre; dhe, mbështetën krijimin e MK-ve.
	Avokimi për të drejtat e pronësore të grave	2018-2020	Rritja e vetëdijes për lidhjen në mes të dhunës me bazë gjinore dhe qasjes në të drejtat pronësore përmes dokumentarëve dhe debateve, të ndjekur nga mbi 1,200 njerëz në 14 komuna..
	Mbështetje strehimoreve për viktimat e dhunës në familje	2019-2020	Mbështetën strehimoret në Novo Brdo/Novobërdë dhe Zubin Potok duke siguruar pajisje rinovuese. Siguruan pajisje për strehimoret për fëmijët që të marrin pjesë në mësimet online gjatë pandemisë. Dhanë si donacion gjëra esenciale.

Tabela I. Përpyjekjet e aktorëve ndërkombëtarë për të adresuar dhunën me bazë gjinore

Aktori	Programet	Kur	Rezultatet
UNDP, UNFPA, UN Women	Programi i Për-bashkët i KB për Dhunën në Familje në Kosovë	2013-2017	Mbështetën themelimin dhe zhvilluan kapacitetet e 10 MK-ve. Mbështetën Institutin Gjyqësor të Kosovës në avancimin e kapaciteteve të gjyqtarëve dhe prokurorëve mbi barazinë gjinore dhe të drejtat e njeriut të grave. Mbështetën MD për të zhvilluar SNMDHF. Mbështetën trajnimin e hetuesve të policisë dhe policisë së komunitetit për parandalimin dhe mbrojtjen e viktimave. Ngritja e vetëdijes së grave/vajzave për dhunën në familje dhe të drejtat e grave në komunat e zgjedhura . Rritja e pavarësisë ekonomike të të mbijetuarve.
U.S. Embassy	Java për të drejtat e viktimave të krimit	Mandati	Mbështetën MV dhe Prokurorin e Shtetit për të organizuar Javën e të Drejtave të Viktimave të Krimit.
	Trajnime për Zyr-tarët Ligjorë	2019-2020	Organizuan trajnime për të ngritur kapacitetet e prokurorëve dhe MV-ve.
	Donacioni i pajisjeve	2020	Dhuruan pajisje teknike për prokurorët, MV-të dhe strehimoret për të ndihmuar me shërbimet online gjatë pandemisë.
USAID	Mbështetja e OSh-CG-ve të Ndryshme në Adresimin e Dhunës me Bazë Gjinore	2017- Në vazhdim	Rritën kapacitetet e OSHCG për të parandaluar dhunën me bazë gjinore dhe forcuar përgjigjen institucionale. Gjithashtu mbështetën programet për qasjen në drejtësi, përfshirë ajp që lidhet me dhunën me bazë gjinore.

Tabela I. Përpjekjet e aktorëve ndërkombëtarë për të adresuar dhunën me bazë gjinore

Aktori	Programet	Kur	Rezultatet
IOM-UN Migration	Programet e ndryshme	2019 – Në vazhdim	Mbështetën strehimoret me pajisjet mbrojtëse gjatë pandemisë. Ofruan trajnim mbi parandalimin e shfrytëzimit dhe abuzimit seksual për institucionet dhe partnerët. Ofruan grante për bizneset që udhëhiqen nga gratë drejt arritjes së barazisë gjinore.

REKOMANDIME

Rekomandime Ligjore

Çështjet tematike

- Të integrohet të kuptuarit e dhunës me bazë gjinore si shkelje e të drejtave të njeriut dhe njohja e ndikimit disproporcional të kësaj dhune mbi gratë, në kornizën ligjore, veçanërisht brenda LMDHF dhe çdo ligji të ardhshëm që kërkon të adresojë dhunën me bazë gjinore. Të sigurohet që dokumentet e politikave dhe strategjive të përfshijnë një kuptim të mjaftueshëm të dhunës me bazë gjinore ndaj grave.
- Të zhvillohet dhe miratohet një strategji gjithëpërfshirëse kombëtare për luftimin e të gjitha formave të dhunës me bazë gjinore ndaj grave, pa u kufizuar në dhunën në familje. Strategjia duhet të sigurojë një përgjigje të integruar, koherente dhe të qëndrueshme ndaj kësaj dhune duke marrë parasysh masat e mandatuara nga KS. Në veçanti:
 - Të zhvillohen përgjegjësi të qarta, protokolle të standardizuara dhe udhëzime për personat që ka të ngjarë të përfshihen me viktimat dhe për bashkëpunim ndërinstitutional;
 - Të vazhdohet të mbështetet, institucionalizohet si dhe të bëhet i detyrueshëm, kur është e mundur, trajnimi bazë dhe i specializuar i të gjithë profesionistëve dhe zyrtarëve përkatës, përfshirë trajnime shumë-sektoriale, drejt një përgjigjeje të koordinuar, uniforme ndaj dhunës me bazë gjinore; dhe
 - Të vazhdoen përpjekjet për të parandaluar dhunën, përmes edukimit dhe fushatave të ndërgjegjësimit, duke bërë sensibilizimin e publikut për të gjitha format e dhunës me bazë gjinore ndaj grave, kornizën ligjore dhe mënyrën e përdorimit të shërbimeve mbështetëse. Të kërkohet të transformohen rolet tradicionale gjinore, duke përfshirë trajnime shumë-sektoriale,, drejt adresimit të shkaqeve kryesore të dhunës me bazë gjinore.
- Të përcaktohen organe të ndara plotësisht të institucionalizuara zyrtare për: (1) koordinimin dhe zbatimin, dhe (2) monitorimin dhe vlerësimin e politikave dhe masave për parandalimin dhe luftimin e të gjitha formave të dhunës me bazë gjinore sipas KS, me burime të përshtatshme njerëzore dhe financiare për të siguruar qëndrueshmëri përtej mandateve të qeverisë. Të përfshihen OSHC-të me përvojë në organin e monitorimit dhe vlerësimit.

E drejta materiale

- Të ndryshohet vepra e dhunës në familje në KPK, si dhe përkufizimet e dhunës dhe marrëdhënieve familjare në KPK dhe LMDHF, për të përmirësuar qartësinë.
- Të riformulohet LMDHF sikurse edhe Ligji për Dhunën me Bazë Gjinore për të zgjeruar qasjen në masa që mund të shqiptohen si pjesë e urdhrave të mbrojtjes për të gjitha format e dhunës me bazë gjinore të mbuluara nga KS. Të sigurohet që Ligji pranon nevojën për vëmendje të veçantë që duhet t'i kushtohet grave viktimat.

- Të zgjerohen rrethanat rënduese sipas KPK-së për siguruar përfshirjen e situatave në të cilat krimet kryhen nga partnerë dhe ish-partnerë të cilët nuk jetojnë me viktimën.
- Të merret parasysh adresimi i dhunës me bazë gjinore të mundësuar nga TIK në KPK.
- Të miratohet Drafti i KPPK-së për të forcuar të drejtat procedurale të viktimave.
- Të ndryshohet Ligji për Shërbime Sociale dhe Familjare për të përfshirë të gjitha shërbimet e mbrojtjes, rehabilitimit dhe riintegrit të parashikuara në KS. Sipas praktikave më të mira në buxhetimin e përgjegjshëm gjinor, të kryhet një analizë e plotë gjinore për të vlerësuar në mënyrë adekuate burimet e kërkuara për të zbatuar në mënyrë të përshtatshme këto shërbime. Pastaj, bazuar në këtë analizë, të caktohen ndarje adekuate të buxhetit në buxhetet vjetore për zbatimin e këtyre programeve. Në financimin e komunave, të përfshihet një grant specifik për sigurimin e këtyre shërbimeve sociale.
- Të fuqizohen viktimat e dhunës me zgjidhje afatgjata të strehimit duke zhvilluar kornizën ligjore për strehimin social, duke përfshirë një perspektivë gjinore.
- Të shfuqizohen referencat e papërshtatshme për pajtim në Ligjin e Familjes.
- Të ndryshohet Rregullorja Nr. 22/2015 për përcaktimin e procedurave për njohjen dhe verifikimin e statusit të viktimave të dhunës seksuale gjatë Luftës Çlirimtare të Kosovës për të ripërcaktuar periudhën e luftës së mbuluar, duke shmangur kështu çdo diskriminim të mundshëm në bazë të përkatësisë etnike, dhe për të zgatur periudhën që viktimat duhet të aplikojnë për njohje dhe përfitime, sipas rekomandimeve të Amnesty International.

Bashkëpunimi ndërinstitutional

- Të zhvendoset koordinimi i grupit ndërministror mbi dhunën në familje nën ABGJ si një organ më i lartë ndërinstitutional se Ministria e Drejtësisë. Ridefinoni mandatin e tij për t'u lidhur me të gjitha format e dhunës me bazë gjinore. Kjo mund të kontribojë në një qasje më gjithëpërfshirëse, më në qendër të viktimave për adresimin e formave të dhunës me bazë gjinore që nuk është vetëm në fokus të drejtësisë, por parashikon një qasje më gjithëpërfshirëse, ndër-ministrore për riintegrimin dhe rehabilitimin afatgjatë të viktimave. Të alokohen fonde shtetërore shtesë për një pozitë të re të përhershme të shërbyesit civil në ABGJ, për ekspertizë të gjerë sa i përket dhunës me bazë gjinore. Të përcaktohen qartë në Ligjin për dhunë me bazë gjinore përgjegjësitë e këtij Koordinatori Nacional që ndërlidhen me bashkëpunimin ndërinstitutional dhe zbatimin e strategjive dhe planeve të veprimit të ardhshme për adresimin e dhunës me bazë gjinore.
- Të themelohet një mandat i qartë ligjor për mekanizmat komunalë të koordinimit (MK-të), ndoshta sipas Ligjit për Shërbime Sociale dhe Familjare ose një Ligji të ri të ndryshuar për Dhunën me Bazë Gjinore, duke mishëruar përgjegjësitë e tyre në ligj dhe duke siguruar ndarje adekuate buxhetore për funksionimin e tyre të duhur, të qëndrueshëm. Të zgjerohet roli i tyre për të adresuar të gjitha format e dhunës me bazë gjinore dhe t'u sigurohet anëtarëve të tyre trajnim adekuat.
- Të ndahet buxhet i mjaftueshëm në nivelin qendror për të zgjeruar MK në komuna ku nuk ekzistojnë, si dhe institucionalizimi i tyre dhe të sigurohet trajnim i duhur i anëtarëve të tyre, si dhe koordinatorëve.

- Të zbatohet përdorim i duhur i bazës së të dhënave të menaxhimit të çështjeve, përfshirë të gjitha format e dhunës me bazë gjinore të mbuluara nga KS.
- Në funksionalizimin e Sistemit të Menaxhimit të Informacionit të Rasteve (CMIS), të sigurohet që të dhënat të ndahen sipas gjinisë dhe llojeve të dhunës, duke bërë të mundur analizimin e rasteve të përgjithshme nga ekspertët e jashtëm. Të angazhohen ekspertë të çështjeve gjinore të specializuar në statistikat gjinore në finalizim për të siguruar që përcjellë dhe prodhon raporte të drejtpërdrejta që publiku mund t'i përdorë në monitorimin e trajtimit të përgjithshëm të rasteve të dhunës me bazë gjinore, përfshirë informacionin mbi shkallët e dënimeve.
- Ndërsa sigurohet mbrojtja dhe konfidencialiteti i të dhënave, të përdoren solucone softuerësh për të ndërlidhur bazën e të dhënave të menaxhimit të rasteve me CMIS, duke u mundësuar aktorëve përkatës të përdorin me efikasitet kohën e tyre në futjen e të dhënave.
- Të sigurohet që të dhënat përmbledhëse janë të arritshme nga publiku përmes një ndërfaqeje në internet, si dhe të dorëzohen të paktën çdo tre muaj në Agjencinë e Statistikave të Kosovës në përputhje me Ligjin për Barazinë Gjinore.
- Të zgjatet mandati i Komisionit për Njohjen dhe Verifikimin e Statusit të Viktimave të Dhunës Seksuale. Të sigurohet mbikëqyrje falas për anëtarët e Komisionit, e kompensuar nga shteti.

Për Ministrinë e Financave

- Të mbështetet krijimi i linjave të përhershme buxhetore për trajtimin e dhunës me bazë gjinore brenda buxheteve të institucioneve përgjegjëse.
- Të zbatohen kërkesat ligjore për organizatat buxhetore për të kryer buxhetim të përgjegjshëm gjinor, përfshirë analizën gjinore, në informimin e ndarjeve të tyre buxhetore.
- Të ndahen fonde të rregullta vjetore për OSHC-të me përvojë për të ofruar shërbime, vetëdijësim të mëtejshëm dhe për të monitoruar në mënyrë të pavarur zbatimin nga qeveria të kornizës ligjore përkatëse.

Për Policinë

- Të kërkojnë fonde shtesë nga Ministria e Financave për të mbuluar shpenzimet emergjente të viktimave, siç rekomandohet në vitin 2017.
- Të detyrohen më shumë zyrtarë të PK-së që të marrin pjesë në trajnime themelore/bazike, të avancuara dhe shumë-sektoriale mbi dhunën me bazë gjinore dhe qasjen e duhur, veçanërisht reaguesit e parë të krimeve të dhunës në familje. Kjo duhet të përfshijë trajnime të mëtejshme mbi dhunën seksuale, duke shmangur fajësimin e viktimës, trajnime të ndjeshme kulturore (p.sh., në lidhje me martesën e hershme dhe gjymtimin e organeve gjenitale të grave), dhe marrëdhëniet e socializuara të pushtetit gjinor.
- Të sigurohet që urdhërat mbrojtës janë përdorur për të mundësuar që zyrtarët e policisë të largojnë kryesit nga një shtëpi e përbashkët dhe të lejojnë që viktimat të mbetet, si prioritet, siç pasqyrohet në KS.

- Të sigurohet që zyrtarët të ndjekin shkeljet e urdhrave të mbrojtjes si vepra penale.
- Të trajnohen më mirë oficerët e policisë në mënyrë që ata të kenë më shumë ndjeshmëri kulturore në komunitet në zonat me romë, ashkali dhe egjiptianë për të përmirësuar besimin në Policinë e Kosovës. Të sigurohet që zyrtarët të jenë të trajnuar mirë.
- Të merret parasysh ofrimi i trajnimeve TIK dhe dhuna në internet ndaj grave, veçanërisht për Njësinë e Hetimit të Krimit Kibernetik të PK-së.

Për Institutin e Mjekësisë Ligjore

- Të vazhdohet organizimi i fushatave sensibilizuese për të rritur njohuritë e publikut se si dhe kur të raportojnë dhunën seksuale, në bashkëpunim të ngushtë me OSHC-të dhe institucione të tjera.
- Të sigurohet përdorimi dhe funksionimi i duhur i PSV për trajtimin e rasteve të dhunës seksuale në IML.
- Të sigurohet disponueshmëria e këshillimit psikologjik pas kontrollimeve, në drejtim të parandalimit të ri-traumatizimit të viktimave.
- Të vazhdohet ofrimi i trajnimeve shtesë për format e dhunës seksuale dhe formave të tjera më të avancuara për personelin mbi dhunën me bazë gjinore dhe menaxhimin e rasteve.

Për Prokurorinë e Shtetit dhe Këshillin Prokurorial të Kosovës

- Të sigurohet që të gjitha komunat të kenë një prokuror në dispozicion i cili duhet të jetë i specializuar në rastet e dhunës me bazë gjinore.
- Të trajnohen prokurorët për përgjigje efektive të prokurorisë ndaj dhunës me bazë gjinore, dhe posaçërisht për përdorimin e veprës penale të dhunës në familje të KPK-së së bashku me akuza shtesë përkatëse. Për më tepër, të përfshihet në trajnim përkufizimi i familjes dhe konceptet e dhunës me bazë gjinore. Të merret parasysh përdorimi i rasteve studimore në trajnim dhe udhëzime nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës për të qartësuar këto çështje.

Për Mbrojtësit e Viktimave

- Të kërkohen ndarje shtesë të buxhetit për më shumë burime njerëzore për të punësuar dhe trajnuar më shumë MV, duke siguruar që MV-të të jenë në dispozicion dhe të pranishëm kur të bëjnë viktimat deklarata në stacionet e policisë (duke shmangur ri-traumatizimin), gjatë seancave gjyqësore dhe për të mbështetur më tej viktimat. Në rekrutim, të përdoren masa afirmative siç parashikohet në Ligjin për Barazi Gjinore për të punësuar më shumë gra si MV, si dhe ato që flasin rrjedhshëm gjuhët e pakicave (p.sh., gjuhen serbe, rome, turke).
- Të sigurohen trajnime të mëtejshme për MV-të mbi dhunën seksuale, si dhe masa të ndryshme në dispozicion përmes urdhrave të mbrojtjes, të cilët ata mund t'i rekomandojnë për të siguruar mbrojtjen dhe autonominë për viktimat.

Për Zyrat e Ndihmës Juridike

- Të sigurohet trajnim i detyrueshëm për ZNJ-të për të rritur ndërgjegjësimin e tyre për forma të ndryshme të dhunës me bazë gjinore me ndjeshmëri gjinore dhe si të ndihmojnë raste të tilla.
- Të merret parasysh zgjerimi i këshillimit në internet, drejt përdorimit efikas të burimeve të kufizuara për të arritur me shërbime mbështetëse më shumë gra në zona rurale, me aftësi të ndryshme dhe/ose gra që janë të izoluar. Për këtë qëllim, të sigurohet që zyrtarët të kenë trajnim të specializuar për mbështetjen online për përballjen e krizës dhe mbështetjen psikosociale afatgjat.

Për Këshillin Gjyqësor të Kosovës dhe Gjykatat

- Të rritet trajnimi i gjyqtarëve për zbatimin e rrethanave rënduese dhe lehtësuese. Të kërkohej që Udhëzuesi i Politikave Ndëshkimore i Gjykatës Supreme të referohet nga gjyqtarët kur shqiptojnë dënime, siç rekomandohet nga Instituti i Drejtësisë i Kosovës, dhe që arsyetimi i duhur të sigurohet në aktgjykime.
- Të sigurohet që trajnimi i gjyqtarëve dhe çdo udhëzues shoqëruar të theksojnë që gjyqësori nuk ka asnjë rol, as bazë ligjore për të kërkuar pajtimin midis një viktime të dhunës dhe një kryesi.
- Të detyrohen gjyqtarët civil dhe penal të ndjekin trajnime themelore, të përparuara dhe multi-sektoriale mbi marrëdhëniet e socializuara të pushtetit gjinor, mbi dhunën me bazë gjinore, mbi dhunën psikologjike, mbi dhunën seksuale, mbi dhunën ekonomike dhe të kenë ndjeshmëri gjinore mbi mënyrën e trajtimit të rasteve të dhunës në familje.
- Të monitorohet shqiptimi i dënimeve në rastet e dhunës me bazë gjinore; dhe përdorimi i pajtimit nga gjyqtarët, veçanërisht në rastet gjyqësore penale.
- Të respektohen dhe zbatohen të drejtat e palës së dëmtuar sipas nenit 62 pika 1.5 të KPPK-së, i cili parashikon: “nëse gjykata nuk mund të urdhërojë kompensimin nga i pandehuri apo të pandehurit për shkak të pamundësisë së tyre për të paguar, mungesës së kompetencës së gjykatës ose vdekjes, i dëmtuari ka të drejtë që të kërkojë nga gjykata që të dërgojë urdhrin për kompensim te koordinatori i fondit për kompensimin e viktimave”.
- Të emërohet dhe sigurohet disponueshmëria e gjyqtarëve të gjykatave civile dhe penale të specializuar në vendimin për rastet e dhunës me bazë gjinore.
- Të sigurohet një gjykim me kohë dhe prioritet i të gjitha rasteve të dhunës me bazë gjinore, siç parashikohet, por që jo gjithmonë zbatohet.
- Të kryhen hulumtime të mëtejshme për shkaqet e viktimave që tërheqin kërkesat për urdhër mbrojtje ose kërkojnë dënime të buta, si dhe mbi kujdestarinë e fëmijëve në lidhje me urdhrat e mbrojtjes, ndoshta në bashkëpunim të ngushtë me OSHC-të e specializuara në monitorimin e gjykatave.

Për Shërbimet Korrektuese dhe Shërbimet Sprovuese

- Të kërkohej që punonjësit të ndjekin trajnime mbi dhunën me bazë gjinore, PSV-të, menaxhimin

e rasteve dhe trajtimin e duhur të roleve të socializuara gjinore, marrëdhëniet e pushtetit, menaxhimin e zemërimit dhe varësinë nga substancat.

- Të zhvillohen programe të përshtatshme rehabilitimi për kryesit e krimeve që synojnë të transformojnë normat tradicionale gjinore dhe të adresojnë shkaqet themelore të dhunës me bazë gjinore, në konsultim të ngushtë me ekspertë të specializuar të barazisë gjinore.
- Të sigurohet që planet personale të rehabilitimit të përfshijnë “risocializimin në lidhje me marrëdhëniet e pushtetit dhe rolet tradicionale gjinore” drejt transformimit të marrëdhënieve tradicionale gjinore dhe parandalimin e dhunës recidiviste.
- Të zhvillohen sisteme të përmirësuara për përcjelljen e krimeve të kryera nga klientët, ndarjen sipas llojit të krimit të kryer, drejt planifikimit më të mirë dhe ofrimit të shërbimeve rehabilituese, si dhe parandalimin e përsëritjes së krimeve. Të përdoren sisteme për të monitoruar më mirë rehabilitimin dhe ri-integrimin e shkelësve.

Për MPMS dhe Qendrat për Punë Sociale

- Të organizohen trajnime për punonjësit social mbi KPK-në, PSV-të e reja, dhunën me bazë gjinore, dhe menaxhimin e përmirësuar të rasteve në rastet e dhunës me bazë gjinore. Të merret parasysh rekrutimi dhe trajnimi i punonjësve social të specializuar në trajtimin e rasteve të dhunës me bazë gjinore.
- Të krijohet një udhëzues dhe të organizohen trajnime për të mbështetur rekomandimet mbi mbrojtjen e fëmijëve në rastet e dhunës në familje dhe të kujdestarisë, duke përfshirë të drejtat e vizitës; dhe për të adresuar presionin për të pajtuar çiftet, drejt shmangies së recidivizmit.
- Të bëhet buxheti për më shumë burime njerëzore dhe automjete për punonjësit social që të kryejnë përgjegjësitë e tyre ligjore në mënyrë më adekuate.
- Të krijohen politikat dhe standardet e shërbimit për mbrojtjen dhe trajtimin e duhur të viktimave; të sigurohet një qasje ndër-sektoriale ndaj shërbimeve që adresojnë nevojat e më të rrezikuara, siç janë personat me aftësi të ndryshme, personat LGBTQIA+ dhe pakicat.

Për MPMS, Zyrat e Punësimit dhe Qendrat e Aftësimin Profesional

- Të sigurohen trajnime të detyrueshme mbi dhunën me bazë gjinore; KPK dhe referimet; qasja specifike për të ndihmuar personin që ka pësuar dhunë (duke përdorur kurrikulat e zhvilluara nga UNDP); dhe rëndësinë e sigurimit të konfidencialitetit kur ndihmojnë rastet, përfshirë punëdhënësit e mundshëm.

Për Strehimoret

- Të sigurohet mbikëqyrje dhe këshillim i rregullt psikologjik për të gjithë ofruesit e shërbimeve të strehimores nga profesionistë të trajnuar, në drejtim të parandalimit të “burnout” (shterimit).
- Të sigurohen trajnime për një qasje feministe për të ndihmuar dhe fuqizuar personat që kanë pësuar dhunë me bazë gjinore.

- Sigurimi i një qasje ndër-sektoriale ndaj shërbimeve që adresojnë nevojat e më të rrezikuarve, siç janë personat me aftësi të kufizuara, personat LGBTQ+ dhe pakicat.
- Rritja e kapaciteteve të brendshme për vlerësimin e nevojave, menaxhimin e të dhënave, planifikimin programatik, planifikimin profesional të zhvillimit të kapaciteteve dhe kostot.

Për MASHT dhe institucionet arsimore

- Të bëhet institucionalizimi i trajnimeve për edukatorët dhe psikologët për format e dhunës me bazë gjinore; si të identifikohen shenjat e dhunës me bazë gjinore; dhe si të ndihmohen dhe si të referohen në mënyrë të përshtatshme fëmijët që kanë pësuar dhunë.
- Të përfshihet materiali mësimor mbi barazinë midis grave dhe burrave, respektin e ndërsjellë, rolet gjinore jo stereotipike, dhunën me bazë gjinore dhe mënyrën e raportimit të tij në kurrikulat arsimore të përshtatshme për grupmosha të ndryshme, siç parashikohet nga KS.
- Të ndahet buxhet i mjaftueshëm për rritjen e numrit të psikologëve në shkolla.

Për MSH dhe institucionet shëndetësore

- Të sigurohen trajnime të detyrueshme mbi dhunën me bazë gjinore, dispozitat e reja të KPK-së, PSV-ve, LMDHF, identifikimin e shenjave të dhunës, komunikimin me viktimat e dhunës sigurimin e konfidencialitetit dhe referim i sigurtë për punonjësit e kujdesit shëndetësor.
- Të sigurohet trajnimi dhe zbatimi i një protokollit të veçantë për trajtimin e rasteve të dhunës seksuale, në përputhje me kërkesat e KS.
- Në bashkëpunim me ekspertët e OSHC-ve, strehimoret, MPMS-në dhe Institutin e Mjekësisë Ligjore, të krijohet një qendër për referimin e dhunës seksuale dhe qendër krize përdhunimi siç parashikohet nga KS me shërbime gjithëpërfshirëse të integruara, duke përfshirë trajtimin e kujdesit shëndetësor emergjent, këshillimin psikologjik, mbrojtjen përmes një strehimi afatshkurtër derisa të jetë i mundur rialokimi, dokumentimi mjeko-ligjor nga profesionistë me përvojë, dhe mekanizmat e duhur të referimit. Të bazohet në përvojat dhe mësimet e nxjerra në krijimin e Qendrës Liliun në Tiranë. Të sigurohen ndarje adekuate buxhetore për burimet njerëzore dhe kostot e tjera, përfshirë mbikëqyrjen e stafit për të parandaluar “burnout” (shterimin). Të merret parasysh krijimi i linjës ndihmëse të këshillimit psikologjik brenda së njëjtës qendër, me burime njerëzore të përshtatshme dhe të trajnuara.
- Të sigurohen kapacitete për punonjësit e kujdesit shëndetësor në menaxhimin klinik të rasteve të përdhunimit.

Për Komunitet

- Të merret parasysh ofrimi i trajnimeve themelore dhe shumë-sektorial për zyrtarët qeveritarë që punojnë brenda komunave për barazinë gjinore, dhunën me bazë gjinore, referimet dhe detyrimet komunale për buxhetin dhe ofrimin e këtyre shërbimeve.
- Të ndahen burime të mjaftueshme, bazuar në analizën gjinore dhe buxhetimin e përgjegjshëm

gjinor, për zbatimin e plotë të përgjegjësive komunale në lidhje me adresimin e të gjitha formave të dhunës me bazë gjinore. Të merret parasysh identifikimi i të ardhurave të reja të mundshme komunale në mënyrë që të mbulohen kostot që nuk financohen përmes nivelit qendror.

- Të sigurohen ambiente/ndërtesa për strehimore në komunat ku ato nuk janë të disponueshme dhe të ndahet strehim social për personat që kanë pësuar dhunë me bazë gjinore për të jetuar në mënyrë të pavarur.

PUNIME TË CITUARA

- Agjencia për Barazi Gjinore, Vlerësim i nivelit të zbatimit të Procedurave Standarde të Veprimit për Mbrojtje nga Dhuna në Familje në Kosovë, 2019, në: [https://abgj.rks-gov.net/assets/cms/uploads/files/Raporti%20ABGJ%20-%20Versimi%20i%20nivelet\(1\).pdf](https://abgj.rks-gov.net/assets/cms/uploads/files/Raporti%20ABGJ%20-%20Versimi%20i%20nivelet(1).pdf)
- Agjencia Evropiane për të Drejtat Themelore, “Adresimi i martesës së detyruar në BE: dispozitat ligjore dhe praktikat premtuese”, 2014, në: https://fra.europa.eu/sites/default/files/fra-2014-forced-marriage-eu_en.pdf.
- Agjencia e Statistikave të Kosovës, Anketa e Fuqisë Punëtore, 2019-2020, në: <https://ask.rks-gov.net/media/5369/anketa-e-fuqis%C3%AB-pun%C3%ABtore-afp-2019.pdf>
- Amnesty International, *Plagë që të Djegin Shpirtin: Kompensim për të mbijetuarit e përdhunimit gjatë luftës, por drejtësi s’ka akoma*, 2017, në: <https://www.amnesty.org/download/Documents/EUR7075582017ALBANIAN.PDF>
- Anitha, S. dhe Gill, A., “Shtrëngimi, pëlqimi dhe debati i martesës së detyruar në MB”, *Studime Ligjore Feministe*, 17 (2), 2009, 165-184
- Arenliu, A., Ibra-Zariqi, Q., Puka, E., dhe Bahtiri, S., “Manual didaktik për parandalimin e dhunës”, 2014, në: https://www.researchgate.net/publication/282284041_MANUAL_DIDAKTIK_PER_PARANDALIMIN_E_DHUNES_Didactic_manual_for_violence_prevention
- Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara, “Raporti i Raportuesit Special për dhunën ndaj grave, shkaqet dhe pasojat e saj”, (A/HRC/26/38), në: <http://undocs.org/en/A/HRC/26/38>
- Banjska, I., Ryan, D., Farnsworth, N., Demiri, L., Sijarina, L., and Tërshani, A. për RrGK, *Diskriminimi me bazë gjinore dhe punësimi në Kosovë*, 2019, në: https://womensnetwork.org/wp-content/uploads/2019/05/RrGK_Diskriminimi-me-baze-gjinore-dhe-punesimi-ne-Kosove_REV_FIN.pdf
- Bashkimi Evropian, Direktiva 2004/113/EC për zbatimin e parimit të trajtimit të barabartë midis burrave dhe grave në qasje dhe furnizim me mallra dhe shërbime, në: <https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/PDF/?uri=CELEX:32004L0113&from=EN>, Direktiva 2006/54/EC për zbatimin e parimit të mundësive të barabarta dhe trajtimit të barabartë të burrave dhe grave në çështjet e punësimit dhe profesionit (e rishikuar), në: <https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/PDF/?uri=CELEX:32006L0054&from=EN>
- _____, Direktiva 2011/36/EU për parandalimin dhe luftimin e trafikimit të qenieve njerëzore dhe mbrojtjen e viktimave të tij, në: <https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/PDF/?uri=CELEX:32011L0036&from=en>
- _____, Direktiva 2011/93/EU për luftimin e abuzimit seksual dhe shfrytëzimit seksual të fëmijëve dhe pornografisë së fëmijëve, në: <https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/PDF/?uri=CELEX:32011L0093&from=EN>
- _____, Direktiva 2011/99/EU për urdhrin evropian të mbrojtjes, në: <https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/PDF/?uri=CELEX:32011L0099&from=EN>
- _____, Direktiva 2012/29/EU për standardet minimale të përbashkëta për të drejtat, mbështetjen dhe mbrojtjen e viktimave, në: <https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/PDF/?uri=CELEX:32012L0029&from=en>
- _____, Rregullorja (BE) Nr. 606/2013 për njohjen reciproke të masave mbrojtëse në çështjet civile, në: <https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/PDF/?uri=CELEX:32013R0606&from=EN>
- _____, Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit ndërmjet Bashkimit Evropian dhe Kosovës (OJ L 71, 16.3.2016), në: [https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/PDF/?uri=CELEX:22016A0316\(01\)&from=EN](https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/PDF/?uri=CELEX:22016A0316(01)&from=EN)
- Bates, A., “Askush nuk do të më besonte kurrë: Një hulumtim i ndikimit të viktimizimit të dhunës së partnerit intim te burrat”, *Psikologjia e burrave dhe maskuliniteteve*, 2020, 21 (4), 497, në: <https://psycnet.apa.org/record/2019-12086-001>
- Bates, E. dhe të tjerët, *Po në lidhje me viktimat meshkuj? Eksplorimi i ndikimit të stereotipave gjinor në qëndrimet implicite dhe qëllimet e sjelljes të shoqëruara me dhunën e partnerit intim*, *Rolet e seksit*, 2018, 81, në: <https://link.springer.com/article/10.1007/s11199-018-0949-x>
- Berisha, A., Farnsworth, N., dhe Hoti, D. për RrGK, *Nga fjalët në vepra: Monitorimi i reagimit institucional ndaj dhunës me bazë gjinore në Kosovë*, 2017, në: <https://womensnetwork.org/wp-content/uploads/2018/10/20180312142859978.pdf>
- Bonewit, A., European Parliament Directorate-General for Internal Policies, “Study on the Issue of Violence Against Women in the European Union” (Studim mbi çështjen e dhunës ndaj grave në Bashkimin Evropian), në: [https://www.europarl.europa.eu/RegData/etudes/STUD/2016/556931/IPOL_STU\(2016\)556931_EN.pdf](https://www.europarl.europa.eu/RegData/etudes/STUD/2016/556931/IPOL_STU(2016)556931_EN.pdf)
- Broshura e Misionit të Bashkimit Evropian për Sundimin e Ligjit, IML, “Ma thuaj me kohë, dhuna seksuale është krim”, në: https://www.eulex-kosovo.eu/eul/repository/docs/176451-Broshura_Sq.pdf

- Buxhetin e Republikës së Kosovës, 2020, në: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=30422>
- Campbell, AM, *Një rrezik në rritje i dhunës në familje gjatë pandemisë Covid-19: Forcimi i bashkëpunimeve në komunitet për të shpëtuar jetë*, 2020, në: <https://www.ncbi.nlm.nih.gov/pmc/articles/PMC7152912/>
- Casey, E., Leek, E., Tolman, R., Allen, C., dhe Carlson, J., “Vendosja e burrave në dhomë: perceptimet e strategjive efektive për të filluar përfshirjen e burrave në parandalimin e dhunës me bazë gjinore në një mostër globale”, *Kultura, Shëndeti dhe Seksualiteti*, 19 (9), 2017, 979-995, në: <https://pubmed.ncbi.nlm.nih.gov/28276920/>
- Cook, R. dhe Cusack, S., *Stereotipat gjinorë të perspektivat juridike transnacionale*, University of Pennsylvania Press, 2010, në: <https://www.jstor.org/stable/j.ctt3fhmhd>
- De Hert, P. dhe Korenica, F., “Kushtetuta e Re e Kosovës dhe Marrëdhënia e saj me Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut: Kushtetutizmi “Pa” Ratifikim në Shoqëritë Pas Konfliktit”, *ZaöRV* 76 (1), 2016, në: https://www.zaoerv.de/76_2016/76_2016_1_a_143_166.pdf
- Duhaček, D., Branković, B. dhe Miražić, M. për Komisionin e Parlamentit Evropian për FEMM, *Të drejtat e grave në Ballkanin Perëndimor*, janar 2019, në: [https://www.europarl.europa.eu/RegData/etudes/STUD/2019/608852/IPOL_STU\(2019\)608852_EN.pdf](https://www.europarl.europa.eu/RegData/etudes/STUD/2019/608852/IPOL_STU(2019)608852_EN.pdf)
- Farnsworth, N. për RrGK, *Hulumtim kërkimor mbi nivelin e Dhunës në Baza Gjinore në Kosovë dhe ndikimin e tij në Shëndetin Riprodhues të Grave*, 2008, në: <https://womensnetwork.org/wp-content/uploads/2018/10/20130204170213282.pdf>
- Farnsworth, N., Guri, N., Selimaj-Krasniqi, N., Dushica, E., Maxharraj, A., Hanna, L., për RrGK, *Pandemia nuk di gjini? Analizë gjinore fiskale buxhetore: Reagimi i Qeverisë së Kosovës ndaj Pandemisë COVID-19 nga perspektiva gjinore*, 2020, në: https://womensnetwork.org/wp-content/uploads/2020/12/RrGK_Pandemia-nuk-njeh-gjini.pdf
- Farnsworth, N., Guri, N., Morina, D., Kohnen, T., për RrGK, *Ku janë paratë për të drejtat e grave*, 2020, në: <https://womensnetwork.org/sq/rrgk-prezanton-raportin-ku-jane%CC%88-parate%CC%88-pe%CC%88-te%CC%88-drejtat-e-grave/>
- Farnsworth, N., Morina, D., Ryan, D., Rrahmani, G., Robinson-Conlon, V., dhe Banjska, I. për RrGK, *Analiza gjinore e Kosovës*, 2018, në: <https://womensnetwork.org/wp-content/uploads/2018/10/20181003170921410.pdf>
- Farnsworth, N. dhe Qosaj-Mustafa, A. për RrGK në bashkëpunim të ngushtë me ABGJ, *Siguria fillon në shtëpi: Hulumtim për hartimin e strategjisë së parë nacionale dhe të planit të veprimit kundër dhunës në familje*, ABGJ: 2008, në: <https://womensnetwork.org/wp-content/uploads/2018/10/20130204170828216.pdf>
- Farnsworth, N., Qosaj-Mustafa, A., Banjska, I., Berisha, A. dhe Morina, D., për RrGK, *Mjaft më me arsye të drejtë – Një analizë e qëndrimeve, incidencës dhe përgjigjes institucionale ndaj dhunës në familje në Kosovë*, 2015, në: <https://womensnetwork.org/wp-content/uploads/2018/10/20151124105025644.pdf>
- Farnsworth, N., Qosaj-Mustafa, A., Ekonomi, M., Shima, A., dhe Dauti-Kadriu, D. për RrGK, *Me çfarë çmimi? Alokimet Buxhetore për Zbatimin e Kornizës Ligjore kundër Dhunës në Familje në Kosovë*, 2012, në: <https://womensnetwork.org/wp-content/uploads/2018/10/20130211130931258.pdf>
- Fondacioni Kvinna till Kvinna, *Të drejtat e grave në Ballkanin Perëndimor, Gratë në politikë, dhuna me bazë gjinore dhe siguria për gratë mbrojtëse të të drejtave të njeriut në Shqipëri, Bosnjë dhe Hercegovinë, Kosovë, Mal të Zi, Maqedoni të Veriut dhe Serbi 2020*, 2020, në: https://kvinnatillkvinna.org/wp-content/uploads/2020/11/The-KvinnatillKvinna-Foundation-report-RRBB_2020.pdf
- Fondi i Popullsisë i Kombeve të Bashkuara (UNFPA), *Dhuna me bazë gjinore*, 2017, në: <https://www.unfpa.org/gender-based-violence>
- Gavrić, S. për Lobin Evropian të Grave, “Hartëzimi i Politikave dhe Legjislacionit mbi Dhunën ndaj Grave dhe Konventa e Stambollit në Kosovë”, në: https://www.womenlobby.org/IMG/pdf/ewl-kosovo_report_web.pdf
- Gratë e Kombeve të Bashkuara (UNW), “Qasja e përqendruar në viktimë/të mbijetuar”, 2019, në: <https://www.endvawnow.org/en/articles/1790-victim-survivor-centred-approach.html?next=1789>
- _____, *Manual për Legjislacionin mbi Dhunën ndaj Grave*, Nju Jork, 2012, në: <https://www.unwomen.org/-/media/headquarters/attachments/sections/library/publications/2012/12/unw-legislation-supplement-en%20pdf.pdf?la=en&vs=1502>
- _____, *Ndikimi i pandemisë COVID-19 në shërbimet e specializuara për viktimat dhe të mbijetuarit e dhunës në Kosovë* *, një propozim për adresimin e nevojave, 2020, në: https://www2.unwomen.org/-/media/field%20office%20eca/attachments/publications/2020/06/kosovo%20covid-vaw_report2.pdf?la=en&vs=1823
- _____, “U themeluan strehimoret e përkohshme për të karantinuar të mbijetuarat e dhunës në familje në Kosovë”, 2020, në:

_____, “Kosova të fillojë të përdorë një bazë të të dhënave të integruar për rastet e dhunës në familje”, 2019, në: <https://eca.unwomen.org/en/news/stories/2019/04/kosovo-to-start-using-an-integrated-database-for-cases-of-domestic-violence>

Grupi i Ekspertëve për Masat kundër Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje (GREVIO), *Raporti i Vlerësimit Bazë - Shqipëri*, 2017, në: <https://www.kmd.al/wp-content/uploads/2020/07/Raporti-GREVIO.pdf>

_____, *Raporti i Vlerësimit Bazë - Mali i Zi*, 2018, në: <https://rm.coe.int/grevio-report-montenegro/16808e5614UNDP>

_____, *Raporti i Vlerësimit Bazë - Serbi*, 2019, në: <https://rm.coe.int/grevio-report-on-serbia/16809987e3>

Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut, *A kundër Kroacisë (Aplikimi nr. 55164/08)*, 2011, në: <https://rm.coe.int/16805a320f>

_____, *Hajduova kundër Sllovakisë (Aplikimi nr. 2660/03)*, 2011, në: <https://hudoc.echr.coe.int/eng#%7B%22i%20i%20butë%22%20%2001-101945%22%7D>

_____, *Opuz kundër Turqisë (Aplikimi nr. 33401/02)*, 2009, në: <https://policehumanrightsresources.org/opuz-v-turkey-application-no-33401-02>

_____, *X dhe Y kundër Hollandës (Kërkesa nr. 8978/80)*, 1985, në: <https://hudoc.echr.coe.int/fre#%7B%22i%20i%20butë%22%20%2001-57603%22%7D>

Instituti Evropian për Barazi Gjinore (EIIGE), “*Dhuna kibernetike ndaj grave dhe vajzave*”, në: <https://eige.europa.eu/publications/cyber-violence-against-women-and-girls>

_____, *Vlerësimi i kostove të dhunës me bazë gjinore në Bashkimin Evropian: Raporti*, 2014, në: <https://eige.europa.eu/publications/estimating-costs-gender-based-violence-european-union-report>

_____, *Terminologjia dhe Treguesit për Grumbullimin e të Dhënave: Përdhunimi, vrasja e grave dhe dhuna e partnerit intim*, 2017, në: <https://eige.europa.eu/publications/terminology-and-indicators-data-collection-rape-femicide-and-intimate-partner-violence-report>

Gjykata Supreme e Kosovës, *Udhëzues për politikën ndëshkimore*, Botimi i Parë, 2018, në: http://www.oak-ks.org/repository/docs/Udhezues_per_Politiken_Ndeshkimore_Shkurt_2018_346913.pdf

Henry, N. dhe Powell, A., “*Dhuna seksuale në epokën digjitale: Fusha dhe kufijtë e së drejtës penale*”, Studime Sociale dhe Ligjore, 2016, në: <https://journals.sagepub.com/doi/abs/10.1177/0964663915624273?journalCode=slsa>

Instituti Ligjor i Kosovës, “*Politika e Dënimeve në Kosovë: Analizë e zbatimit të Udhëzuesit për Politikë Ndëshkimore nga Gjykatat e Republikës së Kosovës*”, 2019, në: <https://kli-ks.org/wp-content/uploads/2019/11/Politika-ndeshkimore-ALB-FINAL-2.pdf>

Institucionet e Avokatit të Popullit, *Raporti Vjetor Nr. 19*, 2019

Këshilli i Evropës, *Të drejtat e fëmijëve*, 2019, në: [https://edoc.coe.int/en/children-s-rights/7869-childrens-rights-istanbul-convention.html#:~:text=Children's%20rights%20\(Istanbul%20Convention\)%20\(2019\)&text=The%20Istanbul%20Convention%20contains%20a%20violence%20and%20prosecute%20the%20perpetrators](https://edoc.coe.int/en/children-s-rights/7869-childrens-rights-istanbul-convention.html#:~:text=Children's%20rights%20(Istanbul%20Convention)%20(2019)&text=The%20Istanbul%20Convention%20contains%20a%20violence%20and%20prosecute%20the%20perpetrators)

_____, *Konventa e Këshillit të Evropës për parandalimin dhe luftimin e dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje (Konventa e Stambollit)*, 2011, në: <https://www.coe.int/en/web/conventions/full-list/-/conventions/rms/090000168008482e>

_____, “*Raporti Shpjegues për Konventën e Këshillit të Evropës për parandalimin dhe luftimin e dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje*”, 2011, në: <https://rm.coe.int/16800d383a>

_____, *Parandalimi dhe Luftimi i Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje në Ukrainë: “Praktikat dhe Standardet e mira Ndërkombëtare mbi Dhunën ndaj Grave dhe Dhunën në Familje*”, 2015, në: <https://rm.coe.int/168044e7c0>

_____, *Hartëzimi i shërbimeve mbështetëse për viktimat e dhunës ndaj grave në Kosovë*, 2017, <https://rm.coe.int/seminar-pristina-report-eng/16807316df>

_____, *Raporti i Vlerësimit të Nevojave: Udhëzime të cilësisë për strehimoret në mbështetje të viktimave të dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje në Kosovë*, 2019, në: <https://rm.coe.int/needs-assessment-report-shelters-of-vaw/16809fe04c>

_____, “*Kuvendi Kombëtar i Kosovës vendos të zbatojë Konventën e Stambollit*”, 2020, në: <https://www.coe.int/en/web/istanbul-convention/-/the-national-assembly-of-kosovo-decides-to-apply-the-istanbul-convention> <https://www.coe.int/en/web/istanbul-convention/-/the-national-assembly-of-kosovo-decides-to-apply-the-istanbul-convention>

_____, “*Rritja e ndërgjegjësimit mbi dhunën ndaj grave dhe dhunën në familje: puna me media në Kosovë*”, 2019, në:

[https://www.coe.int/en/web/genderequality/-/raising-awareness-on-violence-against-women-and-domestic-violence-working-with-media-in-kosovo-](https://www.coe.int/en/web/genderequality/-/raising-awareness-on-violence-against-women-and-domestic-violence-working-with-media-in-kosovo)

_____, Çfarë e shkakton dhunën me bazë gjinore?, ND, në: <https://www.coe.int/en/web/gender-matters/what-causes-gender-based-violence>

Komisioni Evropian, Dokumenti i Punës së Stafit të Komisionit, Raporti Kosovë 2018, 2018, në: <https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/20180417-kosovo-report.pdf>

_____, Dokumenti i Punës së Stafit të Komisionit, Raporti Kosovë 2019, 2019, në: <https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/20190529-kosovo-report.pdf>

_____, “Financimi i mbrojtjes sociale - Kosovë”, 2019, në: https://www.researchgate.net/profile/Artan-Mustafa/publication/336836025_Financing_social_protection_Kosovo/links/5db55a20a6fdccc99da3f9d1/Financing-social-protection-Kosovo.pdf

_____, “Ndikimet juridike të pranimit në BE të Konventës së Stambollit”, 2015, në: <https://www.europarl.europa.eu/cmsdata/115843/commission-report.pdf>

_____, Strategjitë kombëtare për të luftuar mungesën e strehimit dhe përjashtimin nga strehimi - Kosovë, 2019, në: <http://www.praxis.ee/wp-content/uploads/2017/09/homelessness.pdf>

_____, “Forcimi i të Drejtave të Viktimave: Nga kompensimi deri te dëmshpërblimi - për një strategji të re të BE-së për të drejtat e Viktimave 2020-2025”, 2019, në: https://ec.europa.eu/info/sites/info/files/strengthening_victims_rights_-_from_compensation_to_reparation.pdf

I.1.a. Profesionistët e shërbimeve bazë (të tillë si: punonjës të policisë, prokurorisë, mësues, edukatorë, mjekë e profesionistë të tjerë shëndetësorë, psikologë, punëtorë social, mbrojtës të viktimave, etj), të aftësuar ti identifikojnë dhe ti trajtojnë profesionalisht dhe pa paragjyqime rastet e dhunës në familje. → Është arritur pjesërisht: disa të trajnuar e disa jo. Në shumicën e institucioneve, kërkohet trajnim i mëtejshëm për të siguruar kuptim gjithëpërfshirës të dhunës në baza gjinore, profesionalizëm dhe mungesë paragjykimi.

I.2.a. Më shumë viktimë, të dhunës në familje, dhe anëtarë të shoqërisë të inkurajohen që të besojnë tek institucionet përkatëse, dhe si rezultat më shumë raste të dhunës në familje të jenë të raportuara/lajmëruara. → Me sa duket është arritur, siç tregohet nga rritja e rasteve të raportuara (shih I.2.a.I.).

I.3.a. Një përqindje më e madhe e vetëdijësuar e shoqërisë, për format e ndryshme të sjelljes së dhunshme, dhe e cila beson se dhuna në familje është e patolerueshme. → Shoqëria duket më e vetëdijëshme, por të dhënat krahasuese të anketës nuk janë të disponueshme për momentin për të krahasuar ndryshimin.

TREGUESIT NË NIVEL OBJEKTIVASH

I.1.a.I. Rritja me 50 për qind, deri në vitin 2020, e numrit të profesionistëve të shërbimeve bazë të trajnuar, të cilët vlerësohen, për trajtimin me profesionalizëm të rasteve të dhunës në familje. {Njësia matëse: përqindja. Të ndarë sipas: llojit të profesionistëve, komunave ku punojnë, numrit të trajnimeve të ofruara çdo vit, numrit të vlerësimeve të kryera dhe nëse është e mundur edhe vlerësimin që e kanë marrë për shembull në shkallën nga 1-5. Mjetet e verifikimit: të dhënat zyrtare për gjithçka sa më sipër dërguar në fund të vitit, nga çdo institucion zbatues, tek Zyra e Koordinatorit Nacional kundër DhF-së; raporti vjetor i monitorimit të zbatimit të strategjisë, që do të përgatitet nga Zyra e Koordinatorit Nacional kundër DhF-së [dhuna në familje] bazuar në sistemin e M&E-së [Monitorimi dhe vlerësimi] që do të krijohet në kuadër të zbatimit të kësaj strategjie}. → Ndonëse të dhënat gjithëpërfshirëse nuk ishin të disponueshme, bazuar në mostrën e intervistuar nga RrGK, kjo duket pjesërisht e zbatuar. Nuk ka bazë të dhënave për regjistrimin e trajnimeve.

I.2.a.I. Rritja me të paktën 10 për qind, deri në vitin 2020, e numrit të lajmërimeve të rasteve të dhunës në familje, si rezultat i rritjes së besimit të individëve tek institucionet përgjegjëse që ofrojnë mbrojtje dhe trajtim të këtyre rasteve. {Njësia matëse: përqindja. Të ndarë sipas: gjinisë, moshës, aftësive të veçanta, arsimimit, vendbanimit, statusit civil, vitit, institucioneve ku bëhet lajmërimi. Mjetet e verifikimit: të dhënat zyrtare, për gjithçka sa më sipër, dërguar në fund të vitit nga çdo institucion zbatues tek Zyra e Koordinatorit Nacional kundër DhF-së, ose raportet që do të përgatiten nga sistemi i databazës, që pritet të krijohet në kuadër të zbatimit të kësaj strategjie; raporti vjetor i monitorimit të zbatimit të strategjisë, që do të përgatitet nga Zyra e Koordinatorit Nacional kundër DhF-së, bazuar në sistemin e M&E-së, që do të krijohet në kuadër të zbatimit të kësaj strategjie, studimi mbarëkombëtar që do të bëhet sërish nga RrGGK-ja në vitin 2017 – nga ku është marrë edhe baza për vitin 2014.} → Me sa duket është arritur, siç tregohet nga rritja e raportimeve të dhunës në familje në PK, nga 2% në vit.³ Besimi në institucione nuk është matur, pasi RrGK nuk e realizoi por anketa është bazuar në marrëveshjen me aktorët e tjerë.⁴

I.3.a.I. Rritja me të paktën 20 për qind, deri në vitin 2020, e numrit të individëve të shoqërisë të vetëdijesuar, për format e ndryshme të dhunës, të cilët besojnë se dhuna në familje është e patolerueshme. {Njësia matëse: përqindja. Të ndarë sipas: gjinisë, moshës, aftësive të veçanta, arsimimit, vendbanimit, statusit civil, vitit. Mjetet e verifikimit: studimi mbarëkombëtar që do të kryhet nga RrGK-ja në vitin 2017 dhe ndoshta në vitin 2019.} → Të dhënat sasiore të padisponueshme për momentin, por të dhënat cilësore sugjerojnë që ka rritje.

³ Llogaritja e RrGGK-së e rritjes mesatare, bazuar në të dhënat e siguruar nga PK

⁴ Pasi OSBE-ja vendosi të kryejë një studim, në konsultim me aktorët e tjerë, u vendos që RrGK të mos bëjë sondazh në mënyrë që të shmanget anketimi i tepërt i popullatës dhe të parandalohet ri-traumatizimi. Edhe pse disa të dhëna mund të nxirren nga studimi i OSBE-së, ato nuk përfshijnë pyetje që kanë të bëjnë me të gjithë treguesit përkatës. Agjencia e Statistikave të Kosovës planifikon të bëjë një studim në vitin 2021 ose 2022 i cili ndoshta do të mund të sigurojë të dhëna për vlerësimin e mëtejshëm të progresit.

VEPRIME	GRUPET E SYNUARA	INSTITUCIONI ZBATUES	INSTITUCIONI MBËSHTETËS	PERIUDHA KOHORE	TREGUESIT E MONITORIMIT	Financimi Preventivi i Kostos (€) I siguruar	Burimet e Mundshme te Financuara (€)	Kerkohej Financim (€)	Implementimi ne 2017	Implementimi në 2020
Objekti 1.1 Ngritja e kapaciteteve profesionale, të profesionistëve, që ofrojnë shërbimet bazë (si: punonjës të policisë, prokurorë, mësues, edukatorë, mjekë dhe profesionistë të tjerë shëndetësorë, psikologë, punonjës social, mbrojtës të viktimave, etj) për parandalimin e dhunës në familje.										
I. I. I. Trajnimi i vazhdueshëm në baza vjetore dhe certifikimi i zyrtarëve, të Policisë së Kosovës, me fokus tek DhF-ja, me tematika të qëlluara dhe me module të aprovuara	Zyrtarët e Policisë së Kosovës	AKSP-ja dhe Policia e Kosovës	MPB-ja, Donatorët	2016-2020	Numri i moduleve të aprovuara me tematika të specifikuara për DhF-në; Kalendar i aprovuar vjetor i trajnimeve, Numri i zyrtarëve, të Policisë së Kosovës, çdo vit të; Certifikuar Regjistri i përditësuar, me të dhënat për zyrtarët e trajnuar, në bazë të trajnimeve të ofruara dhe certifikimeve të çdo zyrtari	Gjithsej 78, 974 ⁵ Shumë e siguruar nga: OSCE, UNDP, EC (shumat nuk janë ndarë).		Donatorët 78,973.52	0.5: Disa policë janë trajnuar, të tjerë jo; është e paqartë nëse trajnimet gjithmonë rrisin kapacitetet profesionale. Është e paqartë nëse ata kanë zhvilluar një modul të caktuar.	0.5: I përfunduar sipas raportit të monitorimit të MD 2017-2018. ⁶ Megjithatë, monitorimi i RrGK-së sugjeron që të policia të marrë pjesë në trajnime të dhunës në familje, por vetëm DVIU të marrin trajnime të rregullta për dhunën në familje; është e paqartë nëse trajnimet gjithmonë rrisin kapacitetet profesionale.

⁵ Të gjithë numrat në tabelë janë rrumbullakuar në vlerën më të përafërt në euro nga RrGK-ja për të lehtësuar prezantimin e gjetjeve dhe janë përshtatur me prezantimin e numrave në versionin e gjuhës angleze.

⁶ MD, "Raporti i Parë i Monitorimit mbi Zbatimin e Planit të Veprimit të Strategjisë Kombëtare për Mbrojtjen nga Dhuna në Familje 2016-2020", 2018.

I.1.2. Trajnimi i vazhdueshëm, në baza vjetore, dhe certifikimi i zyrtarëve të shëndetësisë, me fokus tek DhF-ja, me tematika të specifikuar dhe me module të aprovuara	Zyrtarët e shëndetësisë	Ministria e Shëndetësisë	Qendrat e Mjekësisë Familjare, UNFPA	2016 -2020	Numri i moduleve të aprovuara, me tematika të specifikuar, për DhF-në; Kalendar i aprovuar vjetor i trajnimeve, Numri i zyrtarëve të shëndetësisë të certifikuar çdo vit, Regjistri i përditësuar, me të dhënat për zyrtarët e trajnuar, në bazë të trajnimeve të ofruara dhe certifikimeve të çdo zyrtari.	Gjithsej 56,879.		Qeveria 28,416.42 Donatorët 28,462.65	0: RrGK nuk gjeti prova të një trajnimi të tillë.	0.5: I përfunduar sipas raportit të monitorimit të MD të përfunduar, por vetëm disa prej punonjësve shëndetësor janë të trajnuar. ⁷ Disa prej tyre janë të certifikuar nga Oda e Mjekëve Monitorimi i RrGK-së sugjeron që njohuritë mungojnë në mesin e disave.
I.1.3. Trajnimi i vazhdueshëm, në baza vjetore, dhe certifikimi i prokurorëve me fokus tek DhF-ja, me tematika të specifikuar dhe me module të aprovuara.	Prokurorët	Gjyqësor i Kosovës në bashkëpunim me Këshillin Prokurorial dhe Këshillin Gjyqësor	Donatorët dhe organizatat ndërkombëtare	2016-2020	Numri i moduleve të aprovuara, me tematika të specifikuar, për DhF-në; Kalendar i aprovuar vjetor i trajnimeve; Numri i prokurorëve të certifikuar çdo vit Regjistri i përditësuar, me të dhënat për prokurorët e trajnuar, në bazë të trajnimeve të ofruara dhe certifikimeve të çdo prokurori.	Gjithsej 11,991.61		Donatorët 11,991.61	0.5: Ka pasur disa trajnime, por trajnimi ende nuk është i institucion-alizuar.	1: E kompletuar sipas raportit të monitorimit të MJ dhe KNDHF. 73 prokurorë morën pjesë në trajnime dhe u certifikuan për dhunën në familje. ⁸

⁷ RrGK intervistë me KNDHF, 2021; informata nga MSH, 2021.

⁸ Informacioni i siguruar nga Këshilli Prokurorial i Kosovës, për periudhën 2017 - 2020.

I.1.4. Trajnimi i vazhdueshëm, në baza vjetore, dhe certifikimi i gjyqtarëve me fokus tek DhF-ja, me tematika të specifikuar dhe me module të aprovuara	Gjyqtarët	Instituti Gjyqësor i Kosovës në bashkëpunim me Këshillin Prokurorial dhe Këshillin Gjyqësor	Donatorët dhe organizatat ndërkombëtare	2016-2020	Numri i moduleve të aprovuara me tematika të specifikuar për DhF-në; Kalandari i aprovuar vjetor i trajnimeve. Numri i gjyqtarëve të certifikuar çdo vit Regjistri i përditësuar, me të dhënat për gjyqtarët e trajnuar, në bazë të trajnimeve të ofruara dhe certifikimeve të çdo gjyqtari.	Gjithsej 9,732		Donatorët 9,732	0.5 Ka pasur disa trajnime, por ato nuk duket të jenë të institucion-alizuara.	0.5: Trajnim ad-hoc dhe ofrohet vetëm nëse gjyqtarët e kërkojnë atë, sipas Akademisë së Drejtësisë.
I.1.5. Trajnimi i vazhdueshëm, në baza vjetore, dhe certifikimi i Mbrojtësve të Viktimave me fokus tek DhF-ja, me tematika të specifikuar dhe me module të aprovuara	Mbrojtësit e Viktimave	Prokuroria e Shtetit	Donatorët dhe organizatat ndërkombëtare	2016-2020	Numri i moduleve të aprovuara me tematika të specifikuar për DhF-në; Kalandari i aprovuar vjetor i trajnimeve Numri i MV-ve të certifikuar çdo vit Regjistri i përditësuar, me të dhënat për MV-të e trajnuar, në bazë të trajnimeve të ofruara dhe certifikimeve të çdo MV-je.	Gjithsej 16,701.67		Donatorët 16,701.67	0.5: Ata janë trajnuar, por është e paqartë nëse janë miratuar module të veçanta dhe janë institucion-alizuar trajnimet për to.	0.5: MV kanë ndjekur trajnime vazhdimisht, megjithatë asnjëherë nuk kanë marrë certifikim.
I.1.6. Trajnimi i vazhdueshëm, në baza vjetore, dhe certifikimi i punonjësve të QPS-ve, QAP-it dhe ZP-së me fokus tek DhF-ja, me tematika të specifikuar dhe me module të aprovuara	Punëtorët social, zyrtarët për BGJ-në dhe punonjësit e QPS-ve, QAP-it, ZP-së	Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale	QPS-të, QAP-i ZP-ja, Komunitat, DKA	2016-2020	Numri i moduleve të aprovuara me tematika specifike për DhF-në; Kalandari i aprovuar vjetor i trajnimeve Numri i punonjësve të certifikuar çdo vit Regjistri i përditësuar, me të dhënat për zyrtarët e trajnuar, në bazë të trajnimeve të ofruara dhe certifikimeve të çdo zyrtari.	Gjithsej 38,681.86		Donatorët 38,681.86	0.5: Është zhvilluar një modul; disa punonjës morën pjesë në një trajnim. Megjithatë, trajnimi ka qenë ad hoc dhe ende nuk është institucion-alizuar.	0.5: 161 trajnime për dhunën në familje janë mbajtur gjatë vitit 2017 deri në vitin 2020, përmes të cilave janë certifikuar 447 zyrtarë. Monitorimi i RrGK-së sugjeroi disa kufizime të njohurive; QAP dhe ZP nuk kanë marrë pjesë të gjithë në trajnim.

I.1.7. Trajnimi i vazhdueshëm, në baza vjetore, dhe certifikimi i stafit profesional (si: mësime të drejtues, pedagogë, psikologë, këshilli drejtues i shkollës, prindër, zyrtarë nga drejtoritë komunale të arsimit) me fokus tek DhF-ja, me tematika të specifikuar dhe me module të aprovuara.	Psikologët, mësuesit	Divizioni për Zhvillimin Profesional të Mësimeve të MASHT-i	ZAR, Drejtoritë e Shkollave, OJQ-të	2016-2020	Numri i moduleve të aprovuara me tematika specifike për DhF-në; Kalendar i aprovuar vjetor i trajnimeve Numri i të certifikuarve, në baza vjetore (4 grupe nga 80 pjesëmarrës) Regjistri i përditësuar, me të dhënat për zyrtarët e trajnuar, në bazë të trajnimeve të ofruara dhe certifikimeve të çdo zyrtari.	Gjithsej 25,057.36 Shuma e shpenzuar : 30,400		Donatorët 25,057.36	0	0.5: Sipas raportit të monitorimit të MD-së, ka progres dhe MASHT-i ka deklaruar se është përfunduar. Sidoqoftë, RrGK ka gjetur prova minimale se janë përfunduar.
I.1.8. Trajnimi i vazhdueshëm, në baza vjetore, dhe certifikimi i gazetarëve dhe zyrtarëve të mediave, mbi mënyrën, se si mediat mund të përdoren si mjet për parandalimin e DhF-së	Gazetarët, drejtuesit e medias	MAPL-ja ,AGK-ja (Asociacioni i Gazetarëve të Kosovës)	MPMS-ja	2016-2020	Numri i moduleve të aprovuara me tematika specifike për DhF-në; Kalendar i aprovuar vjetor i trajnimeve; Numri i të certifikuarve çdo vit; Regjistri i përditësuar, me të dhënat për zyrtarët e trajnuar, në bazë të trajnimeve të ofruara dhe certifikimeve të çdo zyrtari.	Gjithsej 9,494.		Donatorët 9,494.	0	0.5 Këshilli i Evropës dhe OSBE-ja kanë punuar me mediat
I.1.9. Trajnimi i vazhdueshëm, në baza vjetore, dhe certifikimi i punonjësve të OJQ-ve me fokus tek DhF-ja, me tematika të specifikuar dhe me module të aprovuara	Zyrtarët e OJQ-ve	MPMS-ja, Komuna, ABGj-ja	OJQ-të, Komuna, Donatorët	2016-2020	Numri i moduleve të aprovuara me tematika të specifikuar për DhF-në; Kalendar i aprovuar vjetor i trajnimeve; Numri i të certifikuarve çdo vit; Regjistri i përditësuar, me të dhënat për zyrtarët e trajnuar, në bazë të trajnimeve të ofruara dhe certifikimeve të çdo zyrtari	Gjithsej 17,188.92 Nuk ka informacion mbi buxhetin		Donatorët 17,188.92	0.5: Disa OJQ kanë organizuar ngritjen e kapaciteteve në kuadrin ligjor, llojet e DV. Megjithatë, nuk duket të ketë ndonjë trajnim të miratuar modular dhe instituciona.	I: Trajnimet e rregullta mbi dhunën në familje janë mbajtur në vitin 2018 dhe 2019 përmes ZBGj dhe MPMS. Disa OJQ organizuan dhe morën pjesë në trajnim.

Objektivi specifik 1.2. Inkurajimi i viktimave për lajmërimin e rasteve të dhunës në familje dhe rritja e besimit të tyre tek institucionet përkatëse.										
I.2.1. Sistemi i pedagogëve dhe psikologëve në shkolla (për çdo vit janë planifikuar 80 pedagogë/e psikologë/	Shkollat	MASHT-i	MF, Komunitat	2017 - 2020	Numri i pedagogëve dhe psikologëve të emëruar çdo vit; Numri i informatave të mbledhura prej tyre për rastet e DhF-së; Numri i rasteve të adresuara nga pedagogët dhe psikologët tek; Mekanizmi Koordinues (në ato komuna ku ekziston MK-ja) apo tek Policia e Kosovës.	Gjithsej 2,016,000.00 Nuk ka informacion mbi buxhetin	Qeveria 2,016,000.00		0	0.5: 50 pedagogë dhe 59 psikologë kanë qenë të punësuar në shkolla. Numri duket se është rritur, por nuk e ka përmbushur objektivin. ⁹ (2017 = 79; 2018 = 84; 2019 = 99; 2020 = 109). Numri i rasteve të dhunës në familje të adresuara nga psikologët mbetet i paqartë.
I.2.2. Plotësimi i Udhëzimit Administrativ për caktimin e pedagogëve dhe psikologëve (pra, të ndryshohet U.A 26/ 2013 - zgjedhja e nëpunësve – që numri i nxënësve për pedagogë dhe psikologë të mos kufizohet, por secila shkollë të ketë pedagogun dhe psikologun e saj)	Pedagogët, psikologët shkollat	MASHT-i	Drejtoritë Arsimore, MPMS-ja	Tremujori i fundit 2016	Udhëzimi i ndryshuar	Gjithsej 280	Qeveria 280		0	0: Raporti i monitorimit të MD-së tregoi progres, por asnjë informacion specifik nuk ishte ofruar. Statistikat e MASHT-it tregojnë se kjo nuk ka përparuar.

⁹ Bazuar në intervistat e RrGGK me zyrtarë në nivelin komunal: në Prishtinë për 40,000 studentë ka 9 psikologë dhe 3 ose 4 pedagogë, dhe vetëm 9 shkolla kanë psikolog. Në Ferizaj, në zonat rurale nuk ka psikologë ose pedagogë, por shkollat fillore në qytet kanë 7 psikologë, 4 pedagogë, dhe 2 sociologë dhe shkolla të mesme kanë 4 psikologë. Në Gjakovë, zonat rurale gjithashtu nuk kanë psikologë ose pedagogë. Në Gjiilan, përfaqësuesi i Departamentit Komunal të Arsimit nuk kishte informacion në lidhje me numrin e psikologëve dhe pedagogëve në shkolla. Në Mitrovicë, përfaqësuesi pretendoi se shkollat me të paktën 1,000 nxënës kishin një psikolog ose pedagog, por informacioni më i hollësishëm ishte i padisponueshëm. Në Pejë, përfaqësuesi tha se çdo shkollë kishte një psikolog, por nuk kishte informacion të saktë.

I.2.3. Informimi i publikut përmes medias për legjislacionin në fuqi, mbrojtjen që ofrohet dhe institucionet përkatëse ku duhet të adresohen	Publiku në tërësi (fokus i veçantë tek gratë)	Publiku në tërësi (fokus i veçantë tek gratë)	Media, Policia e Kosovës, MV-të, MK-ja, Komuna, donatorët, organizatat ndërkombëtare	2016-2020	Numri i emisioneve televizive apo radiofonike të organizuara; Numri i spotëve televizive të prodhuara dhe të shfaqura (shpeshësia e shfaqjes së tyre është gjithashtu e rëndësishme).	Gjithsej 87,038.90 Shumë e siguruar: Është vështirë të vlerësohet pasi janë të përfshirë shumë akterë ABGJ ka shpenzuar 5,860€ në vitin 2019 për parandalimin në përgjithësi. ¹⁰		Donatorët 87,038.90	0.5: Gjatë 16 ditëve të aktivizimit kundër dhunës ndaj grave, disa akterë promovuan legjislacionin në TV.	I: I bërë sipas raportit të monitorimit të MD dhe KNMDHF. Ekzistojnë gjithashtu dëshmi të programeve dhe spotëve televizive, të radio dhe mediave sociale.
I.2.4. Shpërndarja e informacioneve për legjislacionin në fuqi, mbrojtjen që ofrohet dhe institucionet përkatëse ku duhet të adresohen	Publiku në tërësi (fokus i veçantë tek gratë)	MASHT-i Drejtoritë Komonale për Arsim, ZBGj-të në Komuna	Ministritë përkatëse, Anëtarët e MKsë, donatorët, organizatat ndërkombëtare	2016-2020	Përqindja e popullsisë e vetëdijësuar për legjislacionin në fuqi, mbrojtjen që ofrohet dhe institucionet ku duhet të adresohen; Llojshmëria e mjeteve të përdorura (fletëpalosje, broshurë, poster, etj); Numri i materialeve të prodhuara dhe të shpërndara çdo vit, detajuar sipas tematikës, komunave dhe institucioneve që e kanë përgatitur dhe realizuar	Gjithsej 61,700.00 Shumë e siguruar: Është vështirë të vlerësohet pasi janë të përfshirë shumë akterë .		Donatorët 61,700.00	0.5: Gjatë 16 ditëve, disa akterë prodhuan informata mbi legjislacionin dhe mbrojtjen e disponueshme. Ndergjegjesimi i përgjithshëm do të vlerësohet në vitin 2020.	I: Informacioni është shpërndarë gjerësisht. % e popullsisë së arritur nuk mund të vlerësohet, por ky është pa dyshim tregues i nivelit të objektivit. MASHT nuk kishte informacion dhe KNMDH tha se ishte e nevojshme puna e mëtejshme.

¹⁰ Kjo mund të mos ketë qenë e rëndësishme vetëm për këtë linjë buxhetore; gjithashtu mund të ketë të bëjë me linja shtesë buxhetore.

I.2.5. Zbatimi me përgjegjësi e profesionalizëm i PSV-ve	PK-ja, QPStë, MSh-ja, MV-të, strehimoret	Secili institucion i cituar në PSV	institucionet përkatëse dhe OJQ-të	2016-2020	Numri i ankesave për moszbatim të PSV-ve paraqitur tek ZKNKDhF-ja, detajuar sipas institucioneve që nuk i kanë zbatuar PSVtë; Numri i masave të ndërmarra nga ZKNKDhF-ja në bashkëpunim me ministritë përkatëse, për institucionet, kundrejt të cilave janë listuar ankesat; Numri i personave të certifikuar rregullisht, në baza vjetore, për aplikimin e PSV-ve Numri i shkollave të pajisura me formularët e PSV –ve dhe për matjen e DhF-së; Numri i formularëve të shpërndara nga institucionet arsimore për parandalimin e DhF-së dhe zbatimin e PSV-ve.	Gjithsej – ABGJ ka shpenzuar 8,339€ për trajnimin e PSV			0: Nuk është paraqitur asnjë ankesë. Koordinator/ ja Nacional/ e ende nuk është emëruar. Shkollat nuk kanë njohuri për PSV dhe raportim.	0.5: Institucionet që kanë përgjegjësi sipas PSV-ve kanë njohuri për PSV-të dhe mënyrën se si t'i zbatojnë; ato. Disa, por jo të gjithë u trajnuan për PSV-të. Nuk u identifikuan ankesa, nuk u morën masa ose nuk kishte informacion mbi pajisjen e shkollave me mekanizmat e ankesave. MSH dhe MASHT nuk kanë të dhëna. ABGJ mbajti trajnim për PSV dhe çertifiko i 218 zyrtar.
Objekti i specifik 1.3. Rritja e vetëdijesimit të shoqërisë për të mos pranuar dhe për të mos toleruar ushtrimin e dhunës në familje										
I.3.1. Rishikimi i Kornizës së Kurikulës së Kosovës (KKK), të Arsimit para universitar (APU), dhe përfshirja në të e informacioneve, të standardizuara për DhF-në, si dhe dhënia e informacioneve për DhF-në, grupeve punuese për hartim të kurikulave lëndore - kategorizuar sipas të gjitha grupeve, mbi të cilat mund të ushtrohet kjo dhunë, (gra, fëmijë, të moshuar, PAK, LGBT, komunitetet jo-shumicë , etj), llojeve të dhunës si dhe ku mund të bëhet lajmërimi për rastet e dhunës.	Nxënësit, mësuesit	MASHT-i	ABGJ-ja, OJQ-të, MF-ja	2016 -2017	Numri i kurikulave të rishikuara, detajuar sipas tematikave dhe viteve; Numri i programeve të përfshira, detajuar sipas llojeve të dhunës si dhe ku mund të bëhet lajmërimi për rastet e dhunës	Gjithsej 18,789.30	Qeveria 18,789.30		0	I: Të gjitha format e dhunës me bazë gjinore tani janë pjesë e kurrikulës shkollore. Disa materiale didaktike që adresojnë rastet e dhunës në familje gjithashtu janë shpërndarë në shkolla. Nuk ka informacion në dispozicion në lidhje me buxhetin.

I.3.2. Studime kombëtare periodike mbi fenomenin, përmasat, profilin e autorëve të dhunës në familje/viktimave të dhunës në familje, etj	Publiku	Zyra e Koordinatorit Nacional kundër DhF-së (ZKNKDhF)	ABGj-ja, ministritë përkatëse, institucionet lokale; OJQ-të; donatorët, organizatat ndërkombëtare	2017-2020	Studimet e botuara	Gjithsej 26,690.00 ADA/ RrGK 50,000 ¹¹		Qeveria 13,345.00 Donatorët 13,345.00	0 gjatë kësaj periudhe.	0.5: Nuk ka asnjë raport nga KNMDhF. Raporti i OSBE-së dhe raporti aktual i RrGK-së përmbajnë disa nga këto informacione
I.3.3. Zhvillimi i buletineve statistikore vjetore mbi numrin e rasteve të raportuara dhe trajtuara në mënyrë multidisiplinare	Profesionistë të fushave të ndryshme	Zyra e Koordinatorit Nacional, ABGjja, Komuna	inistritë përkatëse, institucionet lokale, anëtarët e MKR-së, OJQ-të, donatorët, organizatat ndërkombëtare.	2017-2020	Numri i buletineve statistikore të botuara çdo vit, në nivel qendror e lokal, duke përfshirë edhe publikimin e tyre në internet	Gjithsej 47,932.22	Qeveria 47,932.22		0.5: Publikimet e rregullta të MV-së (gjithashtu online). Të tjerët nuk kanë publikuar të dhëna, por sigurojnë atë kur kërkohet.	0.5: Edhe pse institucionet individuale i kanë këto të dhëna, ato nuk janë publikuar online dhe të dhënat për qasjen multidisiplinare nuk janë publikuar nga KNMDhF.

¹¹ Mbështetur nga Agjencia Austriake e Zhvillimit (ADA), RrGK ka shpenzuar afërsisht 50,000 në lidhje me kërkimin mbi të gjitha format e dhunës me bazë gjinore gjatë kësaj periudhe.

I.3.4. Organizmi çdo vit i fushatave kombëtare vetëdijësuese, me tematika të përcaktuara në përputhje me ditët/fushatat ndërkombëtare të organizuara për të njëjtin qëllim, si dhe duke synuar grupe të ndryshme të individëve që rezultojnë më të prekur nga dhuna në familje, si: gratë, fëmijët, të moshuarit, PAK, LGBT, komuniteti RA	Publiku në tërësi	Zyra për Qeverisje të Mirë /ZKM	Ministritë përkatëse, institucionet lokale, anëtarët e MKR-së, komuna, OJQ-të, donatorët, organizatat ndërkombëtare, ZMV-ja	2016-2020	Numri i fushatave të organizuara; Kalendarët e koordinuar të aktiviteteve; Llojet e aktiviteteve të zhvilluara, numri i pjesëmarrësve në to, detajuar sipas grupeve që iu përkasin Numri i aktiviteteve vjetore të MASHT-it (nën temën “Dua jetë të lumtur në familjen time - fëmijët nuk duan dhunë në gjirin familjar) Numri i aktiviteteve i mbajtur me nxënës e prindër në disa nga lëndët mësimore (gjuhë shqipe, edukatë qytetare, fushë të arteve etj)	Gjithsej 104,080.80 ABGJ fushata vetëdijësues: €10,680 ¹² ADA/ UNW/ RrGK 20,000 ¹³		Qeveria 42,872.80 Donatorë	0.5: Gjatë 16 ditëve të aktivizimit, fushata koordinuese me disa aktivitete. Është e paqartë nëse ka grupe të caktuara në shënjestër, ose nëse MASHT ka vazhduar aktivitetet e tij, duke përfshirë edhe me nxënësit dhe prindërit në mënyrë të institucion-alizuar.	0.5: Zyra për Qeverisje të Mirë nuk e bëri, por fushatat e organizuara nga akterë të tjerë. Kalendarit 16 ditor i koordinuar nga UNW. Numri i pjesëmarrësve është vështirë të vlerësohet. Fushatat duket se kanë synuar gratë, fëmijët, personat me aftësi të kufizuara, LGBT dhe RAE, por është e paqartë nëse të moshuarit ishin të synuar. MASHT nuk kishte informacion.
I.3.5. Përfshirja e politikanëve në veprime vetëdijësuese, me transmetimin e porosive të përcaktuara nga ZKNK-DhF-ja, për vetëdijësimin e popullatës kundër dhunës në familje.	Politikanët, gratë deputete, gratë asambleiste	Kuvendi	ABGJ-ja, asambletë komunale, OJQ-të	2016-2020	Numri i aktiviteteve të organizuara, numri i politikanëve pjesëmarrës, detajuar sipas gjinisë, partisë politike, etj.	Gjithsej 13,010.10		Qeveria 13,010.10	0	0.5: Ndonjëherë politikanët figuronin në materialet për ngritjen e vetëdijes.

¹² ABGJ siguroi informacion në përgjithësi në lidhje me rritjen e ndërgjegjësimin, e cila arriti në këtë në vitin 2019. Sidoqoftë, linjat e tjera të buxhetit mund të kenë kontribuar gjithashtu në këtë.

¹³ Mbështetur nga ADA dhe UNW, RrGK ka shpenzuar afërsisht 20,000 në forma të ndryshme të ngritjes së vetëdijes, e cila gjithashtu përfshiu media dhe shtrirjen e grupeve në nevojë.

I.3.6. Mbajtja e ligjëratave të vazhdueshme, në baza vjetore, nga gjyqtarët dhe prokurorët për vetëdijimin e profesionistëve të rinj në lidhje me trajtimin e rasteve të dhunës në familje (shembull: Ligjëratat me studentët dhe praktikantët që mbahen në baza vjetore nga Forumi i Grave Gjyqtare dhe Prokurore).	Studentët e universiteteve të drejtësisë dhe të shkencave sociale	Prokuroria e Shtetit, Gjykatat themelore	MD-ja, Komunitat, ABGj-ja, KNDHF-ja	2016 - 2020	Numri i ligjëratave të mbajtura çdo vit, detajuar sipas tematikave dhe institucioneve që i kanë realizuar (gjykatë, prokurori), dhe komunave ku janë mbajtur; Numri i pjesëmarrësve i detajuar sipas gjinisë, moshës, fakultetit, komunës, etj.	Gjithsej 5,000.00 Shumë e siguruar: Shuma nuk është ndarë me RrGK-në.	Qeveria 5,000.00		0.5: Bërë me mbështetjen e US-AID-it dhe EULEX-it. Vazhdon.	I: Mbahen çdo vit, sipas Këshillit Prokurorial.
I.3.7. Përfshirja e viktimave të riintegruara të dhunës në familje, si modele të fuqizimit, në aktivitete vetëdijësuese (me vullnetin dhe konsensusin e tyre të plotë)	Grupet e rrezuara	Komunitat, MDja, ABGj-ja	MD-ja, ABGj-ja, OJQ-të	2018-2020	Numri i aktiviteteve të zhvilluara me praninë e viktimave të riintegruara, numri i pjesëmarrësve, etj	Gjithsej 16,000.00	-	Donatorët 16,000.00	0	0.5: Në një shembull të identifikuar, kjo kishte ndodhur.

SHTYLLA 2: MBROJTJA DHE KOORDINIMI

OBJEKTIVI STRATEGJIK 2: Të sigurojmë, deri në vitin 2020, mekanizma institucionalë gjithëpërfshirës dhe efikas, për reagim të shpejtë ndaj rasteve të dhunës në familje, si dhe bashkëpunim të përgjegjshëm ndër-institucional, mes palëve të pjesëmarrëse, në nivel qendror dhe lokal, për mbrojtjen dhe menaxhimin e këtyre rasteve. → Vetëm pjesërisht i zbatuar; dëshmitë identifikuan reagimin e ngadaltë dhe mangësi të mbetura në bashkëpunimin ndër-institucional dhe menaxhimin e rastit, megjithëse ka përmirësime të dukshme me MK-të

OBJEKTIVAT:

2.1. Avancimi i politikave gjithëpërfshirëse në kuadër të mbrojtjes së viktimave të dhunës në familje. → Hapat fillestarë të ndërmarrë sa i përket përfshirjes të KS, në Kushtetutë dhe adaptimin e amandamentimit tëKPK-së, por duhet të vendosen ende disa politika dhe standarde.

2.2. Përmirësimi i funksionalizimit të mekanizmave koordinues institucionalë ekzistues në nivel lokal si dhe ngritja e tyre në komunat ku mungojnë. → Ka përmirësim të vërejtshëm, por MK-të nuk janë vendosur dhe nuk janë funksionale në tërë Kosovën.

2.3. Përmirësimi i koordinimit dhe bashkëpunimit ndërinstitucional ndërmjet nivelit qendror, lokal dhe organizatave të shoqërisë civile për mbrojtjen e viktimave përmes qartësimit të roleve, detyrave dhe përgjegjësi të secilit institucion në ofrimin e shërbimeve adekuate. → Pjesërisht i zbatuar: Koordinimi duket se është përmirësuar tek disa MK-të, por shërbimet e kufizuara janë ende të disponueshme, gjë që lidhet me kufizimet në legjislacionin kombëtar

Rezultatet e pritura:

2.1.a. Më shumë politika gjithëpërfshirëse dhe standarde të avancuara, të aplikuara me përgjegjësi, për mbrojtjen dhe sigurinë e viktimave të dhunës në familje. → Hapat fillestarë të ndërmarrë drejt përfshirjes së KS në Kushtetutë dhe amandamentimi i KPK-së, por duhet të vendosen ende disa politika dhe standarde. Nevojitet zbatim i mëtejshëm.

2.2.a. Mekanizma koordinues institucionalë funksionalë dhe efikas, të shtrirë në të gjithë territorin e Kosovës. → Ka përmirësim të vërejtshëm, por MK-të nuk janë vendosur dhe nuk janë funksionale në tërë Kosovën dhe nuk janë gjithmonë efikasë.

2.3.a. Më shumë shërbime ndërinstitucionale dhe të koordinuara ndërmjet nivelit qendror dhe atij lokal, për mbrojtjen e viktimave të dhunës në familje, të ngritura në mbarë Kosovën, të specializuara dhe të shumëllojshme sipas kërkesave dhe standardeve të parashikuara në legjislacionin vendor dhe atë ndërkombëtar. → Pjesërisht i zbatuar: Koordinimi duket se është përmirësuar tek disa MK-të, por shërbimet e kufizuara janë ende të disponueshme, gjë që lidhet me kufizimet në legjislacionin kombëtar.

TREGUESIT NË NIVEL OBJEKTIVASH

2.1.a.1. Rritja në masën 50 për qind, deri në vitin 2020, e numrit të politikave dhe standardeve të përmirësuara të aplikuara për mbrojtjen e viktimave të dhunës në familje. {Njësia matëse: përqindja. Të ndarë sipas: llojit të politikave apo standardeve të përmirësuara dhe të miratuara çdo vit, që zbatohen rregullisht nga institucionet, sipas komunave. Mjetet e verifikimit: të dhënat zyrtare për gjithçka si më sipër, dërguar në fund të vitit, nga çdo institucion zbatues, tek Zyra e Koordinatorit Nacional kundër DhF-së; raporti vjetor i monitorimit të zbatimit të strategjisë, që do të përgatitet nga Zyra e Koordinatorit Nacional kundër DhF-së, bazuar në sistemin e M&E-së që do të krijohet në kuadër të zbatimit të kësaj strategjie}. → Vështirë të matet si përqindje sipas treguesit, por disa politika dhe standarde të reja janë miratuar siç detajohen në këtë raport. Zbatimi kërkon punë të mëtejshme ¹⁴

2.2.a.1. Rritja me të paktën 50 për qind, nga viti 2017 deri në vitin 2020, e efektivitetit dhe eficiencës së funksionimit të 13 Mekanizmave Koordinues ekzistues. {Njësia matëse: përqindja. Të ndarë sipas: komunave ku ekzistojnë MK-të. Mjetet e verifikimit: të dhënat zyrtare për gjithçka si më sipër, të nxjerra nga vlerësimi për funksionimin e MK-ve që mund të realizohet gjatë viti 2016} → Me sa duket pjesërisht i zbatuar pas trajnimeve por efikasiteti i përmirësuar jo domosdoshmërisht i qartë. ¹⁵

¹⁴ Sipas mendimit të RrGK-së, ky tregues u ndërlikua pa nevojë dhe është vështirë të matet. Ndoshta ndonjë tregues më i thjeshtë do të ishte numri i politikave dhe standardeve të reja të zbatuara, me pikënisje dhe objektiva të qarta të vendosura.

¹⁵ Sipas këndvështrimit të RrGK-së, ky tregues ishte i vështirë për tu matur, veçanërisht pasi kuptimi i efikasitetit nuk ishte përcaktuar qartë dhe të dhënat nuk dukeshin të disponueshme.

2.3.a.2 Themelimi i tetë Mekanizmave Koordinues të rinj çdo vit duke filluar nga viti 2017, në komunat ku mungojnë. {Njësia matëse: numri. Të ndarë sipas: komunave, institucioneve që mbështesin ngritjen e MK-ve, vitit kur themelohen, numrit të institucioneve që marrin pjesë, etj. Mjetet e verifikimit: të dhënat zyrtare për gjithçka si më sipër, dërguar në fund të vitit, nga çdo institucion zbatues tek Zyra e Koordinatorit Nacional kundër DhF-së; raporti vjetor i monitorimit të zbatimit të strategjisë, që do të prodhohet nga Zyra e Koordinatorit Nacional kundër DhF-së, bazuar në sistemin e M&E-së që do të krijohet në kuadër të zbatimit të kësaj strategjie} → Pjesërisht e zbatuar 6# i MK të reja të themeluara- gjithsej (jo në çdo vit) të vendosura në: Ferizaj, Hani i Elezit, Obiliq, Mamusha, Malisheva dhe Mitrovica e Jugut. Kjo përfshinte tre në 2018, dy në 2019 dhe një në 2020. Informacione të tjera nuk janë në dispozicion.

2.3.a.1. Rritja me të paktën 3 për qind, duke filluar nga viti 2018, e shërbimeve ndërinstitucionale dhe të koordinuara për mbrojtjen e viktimave të DhF-së. Shërbimet duhet të jenë të shumëllojshme dhe sipas standardeve të kërkuara në legjislacionin vendor dhe atë ndërkombëtar. → Pjesërisht e zbatuar: Edhe pse metoda e matjes është e paqartë dhe është vështirë të bëhet matja e tij, koordinimi duket se është përmirësuar në mesin e MK. Megjithatë, shërbimet e kufizuara mbesin të disponueshme, gjë që lidhet me kufizimet në legjislacionin kombëtar.

Objekti i specifik 2.1. Avancimi i politikave gjithëpërfshirëse në kuadër të mbrojtjes së viktimave të dhunës në familje										
2.1.1. Rishqyrtimi dhe rishikimi i politikave dhe programeve ekzistuese	Viktimat, kryesit	KNKDhF-ja	ABGj-ja, ministritë përkatëse, organizatat ndërkombëtare, OJQ-të,	2016-2020	Numri i programeve të rishqyrtuara dhe i propozimeve të përgatitura; Numri i ndryshimeve të miratuara	Gjithsej 5,866.16 ABGJ 56,892 ¹⁶	Qeveria 5,866.16		0	0.5: ABGJ zhvilloi një vlerësim të PSV-ve, por asnjë politikë dhe program nuk duket se është rishikuar.
2.1.2. Rishikimi i nevojave për plotësimin dhe ndryshimin e formularëve të PSV-ve	Viktimat	ABGj-ja	Ministritë përkatëse, organizatat ndërkombëtare, OJQ-të,	2017 - 2018	Numri i formave të reja, të propozuara, të referimit; Numri i formave të reja, të aplikuara, të referimit	Gjithsej 391.58 ABGJ 5,821	Qeveria 391.58		0	0.5: ABGJ rishikoi ndryshimet e nevojshme për PSV-të, përfshirë përmes 5 punëtorëve, por nuk mund të propozonte ndryshime dhe forma të reja derisa të miratoheshin ligjet e reja përkatëse.

¹⁶ Në lidhje me këtë Aktivitet 2.1.1., ABGJ shkruajti në draft raportin që ata kanë shpenzuar 14,352 në 2018 dhe 42,540 në 2019 në lidhje me rishikimin dhe ndryshimin e politikave dhe programeve ekzistuese, si dhe mbi trajnimin dhe subvencionet për SKMDHF. Prandaj, kjo shumë totale mund të ketë të bëjë me aktivitete të tjera dhe linja buxhetore gjithashtu, por përfshihet këtu në total.

2.1.3. Përmirësimi i standardeve të shërbimeve për viktimat/të mbijetuarit e dhunës në familje	Viktimat dhe viktimat e mundshme	MPMS-ja	ABGj-ja, KNK-DhF-ja, OJQ-të, organizatat ndërkombëtare, MSh-ja, shtëpitë e shëndetit, drejtoritë komunale të shëndetësisë	2018 – 2020	Numri i standardeve të reja të propozuara; Numri i standardeve të përmirësuar/miratuara	Gjithsej 156.63	Qeveria 156.63		0	0
Objekti specifik 2.2. Rritja e funksionalizimit të mekanizmave koordinues institucionalë ekzistues në nivel lokal si dhe ngritja e tyre në komunat mungojnë										
2.2.1. Rritja e përgjegjësisë të ZBGj-ve për të përfshirë edhe detyrën si koordinator lokal i MK-ve, si dhe kompensimi adekuat i tyre në përputhje me përgjegjësitë e shuara	ZBGj-të dhe MK-të	Komuna	MPMS-ja, donatorët	2016 - 2020	Përshkrimi i punës së ZB-Gj-ve përfshin përgjegjësinë e tyre si koordinatorë të MK-ve; Paga e harmonizuar në përputhje me përgjegjësitë.	Gjithsej 66,000.00 <i>Për DhF-në nuk është alokuar buxhet i qartë.</i>	Qeveria 66,000.00		0	0.5: Në komunat e monitoruara, ZBGj-të tani koordinojnë MK-të, përveç në Ferizaj ku u emërua Zëvendës Kryetari. RrGK nuk gjeti indikacione të përfshirjes në përshkrimet e punës ose rritjen e kompensimit.
2.2.2. Krijimi i sistemit të menaxhimit të të dhënave për rastet e trajtuara në mënyrë të koordinuar nga ana e MK	Anëtarët e MK-ve	Komuna, KNDhF-ja	Ministritë përkatëse, Policia e Kosovës, anëtarët e MKve, Gjykatat themelore, Prokuroritë themelore, Këshilli Gjyqësor i Kosovës, donatorët, organizatat ndërkombëtare	2016-2020	Baza e krijuar e të dhënave; Raportet periodike të përpiluara dhe të dorëzuara tek anëtarët e MK-ve si dhe pranë KNKDhF-së	Gjithsej 56,632.00 <i>UNW</i>	Qeveria 13,832.00 Qeveria 7,600.00 Donatorët 35,200.00		0	0.5: Ekziston një bazë e të dhënave funksionale ku institucionet përkatëse fusin të dhënat e tyre. Megjithatë, jo çdo institucion vazhdimisht i fut të gjitha të dhënat, dhe raportet periodike nuk ishin të disponueshme.

2.2.3. Trajnimi i anëtarëve të MK-ve për bashkëpunimin ndërinstitucional si dhe përdorimin e sistemit të menaxhimit të të dhënave për rastet e trajtuara mënyrë të koordinuar nga ana e MK-ve	Anëtarët e MK-ve	KAP-i dhe mekanizmat e tjerë institucionalë që ofrojnë trajnime	KAP-i dhe mekanizmat e tjerë institucionalë që ofrojnë trajnime	2016-2020	Përqindja e anëtarëve të MK të trajnuar për përdorimin e sistemit, të menaxhimit të të dhënave, për rastet e trajtuara mënyrë të koordinuar; Kapacitetet e përmirësuara, demonstruar nga përdorimi me efektivitet dhe efikasitet të sistemit të të dhënave	Gjithsej 43,980.00		Donatorët 43,980.00	0	0.5: Disa institucione u trajnuan se si të përdorin bazën e të dhënave. Megjithatë, jo të gjithë po i fusin të dhënat në mënyrë të vazhdueshme, gjë që sugjeron vetëm kapacitete pjesërisht të përmirësuara.
2.2.4 Shtirja e Mekanizmave Koordinues komunalë në komunat që mungojnë	Viktimat dhe fëmijët e tyre	MAPL-ja	Institucionet përgjegjëse anëtare të MKve	2016 - 2020	Numri i MK-ve të reja të themeluara; Numri i memorandumëve të mirëkuptimit të nënshkruara	Gjithsej 199,991.00 <i>Asnjë buxhet i njohur nuk është alokuar për MK-të.</i>	Qeveria 199,991.00		0: Numri i komunave me KM ka mbetur i njëjtë si para adoptimit të kësaj strategjie.	0.5: Ka 6 MK më shumë, por jo në të gjitha komunat ku ato mungojnë. Kjo duket se është financuar nga aktetë ndërkombëtare dhe jo përmes financimit të institucionizuar të qeverisë. 17 memorandumë mirëkuptimi janë nënshkruar
2.2.5. Krijimi i një nënkategorije për financimin e Zyrës për Barazi Gjinore në nivel komunal dhe mbështetjen e funksionimit të MK-ve	MK-të	Komunat	Institucionet përgjegjëse anëtare të MKve	2017 - 2020	Numri i komunave, të cilat çdo vit, krijojnë një vijë buxhetore për mbështetjen e funksionimit të MK-ve	Gjithsej -			0: Shumica e komunave ende nuk kanë linja specifike buxhetore.	0: Komunat kanë linja buxhetore për zyrat për barazi gjinore, por është e paqartë nëse këto linja financojnë funksionimin e MK-ve. Linjat e përhershme të buxhetit nuk parashihen në Ligjin për Financat e Pushtetit Lokal ose në buxhetet.
Objekti i specifik 2.3. Përmirësimi i koordinimit dhe bashkëpunimit ndërinstitucional ndërmjet nivelit qendror, lokal dhe organizatave të shoqërisë civile, për mbrojtjen e viktimave, përmes qartësisht të roleve, detyrave dhe përgjegjësisë të secilit institucion në ofrimin e shërbimeve adekuata.										

2.3.1. Shtimi i shërbimeve, të ofrimit të ndihmës ligjore falas, për viktimat e dhunës në familje	Viktimat, familja	MD-ja	Gjykata, Oda e Avokatëve, OJQ-të	2016 – 2020	Numri i shërbimeve të reja, të ndihmës ligjore falas, të ngritura në vit (objektiv mund të jetë edhe shtrirja në komuna)	Gjithsej 229,545.23 Nuk ka është alokuar asnjë buxhet i njohur.	Qeveria 229,545.23		0	0.5: Që nga korriku 2018, janë hapur 14 zyra të lëvizshme dhe ofrojnë ndihmë juridike falas përmes 21 zyrave për ndihmë juridike falas. Disa shërbime të reja janë ofruar.	
2.3.2. Shtimi i numrit të Mbrojtësve të Viktimave serbishtfolës (si dhe folës të gjuhëve të tjera sipas komuniteteve joshumicë që ekzistojnë në Kosovë) në zyrat ekzistuese, si dhe hapja e zyrave të Mbrojtësve të Viktimave (aty ku mungojnë p.sh në veri)	Viktimat dhe fëmijët e tyre	Prokuroria e Shtetit, MV-të	KNKDHf-ja, donatorët, mbrojtësit e viktimave	2016-2020	Numri i MV-ve serbishtfolës (si dhe folës të gjuhëve të tjera sipas komuniteteve joshumicë që ekzistojnë në Kosovë) të shtuar në zyrat ekzistuese; Numri i zyrave të reja të hapura (objektiv është shtrirja gjeografike)	Gjithsej 251,400.00 Nuk është alokuar asnjë buxhet i njohur shtesë.	Qeveria 251,400.00		0	0.5: I zbatuar: 15 MV-ve të reja u shtuan, mes tyre janë dy që flasin gjuhën serbe, dy që flasin gjuhën turke dhe një që flet gjuhën boshnjake. Asnjë nuk e flet gjuhën rome. Asnjë zyre e re nuk është krijuar, por nuk është e nevojshme sipas	
2.3.3. Shtimi i numrit të stafit të shërbimit, të linjës ekzistuese telefonike falas, edhe me punonjës serbishtfolës (si dhe folës të gjuhëve të tjera sipas komuniteteve joshumicë që ekzistojnë në Kosovë) si dhe shtrirja e këtij shërbimi në zonat ku mungon (p.sh. në veri)	Viktimat dhe viktimat e mundshme	Prokuroria e Shtetit	KNDHF-ja, MDja, OJQ-të, organizatat ndërkombëtar, komunat, donatorë	2016 - 2017	Numri i stafit serbishtfolës të shtuar në shërbimin ekzistues të linjës telefonike të ndihmës (si dhe folës të gjuhëve të tjera sipas komuniteteve joshumicë që ekzistojnë në Kosovë). Shërbimi i ngritur aty ku mungon	Gjithsej 198,720.00 Nuk është alokuar asnjë buxhet i njohur shtesë.	Qeveria 198,720.00		0	Ata nuk e kanë rritur numrin e stafit. Megjithatë, MV-të thanë se flasin gjuhët lokale	0.5: Nuk ka rritje të numrit të stafit të linjës së ndihmës për MV. Sidoqoftë, stafi flet shqip dhe serbisht. Dy linja ndihme janë të disponueshme në veri të Kosovës.
2.3.4. Krijimi i partneritetit ndërkomunal (rajonale) për identifikim, eferim, strehim, rehabilitim dhe fuqizim të viktimave të DhF-së.	Viktimat dhe fëmijët e tyre	Komunat, MPB-ja, MPMS-ja	QPS-të, strehimoret, Policia rajonale, OJQ të, organizatat ndërkombëtare	2016 - 2020	Numri i marrëveshjeve rajonale të nënshkuara; Përqindja e buxheteve komunale të transferuara për këtë qëllim	Gjithsej -			0.5: Kjo ekziston në disa komuna, por jo në të tjera.	0.5: 64 partneritete rajonale ekzistojnë. Sidoqoftë, vetëm katër komuna kanë buxhete të ndara.	

2.3.5. Përmirësimi i shërbimeve për fëmijët dëshmitarë të dhunës në familje, me theks të veçantë fëmijët - djem mbi 12 vjeç	Fëmijët, djemtë mbi 12 vjeç	QPS-të	Komuna, OJQtë	2016 - 2020	Numri i shërbimeve të ngritura për fëmijët dëshmitarë të dhunës në familje; Numri i qendrave që mundësojnë mbrojtjen dhe trajtimin e djemve mbi 12 vjeç	Gjithsej 97,915.10 Nuk është alokuar buxheti	Qeveria 97,915.10		0	0.5: Ekzistojnë dhoma të veçanta në disa QPS të vendosura për të intervistuar fëmijë (nga UNICEF). Ende nuk ka hapësirë specifike për djemtë mbi 12 vjeç me nënat e tyre, megjithëse Shtëpitë dhe Shpresa për Fëmijët dhe Strehimorja SOS, vazhdojnë t'i trajtojnë djemtë individualisht
2.3.6. Përshtatja e shërbimeve mbrojtëse, në mënyrë që të jenë të qasshme, edhe për grupet me nevojë të veçanta (të tillë siç janë personat me AK, LGBT, komunitetet joshumicë – ofrimi i shërbimit në gjuhën e tyre, etj), në përputhje dhe me standardet e përmirësuara dhe të miratuara bazuar në ato ndërkombëtare	Viktima të DhF-së, sidomos ato me nevojë apo nga grupe të veçanta,	MPMS-ja, KNDHF-ja dhe palë të tjera pjesëmarrëse	Komuna, OJQtë	2017-2020	Numri i shërbimeve mbrojtëse të përshtatura edhe për trajtimin e grupeve me nevojë të veçanta	Gjithsej ¹⁷ -			0	0: Ende ka ndërlikime me qasjen për personat me aftësi të ndryshme. Nuk është e qartë nëse shërbimet e mbrojtjes arrijnë tek personat LGBT. Shërbime të reja në dispozicion për pakicën serbe, por është e paqartë nëse janë në dispozicion për të tjerët.

¹⁷ Ndërsa nuk ishte paraparë asnjë buxhet, pa dyshim vendosja e shërbimeve të reja do të përfshinte kosto.

